

Bashkim Ali Azemi

FJALOR I PEDAGOGJISË

Prishtinë, 2024

Bashkim Ali Azemi

FJALOR I PEDAGOGJISË

Prishtinë, 2024

Botues:

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin

Dr. Ismet Potera

Autor:

Bashkim Ali Azemi

Recensentë:

Dr. Demë Hoti

Dr. Jonuz Dërvodeli

Lektura:

Sabit Jaha

Radhitja kompjuterike:

Skender Mekolli

PARATHËNIE

Të nderuar lexues,

Fjalorët, në këtë rast pedagogjik, kanë rol informativ për lexuesin ose profesionistin e fushës që i dedikohet. Përveç aspektit informativ, rëndësia e fjalorëve qëndron edhe në zhvillimin akademik të punonjësve arsimorë dhe intelektual në përgjithësi. Bazamenti i zhvillimit dhe i sforcimit të njohurive dijeve është zbërthimi i koncepteve dhe të kuptuarit e tyre, prandaj edhe janë ndërtoar e konceptuar fjalorë shumë specifik dhe të përgjithshëm.

Ky fjalor është hartuar që t'ju ofrojë një mundësi për të kuptuar dhe përdorur terminologjinë pedagogjike. Fjalori është punuar me përkushtim dhe qëllimi ka qenë për të sjellë te lexuesit një fjalës të pasur të termave dhe koncepteve që janë të rëndësishme në fushën e arsimit dhe pedagogjisë. Gjithashtu qëllimi i këtij fjalori është të shërbejë si forum për pedagogët, studentët, hulumtuesit e rinj dhe të gjithë ata që janë të interesuar për edukimin dhe mësimdhënien.

Në këtë fjalor, do t'i gjeni jo vetëm përkufizimet por edhe lidhjet e ndryshme në mes termave dhe nocioneve që mundësojnë për të krijuar një panoramë të plotë të terminologjisë pedagogjike që e shndërron atë në një udhëzues të vlefshëm për zgjerimin e njohurive tuaja në fushën e arsimit, pedagogjisë dhe mësimdhënies. Në fjalor secili term është shoqëruar me një

shpjegim të veçantë bazuar në kontekstet e përdorimit të tij qoftë në mësimdhënie, në të mësuarit në klasë dhe konteksteve të tjera duke ju ndihmuar të kuptoni thellësisht kontekstin dhe aplikimin e tij në praktikë.

Në këtë fjalor (si udhëzues referencë terminologjike), do të gjeni nocione, terma, shprehje për pasurimin e njohurive për mësimdhënien dhe për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse, për çështje thelbësore dhe metodologjike të mësimdhënies dhe të mësuarit në klasë¹.

Fjalori i pedagogjisë i referohet praktikës së përmirësimit të vazhdueshëm të të kuptuarit të nocioneve, termave dhe koncepteve themelore që aplikohen në kontekstin e mësimdhënies, pa synuar që t'i përfshijë të gjitha, në kontekstin e klasës gjatë punës me nxënës në funksion të mësimdhënies.

Pasurimi i fjalorit të pedagogjisë² është konceptuar si ndihmesë në shpjegimet e shprehjeve terminologjike (nocione, terma, shprehje) që aplikohen në kontekstet e mësimdhënies dhe të të mësuarit dhe i njëjti mund të plotësohet dhe të përshtatet me kushtet dhe kontekstet e reja në të cilat po hyn shoqëria jonë dhe sistemi arsimor i vendit. Zhvillimet dinamike sociale dhe arsimore sigurisht që do të imponojnë rivlerësimin, rishikimin dhe

¹Nga literatura mësojmë se terminologjitë dhe fjalorët shpjegues u kanë shërbyer fushave të dijes apo brenda një fushe dijeje, në formë dhe përmbajtje ku terminologjia ofrohet në lidhje me konceptin dhe termin, çdo term identifikohet si një dhe i vetëm në shkencën përkatëse, saktësia e shënimit të konceptit, qartësia e termit dhe termave themelore, si dhe shpjegimi i tyre përems përkufizimit, pastaj terma të huazuar nga fushat tjera por që kanë gjetur përdorim edhe në pedagogji.

²Fjalori i pedagogjisë, Bashkim Ali Azemi 2014.

Fjalor i pedagogjisë

përfshirjen e koncepteve, nocioneve dhe termave të rinj që, në ndërkohë, do të futen në komunikimet shkencore dhe akademike në fushën e arsimit dhe të edukimit.

Botimi i këtij fjalori do të sjellë nga lexuesit vërejtje, sugjerime dhe këshillat për nocionet e termat të cilat nuk janë përkufizuar me të gjitha kuptimet e mundshme dhe për këtë, do të jem gjithnjë i gatshëm që këtij fjalori t'i rikthehem dhe ta pajisë atë me të gjitha prurjet nga lexuesit e tij.

Duke ju falënderuar që keni zgjedhur për ta përdorur Fjalorin e Pedagogjisë, shpresojmë që ky libër do të jetë i dobishëm dhe frytdhënës në rrugëtimin tuaj në botën e pasur dhe sfiduese të edukimit dhe arsimit.

Shfletim dhe përdorim të këndshëm!

A

Abstraktim: Procesi i heqjes ose eliminimit të karakteristikave nga diçka për ta reduktuar atë në një grup karakteristikash thelbësore. Proces i ndarjes të së përgjithshmes dhe asaj që është fillimisht e përbashkët nga ajo që është e posaçme dhe shumë individuale, ose ndarja e së posaçmes, e cila përmban atë që është e përbashkët nga e veçanta dhe që është formuar si e veçantë, që dallohet me disa dispozita nga e përgjithshmja.

Abstrakt i një kërkimi: Është një përmbledhje e shkurtër që i përshkruan aspektet më të rëndësishme të një punimi.

Adaptimi: Është proces i zhvillimit për t'u përshtatur (akti i ndryshimit të sjelljes për ta bërë atë të përshtatshme) për një qëllim ose situatë të re.

Administrim i të dhënave të gatshme: Të dhënat hulumtuese që merren nga portofoli, dokumentacioni, udhëzimet, ligjet etj.

Administrimi i identitetit digjital: Ka të bëjë me menaxhimin etributeve që lidhen me përdoruesin (grupin e përdoruesve ose identitetin e ndonjë përdoruesi tjetër që mund të kërkojë qasje herë pas here në sistem) të krijojë, adaptojë dhe drejtojë një ose më shumë identitete digjitale, të jetë i aftë të mbrojë reputacionin e dikujt, të merret me të dhënat që ai prodhon përmes disa llogarive të aplikimeve.

Administruesi i testit të maturës: Mësimdhënësi apo zyrtari profesional i cili përzgjidhet nga organet kompetente për administrimin e testimit nga MASHT përkatësisht mbikëqyrjen e procedurës së testimit për nxënësit.

Afazia: Është çrregullim në të folur, vështirësi komunikimi, përkatësisht paaftësia për të folur dhe kuptuar fjalët që dëgjon, që ka të bëjë me humbjen e aftësive gjuhësore të fituara, zakonisht si rezultat i goditjeve apo lëndimeve të trurit apo deformimeve të qendrave gjuhësore të trurit. Mund të jetë motorike, sensorike ose perceptive. Për nga natyra dhe ajo ndryshon nga vonesa e thjeshtë e gjuhës.

Aftësitë pedagogjike të mësimdhënësit: Nënkuptohen aftësitë praktike dhe teorike të mësimdhënëseve, që ju lejojnë atyre t'i përshtatin me nevojat e nxënësve, strategjitë e të mësuarit dhe të mësuarit në situata të ndryshme të mësimin në përshtatje me veçoritë individuale të nxënësve duke e konsideruar procesin e të mësuarit si një proces që vazhdon gjatë gjithë jetës.

Afeksion i mësimdhënësit ndaj nxënësit: Përkujdesi dhe mbështetja e mësimdhënësit në jetën personale të nxënësve kur përballen me probleme emocionale apo ndërpersonale, ndihmë që të neutralizojë efektet negative në mësim dhe në sjellje.

Afekt: Gjendje emocionale shumë e fuqishme, që zgjat pak sekonda dhe mund të manifestohet si dëshpërim i madh ose gëzim i pafrenueshëm.

Aftësi: Veçori individuale (predispozitë e lindur ose e fituar për të bërë diçka), relativisht e qëndrueshme, që ndikon në kryerjen me sukses të një veprimtarie dhe përcakton përshtatshmërinë e

njeriut për kryerjen e ndonjë lloj veprimtarie, apo ndaj disa llojeve të saj.

Aftësia (ndikimi i saj për nxënësit): Ndikon në përvetësimin e shpejtë dhe të lehtë të njohurive, shkathtësive e shprehive dhe në origjinalitetin e zbatimit të tyre në të mësuar dhe në jetë.

Aftësi të mësimdhënësit profesionist: Aftësitë e nevojshme për krijimin e planeve mësimore, udhëzimin e nxënësve, punën me administratorët dhe ndërveprimin me prindërit që merren në sistemin e arsimit formal gjatë përvojës dhe i'u krijojnë mundësitë të punojnë me fëmijët për të zhvilluar njohuritë e tyre dhe të menduarit kritik (aftësi profesionale në lëndën që ai jep mësim, aftësi pedagogjike, aftësi komunikuese dhe aftësi vlerësuese).

Afniteti: Term për përvetësimin e shpejtë dhe të lehtë të diturive, shprehive e shkathtësive si dhe identifikimi i rrugës origjinale dhe më të suksesëshme për zbatimin e tyre në jetë.

Aftësi emocionale të nxënësit: Nënkupton aftësin për të shprehur ndjenjat e tyre duke folur, komunikuar për situatën dhe qartësuar se si ndjehet ai.

Aftësi në matematikë: Përkufizohet si aftësia e nxënësit për të formuluar, punuar dhe interpretuar konceptet matematikore në kontekste të ndryshme për të përshkruar, shpjeguar dhe parashikuar rolin që luan matematika në jetë.

Aftësi në shkencë: Përkufizohet si aftësia për t'u angazhuar me probleme në lidhje me shkencën, dhe me idetë e shkencës si individ reflektues me aftësi analitike.

Aftësit njohëse: I referohet aftësive (për nxënësit) për të regjistruar, njohur dhe kuptuar sinjale që vijnë nga të tjerët (në mënyrë të veçantë ndjeshmëria për nevojat njohëse, dhe të të mësuarit).

Aftësi punë: Veçori psikike individuale, cilësi e personalitetit, prej së cilës varet shpejtësia në kryerjen e suksesshme të një pune.

Aftësi të komunikimit: Veçori individuale të komunikimit gjatë bashkëpunimit, ndërveprimit me të tjerët për të marrë informacion, e dhënë informacion, ofrim i shpjegimeve e qëndrimeve aktive gjatë zbatimit të tyre në jetë.

Aftësi themelore: Aftësi bazike të strukturuar qartë, individuale e të nevojshme për të mësuarit e mëvonshëm dhe që u mësohen nxënësve hap pas hapi.

Aftësia e kufizuar intelektuale: I referohet kufizimeve të ndjeshme në funksionimin intelektual të shprehura në aftësitë konceptuale, sociale dhe të përshtatjes. Aftësia e kufizuar intelektuale pasqyron përputhshmërinë mes mundësive të individit dhe strukturës së pritshmërive të mjedisit.

Aftësim profesional: Nënkupton sistemin e organizuar me përmbajtje konkrete dhe qëllim të veçantë për aftësimin në kryerjen me sukses të një profesioni të caktuar, të cilin e kryen tani nxënësi/individit ose do ta kryejë në të ardhmen.

Aftësit intelektuale: Nënkuptojnë aftësi mendore të shprehura si aftësi konceptuale (si marrim kodifikojmë dhe ruajmë informacionin) sociale (si përdorim rregulla, udhëzime të mësuara me parë për zgjidhjen e problemeve) dhe të përshtatjes (si i

përdorim ato aftësi në përputhshmërinë mes mundësive të individit dhe strukturës së pritshmërive të mjedisit në të ardhmen).

Aftësitë e të lexuarit të nxënësit: Nënkuptohen apo vlerësohen si shkallë gatishmërie, në të cilën nxënësit mund të përdorin aftësitë e tyre të leximit për të interpretuar lloje të ndryshme të materialeve të shkruara, materiale me të cilat ata ndeshën në jetën e tyre të përditshme.

Aftësitë e nxënësit: Nënkuptohen vecoritë psikike, cilësitë që zotëron një nxënës për të përmbush një detyrë, veprim, aktivitet, në mënyrë të suksesëshme brenda një afati të caktuar kohor të dhënë nga mësimdhënsi.

Aftësitë jolokomotore të nxënësit: Nënkuptohen lëvizjet që i kryejmë kur trupi nuk zhvendoset në hapësirë, përfshijnë format e ndryshme të ekuilibrit (qëndrimi me një këmbë) apo lëvizje të tjera si të përkulurit e pjesëve të ndryshme të trupit në drejtime të ndryshme, p.sh. përkulja e trupit para, prapa, majtas apo djathtas, përkulja e qafës në drejtime të ndryshme etj.

Aftësitë lëvizore manipulative të nxënësit: Nënkuptohen lëvizjet që kryhen gjatë bashkëveprimit me objekte të ndryshme, gjatë hedhjes së tyre, p.sh. të gjuajturit, të goditurit, të hedhurit etj, gjatë kapjes së tyre, p.sh. të kapurit, të shtypurit etj.

Agjent ndryshimi në arsim: Një person, grup, agjenci që synon të ndryshojë, të ristrukturojë, të transformojë arsimin, konceptet, rrethanat, proceset, institucionet, vetën.

Agnozia: Paaftësia e rinjohjes së objekteve dhe dukurive të përceptuara më parë dhe të kuptuarit e tyre.

Agrafia: Humbja e pjesëshme ose e plotë e aftësisë së shprehjës së mendimeve me anë të shkrimit. Humbje e aftësisë për të shkruar në mënyrë të rregullt, paaftësia për të bashkuar shkronjat ose rrokjet për të formuar fjali.

Agresiviteti: Sjellja dhe kundërshtimi ndaj njerëzve që e rrethojn ndjenjë e të shprehurit të ndjenjave me veprim agresiv verbal apo fizik apo të dyja së bashku.

Agresivitet fizik: Mënyrë ndërveprimi apo sjelljeje ku synohet të plotësohen nevojat e menjëhershme të vetvetës duke rezultuar në shkaktimin e dëmit apo dhimbjes tek të tjerët, p.sh. Grushtimi.

Akronimet: Nënkuptojnë fjalë të krijuara me germat e para të termave të mësuara mneomonika e germave të para të çdo fjale në grup fjalësh dhe formimi i një fjalie të re, kryesisht shkronjat e para të çdo fjale në grup fjalësh, por ndonjëherë mund të përdoren edhe rrokje (në raste të rralla) p.sh. MASHT-Ministria e Arsimit Shkences dhe Teknologjise. Megjithatë duhet të ketë kujdes që jo të gjitha fjalët mund të shkruhen me akronime ngase përdorimi i tyre i pavend sjell huti tek lexuesi (p.sh në fillim të tekstit).

Akrosti: Fjalë të krijuar me fjalë që rrjedhin nga germat e para të termave mësimore.

Aktivitet: Veprimtari e organizuar e procesit mësimor nën udhëheqjen e mësimitdhënsit për të arritur një qëllim edukativ ose për të pasur rezultate të caktuara në një aktivitet mësimor.

Aktivitet hulumtues: Veprimtari zbuluese, kontrolluese ku bëhen kërkime për diçka të re.

Aktivitet i lirë nga nxënësit: Çdo lloj veprimtarie që ndërmarrin nxënësit pa u udhëzuar dhe e drejtuar nga ana e mësimit.

Aktivitet i përbashkët i mësimit: Aktivitet i organizuar dy nga dy, ose në grupe, në mënyrë që të ndërtohet së bashku njohuria përmes ndërveprimit asimetrik, është i rëndësishëm për të zhvilluar kuptimet e ndara ndërmjet tyre, ose të kuptuarit e përbashkët të nxënësve.

Aktivitet jashtëshkollor: Veprimtari edukative që organizohet dhe realizohet jashtë shkollës, por nën udhëheqjen e mësimit.

Aktivite festive kulturore në shkollë: Mbajtja e festave dhe formave të tjera masive, me qëllim njohjen e fëmijëve me kulturën dhe traditat e kombit (popullit) të tyre.

Aktivite pedagogjike që funksionojnë (histori personale të mësimit): Aspekte të organizimit didaktik pa njohuri pedagogjike që din t'u shpjegojnë nxënësve dhe që zbatohen në situata të ndryshme mësimore, e të cilat nxisin motivimin dhe interesimin e nxënësve për njohuri.

Aktivitetet e të mësuarit të objektivave: Veprimtaritë që synojnë t'i përfshijnë nxënësit në proceset e të mësuarit të një objekti të të mësuarit që është rezultati përfundimtar i dëshiruar i procesit të shpjegimit të të mësuarit.

Aktivitetet e të mësuarit (të përshtatshme e objektivave): Veprimtaritë që synojnë t'i përfshijnë nxënësit në proceset e të mësuarit të cilat zotërojnë dy karakteristika. Së pari, ato janë të

përshtatshme për nxënësit dhe së dyti, ato janë të lidhura me arritjen e objektivave të përcaktuara të të mësuarit.

Aktivitetet e të mësuarit: Procesi i mësimdhënies dhe të mësuarit përmes të cilit arrihet rezultati në klasë përkatësisht të gjitha veprimtaritë që përdorin mësimdhënësit që ti përfshijnë nxënësit në proceset e të mësuarit të cilat janë të përshtatshme për nxënësit dhe të përcaktuara nga mësimdhënësi.

Akulturimi: Procesi i asimilimit të elementeve kulturore të huaja nga ana e një grupi.

Alali: Mungesë e të folurit të artikuluar, manifestohet në mosshqiptimin e drejtë të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve, ose në vështirësitë e lidhjes së tingujve ndërmjet vete.

Album mësimor: Mjet mësimor i konkretizimit të mësimit, që përmbledh fotografi, portrete, skica, vizatime, harta dhe diagrame.

Alegoritmet kurrikualare: Janë këndvështrime të hollësishme profesionale për ndjekjen e procedurave të zbatimit të kurrikulit si proces dhe zhvillim.

Alfabeti Brajl Alfabeti i Louise Braille/Luj Braj: Një sistem gjashtëpikësh të ngritura në relief, (alfabeti me shkronja në relief) i hartuar nga Brajli që përdoret për të mësuar dhe komunikuar nga individët me dëmtime në të parë, të cilët i aftëson për të shkruar, lexuar dhe komunikuar.

Alternativa drejt përmirësimit të mësimdhënies: Nënkupton preokupime të mësimdhënësit të cilët janë të vëmendshëm se diçka nuk po ecën me procesin e mësimdhënies së tyre pas

përpyekjeve të përsëritura të strategjive dhe metodave dhe gjetjen e alternativave tjera efektive nga burimet ose vetëreflektimi i tij pas mësimdhënies.

Altruizëm: Ndjenjë humane e individit që ka të bëjë me respektimin e nevojave dhe kërkesave të njëri-tjetrit si genie njerëzore.

Ambicie: Synim i fuqishëm i individit për arritjen e një qëllimi të caktuar.

Analfabetizëm funksional: Paaftësia e njerëzve për të përdorur mjetet e reja të informacionit dhe të komunikimit.

Analfabetizëm emocional: Paaftësia e të mësuarit emocional kur ata që vuajnë prej tij nuk janë në gjendje të kuptojnë gjendjet e tyre emocionale, të kuptojnë ato të të tjerëve dhe të shprehin atë që ndjejnë vetë.

Analiza e përmbajtjes së një teksti: Një metodë sistematike për të grupuar shumë fjalë të një teksti në disa kategori përmbajtjesh, bazuar në rregulla të qarta. Analiza e përmbajtjes mundëson që të analizohen shumë të dhëna me lehtësi përmes një metode sistematike (për objektivat, tekstet e librave dhe për burime të tjera të të mësuarit si dhe për lloje dhe norma të ndryshme të vlerësimeve).

Analiza e përmbajtjes: Një mënyrë për të grupuar shumë fjalë të një teksti në disa kategori përmbajtjesh, bazuar në rregulla të qarta që të analizohen shumë të dhëna me lehtësi përmes një metode sistematike. Në fushën arsimore mund të përdoret për objektivat,

tekstet e librave dhe për burime të tjera të të mësuarit si dhe për lloje dhe forma të ndryshme të vlerësimeve.

Analiza interpretuese fenomenologjike: Qasje shpjeguese dhe idiografike, që nënkupton se ka për qëllim të ofrojë njohurit se si një person i caktuar, në një kontekst të dhënë, i jep kuptim një dukurie të caktuar, ngjarje të rëndësishme në jetë, ose zhvillimi i një marrëdhënieje të rëndësishme.

Analizë e detyrës profesionale: Procesi i përcaktimit të njohurive, shkathtësive, shprehive e qëndrimeve, si dhe të kushteve, procedurave teknikave dhe mjeteve e pajisjeve të nevojshme për të përmbushur një detyrë pune në përputhje me standardet profesionale.

Analizë e nevojave për trajnim të mësimdhënësve: Tërësi procedurash me anën e të cilave përcaktohen mungesat që kanë mësimdhënësit në njohuri, shkathtësi, shprehi, vlera dhe qëndrime, mungesa që i pengojnë ata për të përmbushur detyrat në përputhje me standardet e caktuara profesionale.

Analizë e punës profesionale: Procesi i përcaktimit të funksioneve dhe detyrave përkatëse (kërkesat e profesionit, mjedisin te punës, kushtet e punës, pajisjet dhe mjetet kryesore të punës etj.) të cilat përmbushen nga punonjësit e një profesioni të caktuar.

Analizë e tregut të punës për mësimdhënës: Procesi i përcaktimit të karakteristikave aktuale dhe perspektive të tregut të punës (epërsitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet) në lidhje me një punësim të ofruar, në një vend, e të cilat kanë të bëjnë kryesisht me kërkesën dhe ofertën për mësimdhënës.

Analizë: Veprim mendor, me anë të të cilit një objekt ose dukuri që e studiojmë e ndajmë mendërisht në pjesë.

Analizoj: Vë në dukje anët pozitive dhe negative të njohurive që i kemi për objektet që i analizojmë.

Analogjia: Mënyrë arsyetimi për shpjegimin e dukurive të ndryshme në bazë të ngjashmërisë ndërmjet tyre.

Andragogjia: Shkencë (relativisht e mëvetësuar) që merret me të mësuarit e të rriturve si proces vetëdrejtues apo me fasicelitim/mentorim për çfarëdo modaliteti të të mësuarit (formal, joformal dhe informal) prej tyre në profesion dhe jetë.

Andragogu: Mësimdhënësi që është aftësuar për trajnimin dhe punën me të rritur.

Androgjini: Nënkupton karakteristika të njëherëshme femërore dhe mashkullore.

Angazhim: Shfaqje e shprehje e përkushtimit të individit gjatë veprimtarisë mësimore duke përceptuar reagimin e çmuar e të vlerësuar.

Angazhimi i mësimdhënësit në klasë: Nënkupton një nga mënyrat, veprimtarit e mësimdhënësit se si gjindën, sillen ata në klasë, si do të demonstrojnë angazhimin e tij në kohën mësimore për problemet me komunikimin, menagjimin e klasës, përgjegjësi të tij për vlerësimin dhe gjithçka që bën mësimdhënësi për t'i ardhur në ndihmë nxënësve në të mësuar.

Angazhimi i nxënësit: Nënkupton shkallën e përpjekjes (angazhimit, kohës gjatë veprimtarive mësimore që shfaq dhe shpreh një nxënës në mësim.

Anketa me pyetje të mbyllura: Është teknikë hulumtuese, përmes së cilës pyetjet e parashtruara e kufizojnë të anketuarin në përzgjedhjen e një apo disa alternativave të parashtruara, për hulumtimin e opinioneve, interesave, motiveve dhe dëshirave, si dhe qëndrimeve të një grupi njerëzish për çështje të caktuara arsimore.

Anketimi (procedura): Procedura konkrete e hulumtimit që konsiston në ndërtimin e një pyetësoi të shkruar, i cili u shpërndahet njerëzve të përzgjedhur në bazë kriteresh të caktuara, për t'iu përgjigjur me shkrim. Përparësi kryesore ka mbledhjen e informacionit të gjerë brenda një kohe të shkurtër, p.sh. anketa me pyetje të hapura, ku i anketuari ka më tepër liri për dhënien e përgjigjes.

Anksioziteti: Është ndjenjë frike, emocion i lindur dhe i dobishëm që tregon rrezikun apo ndryshimin e paqartë, të papritur dhe nxit individin për t'u parapërgatitur dhe për t'u përgjigjur.

Ankth: Shqetësim ndaj një tensioni në përqëndrim të vëmendjes gjatë mëimit dhe testimit (mendim, ndjenjë negative që nuk e lë të qetë emocionalisht fëmijën/nxënësin).

Ankthi paraprak: Shqetësim ndaj një situate që ende ska ndodhur, që do të vijë apo që e ka përjetuar në të kaluarën e që fëmija përpiqet ti shmanget, anashkalojë, që ndikon në shpërqëndrimin e fëmijës/nxënësit dhe nuk e lë të qetë .

Ankth shkollor: Reagimi emocional i nxënësve ndaj kërkesave të tepruara që i përjetojnë gjatë aktiviteteve shkollore nga mësimdhënësit apo aktivitetet shkollore.

Antropologji sociale: Shkenca e ligjeve të përgjithshme që përcakton zhvillimin e kulturave të ndryshme shoqërore.

Apatia: Nënkupton mosndjenjë ose mosreagim emocional ndaj një ngjarje ose ndodhie të ndryshme shoqërore në shkollë ose jashtë saj.

Aplikimi i njohurive: Aplikimi i njohurive të nxënësve në situata reale në jetë.

Apraksia: Nënkupton vështirësi të komunikimit, që lidhen me aspektin motorik në të folur, në një bisedë, në përdorimin e fjalëve ose të fjalive të gjata, sidomos në situata që provokojnë ankth dhe tension. Fëmija di se çfarë dëshiron të thotë, por truri i tij e ka të vështirë të koordinojë lëvizjet e muskujve të nevojshëm për t'i thënë ato fjalë.

Argumentim: Arsyetimi i një procesi, dukurie apo zgjidhje të problemit, duke u bazuar në fakte relevante. E argumentuar është krejt ajo që nuk mund të përgënjeshtrohet me fakte.

Arritja e njohurive të nxënësit: Shkalla, sasia e njohurive të përgjithshme që ka përvetësuar një nxënës, deri në një moment të caktuar. Arritja ndryshon nga të mësuarit, pasi të mësuarit përbën një ndryshim në arritje me kalimin e kohës.

Arritje e programit: Shkalla e përmbushjes, rezultatet e dëshiruara (të realizmit) të objektivave, p.sh. të një program kualifikimi që rezultojnë gjatë zbatimit të programit.

Arritje e nxënësit: Çdo arritje e matshme ose e vëzhguar, që është rezultat i të mësuarit.

Arritshmëri të njohurive: Shkalla e përvetësimit të njohurive për një nivel shkollor.

Arsim gjatë gjithë jetës: Arsime gjatë gjithë jetës nga çdo individ, pavarësisht nga mosha, gjinia, niveli arsimor dhe grupi shoqëror.

Arsim profesional: Përvetësim i njohurive profesionale dhe kompetencat praktike që u jep mundësi individëve të fitojnë dhe praktikojnë shkathtësitë dhe shprehitë e duhura për ushtrimin e profesioneve të caktuara për punë, si parakusht për dhe gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale.

Arsim profesional i vazhdueshëm: Arsime dhe formim që përfshin dy periudha kryesore: periudhën e kualifikimit fillestar (kryesisht nëpërmjet arsimit profesional) dhe periudhën e kualifikimit të mëtejshëm (kryesisht nëpërmjet formimit profesional) të trajnimit të ndërthurur ose jo me punën që bën.

Arsimim: Nënkupton proces që zhvillohet gjatë punës mësimore dhe të mësimdhënies për përvetësimin e një sasive të caktuar të diturive, zhvillimin e shprehive e të shkathtësive, formimin e botëkuptimit shkencor, zhvillimin e aftësive psikofizike, intelektuale, funksionet gnoseologjike etj., në shkollë.

Arsimi dhe aftësimi për të rritur: Nënkupton tërë arsimin dhe aftësimin publik dhe privat të ofruar për të rriturit dhe /ose për të rinjtë mbi moshën 15-vjeçare, të cilët kanë të drejtë të ndjekin programet e mësimit, të hartuara për të rriturit.

Arsimi formal: Modalitet i arsimit gjatë gjithë jetës, i institucionalizuar me hirearki dhe kronologji nga niveli fillor deri në atë universitar në harmoni me planin dhe programin mësimor i cili realizohet nën udhëheqjen e mësimeve.

Arsimi informal: Modalitet i arsimit gjatë gjithë jetës i pastrukturuar dhe i natyrshëm individual i individit pavarësisht ku gjendet, në shtëpi, në lagje, në shkollë, për qëllim vetërealizimin dhe vetaktualizim e tij në punë apo në jetë.

Arsimi joformal: Modalitet i arsimit gjatë gjithë jetës i organizuar jashtë kornizave të institucionalizuar pa një hirearki dhe kronologji të qartë, i cili nuk kushtëzohet me dokumentacion paraprak formal apo certifikatë, me një përmbajtje të caktuar aftësimi për grupe të ndryshme fëmijësh apo të rriturish, certifikimi i të cilave njihet, pranohet nga institucionet publike.

Arsimim: Procesi që zhvillohet për tu ofruar mundësi për përvetësimin e njohurive, shikësive, që u mundëson njerëzve për t'u zhvilluar dhe shfaqur potencialin e tyre në shoqëri si rezultat i të mësuarit në shkollë apo në një institucion mësimor.

Arsimimi multikulturor për komunitete: Arsimimi që i ofrohet anëtarëve të grupeve minoritare që është i akceptueshëm për çdo nxënës pavarësisht cilit komunitet i takon.

Arsyetim: Formë e të menduarit logjik, kur nga dy apo më shumë gjykime që kanë lidhje ndërmjet tyre nxjerrin një gjykim të ri, arsyetimin përfundimtar.

Arsyetimi pedagogjik: Është një proces ciklik kur mësimdhënia fillon me të kuptuarit e qëllimeve të mësimdhënies, vazhdon me transformimin me të cilin mësimdhënësit i transformojnë njohuritë e tyre për përmbajtjen tek nxënësit në forma të adaptueshme pedagogjike, që përmbajtja të kuptohet varësisht sipas stileve të të mësuarit të nxënësve, pason me menaxhimin e klasës, shpjegimin ndërveprimin efektiv me nxënësit, diskutimin dhe ofrimin e udhëzimeve për vlerësim të të kuptuarit, përkatësisht reflektimi i mësimdhënies që bënë dhe në fund procesi i arsyetimit pedagogjik rikthehet për të ndikuar në të kuptuarit e mësimdhënies si rezultat i përvojës së arritur përmes praktikimit në klasë.

Artikulum: Veçori e të folurit të individit me hollësi të lartë shjtjellimi dhe veçanti për të menduar tipik.

Artikull: Punim shkencor për një temë të caktuar, i cili duhet të pasqyrojë drejt dhe qartë njohuritë aktuale shkencore, të jetë burim informativ i mundshëm për të gjithë.

Artikulli (vështrimi) shkencor: Është punimi shkencor që i kushtohet një problemi të vogël brenda një problemi të madh shkencor.

Aspekte të organizimit didaktik të të mësuarit bashkëpunues: Nënkuptohën procedurat dhe veprimet (aktivitete, konstruktive, reflektuese dhe autentike të të mësuarit në bashkëpunim mësimdhënës-nxënës.

Aspekte të organizimit didaktik të të mësuarit me kuptim: Nënkuptohen procedurat dhe veprimet (njohja, kuptimi, inkurajimi, dhe përforcimi).

Aspekte të organizimit didaktik të të mësuarit ndërveprues: Nënkuptohen veprimet e mësimdhënësit me pjesëmarrje në inkurajim, diskutim, nxitje dhe vlerësim të efikasitetit të të mësuarit të nxënësit si reagim i menjëhershëm sqarues dhe shpjegues nga ana e mësimdhënësit.

Aspekti kognitiv (njohës) i mësimdhënies: Nënkupton proceset mendore që ka të bëjë me përceptimin e të mësuarit, ruajtjen e informacionit, kujtesën, të menduarit dhe zgjidhjen e problemeve (detyrave, udhëzimeve dhe vlerësimin) dhe faktorët që ndikojnë në një proces me kompleksitet më të thellë njohës.

Aspiratë: Synimi ndaj një qëllimi të caktuar, që përcillet me një dëshirë dhe motiv të fuqishëm për realizimin e tij.

Atlas shkollor: Mjet mësimor sipas lëndëve shkollore, ku përfshihen harta, figura, fotografi etj.

Atmosfera në shkollë: Nënkupton mjedisin ose sipas terminologjisë së përgjithshme “ndjesia” e një nxënësi në një shkollë ose klasë në një moment të caktuar.

Atributet: Atributet kanë të bëjnë me veti a cilësi thelbësore të domosdoshme dhe të përhershme të sendeve apo dukurive.

Atributi në sjelljen e nxënësit në shkollë: Një shpjegim i shkaqeve dhe/ose pasojave të sjelljeve ose ngjarjeve. Dy llojet kryesore të attributeve janë: të brendshme (ku ai ose ajo mendon

se ai ose ajo është përgjegjëse për sjelljen ose ngjarjen), dhe të jashtme (ku përsioni mohon përgjegjësinë dhe fajëson faktorët e jashtëm për sjelljen ose ngjarjen e shkaktuar).

Audiolog: Nënkupton profesionistin, ai që administron testet e të dëgjuarit dhe rekomandon mënyra të specializuara se si mund të përmirësojnë ose kompensojë paaftësinë në të dëgjuar të individit.

Audiometri: Metodë e ekzaminimit të nivelit të dëgjimit që kryhet me aparate të posaçme elektroakustike, nga profesionisti, otorinolaringologu me qëllim përcaktimin e pragut minimal dhe maksimal të nivelit të dëgjimit të individit.

Autizëm: Çrregullim neurobiologjik i individit, që veçohet me vështirësi në komunikim, ndërveprim shoqëror dhe sjellje të përsëritura dhe “reze” të kufizuar interesash.

Autodidakt: Njeriu që mëson dhe përvetëson dituri, aftësi dhe shprehje jo në institucione të posaçme shkollore, por falë organizimit të procesit të të mësuarit sistematik nga vetë ai si vetëmësim dhe vetëdrejtim apo përzgjedhje të literaturës.

Autorët e teksteve shkollore: Hartuesit e teksteve shkollore që integrojnë një pedagogji të përshtatëshme për nxënësit, me aparaturë didaktike për një lëndë të caktuar mësimore.

Aktivitete mësimore: Nënkupton aktin e punës së nxënësit në shkollë “identifikimin” (të shkruarit, të lëxuarit, zgjidhjen e ekuacioneve matematikore) **kujdes** aktivitete mësimore nuk janë testet dhe vlerësimi.

Avantazh në të mësuar: Mbështetja e “shfaqur” dalluar në të mësuar në kohë apo sqarim të veçuar gjatë të mësuarit nga mësime të mësuara që shkakton ndjesi, privilegje të nxënës.

B

Banka e kërkesave/pyetjeve të një testi mësues: Nënkupton një grup pyetjesh të qarta, standarde me mundësi përdorimi sipas një parametri shkencor. Bankat e pyetjeve mund të ruajnë pyetje për fusha të ndryshme mësuese, sipas niveleve të vështirësive dhe për grupmosha të ndryshme. Kategoritë mund të kufizohen për t'u përdorur në nivelin e sajtit, kursit ose kuizit.

Barazia: Barazia do të thotë që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e individëve nuk do të varen nga fakti nëse ata janë meshkuj apo femra, me aftësi të kufizuara apo me paaftësi, të rinj apo të moshuar, të bardhë apo të zinj, apo në të ardhur nga mjedise rurale apo urbane.

Barazia gjinore e fëmijëve: Nënkupton përfshirjen dhe trajtimin e barabartë të fëmijëve gjatë edukimit, pa bërë dallime e diskriminime në baza gjinore (meshkull/femër). Barazia gjinore në shkollë reflektohet në raportet ndërmjet fëmijëve, raportet e të tjerëve me fëmijët, realizimin e aktiviteteve, përfshirjen në lojë, inkuadrimit në të mësuar etj.

Bashkëbisedim: Nënkupton bisedën midis dy ose më shumë njerëzve në të cilën shprehen mendimet, ndjenjat dhe idetë, bëhen pyetje dhe jepen përgjigje, ose shkëmbehen lajme dhe informacione.

Bashkëbisedim mësimor: Nënkupton situatat e ndryeshme që ndodhin ose planifikohen nga mësimdhënësi që ndodhin gjatë veprimtarisë mësimore në të cilën nxënësit mësojnë përmes ndërveprimeve me mësimdhënësin, ndërveprimeve me njëritjetërin, ose një nxënësi me nxënësit e tjerë.

Bashkëbisedimi vlerësues: Nënkupton procesin i cili shërben si një metodë ndihmëse e plotësuese në vlerësim nga vlerësuesi që orienton bashkëbisedimin drejt informacioneve që ka për qëllim të marrë.

Bashkëdukim: Termi i referohet edukimit të përbashkët të djemve dhe vajzave të dy gjinive (meshkuj dhe femra) që vijnë së bashku mësimet në të njëjtën klasë, shkollë ose institucion tjetër arsimor, dhe jo veçmas/ndaras.

Bashkëpunim: Filozofi se si të komunikosh një ide, të ndash me të tjerët, se si të mësosh dhe të ndërveprosh, bashkëpunosh për realizimin e asaj ideje.

Bashkërendimi: Nënkupton nivelin ku objektivat, vlerësimet, udhëzimet dhe burimet e të mësuarit përshtaten mirë me njëritjetrin në një moment të caktuar.

Bashkërendimi i jashtëm: Nënkupton ndërveprimet midis atyre që mund të kontrollohen brenda një shkolle, ose brenda një sistemi shkollor dhe asaj që shtrihet përtej kontrollit të mësimdhënësve, të cilët punojnë brenda një shkolle ose brenda një sistemi shkollor (p.sh. ligjet, politikat, kushtet e punës). Fokusi i bashkërendimit të jashtëm mund të përqendrohet në një moment kohor, ose në të gjithë harkun kohor të një strategjie, ose së bashku.

Bashkërendimi vertikal: Nënkupton nivelin ku objektivat, vlerësimet, udhëzimet dhe burimet e të mësuarit përshtaten mirë me njëri-tjetrin në një moment të caktuar (bashkërendimi horizontal) ose me kalimin e kohës (bashkërendimi vertikal).

Bashkëveprim: Nënkupton mënyrën e të punuarit me të tjerët, puna e përbashkët me ndonjë person ose organizatë për të arritur një qëllim të përbashkët, apo arritjen e një rezultati në edukim.

Bashkëveprimi i mësimdhënsit me nxënësit: Nënkupton procesin e agazhimit të nxënësve gjatë planifikimit të veprimtarive, (kërkesa nxënësve për mësimin dhe për sjellje të përshtatshme, t'i japësh sinjale të qarta, t'i kryesh kalimet nga një veprimtari në tjetrën me qetësi dhe të parashikosh e të ndalosh problemet para se ato të fillojnë), të përzgjedhësh realizimin e veprimtarive efektive që vëmendja e interesi i nxënësve të ruhët e të rritet dhe jo të shuhët.

Baza materiale dhe didaktike: Nënkupton, e përcakton shkallën e përdorimit të bazës materiale didaktike të planifikuar; përshtatshmërinë e saj me përmbajtjen mësimore, lehtësinë e përdorimit nga nxënësit dhe mësimdhënsit dhe nivelin e punës së përbashkët nga mësimdhënsit dhe prindërit për përgatitjen (nxënësve/fëmijëve) të tyre për jetën.

Bihejviorizëm: Nënkupton një nga teoritë e të mësuarit që përqendrohet të sjelljet e individit që mund të vëzhgohen.

Belbëzim klonik: Nënkupton çrregullimin e rrjedhshmërisë së të folurit (të nxënësit/fëmijës) që shkakton përsëritje jo të rregullt por të theksuar të një bashkëtingëlloreje në fillim të një fjalie.

Belbëzim tonik: Nënkupton çrregullimin e rrjedhshmërisë së të folurit (nxënësit/fëmijës) që shkakton një bllokim, si pasojë e të cilit kemi një ndërprerje të rrjedhës normale të frazës, ndonjëherë madje që në fillim të saj.

Belbëzim: Nënkupton çrregullim të ritmit dhe të artikulimit të fjalëve (nxënësit/fëmijës) përkatësisht çrregullimi i rrjedhshmërisë së të folurit, mosnxjerrja fare e zërit, zgjatja e tepruar e disa tingujve, përsëritje e shkronjave, rrokjeve apo fjalëve.

Benefitet në arsim: Nënkuptohen përfitimet e sjellura të cilat mund të vëzhgohen ose të përshkruhen me fjalë (që ndërlidhen me aspekte dhe veprimtari tjera në shoqëri).

Besim në edukim: Nënkupton mbështetje siguri te fjalët e dikujt, si të vërteta, që përkojnë me mendimet dhe qëndrimet e tij në aspektin e edukimit.

Besueshmëria e kërkimit: Nënkupton përmasa në të cilën përfundimet e kërkimit shkencor janë të qëndrueshme sa herë që ai të përsëritet, si dhe përmasa në të cilën një studim mund të replikohet (mund të përsëritet nga studiues të tjerë).

Bibliografia libër: Nënkupton libër që përmbledh, vlerëson, zgjedh, analizon përmbajtjet dhe përshkruan veprat e publikuara, të shumëzuara dhe që janë të dedikuara për publikun.

Bibliografia: Nënkupton literaturë e cituar, që zakonisht jepet në fund të kapitujve të librit ose në fund të librit.

Bibliotekë shkollore: Nënkupton hapësira (ambienti në shkollë) ku janë të vendosura të gjitha tekstet (lektyra, romane, enciklopedi) dhe shfrytëzohet nga mësimdhënësit, nxënësit dhe stafi tjetër për t'u shërbyer me literaturën e nevojshme.

Bihejvioristët: Nënkupton mbështetësit e kësaj teorie që shprehën se të mësuarit është një ndryshim në sjellje, nga mënyra se si një (nxënës/fëmijë) vepron në një situatë të veçantë që sipas tyre më shumë përcaktohet nga kushtet e mjedisit dhe si produkt i qëllimit apo përfitimit se sa i të mësuarit.

Biheviorizmi: Nënkupton teori e të mësuarit sipas së cilës të mësuarit dhe të sjellurit e (nxënësve/fëmijëve) ndikohet nga teknika të përshtatshme të përforcimit e të përfitimit individual dhe përmes kontrollit të kujdesshëm të mjedisit.

Bilinguizëm: Nënkupton procesin e të mësuarit dhe komunikimi në dy gjuhë njëkohësisht nga një nxënës/fëmijë.

Bindje në mësimdhënie: Nënkupton bindja e plotë dhe pa asnjë dyshim në diçka që është e vërtetë dhe e drejtë përgjegjëse për sukses për të cilën ndiejmë krenari.

Biseda: Nënkupton një komunikim ndërmjet dy njerëzve në jetë.

Biseda në mësim: Metodë e mësimdhënies, ku gjatë dhënies së informacionit mësimdhënësi “tërheq” nxënësit në bashkëbisedim për të pyetur, mësuar, analizuar, vlerësuar etj.

Biseda vlerësuese: Nënkupton komunikim midis dy subjekteve: mësimdhënësit dhe nxënësit gjatë procesit vetëvlerësimit vlerësimit periodik dhe në fund të procesit mësimor.

Botëkuptim: Tërësia e pikëpamjeve të njeriut për jetën, natyrën dhe shoqërinë që e rrethon.

Buletini i pjesëmarrjes: Përdoret si instrument gjatë vërtetimit dhe ndihmesës së punës në grupe të vogla me nxënës. Mësimdhënësi shënjon se kush nga nxënësit jep ndihmë, sa shpesh bashkëpunon dhe sa të vlefshme janë ndihmesat. Planifikohet për një periudhë të gjatë kohore (semestrare, apo vjetore).

Bullizmi: Nënkupton tallje, fyerje moslënie rehat me qëllim ngacmime të përsëritura (përqeshje kryesisht me fjalë, por edhe me gjeste fyese, goditje dhe veprime përjashtuese) të një nxënësi nga nxënësit tjerë për shkak të racës, vendbanimit, etnisë, fesë, veshjës, mbipeshës, etj.

Burim i treguesit në kërkimet në edukim: Nënkupton dokumentet, nga të cilat mund të sigurohet treguesi, me matje plotësisht të re apo me rishikimin e të dhënave ekzistuese për rezultatet e mëparshme, që mund të jenë shënime, statistika apo dokumente të tjera shkollore.

Burime materiale: Nënkuptohen të gjitha materialet dhe pajisjet e nevojshme për një aktivitet shkollor që ndihmojnë në realizimin e procedurave dhe veprimtarive mësimore.

Burime mësimore historike: Nënkuptohen burime që përfshijnë objekte nga mjedisi natyror si edhe artefakte historike si p.sh. dokumente të shkruara, të dhëna statistikore, fotografi, dokumentar dhe filma.

Burimet e financimit në shkollë jopublike: Nënkuptohen (përfshin) donacionet, të hyrat vetanake nga regjistrimi i nxënësve, të hyrat nga akterët që kanë në pronësi shkollën, bordet udhëheqëse dhe menaxhuese për shkollën.

Burimet e financimit në shkollë publike: Nënkuptohen (përfshin) grantet qeveritare, të hyrat vetanake komunale, të hyrat e dedikuara për shkollën.

Burimet e të mësuarit: Nënkuptohen gjithë grupi i mjeteve, duke përfshirë pajisjet dhe materialet që mundësojnë ose mbështesin, procesin e të shpjeguarit, të mësuarit përmes të cilave një mësimsdhënës mundë të përpiqët që t'i përfshijë nxënësit në procesin mësimor dhe t'i orientojë dhe lehtësojë të mësuarit dhe arritjet e tyre.

Burimi pedagogjik: Nënkupton referencën shkencore, ku bazohet dhe nga ku buron tematika edukativo-arsimore, fusha tematika ose njësia mësimore.

Buxhet i shkollës: Mjetet financiare që i ka në dispozicion (shkolla) të gjitha shpenzimet e parapara për aktivitete, llojet e shpenzimeve si dhe burimet tjera financiare të shkollës.

Buxheti i kërkimit: Plani i shpenzimeve të projektit kostoja (paratë) e nevojshme që duhet paguar për realizimin e kërkimit, preferohet të jepet (shkruhet) në formë tabelare, të ndarë në

aspekte apo etapa të veçanta të realizimit të kërkimit, ndërsa kërkohët kur kërkimi mbështetet financiarisht.

C

Caktimi i mostrës në kërkim: Në bazë të popullatës që e përbën problemin zgjidhet grupi, i cili me gjasë mund të jetë përfaqësues për tërë popullatën.

Cd mësimore: Nënkupton përdorim të CD (produkti) që ruan, transmeton ose merr informacione elektronike në formë digjitale, kompjuterat personal, të cilët janë në gjendje të kontribuojnë pozitivisht në procesin e shpjegimit dhe përvetësimit të mësimin, në orët e mësimin për nxënësit.

Centralizimi: Centralizimi është një formë menaxhimi në të cilën pushteti është i përqendruar në një autoritet ose institucion, i cili është ai që jep udhëzimet që duhet të ekzekutohen nga pjesa tjetër e institucioneve varëse.

Centralizimi në arsim: Është formë e menaxhimit të arsimit në të cilën pushteti për udhëheqjen e arsimit është i përqendruar në Ministrinë e Arsimit përkatësisht ministria ka një kontroll të aktiviteteve të punës së shkollave dhe të cilësisë së mësimdhënies në procesin e vendimmarrjes (kurrikulës, vlerësimit, etj.).

Certifikatë: Dokument zyrtar i cili regjistron (në forma të ndryshme) arritjet e individit në fund të një procesi arsimimi ose trajnimit të njohur, që jepet pas përfundimit të suksesshëm të një

kursi, programi të arsimit ose aftësimit, apo pas dhënies së provimeve në institucionin e arsimit dhe aftësimit profesional.

Certifikim: Nënkupton procesin që ka të bëjë me njohjen e arritjeve apo kompetencave të fituara nga individët që marrin pjesë në kurse afatshkurtra apo afatgjata arsimimi ose formimi (vlerësim me shkrim zyrtar i të arriturave të nxënësit në lidhshmëri me shkathtësitë, njohuritë dhe qëndrimet) në përfundimin e arsimit ose aftësimit të pranueshëm.

Ciklet e arsimit të lartë (universitar): Nënkuptohen kualifikimet në ciklin e parë, studime të rregullta (për diplomë bachelor), ciklin e dytë ose studime pasdiplomike (master teorik-shkencor, master profesional) dhe ciklin e tretë, që u referohemi si studime të doktoratës (Phd).

Cilësi të vëmendjes: Nënkuptohet qëndrueshmëria përkatësisht pa qëndrueshmëria dhe përqendrimi i vëmendjes së fëmijë/nxënësit.

Cilësi trupore te nxënësit: Nënkupton aspekti fizikë në bashkëveprim me atë nervor shtatëlartësi, forma dhe gjatësia e gjymtyrëve, veçoritë e sistemit nervor dhe endokrin.

Cilësi: Nënkupton veti thelbësore që e dallon një fëmijë/nxënës një individ nga fëmijët/nxënësit tjerë.

Cinizëm: Nënkupton nënçmimin (me fjalë) dhe injorimin e vlerave të tjetrit, duke përqeshur, tallur e zhvlerësuar.

Citat: Nënkupton riprodhim tekstualisht i një fjalie (mendimi) e marrë fjalë për fjalë nga një tekst pedagogjik, që futet në thonjëza dhe pasohet me një shënim për tekstin, autorin, titullin e tekstit, shtëpinë botuese, vendin dhe vitin e botimit.

Ç

Çerdhe:Nënkupton institucion edukativ për fëmijët nga lindja deri në moshën pesëvjeçare, ku përveç përkujdesjes për ushqimin dhe zhvillimin fizik, mendor, moral, estetik të fëmijët, ofrojnë dhe mundësi socializimi.

Çështje kyçe: Nënkupton përkufizimet kryesore rreth kuptimit të temës së mësimëve.

Çirak:Nënkupton personin që mëson duke punuar pranë një ndërmarrjeje, punishteje, etj., nën mbikëqyrjen e një instruktori (mjeshtri), për të fituar shkathtësitë dhe shprehitë e nevojshme për ushtrimin e një zanati të caktuar.

Çirakëri:Nënkupton sistemin e përgatitjes së çirakëve. Mund të jetë formal (p.sh. sistemi dual në arsimin profesional) por edhe jo formal pranë një punishteje.

D

Dakordim: Nënkupton pëlqimin e dyanshëm për të bërë diçka për të cilën janë pajtuar paraprakisht, ose edhe pëlqimi për të bërë diçka që është sygjeruar nga një person tjetër.

Daktilim: Nënkupton mënyra e komunikimit me anë të shenjave alfabetike të krijuara nga lëvizjet e gishtërinjve të duarve për

kumtimin e mendimeve e të ndjenjave për personat që kanë vështirësi të theksuar në të dëgjuar.

Dallueshmëria individuale: Nënkupton origjinalitetin, veçantin, papërsëritshmëria e nxënësit me veçoritë e tij biologjike.

Decentralizim në arsim: Nënkupton një dallim më preciz të të drejtave dhe përgjegjësive të autoriteteve qendrore dhe lokale, gjegjësisht shpërndarje të detyrave dhe përgjegjësive dhe të drejtave të komunave të menaxhojnë jo vetem me mjetet financiare të ndara për arsim në procesin e vendimmarrjës por edhe një kontroll më efikas të aktiviteteve të punës së shkollave dhe të cilësisë së mësimdhënies.

Deduksion: Metoda apo mënyrë e arsytimit, e nxjerrjes së përfundimeve nga një apo më tepër premisave, që nisët nga e përgjithshmja për të nxjerrë të veçantën a më pak të përgjithshmen; nxjerrja e një përfundimi logjik të veçantë a të pjesshëm nga një tezë a nga një ide e përgjithshme apo nga dy e më shumë qëndrime.

Deduksioni i drejtpërdrejtë: Nënkupton nxjerrjen e qëndrimit të ri nga një premisë.

Deduksioni i tërthortë: Nënkupton nxjerrjen e qëndrimit të ri nga dy apo më tepër qëndrime.

Defektologjia: Shkenca që merret me studimin e të metave organike dhe psikike të individëve, të cilat paraqesin vështirësi në jetë.

Dëftesë: Dokumenti i nxënësit për rezultatet e arritura gjatë një viti shkollor ose në përfundim të një cikli shkollor, në të cilin, përveç vlerësimit numerik të arritjes së nxënësit, përfshihen edhe sjelljet e nxënësit.

Dekurajim: E kundërta e inkurajimit. Në mësimdhënie dekurajimi përdoret rrallë por ajo është e rëndësishme kur përdoret së bashku me metoden e pengimit, në shuarjen e sjelljeve devijante të nxënësve në shkollë.

Delikti: Sjelljet karakteristike të individit, me të cilat i sjellin dëm njëri-tjetrit dhe shoqërisë.

Delikuencë: Nënkupton dukuri psikike që shprehet në mosrespektimin, që bie në kundërshtim me rregullat shoqërore apo në kundërshtim me ligjin.

Demonstrim: Metodë me të cilën mësimdhënësi e kryen një detyrë, duke u treguar nxënësve se çfarë duhet të bëjnë dhe si ta bëjnë, ne veprime praktike, ushtrime praktike, të cilat më pas diskutohen përkatësisht demonstrohen pra mësohet procedura se si përdoret një pajisje dhe aplikimi.

Demonstrimi në mësimdhënie: Mësimdhënësi demonstron aftësi gjatë punës praktike në klasë apo kabinet mësimor gjatë ekskursioneve apo udhëtimeve mësimore, nxënësit shikojnë, mësojnë duke parë dhe diskutojnë.

Denigrim i nxënësve: Nënçmimi që iu bëhet nxënësve nga mësimdhënësi, mos pranimit indentiteti, mbizotërimi kundër rregullave që mund t'i dëmtojë emocionalisht në raste të caktuara ose në të mësuar në procesin mësimor.

Dënimi: Metodë e edukimit, përmes së cilës synohet të arrihet qëllimi, te nxënësi.

Depresion: Gjendje që manifestohet me rënien shpirtërore, me ndryshime negative në proceset intelektuale, emotive dhe të krejt veprimtarisë së individit.

Dëshpërimi për të mësuar: Nënkupton heqja dorë nga nxënësi për t'u përpjekur për të mësuar në një mënyrë ose rrugë tjera alternative.

Determinizëm: Doktrinë, sipas të cilës të gjitha dukuritë e ngjarjet kushtëzohen nga lidhja shkakore objektive.

Detyra me shkallë të lartë të vështirësisë: Detyra (pyetje ose kërkesa) që shtron mësimdhënësi për t'i kryer nga nxënësit që janë të një niveli me të lartë nga njohuritë dhe aftësitë e nxënësve, zakonisht kur kërkohet analiza, sinteza dhe gjykimi.

Detyra me shkallë të ulët të vështirësisë: Janë detyra (pyetje ose kërkesa) të një niveli më të ulët që parashtron mësimdhënësi për t'i kryer nga një nxënës ose disa nxënës me qëllim, që ata të ndihën më të motivuar, më të ditur, ngase kapërcimi i sfidave jep një vetëkënaqësi të nxënësit dhe i nxitë për të mësuar.

Detyra mësimore: Veprimtaritë mësimore, që duhet t'i kryej nxënësi, operacionet mendore që kërkohen për të mësuarit e përmbajtjes së mësimi.

Detyra praktike: Detyra të cilat duhet të sigurojnë reagime të menjëherëshme të nxënësit që të përformojnë saktë detyrën ose

kërkesat që shtron mësimdhënësi për nxënësit të dobishme për jetën e përditshme.

Detyra sfiduese për nxënësit: Detyra të ofruara (dhëna) nga mësimdhënësi që nxitin krijueshmërinë.

Detyra unë kërktoj: Një lloj i njohur i kryerjës së projekteve hulumtuese në klasë që thekson procesin e hulumtimit dhe lidhjet vetjake të nxënësve me temën që zhvillohet në disa faza.

Detyrat kreative për argëtim: Detyra (pyetje ose kërkesa), që shtron mësimdhënësi për t'u kryer nga nxënësit ose disa nxënës paraprakisht duke dhënë udhëzimet rutinë, e të cilat janë të dobishme në stimulimin e nxënësve, në kuriozitetin e tyre dhe në motivimin e nxitjen e konkurrencës.

Detyrat voluminoze: Janë detyra, pyetje që parashtron mësimdhënësi për t'i kryer për një kohë më të gjatë nga nxënësit zakonisht në mes të gjysëmvetorëve të vitit shkollor.

Detyrat e shtëpisë: Nënkupton kërkesat ose pyetjet e mësimdhënësit brenda orës mësimore për të mësuar jashtë mjedisit shkollor për përvetësimin e mësimëve të përfituara në shkollë si dhe për të nxitur përvetësimin e mësimin në vazhdimësi.

Detyrat e shtëpisë për nxënësit: Nënkuptohen detyrime ose aktivitete që duhet t'i zhvillojnë nxënësit, që rrjedhin si vazhdimësi nga puna e mësimdhënësit në shkollë, por që realizohen jashtë shkollës, përkatësisht në shtëpi si: ushtrimet, punimet e veçanta në projekte, që nxënësi duhet t'i kryej jashtë orarit të mësimin, rëndom në shtëpi.

Detyrat mësimore edukative: Detyra ose aktivitete që stimulojnë një të mësuar të materialeve (përvetësimin e njohurive), funksionale (zhvillimin e aftësive psiko-motorike) edukative (zhvillimin e vetive pozitive të personalitetit).

Detyrat në klasë: Nënkupton detyrime ose aktivitete pyetje ose kërkesa që shtron mësimdhënësi që jepen për qartësimin e konfuzionit në lidhje me ato që u është shpjeguar dhe u është kërkuar të kuptojnë për një qëllim të caktuar mësimor.

Detyrat sfiduese: Nënkupton detyrime ose aktivitete pyetje që shtron mësimdhënësi mbi nivelin e njohurive dhe aftësive të tyre, (por jo të paarritshme detyra duhet të jetë sfiduese për nivelin e nxënësve duke i përshtatur njohurive, zotësive dhe shprehive të tyre që të mos jetë e tejkaluar për ta) si një angazhim shtesë, në nxitjen e nxënësve për të mësuar.

Detyrat sipas specifikave të nxënësve: Nënkuptohen detyra, pyetje që shtron mësimdhënësi në përputhje me nivelin e paranjohurive dhe specifikat e nxënësve. Mësimdhënësi gjatë dhënies së detyrave specifike duhet të jetë në gjendje të njohë dallimet individuale në zhvillim, njohuritë dhe aftësitë e ndryshme, si dhe shpejtësinë e të mësuarit dhe interesimit të tyre.

Detyrë mësimore: Nënkupton detyrime ose aktivitete që nxënësi duhet të kryejë bazuar në përmbajtjen e mësimin të dhënë duke përdorur operacionet mendore të nevojshme.

Detyrë profesionale: Nënkupton detyrime ose aktivitete pune të veçantë, në një profesion specifik, e vëzhgueshme, me procedurë unike, në shërbim apo vendimmarrje për ushtrimin e të cilave kërkojnë kompetenca unike.

Detyrim obligues në edukim: Nënkupton kur rregullat e sjelljës janë të imponuara nga mësimitdhënësi dhe atyre duhet të ju bindet nxënësi gjithmon dhe me detyrim ku nuk lejohen përjashtime.

Deviacion: Nënkupton shmangie të rrjedhës së një dukurie, procesi, prirje etj.

Devijim standard: Matje statistikore që tregon një vlerë të shpërndarjes brenda një renditjeje vlerash, e barabartë me rrënjën katrore të variancës. Simboli i tij është s (sigma). Devijimi standard është treguesi më i përdorur i variacionit të vlerave prej mesatares.

DH

Dhënia e detyrave nga mësimitdhënësi në klasë: Nënkupton veprimtarinë e mësimitdhënësit brenda orës mësimore në dhënie e detyrave nxitjen e motivimit tek nxënësit për të mësuar.

Dhënia e mundësive nxënësve: Nënkupton ofrimin si premisë, parakusht të mundësive për formimin e nxënësve të përgjegjshëm përsa i përket formimit përsoneal, nxitje të krijimit të besimit që ata të jenë të aftë për t'u përballur me jetën.

Dhuna digjitale: Nënkupton çfarëdo formë të dërgimit të porosive përmes internetit, apo telefonisë mobile me qëllim fyerjen, lëndimin, shqetësimin ose çfarëdo lloj tjetër të dëmtimit në formë të videove ose porosive tekstuale, fotografive a thirrjeve.

Dhuna emocionale/psikologjike: Përfshin mospërkrahimin e një mjedisi të përshtatshëm zhvillimor e mbështetës, edhe kur ndaj fëmijës mund të kryhen akte, të cilat shkaktojnë ose kanë mundësi të madhe të shkaktojnë dëme në shëndetin ose në zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral ose social. Këto akte mund të përfshijnë kufizimin e lëvizjeve, talljen, denigrimin, fajësimin, kërcënimin, trembjen, diskriminimin, përqeshjen.

Dhuna fizike: Nënkupton çdo formë të abuzimit fizik, duke përfshirë këtu rrahjen me çfarëdo mjeti, goditje me shuplakë ose edhe me mjete të tjera, shtrëngimin e fytyrës dhe çdo veprim tjetër që shkakton dhimbje fizike.

Dhuna nga mësimdhënësit në shkollë: Nënkupton ndëshkimin fizik apo psikologjik si tërheqje veshi, shuplaka, fyerje, ndëshkim me notë, kërcënime me fjalë dhe frikësimin, etj.

Dhuna verbale: Nënkupton përdorimin e fjalëve që shkaktojnë dëme për personin, duke folur për të si: bërtitje, fyerje, kërcënim, frikësim, turpërim, poshtërim, përdorimi i gjuhës nënçmuese dhe deklarata negative për personin ose në lidhje me personin.

Dhuna: Ushtrimi i forcës a shtrëngimi me mjete e me mënyra të vrazhda ndaj dikujt; detyrim a shtypje me anë të forcës apo përdorim ose aplikim i vullnetshëm i forcës a fuqisë fizike kundrejt një personi me mundësi dëmtimi, krijimi të pasojave psikologjike apo fizike.

Dhunë ndaj fëmijës: Nënkupton të gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit dhe shpërdorimit ndaj fëmijës që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm ose të vërtetë të shëndetit,

mbijetesës, zhvillimit, apo dinjitetit të fëmijës, në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit, ose forcës.

Dhunti: Nënkupton zhvillim të lartë të aftësisë së fëmijës, (zgjuarsi e veçantë natyrore, e dhënë) e cila shfaqet në një lëndë të caktuar apo në një lloj të caktuar të aktivitetit të fëmijës, p.sh. pikturimi.

Di, dua të di, mësova: Nënkupton aktivitet teknike të organizuar në formë të një tablele të përbërë nga tri shtylla ku nxënësit bëjnë pyetje dhe kërkojnë në mënyrë të kujdesshme përgjigjet për pyetjet që i kanë parashtruar vetë.

Diagnostifikimi i pikëve të forta dhe të dobëta të nxënësve: Nënkupton aktivitete duke iu dhënë atyre informata që synojnë të njohin gjendjen dhe nivelin që mund ta arrijnë për ecurinë e të mësuarit në të ardhmen apo për të përcaktuar, përzgjedhur shkollimin e mëtutjeshëm për aftësim.

Diagram: Nënkupton mjet për paraqitje grafike me anë të figurave gjeometrike ose skicave, që zakonisht përdoret në lëndët natyrore, por edhe në lëndën e gjeografisë dhe të historisë.

Diagrami i Venit: Aktivitet mësimor, teknikë, me anë të së cilës evidentohen elementet e përbashkëta dhe ato që dallohen ndërmjet dy a më tepër koncepteve, objekteve, personazheve, dukurive kur kërkohet krahasimi i dy elementeve (duke i vizatuar dy apo më shumë rrahë, të cilët ndërpriten ndërmjet vete).

Dialekt: Nënkupton variant të gjuhës (të folurit, shqiptimi) që flitet praktikohet në jetën e përditshme nga një grup i njerëzve në një rajon të caktuar.

Dialog: Nënkupton shkëmbim të ideve dhe bindjeve, me qëllim të komunikimit të mësuarit dhe mirëkuptimit në mes të njerëzve.

Dialogu konstruktiv në klasë: Aktivitet komunikimi që udhëhiqet nga mësuesi që qëllim ka të udhëheq, të ndihmoi, të kordinojë, të përcjellë, të ridrejtoj, të menaxhojë sjelljet e nxënësve në klasë, duke ia komunikuar nxënësve në mënyrën më të mirë të mundshme.

Disiplinë shkencore pedagogjike: Nënkupton një disiplinë shkencore e organizuar si tërësi (me lëndë të studimit, me metodologji të vetën shkencore, me koncepte shkencore, me teoritë e veta shkencore) e cila është e mbështetur në aplikimin e metodave shkencore në një fushë.

Didaktika (Teoria e të mësuarit dhe e mësimit): Nënkupton disiplinën që ka për objekt studimi problemet e gjithanshme të mësimit, të strategjive, metodave dhe teknikave të mësuesit, të mësimit dhe të procesit të njohjes me karakter pedagogjik, përkatësisht përmbajtjen dhe synimet e procesit mësimor, u përgjigjet pyetjeve çfarë duhet të mësojnë nxënësit, si të përditësojnë të mësuarit si dhe procesin e vlerësimit mësimor në shkollë.

Dije: Nënkupton njohuri kolektive deri në këtë kohë që paraqesin gjithë njohurin në një shkencë.

Dijet epistemike: Nënkupton dijet personale, dijet mbi detyrat dhe dijet e strategjive.

Dikotomia: Procedura e ndarjes së një nocioni apo koncepti në dy pjesë: njëra pozitive dhe tjetra negative: p.sh. i suksesshëm - i pasuksesshëm; i vlefshëm-i pavlefshëm; i shkathët - i ngathët.

Diktimi: Një nga mënyrat e mësimit të rregullave drejtëshkrimore nga nxënësit, ku mësimitdhënësi lëxon tekstin dhe nxënësit shkruajnë atë në fletore.

Dinjiteti: Nënkupton tërësinë e vlerave morale të njeriut, vetëdija që ka individi për këto vlera, si dhe për të drejtat e veta në shoqëri.

Diploma: Dokument zyrtar, lidhur me kualifikimin e individit, që jepet nga një institucion i arsimit të lartë, pas mbarimit të një programi të njohur të studimeve.

Disavantazh në pjesëmarrje në të mësuar: Nënkupton aftësi të kufizuara paraprake si pasojë e të mos mësuarit apo mos pjesëmarrjes në mësim, mungesa për shkak të sëmundjeve apo vështirësi të tjera (të gjuhës, shkaqeve, që lidhen me vështirësitë në të mësuar, vonesën mendore, etj.).

Disavantazh në të mësuar nga mësimitdhënësi: Nënkupton injorimi dhe mos mbështetja në të mësuar, në kohë e komunikimit apo sqarimit gjatë të mësuarit që shkakton ndjesi jo të mira të nxënësi deri në humbjen e interesimit për të mësuar.

Disertacioni i doktoratës: Është një kontribut shkencor origjinal i kandidatit për zgjedhjen ose ndriçimin e çështjeve të ndryshme shkencore, në të cilën zbulohen fakte të reja, apo si studim, monografi në të cilën trajtohen e zgjidhen çështje të përbëra shkencore.

Disfazia: Nënkupton vështirësi për të kuptuar ose “prodhuar” gjuhën e folur (për të treguar një histori me fjalë apo për të komunikuar me dikë, për të folur të rrjedhshëm, për të kuptuar saktë dhe drejt fjalët, instruksionet, detyrat, etj.), gjë që interferojnë në arritjet shkollore e në aktivitete të tjera jashtëshkollore, si dhe në komunikimin social të fëmijës.

Disfunksion minimal i trurit: Nënkupton dëmtimin e trurit të fëmijës, i cili ka ndodhur gjatë lindjes.

Disgrafia (agrafia): Nënkupton dëmtim të funksionit grafik të nxënësit që ndikon në fushën e shkrimit që e bën të vështirë aktin e të shkruarit dhe sjell vështirësi në organizimin e shkronjave, numrave dhe fjalëve në një rresht apo në një faqe.

Disiplinë shkollore: Nënkupton rregullat dhe normat, të cilat duhet të respektohen nga nxënësit për sjelljet brenda aktiviteteve që realizohen në shkollë, ato përcaktohen me rregullore të sjelljeve të nxënësve në shkollë.

Diskalkulia: Nënkupton vështirësi të të mësuarit të funksioneve matematikor dhe të arsyetimit logjik, përkatësisht pamundësinë për të kryer veprime matematikore, vështirësi në klasifikimin e objekteve nga më i madhi tek më i vogli apo në klasifikimin e objekteve sipas karakteristikave të tyre.

Diskriminimi në mësimdhënie: Nënkupton trajtim, injorim dhe vlerësim negativ apo sjellja jo e barabartë, ndaj nxënësve të caktuar brenda një klase nga mësimdhënësi.

Diskriminimi: Nënkupton trajtim jo i barabartë i kategorive të caktuara të njerëzve, ai mund të jetë pozitiv apo negativ.

Diskriminimi pozitiv në mësimdhënie: Nënkupton trajtim dhe vlerësim në mënyrë pozitive apo sjellja jo e barabartë, sjellja me përparësi ndaj disa nxënësve të caktuar brenda një klase kundrejt disa nxënësve tjerë në atë klasë.

Diskutimi në grup: Bisedë, në të cilën mësimdhënësi nuk ka rol mbizotërues; nxënësit bëjnë pyetje dhe u përgjigjen pyetjeve të njëri-tjetrit.

Diskutime në bazë paneli në mësimdhënie: Nënkupton një diskutim informal të një çështjeje, me disa nxënës i cili pasohet nga pyetje dhe përgjigje nga mësimdhënësi.

Diskutime të fokusuara në mësimdhënie: Nënkupton një diskutim që fokusohet në një temë të caktuar, një çështje, një skicë grafike, një videoje, një artikull libri, një demonstrim apo një modeli mësimor.

Diskutimi direkt ose diskutimi i dilemës: Nënkupton kur nxënësve iu kërkohet që pasi të lexojn detyrën të japin mendime për zgjidhjen e dilemës nën drejtimin e mësimdhënësit përmes supozimeve, argumenteve dhe sfidimit përmes kundër argumenteve dhe të përgjigjurit mbi bazën e zgjidhjes.

Diskutimi i udhëhequr nga mësimdhënësi: Nënkupton kur mësimdhënësi drejton diskutimet e të gjithë nxënësve, të cilët luajnë rolin e debatuesve, për një temë të caktuar, një çështjeje duke dhënë mendimet e tyre.

Diskutimi në forma verbale: Nënkupton diskutim i lirë në mësim, (variant i dialogut) ku mësimdhënësi zhvillon rreth problemeve mësimore, që e rrisin shkallën e pavarësisë aktive të

nxënësve në mësim, duke i kërkuar të vërtetat të cilat janë të njohura, që gradualisht t'i përgatisë nxënësit për diskutim të çështjeve të ndryshme mësimore që janë në interes të tyre.

Diskutimi: Metodë e mëimit, e cila mbështetet në komunikimin dhe ndërveprimet e mësimdhënësit dhe të nxënësve. Përdoret edhe si komunikim dhe ndërveprim në mes të vetë nxënësve, por me moderimin e mësimdhënësit, i cili ka mundësi të përcaktojë pikat kryesore për diskutim dhe përgatit nxënësit për analizë dhe vlerësim rreth temave të caktuara.

Dislali: Nënkupton dëmtim në të folur, paaftësi për të folur rrjedhshëm shprehje e fjalë dhe çrregullime të shqiptimit të tingujve.

Disleksia: Është vështirësia në aftësinë për të lexuar, për të identifikuar, kuptuar, riprodhuar me gojë simbolet e shkruara, ngatërrimin e shkronjave dhe perceptimin e shtrembër të tyre, për të lexuar tingujt njërin pas tjetrit.

Disortografia: Nënkupton vështirësinë që kanë fëmijët për ta shkruar gjuhën që flasin, për të përkthyer saktë shkronjat që përbëjnë fjalët, në simbole grafike.

Ditari personal i mësimdhënësit: Nënkupton, një ditar që e mban mësimdhënësi ku përmban përvojat e tij ose të saj, duke shprehur edhe interpretimet personale ose mënyrat e bashkëveprimit që ka ndërmarr, dhe i cili i lejon një nivel të lartë të reflektimit rreth proceseve të mësimdhënies dhe të mësuarit dhe ofron hapsrë të mëtejshme për diskutim.

Ditari dypjesësh: Ditari ku nxënësit përshkruajnë përvojat e tyre gjatë shërbimit, mendime vetjake, si edhe reagime ndaj

veprimtarive të shërbimit. Në anën e djathtë të fletores ata diskutojnë mënyrat se si grupi i parë i ditarit lidhet me konceptet kyçe, paraqitjet në auditor dhe me leximet.

Ditari i zhvillimit të fëmijës: Nënkupton të dhëna sistematike të regjistruara nga prindi, edukatorja në çerdhe, ose ndonjë pedagog që përcjell zhvillimin e fëmijës në moshën parashkollore.

Ditari trepjesësh: Nënkupton strukturë (veprimtari) mësimore me tri ndarje, që përmban kërkesat: (a) Përshkruaj se çfarë ndodhi në përvojën e shërbimit; (b) Analizo se si lidhet përmbajtja e programit me përvojën e shërbimit; (c) Zbato materialet e programit dhe përvojat e shërbimit tek vetja dhe jeta jote.

Ditari trepjesësh (teknikë): Përdoret për të motivuar nxënësit të lexojnë dhe të lidhin ngushtë materialin e tekstit me përvojat dhe kureshtjen e tyre, nxit nxënësit që të reflektojnë mbi materialin që lexojnë, duke paraqitur ide nga përvoja e tyre jetësore.

Ditura (individuale): Nënkupton njohuritë, shkathtësitë, vlerat, eksperiencat dhe aftësitë vendimarrëse që e ndihmojnë nxënësin të kuptojë dhe të njohë natyrën, shoqërinë dhe mendimin njerëzor.

Dituritë (kolektive): Janë tërësi e fakteve, koncepteve dhe përgjithësimeve që të kuptojmë dhe të njohim natyrën, shoqërinë dhe mendimin njerëzor.

Diversiteti: Nënkupton dallimet në mes të grupeve të caktuara, grupeve kulturore apo etnike të fëmijëve në shkollë, përdoret edhe për të përshkruar dallimet brenda grupeve (mbi bazën e moshës, gjinisë, pasurisë, paaftësisë, kulturës, fesë, vendbanimit, statusit shëndetësor, social dhe etik).

Dizajni historik: Është strategji e kërkimit që të mbledhë, të verifikojë dhe të sintetizojë dëshmi nga e kaluara, dhe një shumëllojshmëri të provave dokumentare parësore, të tilla si: ditare, regjistrimet zyrtare, raporte, arkivat dhe informacione jo tekstuale (harta, fotografi, audio dhe regjistrime vizuale) autentike dhe të vlefshme.

Dizajnimi i kërkimit: Nënkupton përzgjedhja (fokusi) i problemit, konceptimi apo definimi i hulumtimit, kronologjia e aktiviteteve.

Dizekuilibri: Ndodh atëherë kur aftësitë e fëmijës për të kuptuar botën kanë vështirësi.

Dogmë: Mendim, pikëpamje, përfundim që merret si e vërtetë e pakundërshtueshme, pa marrë parasysh arsyet e zbatimit dhe pa iu nënshtruar vërtetësisë shkencore.

Dokimologjia: Disiplina pedagogjike e cila merret me vlerësimin e të mësuarit të nxënësit.

Dokumentacion shkollor: Materialet, si plani mësimor, programet, tekstet, rregullorja e shkollës, libri amë, ditari, orari javor i mësimëve etj., e përbëjnë dokumentacionin shkollor.

Dokumentimi: Veprimi kur kërkuesi mban shënime, regjistron dhe përshkruan sjellje dhe mbi bazën e tyre pas një analize, dhe bën raportin me shkrim të kërkimit.

Donacion për shkollën: Të ardhurat, dhurata (si para apo mjete dhe teknologji mësimore /shkollore), të pakthyeshme të cilat realizohen në bazë të një kontrate me shkrim ndërmjet ofruesit dhe pranuesit të donacionit.

Donatori: Nënkupton individ apo grup njerëzish, organizatash, shoqatash apo institucionesh, të cilat materialisht ose nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme përkrahin projektet e caktuara shkollë.

Doracak rezultatësh: Rregulla që përdoren për të përcaktuar cilësinë e performancës së një nxënësi, mësimitdhënësi, drejtori të shkollës, etj.

Doracaku: Nënkupton një vepër ndihmës, që përmban informacione të domosdoshme për zotërimin e diturisë, përcaktimin e performancës etj.

Dosja e mësimitdhënësit: Përmbledhje pasqyruese e profesionalizmit nga përvoja e tij në mësimitdhënie, punime, shembuj, reflektime, trajnime, zhvillim profesional, instrument reflektimi për identifikimin e metodave të ndërveprimit me nxënës, biorgafi e shkurtër mësimit e përzgjedhura (fletë pune, materialet e nxënësve) vlerësimet e produkteve të nxënësve (rezultatet e testimit (nëse ka ndonjë) video ose fotografi nga mësimit apo aktivitetet e veçanta).

Dosja e nxënësit: Grumbullim sistematik të punëve të nxënësit, shpesh duke përfshirë një punë në vazhdim, rishikime të saj, vetë analiza dhe reflektime rreth asaj që ka mësuar nxënësi.

Dramatizimi në mësimitdhënie: Nënkupton procesin kur mësimitdhënsi gjatë procesit mësimit iu tregon nxënësve se do të luajnë ndonjë (rol) karakter nga tregimi, rregulla dhe pritshmëri sipas detyrave konkrete nën drejtimin e mësimitdhënësit me bazë reflektimet duke bërë, artikullimin e tingujve, dëgjimin, zërin, ritmin, ndërveprimin, mendimin kritik dhe krijimtarinë.

Drejtori i shkollës: Drejtues, udhëheqës dhe menaxher i punës së institucionit shkollor për arsimin dhe aftësimin e nxënësve.

Durim: Aftësia për të përballuar me gjakftohtësi pa u ankuar dhe pa u ligështuar ndaj vështirësive, shqetësimeve, vuajtjeve, gjendjes së rëndë shpirtërore.

Dyshimi: Qëndrim apo sjellje dyshuese ndaj punës apo aktivitetit të filluar.

E

Edukata: Kuptimi i përgjithshëm formativ i saj është ndikim, lartësim, bartja e njohurive, përvojave, formësim të shkathtësive, me qëllim të avancimit kognitiv, socio- emocional dhe fizik.

Edukatë familjare: Nënkupton ndikimin (edukatën) që i jep familja fëmijës së vet.

Edukator: Personaliteti që në mënyrë sistematike dhe të organizuar zhvillon (ushtron) ndikim edukativ përmes veprimtarisë edukuese tek nxënësi.

Edukatori reflektiv: Mësimdhënësi që ka një vlerësim mendor, gjykues, që është analizues i përvojës vetijake në mësimdhënie.

Edukim: Termi edukim është një aktivitet i nisur apo i ndërmarë nga një apo shumë individ për të sjellë ndryshime në njohuritë aftësitë dhe qëndrimet e individit apo grupit të individëve, pra thekson edukatorin.

Edukim bazë: Nënkupton mësimdhënien e njohurive elementare bazike përmes lëndëve mësimore, përgatitja për jetën sociale dhe për përgjegjësitë e jetës në komunitet.

Edukim estetik: Nënkupton edukimin e nxënësve/të rinjëve përmes të mësuarit, njohjes, vlerësimit dhe dashurisë ndaj së bukurës, përmes së cilës ndikohet në formimin e personalitetit.

Edukim fizik: Nënkupton edukimin e nxënësve/të rinjëve për njohurit në forcimin e trupit dhe shëndetit, insistohet të ndikohet në zhvillimin harmonik fizik të individit.

Edukim formal: Nënkupton edukimin e nxënësve/të rinjve si proces i të mësuarit në mënyrë të organizuar dhe sistematike në institucione shkollore.

Edukim informal: Nënkupton edukimin e nxënësve/të rinjëve gjatë procesit së mësimdhënies së rastësishme nga ana e çdo njeriu jashtë sistemit arsimor të organizuar formal ose joformal.

Edukim intelektual: Nënkupton edukimin e nxënësve/të rinjve përmes proceseve dhe aktiviteteve kognitive që synohet të formohet personaliteti i gjithanshëm.

Edukim moral: Nënkupton edukimin e nxënësve/të rinjve në formimin e pikëpamjeve, bindjeve dhe shprehive morale, karakterit të fortë pozitiv në shërbim të formimit të gjithanshëm të personalitetit.

Edukimi financiar: Nënkupton edukimin e nxënësve/të rinjëve njohuritë që ata kanë mbi problemet dhe sfidat kryesore ekonomike të vendit të tyre.

Edukimi joformal: Nënkupton edukimin e nxënësve/të rinjëve ndikimin pozitiv nëpërmjet veprimtarive ose programeve që organizohen jashtë kontekstit të sistemit shkollor formal.

Edukimi konfluent: Nënkupton edukim e nxënësve me elemente afektive dhe konjitive në të mësuarit pa drejtimin dhe udhëheqjen e mësimit.

Edukimi mediatik: Nënkupton ndikimin (edukata) e programeve mediatike të cilat ndikojnë pozitivisht në një larmi formash tek individit.

Edukimi në teatër: Nënkupton edukimin e nxënësve/të rinjëve duke vizituar apo marrë pjesë në shikimin e veprave të ndryshme teatrale, të cilat ndikojnë në të kuptuarit e diksionit, ndërveprimet, artikullimit, dëgjimit, etj.

Edukim: Nënkupton tërësinë e ndikimeve, do të thotë, të gjitha ato ndikime a veprime që i ushtron individit, shoqëria, grupet shoqërore dhe institucionet, me mjete, metoda, strategji e forma të ndryshme që si qëllim të fundit e kanë realizimin e një edukate të caktuar.

Edukimi për karrierë: I referohet aktiviteteve brenda shkollës nga këshilltari i karrierës për t'i ndihmuar nxënësit të qartësojnë qëllimet për karrierë, të kuptojnë botën e mësimit dhe punës dhe që u mundësojnë të identifikojnë kapacitetet, kompetencat dhe interesat e tyre, për të marrë vendime për karrierën e tyre dhe aftësitë për menaxhimin e karrierës.

Edukimi për paqën: Edukimi i nxënësve për një qëndrim të favorshëm ndaj paqës ndërmjet komuniteteve dhe popujve.

Edukimi shoqëror: Nënkupton edukimin e nxënësve/të rinjëve në procesin e socializimit pozitiv jo vetëm brenda hapësirës së shkollës por edhe të komunitetit shoqëror.

Edukimi special: Nënkupton edukimin e veçantë për kategoritë e nxënësve me nevoja të veçanta.

Edukologjia: Nënkupton emrin bashkëkohor të shkencës mbi edukimin, fenomenologjin e edukimit si proces teorik e praktik e cila përfshin si pedagogjinë ashtu edhe andragogjinë.

Efekt i Halo: Nënkupton një karakteristikë që influencën gjithë përshtypjen.

Efekt i Pygmalion: Nënkupton ndikimin e parashikimit të mësimdhënësit që çon në profeci vetëpërmbushëse.

Efekt: Nënkupton ndryshimet që shkaktohen nga një shkak i caktuar dhe që prodhon një pasojë të caktuar, mund të jenë pozitive apo negative në edukim.

Efektivitet: Nënkupton rezultat të vëzhgueshëm të të mësuarit, të zotëruar nga individit.

Efikasiteti i mësimdhënësit: Nënkupton një nga karakteristikat që thekson aftësitë, këmbënguljen dhe mbështetjen që mësimdhënësi e jep gjatë zbatimit të strategjive dhe ndihmave për t'i mbajtur të angazhuar të mësojnë në mënyrë të pavarur dhe me efikasitet.

Efikasiteti në mësimdhënie: Shkalla apo niveli i arritjes së pikësynimit të mësimdhënësit gjatë zbatimit të strategjive për ti

mbajtur të angazhuar nxënësit si dhe arritjet e tyre që të mësojnë në mënyrë të pavarur dhe me efikasitet të lartë.

Ego: Nënkupton identitetin, integritetin dhe veçantinë e personalitetit, për të cilat ai është i vetëdijshëm.

Egocentrizëm: Pikëpamje, sipas së cilës në mendimet dhe veprimet e veta në qendër të çdo gjëje njeriu e ka unin e tij.

Egocentrizmi i nxënësit: Termi i referohet supozimit se të gjithë njerëzit e shikojnë botën sikur e shikon (kupton) ai vetë.

Ekipi për vlerësim i shkollës: Ekipi i formuar dhe i aftësuar me qëllim që të bëjë vlerësimin e zbatimit të planit të zhvillimit të shkollës dhe të projekteve shkollore.

Ekipi zhvillimor i shkollës: Ekipi i formuar dhe i aftësuar me qëllim që të bëjë vlerësimin e zbatimit të planit të zhvillimit të shkollës.

Eksemplaritet: Nënkupton tërësi përmbajtësore, hulumtuese-integrative ose projektuese, që mund të shërbejë si shembull në qasje të ngjashme në mësim.

Ekskursion mësimor: Nënkupton vizita e bibliotekave të qytetit, muzeut të ekologjisë, historisë, ndonjë objekti arkitektonik, institucioni, apo hapësire tjetër, e planifikuar mirë dhe me qëllim të caktuar mësimor.

Eksperiencia në edukim: Nënkupton përvoja të ndryshme mësimore që janë të dobishme dhe të rëndësishme dhe që ndihmojnë në përvetësimin e shkathtësive dhe aftësive mësimdhënëse.

Eksperiencia personale: Nënkupton shumëllojshmërinë e ndërveprimeve, aktiviteteve dhe vështirësive praktike që ne kemi gjatë të jetuarit (fizike, mendore dhe sociale) e të cilat janë të veçanta dhe individuale gjatë përvojave jetësore.

Eksperiencia: Përvoja gjatë ndërveprimeve specifike apo rastësore me mjedisin dhe njerëzit (eksperiencia fizike dhe sociale).

Eksperiment: Metodë shkencore dhe arsimore, ku një grup i caktuar subjektesh është grup eksperimental, ndërsa tjetri është grup i kontrollit dhe këtu ka mundësi kontrollimi “manipulim” të një variabli.

Ekspert i fushës: Person me njohuri dhe aftësi specifike në një fushë të caktuar të edukimit (p.sh. ekspert për hartimin e kurrikulës shkollore, vlerësimin).

Ekstenzifikim: Zgjerimi i përmbajtjeve programore në arsim.

Ekstra-kurikulumi: Nënkupton rrjedhoja të aktiviteteve të ndara, në radhë të parë praktike, që paraqesin pjesë të veçanta shtesë të kurrikulumit institucional ose të kurrikulumit të shkollës.

Ekulibri: Promovon progresin e të menduarit duke krijuar një balancë mes informative dhe eksperiencave që nxënësit përjetojnë në mësim.

Elasticiteti në mësimdhënie: Nënkupton përdorimin e njohurive dhe teknikave që ka në dispozicion mësimdhënësi për të formuluar një plan efektiv mësimi, aftësia për të improvizuar, kjo mund t’u përshkruhet si një “ndjenjë” e mësimdhënësit për të bërë

një veprim të duhur në kohën e duhur gjatë procesit të mësimdhënies (mësimdhënia nuk ka formula të sakta zbatimi në klasë).

Element nga një detyrë: Një nga detyrat (p.sh. pyetja) e përfshirë në një test ose në një detyrë kontrolli, provim të shkurtër, kuiz, etj.

Emocionet: Janë gjendje psikofiziologjike që orkestrojnë veprimet tona, të cilat i lehtësojnë sjelljen, zhvillimin tonë, ndërveprimin tonë të përditshëm, pjesë integrale e mësimdhënies dhe të mësuarit të cilat ndërlidhen me kreativitetin, sfidën, kurajën, gëzimin, përkushtimin, hidhërimin.

Emocioni i fëmijëve: Përjetim i ndjenjave të fëmijës, të lidhura kryesisht me dashurinë, gëzimin, pikëllimin, zemërimin, frikën.

Empati: Ndjeshmëria e individit ndaj ndjenjave dhe motiveve të të tjerëve, ose vënia e vetës në vendin e tjetrit.

Empatia e mësimdhënësit: Aftësia emocionale ndjeshmëria për nevojat njohëse, dhe të të mësuarit e nxënësit nga mësimdhënësi.

Empiricizmi: I referohet të gjitha teorive që vijnë nga përvoja dhe çdo gjë që ofrohet nga shqisat, për t'u vendosur në shërbim të përvojës si objekt analize.

Enciklopedia: Vepër gjithëpërfshirëse, duke përmbajtur njohuri, informacione me përmbajtje të të gjitha degëve të diturisë dhe të thesareve kulturore, të shkencave natyrore, teknike dhe shoqërore-politike.

Enkopresi (defektim i pavullnetshëm): Është pasojë e një situatë me një ngarkesë të madhe emocionale për fëmijën (vdekje, ndarje, dhunë, etj).

Entuziazmi mësimor: Një ndjenjë veprimi personale, gëzueshmëria, dëshira për të mësuar në një aktivitet mësimor, ndjesia që nxënësit dëshirojnë të punojnë për një detyrë (sepse dëshirojnë, jo sepse u është thënë nga mësimmhdhënsi).

Entuziastët: Nënkuptohen, dëshirën e disa nxënësve për ndryshimin pozitiv dhe gatishmërin për të zgjedhur të mësuarit sipas perspektivës individuale, stilit dhe aftësive të tyre për zhvillim.

Entuziazmi i mësimdhënësit: Nënkupton shprehje të vërtetë energjike, emocioni dhe dëshirë gjatë zhvillimit të mësimimit me nxënës.

Entuziazmi për të mësuar: Dëshira e fëmijës e bashkëdyzuar me përpjekjen konjitive e cila ndikon në prirjen për të mësuar më shpejt dhe saktë.

Epistemologjia: Nënkuptohet njihet ndryshe si shkencë e dijës, reflektimi rreth parimeve e metodave të njohjes shkencore pasi i janë nënshtruar arsyetimit racional dhe analizës teorike, pra një “pavarësim/çlirim” të shkencës nga përvoja.

Eseja 5’: Është një teknikë e të shkruarit ku nxënësit shkruajnë dy gjëra: Një gjë që mësohet gjatë orës dhe që për ta kishte rëndësi dhe një pyetje rreth mësimimit që mësuan.

Eseja shkencore: Punimi që përmban elemente të shkrimit shkencor, letrar dhe publicistik për një çështje të caktuar shkencore e shoqërore.

Etapa përgatitore (hyrje në orën mësimore): Nënkuptohej etapa në përgatitjen e nxënësve, nxitja e interesave për të mësuar dhe për përvetësimin e diturive si dhe për vëmendje dhe një angazhim shqisor në mësim.

Etapa kryesore e orës (pjesa kryesore e orës mësimore): Është pjesë më e rëndësishme kur mësimdhënësi zhvillon njësi të re mësimore, dhe nxënësi mëson, njeh, kupton, analizon dhe arrin të ketë një kuptim të vetin për njësinë e re.

Etapa përfundimtare (pjesa përfundimtare në orën mësimore): Nënkuptohej etapa me rëndësi në përsëritjen e njohurive të mësuara, për kontroll në përvetësimin e shprehive dhe aftësive dhe dhënia e detyrave të shtëpisë.

Etapat e zhvillimit të përmbajtjeve: Nënkuptohej, ndarje mësimore logjike në tri pjesë (në disa raste edhe në planifikim të shkruar) e një ore mësimore pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe pjesa përfundimtare.

Etika e komunikimit online: Rregullat e komunikimit online në ndërkomunikimet virtuale, ku nxënësi të jetë i aftë të mbrojë veten dhe të tjerët nga rreziqet e mundshme online, nga fjalët e papranueshme.

Etikë: Doktrina që ka për objekt gjykimin ndërmjet së mirës dhe së keqës.

Etiketimi i fëmijëve: Nënkupton shprehje fyese nga mësimdhënësit ose bullizuese ndaj nxënësve të cilat prekin personalitetin dhe integritetin e tyre.

Eustres: Nënkupton përvojat e këndshme të njeriut në jetë, siç është martesë.

Evaluimi: Nënkupton vlerësimi në rrjedhë dhe përfundimtar i rezultateve të arritura.

Ë

Ëndrra: Ëndrra është një aktivitet mendor gjatë gjumit.

Ëndrrimi: Një gjendje (e ngjajshme me imagjinatën) në të cilën një individ, imagjizon realizimin e dëshirave të tij ose kompenson nënvetëdijshëm disa dështime nga jeta e përditshme.

Ëndërrimi në klasë: Proces i nënvetëdijshëm me sy hapur i nxënësit në klasë për situatat jetësore, dukuritë që nuk kanë bazë reale nga shqisat.

F

Fakt: Një ngjarje reale, konkrete që mund të dëshmohet.

Fakt pedagogjik: Nënkupton informacion specifik, unik për subjekte dhe objekte konkrete, si nxënësi, mësimdhënësi, ditari, libri, etj.

Faktor: Rrethanë dhe forcë lëvizëse që ndihmon të shfaqet e të realizohet një dukuri apo një proces.

Faktor kontekstual në arsim: Nënkupton faktorë të ndryshëm të kontekstit të një vendi të cilët janë socio-kulturorë, socio-ekonomik, socio-gjuhësor e të cilët mund të ndikojnë pozitivisht apo negativisht në procesin e arsimit.

Faktorët e jashtëm ndikues në edukim: Nënkupton mediat, individët (profesionistët, hulumtuesit, njohësit e arsimit) organizatat profesionale dhe joprofesionale të cilat japin gjykime apo opinione për një strategji, qasje, tekst, çështje ose veprimtari mësimore për ta rishikuar apo ndryshuar tërësisht. Ndikimi nga faktorët e jashtëm mund të jetë pozitiv dhe negativ.

Faktorët objektiv në mësimdhënie: Nënkupton faktorët të cilët ndikojnë në dinamikën e funksionalitetit të procesit mësimor në mënyrë që puna mësimore të zhvillohet sipas planifikimit të mësimdhënies për nxënësit.

Faktorët e procesit të mësimdhënies: Nënkupton faktorët subjektivë dhe objektivë (dy faktorët kryesorë dhe të rëndësishëm) që ndikojnë në procesin e mësimdhënies.

Faktorët subjektivë: Nënkupton faktorët e brendshëm të cilët ndikojnë në dinamikën dhe në funksionalitetin e procesit mësimor sipas planifikimit të mësimdhënies për nxënësit si kreativiteti, imagjinata, etj.

Faktorët kufizues në arsim: Nënkupton faktorët pengues, socio-kulturorë, socio-ekonomik, socio-gjuhësor dhe faktorët politikë që ndikojnë në humbje të vullnetit të nxënësve për mësim.

Faktorët kyç në mësimdhënie: Nënkupton pikësynimet e një mësimdhënie të ndërlidhur si: planifikimi, qartësia dhe organizimi, ngrohtësia dhe entuziazmi, arritjet në mësim dhe motivimi, gjatë situatave mësimore dhe vlerësimi me qëllim që nxënësit të mësojnë përmes mësimdhëniës një mësim të caktuar.

Faktorët ndikues në mësimdhënie: Nënkupton faktorë që ndikojnë drejtpërdrejtë ose tërthorazi në cilësinë e mësimdhënies ose ndryshimin e natyrës së mësimdhënies.

Faktorët objektivë në hulumtim: Nënkupton faktorët e imponuar nga jashtë, që ndikojnë në punën tuaj hulumtuese.

Faktorët që influencojnë të mësuarit: Nënkupton nxitës në të mësuar si atmosfera e klasës, motivimi për të mësuar, nga mësimdhënësi dhe metodologjia e punës së tij.

Familiarizimi: Nënkupton që nxënësi ka njohuri më përpara për atë koncept, term, nocion të cilin po e mëson tani në klasë si terminologji.

Familje: Nënkupton një bashkësi me lidhje gjaku që karakterizohet nga marrëdhëniet ndërmjet burrit e gruas dhe fëmijëve të tyre.

Fantazi: Dukuri psikike që mbështetet në të menduarit krijues, që ka të bëjë me përfytyrimin e objekteve, dukurive, etj.

Faza paraaktive e mësimdhënies: Nënkupton arsyetimin e mësimdhënësve gjatë marrjes së vendimeve për planifikimin e mësimin në funksion të zgjidhjes së kompleksitetit të situatave mësimdhënëse në klasë.

Faza pasaktive e mësimdhënies: Nënkupton argumentet e përdorura nga reflektimi, vënia në pah e mangësive specifike në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies në klasë.

Fazat e kërkimit shkencor: Përmbajn të gjithë hapat, sipas të cilëve do të zhvillohet kërkimi prej fillimit deri në fund, procedurë kjo që ndryshon në qasjen sasiore dhe qasjen cilësore të projekteve kërkimore.

Fazat e orës mësimore: Nënkupton mënyrat se si do të strukturohet, mësohet dhe vlerësohet tek sekuencat e ndara me shkrim (apo në mendje) të veprimtarisë së mësimdhënsit gjatë aktiviteteve mësimore brenda orës 45' minutash në klasë.

Feedback: Nënkupton një pjesë të rëndësishme të procesit të shpjegimit dhe të mësuarit që bëhet në formën e një bashkëbisedimi ndërmjet mësimdhënsit dhe nxënësve që do t'i mundësojnë atyre të përmirësojnë të mësuarit e tyre duke marrë veprimet e duhura për të përdorur pikat e forta dhe për të kapërcyer pikat e dobëta të të mësuarit në klasë.

Fëmija pjesëmarrës aktivë në edukim: Nënkupton kur fëmija zhvillohet dhe mëson më së miri, duke u ballafaquar me sfida, në këtë ballafaqim i rrituri është vetëm orientues, i cili nuk pengon iniciativat dhe kreativitetin e fëmijës, përkundrazi i nxit atë vazhdimisht në këtë drejtim dhe i krijon një ambient sa më motivues.

Fëmijë: Nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën 18-vjeçare, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin e atij vendi, të cilit ai i nënshtrohet si qytetar.

Fëmija egocentrik: Nënkupton fëmijë që e shikon botën nga perspektiva personale.

Fëmijë i vështirë: Nënkupton për të treguar një sërë devijimesh varësisht nga vështirësia në sjelljen e fëmijëve.

Fiksion: Nënkupton mendimi për situatën, raportin, dukurinë që nuk ka bazë reale.

Filozofia: Shkenca e cila studion fenomologjinë e ekzistencës dhe realitetit mbi të vërtetën, njohjën, vlerat, arsyet, mendjen dhe gjuhën si shqyrtim filozofik.

Financimi i kërkimeve: Nënkupton financimin (në bazë të vlerësimit paraprak të projektit kërkimor) për botim ose studim të mëtejshëm të kërkimeve.

Fjala “kurrikulë”: Nënkupton tërësi të përmbajtjeve të cilave u nënshtrohet nxënësi gjatë përvojës së tij arsimore, që përfaqësojnë qëllimet e kursit, planin mësimor, programet e lëndëve metodologjin vlerësuese dhe tekstet mësimore.

Fjalët kyçe: Nënkupton fjalët kryesore që tregojnë fokusin ose elementet kryesore më të rëndësishme që thuhën në tekst ose duhët të mësohen në analizën e detyrës që tërheqin vëmendjen e nxënësit, që janë veçanërisht të rëndësishme në të mësuarit e qëllimshëm dhe gjatë përfundimit të orës mësimore.

Fjalorët: Paraqesin fonde të fjalëve e të shprehjeve, specifike dhe të përgjithshme me të cilat shërbehemi më shpesh dhe japin një ndihmesë, për të mësuar dhe sqaruar (nocionet, termat, fjalët, shprehjet) që i përdorim dhe të kuptuarit e tyre.

Fleksibël: Nënkupton atë që i përgjigjet diversitetit të nxënësve dhe problematikave, kushteve të punës dhe çështjeve që trajtohen nga mësimdhënësi.

Fleksibilitet në mësimdhënie: Nënkupton elasticiteti, përshtatja në procesin e punës mësimdhënëse sipas karakteristikave individuale dhe karakteristikave të tjera të fëmijëve/nxënësve nga mësimdhënësi në klasë.

Fleksibiliteti në komunikimin në mësimdhënie: Nënkupton një gatishmëri për t'ju përshtatur dhe përputhur procesit të të shpjeguarit, në bazë të kushteve dhe situatave të reja dhe të ndryshme në klasë nga mësimdhënësi.

Fletanketë: Mjet (fletë) për kryerjen e anketimit, ku zakonisht janë shkruar pyetjet.

Fletore pune: Nënkupton një “libër” i veçantë shtesë që vie bashkë me tekstin shkollor në të cilën jepen udhëzime për të mësuar procedura të qarta përshkruese (zgjedhje detyrash) të listuara sipas temave që i ndihmojnë nxënësit në të mësuar të pavarur në klasë dhe në shtëpi.

Forma frontale e mësimdhënies: Nënkupton organizimi i përbashkët i mësimit me të gjithë nxënësit e një klase, në kohë të njëjtë dhe ku zhvillohet në tërë klasën, nën udhëheqjen e mësimdhënësit.

Fobi: Frikë e paarsyeshme ndaj objekteve, dukurive ose situatave reale.

Fondi i shkollës: Nënkupton tërësinë e burimeve financiare që përdoren për zhvillimin e veprimtarisë mësimore të përgjithshme dhe specifike në shkollë.

Fonologjia: Nënkupton një mënyrë e kombinimit të tingujve për të formuar fjalë, pra sistemi i tingujve dhe rregullave që udhëheqin këtë kombinim për të mundësuar nxënësit për të vargëzuar e kombinuar tingujt në formimin e fjalëve.

Forma frontale (ballore): Nënkupton kur procesi mësimor dhe mësimdhënia nuk diferencohet për interesa, stile të ndryshme të të mësuarit të nxënësve por ofrohët, organizohet për të gjithë njëjloj nga mësimdhënësi.

Formalizëm: Nënkupton një mësimdhënie (inefektive, formaliste), ku është e ndarë forma nga përmbajtja dhe shpie drejt të mësuarit përmendësh (mekanik) të nxënësve.

Formalizmi didaktik: Nënkupton një mbitheksim të qëllimeve dhe aspekteve funksionale mbi ato njohëse gjatë mësimdhënies dhe të mësuarit.

Format e bashkëpunimit në të mësuar (veprimtari mësimore) në klasë: Janë format e të mësuarit të nxënësve gjatë procesit mësimor ato ndahen në individuale, kolektive ose në grupe (dyshe).

Format nxitëse: Janë format e të mësuarit gjatë procesit mësimor nxitjet për të përmbushur nevojat ekzistuese të nxënësve duke marrë parasysh specifikimet, vlerësimin dhe planet alternative të komunikimit.

Formësimi i shprehisë: Nënkupton vlerësimin e përpjekjes së nxënësit që i afrohet synimit të detyrës, dhe që gradualisht, pas përpjekjeve të përsëritura të nxënësit arrin shprehinë (psh.për të shkruar, arrin të shkrimi thuajse standard apo standard i gjuhës).

Formësimi: Nënkuptoheft aftësimi gradual që iu mundëson qenieve humane që të mësojnë (si të shkruajmë, si të sillemi, si të komunikojmë) në situata komplekse gjatë gjithë jetës.

Formim profesional i vazhdueshëm: Nënkuptohen të gjitha aktivitetet që shërbejnë për zgjerimin e njohurive dhe aftësive profesionale, për t'i përshtatur ato ndaj ndryshimeve përmbajtësore, që kanë për qëllim zhvillimin profesional të individit, nëpërmjet trajnimeve të ndryshme gjatë punës, ose trajnimeve që organizohen nga agjencione të specializuara në zhvillimin e mësimdhënies bashkëkohore.

Formimi dhe zhvillimi i vizionit nga nxënësit: Ndikohet nga faktorë të ndryshëm socialkulturore dhe vizioni i tij për vetën i cili mund të jetë jo shumë i qartë p.sh. nuk e di çfarë profesioni dëshiron, mësimdhënësi ndikon në formimin e një vizioni të qartë për nxënësin.

Formimi fillestar i mësimdhënësve: Nënkuptohen mënyrat e zhvillimit profesional, bazat e kapacitetit të duhur profesional që fillon me formimin fillestar të mësimdhënësve, pasuar nga një fazë përfshirjeje në profesion në vitet e para të punës dhe duke vazhduar me një proces tërësor të zhvillimit profesional gjatë karrierës, si një proces i vazhdueshëm i të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Formimi i nocioneve: Nënkuptohe proces mendor sistematik, gjatë të cilit bëhet krahasimi, dallimi dhe identifikimi i cilësive thelbësore dhe ruajtja, përditësimi e përdorimi i nocioneve gjatë procesit të komunikimit.

Formulimi i problemit: Nënkupton zgjedhjen e temës, që zakonisht është titull i punimit të hulumtimit.

Foshnjëri: Nënkuptohen mosha e fëmijës nga lindja deri në moshën 1-vjeçare.

Frika në shkollë: Nënkupton frikë të theksuar për të shkuar në shkollë ose ndarje nga prindi.

Frikë: Nënkuptohe ndjenjë shqetësimi ndaj situatave të papritura ose të rrezikshme.

Frustracion: Nënkuptohe gjendje shpirtërore që shkaktohet nga mosrealizimi i qëllimit.

Frustrimi i fëmijës: Nënkupton sjellje kur në pamundësinë e plotësimi të ndonjë nevoje apo arritjes së qëllimit, të cilat në disa raste arrijnë të sforcohen deri në atë masë që fëmijën ta nxisin, të sulmojë bashkëmoshatarët e tij.

Frymëzim: Nënkuptohe gjendje psikike optimiste dhe entuziaste për një veprimtari.

Funksion motivues: Nënkuptohe qëllimi, roli i një marrëdhënie të ndërvarur në mes të aftësive dhe motivimit të individit.

Funksion profesional metodik: Nënkuptohej rol tipik, nga detyrat profesionale sipas një kriteri të caktuar, njëri nga funksionet e profesionit të mësimdhënies është ai metodik.

Funksion vullnetarësh në shkollë (i prindit, i personit tjetër): Nënkuptohej pjesëmarrja vullnetare në aktivitete hulumtuese integrative apo zhvilluese në shkollë.

Funksione të të folurit: Nënkuptohej disa funksione në jetën e fëmijës: gjuhësor, informativ, shprehës, përcjellës i mendimeve, afirmativ, abstragues, etj.

Funksionet e vlerësimit të brendshëm nga mësimdhënësi: Nënkupton vlerësimin për planifikim, për përmirësim, për përgjegjësi, për përzgjedhje, për certifikim, për motivim, për monitorim, për mbështetje publike për zhvillimin e veprimtarisë në procesin mësimor, etj.

Funksioni i mjeteve mësimore: Nënkupton ndikimin e këtyre mjeteve në disa aspekte si: të natyrës psikologjike, gnoseologjike, didaktike, praktike dhe konkretizuese-ilustrative në mësimdhënie dhe në të mësuar.

Funksioni semiotik gjuhësor: Nënkupton aftësimin e nxënësve për të përdorur simbolet gjuhësore, shenjat apo gjestet, për të sjellë në mendje veprimet apo objektet.

Funksioni abstragues gjuhësor: Nënkupton aftësimin e nxënësve për të lidhur me procesin e të menduarit gjuhësor.

Funksioni i afirmimit gjuhësor: Nënkupton një funksion për aftësimin e nxënësve në afirmimin e vetvetës dhe për shprehjen e përvojave vetjake.

Funksioni i ndërveprimit gjuhësor: Nënkupton aftësimin e nxënësve që me anë të gjuhës të përcjellë mendimet e tij dhe të realizojë të folurin në shprehjen e të gjitha ndjenjave, që lidhen me marrëdhënien e fëmijës me botën që e rrethon.

Funksioni informativ gjuhësor: Nënkupton aftësimin e nxënësve për të komunikuar dhe të prezantimit dhe përfaqësimit të vetës .

Fuqizimi i nxënësit në të mësuar: Nënkupton aftësimin e nxënësve për të rritur nivelin e pavarësisë dhe vendosmërisë duke bërë të mundur që ata të mësojnë në mënyrë të pavarur, të përshtasin të mësuarit e tyre dhe ta vlerësojnë atë në një mënyrë objektive të arsyeshme.

Fusha emocionale: Është fusha e cila i referohet strukturës së emocioneve të nxënësve që fokusohen të ndjenjat dhe qëndrimet e nxënësve ndaj të mësuarit.

Fusha kognitive ose njohëse: Është fusha e cila i referohet strukturës së dijes ose njohëse, në të cilën do të përqendrohemi, si një sekuencë progresive e kontekstualizimit të materialit mësimor të nxënësve.

Fusha programore: Nënkupton një pjesë e përmyllur nga programi arsimor/mësimor për arsimin parashkollor dhe për arsimin fillor.

Fushë profesionale e mësimdhënies: Është fusha e cila i referohet aftësitë të mësimdhënësve sipas niveleve të ndryshme të kompetencave profesionale.

Fushë psikomotore: Është fusha e cila i referohet aftësive fizike dhe lëvizore (lëvizshmërisë) së nxënësve, sforcimit të tyre nga ushtrimet fizike.

Fusnotat: Nënkupton numra “simbolikë” kur marrim një mendim të një autori, e sistemojmë në studimin a punimin tonë, e vejmë në thonjza dhe e evidentojmë, me numra “simbolikë” që vendosën në fund të tekstit me rastin e citimit, perifrazimit, apo diku në faqe të tekstit, gjithashtu edhe në rastet kur dëshirojmë të sqarojmë pa bërë ndërhyrje në tekst.

G

Gabim në mësim: Pasaktësi në numërim, në llogaritje, në vrojtim në të mësuar etj, që shkaktohet nga njohja e pamjaftueshme dhe jo e drejtë e detyrës, kërkesës, etj.

Gabimi standard: Nënkupton term në hulumtime që pasqyron devijimin standard të shpërndarjës së mostrave të asaj popullate, pra luhatjet e mostrës së përfshirë në ndërtimin e intervaleve të besimit dhe testimi i domethënies bazohët në gabimet standarde.

Gantogram: Nënkupton term në hulumtime tabelë që i përmban të gjitha aktivitetet e rëndësishme dhe që shënon periudhën e tyre kohore të realizimit, kontributin dhe përgjegjësitë.

Gatishmëria për të mësuar: Nënkupton ka të bëjë me nivelin e serozitetit, maturimit dhe disa shprehi bazë (nxënësit bëhen gati të mësojnë atë që mësimdhënësi ju thotë se duhet ta mësojnë), kur nxënësi jep sinjale se ka arritur gatishmërinë optimale të vëmendjës për të mësuar një të dhënë, shprehi ose një sjellje të re.

Gënjeshtra e fëmijëve: Nënkupton fshehjen e së vërtetës me qëllim mashtrimi të edukatorit ose prindërit.

Gerontologji: Nënkupton shkencën që studion moshën e pleqërisë.

Gjeje titullin: Nënkupton një teknikë, kur nxënësit e lexojnë me kujdes materialin, analizojnë atë në tërësi dhe japin një gjykim të shkruar si titull, i cili do të shprehte përmbajtjen dhe mesazhin e tekstit të lëxuar.

Gjellërim i nxënësit: Nënkupton reagim fizik (valë trunore, rrahje të frymarrjës dhe rrahje të zemrës) psikologjik (të emocionuar, vemendje e përqendruar “me sy dhe vesh”) që e bëjnë një nxënës vigjilent, të vëmendëshëm dhe të zgjuar të punojë me efikasitet brenda klasës dhe shkollës.

Gjenealogji: Nënkupton prejardhjen e individit, familjes, fisit sipas rrjedhës historike.

Gjeni: Nënkupton zgjuarsia e mbiveçantë natyrore e një individi për të gjitha aktivitetet në jetë.

Gjenotip: Nënkupton tërësin e dispozitave të trashëguara te një individ.

Gjesti etik: Nënkupton pozicionin e nxënësit reagimin apo kundër reagimin e tij pozitiv.

Gjesti joetik: Nënkupton gjestin e pahijeshëm negativ kundrejt rregullave etike.

Gjestikulacionet: Nënkuptohen lëvizjet e kokës (gjymtyrëve) duarve dhe këmbëve.

Gjithëpërfshirja: Nënkupton përfshirjen e të gjithë fëmijëve a nxënësve në edukim, pa dallim race, gjinie, gjuhe, kombi apo dallimeve të tjera individuale: mendore, fizike, emocionale, sociale dhe përdorimin pozitiv të këtij fakti për të siguruar pjesëmarrje aktive në procesin mësimor në shkollë.

Gjobë: Nënkupton vëndosje të dënimit (pagesë në përputhje me shumat e përcaktuara) e cila jepet në rast të shkeljeve të legjislacionit ose rregullores së etikës në mësimdhënie për mësimdhënësin.

Gjuha funksionale e nxënësit në shkollë: Nënkupton disa funksione abstraguese, të lidhura me procesin e të menduarit, informativ dhe të përfaqësimit për afirmimin e vetvetës dhe për shprehjen e përvojave vetjake të ndjenjave dhe ndërveprimeve në komunikimin me mësimdhënësin që nga biseda, pohimi, mohimi, vlerësimi, gjykimi, etj.

Gjuha receptive: Nënkupton mesazhin, që nxënësit “marrin” gjatë një bisede me mësimdhënësin.

Gjuha shprehëse: Nënkupton mendimin që nxënësit përcjellin, kur “flasim” me mësimdhënësin.

Gjuha: Nënkupton një kod arbitrar, një sistem simbolesh, për të përcjellë mendime që përfitohen (mësohen) gjatë fëmijërisë, në komunikim, ndërveprim, në shprehjen e të gjitha ndjenjave dhe afirmimin e vetvetes në të gjitha fushat e zhvillimit.

Gjykim: Formë e të menduarit logjik, në të cilin pohojmë ose mohojmë diçka.

Gjymtyrë: Organet lëvizore të trupit të njeriut, përkatësisht duart dhe këmbët.

Gradë shkencore: Kualifikim pasuniversitar që arrihet si rezultat i studimeve dhe mbrojtjes, me sukses të temës së nivelit të caktuar. (master shkencor, Msc, përkatësisht, doktor shkence, Dr.PhD).

Grafologji: Nënkuptohe interpretimi dhe gjykimi i zhvillimit të individit në bazë të dorëshkrimit të tij.

Grafomotorika: Nënkuptohe aftësia motorike e gishtrinjëve të dorës në të shkruar.

Grant: Nënkuptohen mjetet monetare të cilat ministria (MASHT) i ndan nga buxheti shtetëror, për pagat e mësimdhënësve apo tekstet shkollore, për nevoja specifike të shkollës, apo për një aktivitet me një qëllim të caktuar (sidomos për shkollat profesionale).

Grantet specifike për arsim: Nënkuptohen mjetet monetare të cilat ministria (MASHT) i ndan (përcakton me një formulë sipas numërit të nxënësve, arsimimit të nxënësve me nevoja të veçanta, dhe lokacionit specifik të shkollës) për komuna për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, për realizimin e procesit mësimor në shkolla.

Grupet e interesit në arsim: Nënkuptohen të gjithë subjektet e interesuara që arsimi të zhvillohet në vazhdimësi dhe që kontribuojnë në zhvillimin e arsimit.

Grupi përfaqësues në hulumtim: Nënkuptohen pjesë te popullacionit, e zgjedhur nga një pjesë te rasteve individuale (në bazë të disa kriterëve), me qëllim të përfaqësimit të tërë popullacionit të hulumtimit. Grupi përfaqësues në literaturë haset edhe me emërtime të tjera: model, kampion, ekzemplar.

H

Habi: Ndjenjë e papritur, e pakuptueshme, ose e pabesueshme për individin.

Hamendje: Gjykimi si na merr mendja, pa informata, të dhëna të mjaftueshme apo fakte për dukurinë.

Harresë: Pamundësia e individit për të njohur ose riprodhuar atë që ka jetuar, parë ose ka mësuar më parë.

Harta e konceptit: Nënkuptohet organizimi grafik për të lidhur vizualisht copëza dhe pjesë të informacionit, të cilat mund të përdoren për prezantim vizual të karakteristikave të konceptit përmes përdorimit të një organizimi të lidhur dhe hierarkik të informacionit.

Hartë mësimore: Mjet mësimor ndihmës i printuar ose digjitale për ilustrim të mëimit që paraqet në përmasa të zvogëluara sipërfaqe të caktuara të rruzullit tokësor ose të pjesëve të saj.

Hedonizmi: Teoria që thekson se individi është i motivuar të kërkojë kënaqësinë dhe të shmang dhimbjen.

Heteronomus: Term që përdoret kur subjekti (nxënësi) i nënshtrohet rregullave të jashtme ose ligjeve nga mësimdhënësi në të cilat nuk lejohet përjashtimi, atyre rregullave duhet të ju binden nxënësit, andaj ndryshe quhet edhe si moraliteti i detyrimit ndaj nxënësve.

Hezitim në të mësuar: Nënkuptohen sjellje papërcaktueshmërie dhe pavendosmërie të nxënësit për të marrë pjesë në procese mësimore në klasë, hezitim për t'u përgjigjur, komunikuar apo diskutuar me mësimdhënësin.

Hezitimi pët të filluar një aktivitet mësimor: Nënkupton pasigurin e nxënësit për të filluar një aktivitet mësimor si: lexim, të shkruar, vizatim, këndim ose një ushtrimi fizik në klasë.

Hidhërim: Ndjenjë që shkaktohet nga mosplotësimi i motiveve apo nevojave të fëmijës.

Hierarkia e nevojave: Nënkupton rendin sipas së cilit paraqiten nevojat në bazë të intensitetit të tyre.

Hiperaktiviteti: Nënkupton zhvillim jo adekuat i vëmendjes dhe përqëndrimit, (të qenit shumë aktiv gjatë të mësuarit ose kryerjes së ndonjë detyre mësimore e cili manifestohet me ngutësi dhe

moskontroll në reagime nga nxënësi), levizje e tepruar dhe e pakontrolluar, ndaj ngacmimeve të ndryshme të mjedisit.

Hipoteza: Ide ose parashikimi për një çështje, problem të caktuar, e parashtruar si bazë për punë empirike, një mendim, një ide, tezë, gjykim apo qëndrim i besueshëm dhe i mundshëm për objektin e studimit, që hulumtuesi duhet të na vërtetoj më vonë pas hulumtimit.

Historia e pedagogjisë: Disiplinë pedagogjike që studion idet dhe sendërtimet pedagogjike, gjenezën, fillet e edukatës, arsimin, shkollimit, zhvillimin e edukatës, në periudha dhe formacione të ndryshme ekonomike, politike dhe shoqërore.

Hospitim të mësimdhënjes në shkollë: Nënkupton vlerësimin përmes vëzhgimit të praktikës së mësimdhënies në një orë mësimore, (nga inspektorët ose drejtorët e shkollave), i cili mundëson atyre të mësojnë për punën e drejtpërdrejtë në shkollë ose për njohjen e punës provuese (licencës/lejës së punës për mësimdhënës fillestar) dhe vlerësimit të performancës së mësimdhënësve për kategorizim profesional të mësimdhënësve etj.

Hulumtim i zgjeruar: Nënkupton fazat kur hulumtuesit e specializimeve të diciplinave pedagogjike (pedagog shkollor, psikolog shkollor, sociolog shkollor) kryejnë një hulumtim si pjesë të një hulumtimi ndërdisiplinar.

Hulumtim: Vrojtje, shqyrtim, gjurmim për një problem që është i panjohur për ta studiuar në diçka të panjohur për të zbuluar të plotë apo disa aspekte të panjohura të problemit.

Humanizëm: Teori e të nxënësve që synon të udhëzojë nxënësit drejt rritjes së tij si personalitet i tërë, i tërësishëm, i cili nënkupton zhvillimin: fizik, mendor, emocional, moral, punues, religjioz etj.

Humor: Nënkupton gjendje shpirtërore ose qëndrim të brendshëm të individit ndaj situatave jetësore dhe shoqërore.

Huti: Nënkupton shfaqja të kundërt me vëmendjen, që shprehet në pamundësinë për ta përmirësuar apo ruajtur vëmendjen.

I

Identifikim: Nënkupton lloj mekanizmi mbrojtës personal, që përjeton individit në realizimin e tij duke u identifikuar me grupin apo një anëtar grupi, gjinie, etniciteti etj.

Ilustrimet: Nënkuptohen mjetet mësimore, që kanë edhe funksionin e metodës, që integrohen në veprimtari të ndryshme të punës mësimore, sidomos kur objekti ose dukuria për të cilat flitet në punën mësimore ndodhet në largësi hapësinore ose kohore, ose kur për shkaqe të tjera nuk mund të prezantohet në klasë.

Iluzion: Nënkupton përceptim të gabuar të objektit që ushtron ndikim të drejtpërdrejtë në shqisat tona.

Imagjinata e nxënësve: Nënkupton “të menduarit” përtej kufizimeve të objekteve fizike që ai sheh duke “krijuar” objekte imagjinare në mendjen e tij.

Imagjinata: Nënkupton proces mendor, përtej kufizimeve të objekteve fizike për zhvillimin e ideve duke krijuar apo përpjekur për të “krijuar” objekte imagjinare.

Imitim: Nënkupton riprodhim të saktë ose të ngjashëm të veprimeve, sjelljeve të një individi nga ana e një individi tjetër.

Improvizimi në mësimdhënie: Nënkupton procesin e mësimdhënies kur rivlerësohet nga mësimdhënsi se nuk mund të zbatohen metodat dhe teknikat mësimore të planifikuara, atëherë ato improvizohen me metodat dhe teknikat mësimore por që janë infektive në mësimdhënie.

Impuls: Nënkupton nxitje për veprim të një ose disa organeve që të kryejnë një veprim të caktuar ndaj një ose disa objekteve, fuqizimi i një dëshire për realizimin e saj.

Indeksi i cilësisë së shkollës: Nënkupton instrument, i cili synon të masë aspekte të organizimit, menaxhimit të shkollës, si dhe mirëqenies së fëmijës.

Indinjatë: Nënkupton një ndjenjë që karakterizohet nga zëmërimi me intensitet relativisht të lartë, ndaj fjaleve fyese ose sjelljeve jo të përshtatshme nga nxënësi.

Individ: Njeri, organizëm i integruar në tërësi biologjike, psikike, shoqërore, me të gjitha tiparet dhe veçoritë e tij.

Individual: Nënkupton një karakteristikë që i përket vetëm atij që dallohet në krahasim me të gjithë të tjerët.

Individualitet: Tërësia e veçorive e tipareve të veçanta karakteristike themelore e njeriut për nga veçoritë e tij endokrine,

anatomike, nervore, kortikale e motivuese që dallojnë në aspektin e krijimtarisë nga të tjerët.

Individualizimi i mësimit: Nënkupton përshtatjen e kërkesave, formave, modeleve, mënyrave dhe mjeteve mësimore me qëllim të zhvillimit maksimal të çdo nxënësi.

Induksion (logjik): Nënkupton proces intelektual, nëpërmjet të cilit nga një numër pohimesh të dhëna kalohet në një pohim më të gjërë.

Induksioni i plotë (logjik): Nënkupton proces intelektual ku nga të gjitha pohimet nga pjesëtarët e grupit (pra ka të bëjë vetëm me grupin përfundimtarë) konkludon një pohim qëndrim (mendim) të përgjithshëm të gjërë, në bazë të të gjitha qëndrimeve apo mendimeve për çdo pjesëtar individualisht.

Induksioni jo i plotë (logjik): Nënkupton një proces intelektual ku një pohim qëndrim mendim nxirret në bazë të pohimeve qëndrimeve dhe mendimeve të një numri të caktuar të ekzemplarëve për të gjitha modelet e ekzemplarëve, i cili mund të jetë përfundimtar për të gjithë klasën.

Inferioriteti i mësimit: Nënkupton ndjenjën e mësimit si i pa aftësuar si pasojë e mos “aftësimit akademik” në aplikim e qasjeve metodave dhe teknikave bashkëkohore përkatësisht gjatë aktivitete mësimore gjatë komunikimit me nxënësit në klasë.

Inferioriteti tek nxënësit: Nënkupton ndjenjën e nxënësit si i pazoti për të vepruar, ndjenja se asgjë nuk mund të bëjë mirë në

shkollë, si hezitues të përfshihen në aktivitete mësimore dhe të paaftë të zgjidhin detyra në klasë.

Informacion kthyes në klasë: Përdoret shpesh edhe si “feedback” nënkupton çdo lloj informacioni që siguron një raport kthyes për realizimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të mësimdhënies në klasë.

Informacionet përshkruese: Proceset e përgjithshme përshkruese njohëse si: shpjegimi, klasifikimi, sqarimi, dallimi, organizimi, vlerësimi.

Informatat: Nënkuptohen konsistojnë në pasjen, njohjen e informatave për faktet e përgjithshme.

Iniciativa e mësimdhënësit: Nënkupton marrjen përsipër këmbënguljen në kryerjen e një detyre ose fillimi i një aktiviteti për të eksploruar ose eksperimentuar nga ana e mësimdhënësit në procesin mësimor.

Iniciativ për të hulumtuar: Nënkupton gatishmërin e kërkuesit për të filluar kërkimin dhe për të kërkuar njohuri të reja në drejtime të reja ose të pa zbuluara më parë.

Inkurajimi i nxënësit nga mësimdhënësi: Nënkupton nxitje në të mësuar nga mësimdhënësi (si pohim verbal, joverbal ose me shkrim, mbështetje që shprehet nëpërmjet lavdërimit dhe përforcimit efektiv për arritje dhe vetëbesim) në shumë aktivitete gjatë procesit mësimor në shkollë.

Inkurajimi: Nënkupton nxitje që të mësojë, të ketë rezultate të mira në arritje, vetëbesim në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme.

Insert: Nënkupton një metodë/teknikë mësimdhënie, e cila u siguron nxënësve të kontrollojnë në mënyrë aktive shkallën e tyre të të kuptuarit gjatë procesit të leximit dhe në fazën e kuptimit efikas, nga materialet që përmbajnë informacion faktike.

Inspektor arsimi: Zyrtari arsimor, i cili kryen mbikëqyrjen inspektuese arsimore të cilësisë së procesit arsimor dhe efektivitetin përmes evoluimit të punës së institucioneve edukativo-arsimore dhe mbikëqyrjen mbi zbatimin e ligjeve, rregullave të tjera dhe akteve të përgjithshme nga sfera e edukimit dhe arsimit.

Institucionalizimi i inovacionit: Nënkupton zbatim të risisë në praktikë që vazhdon të përdoret nga një shkollë pas një periudhe përdorimi, zakonisht dy deri në pesë vite.

Institucionalizimi tematik: Nënkupton futjen e tematikës së caktuar në procesin e mësimdhënies e që më herët nuk ishte pjesë e saj, p.sh. edukimi mjedisor.

Institute hulumtuese pedagogjike: Nënkuptohen institucione kërkimore që në radhët e veta kanë hulumtues me grada shkencore pedagogjike për problematika të veçanta pedagogjike si: mësimdhënja/të mësuarit, komunikimi, menaxhimi i klasës, udhëheqja e shkollës, kurrikula etj.

Instruktimi në mësimdhënie: Nënkupton dhënien e informacioneve udhëzimeve precize nga mësimdhënësi se si duhet të veprohet gjatë përdorimit praktik: në art muzikor, të një vegle muzikore, në art figurativ, brusha, lapsi, në edukatë fizikë, driblime topi në fushë, në teknologji përdorimi i paisjeve për kodim, etj.

Instruktimi: Nënkupton dhënien e njohurive dhe aftësive të reja për një mjet të caktuar, aftësi praktike, dhe t'u japë instruksione verbale gjatë të mësuarit apo zotërimit praktik.

Instrumente vlerësimi: Nënkuptohen të gjitha instrumentet për të dhënat sasiore dhe cilësore (testet, vëzhgimet, dëshmitë anekdotike, studimet e rastit), me anë të të cilave merret informacioni, për efektshmërinë e mësimdhënies dhe të mësuarit për nxënësit.

Instrumenti mësimor për vlerësim të nxënësit: Nënkupton test, pyetësor për çështje të përgjithshme dhe të veçanta që siguron, dëshmon, matë, krahason dhe vlerëson për anët e forta dhe të dobëta të nxënësit në të mësuar në lëndë apo tema të veçanta.

Instrumenti i gatshëm: Nënkupton një instrument të standardizuar, i cili ka nevojë vetëm të përshtatet për kontekstin e caktuar ku përdoret.

Instrumenti i përzier: Nënkupton një instrument kur kërkuesi i merr disa nga pyetjet nga instrumenti i standardizuar, por hiqen disa pyetje dhe vendosen disa pyetje që lidhen me kontekstin vendor ku zhvillohet hulumtimi.

Instrumenti i ri: Nënkupton një instrument që kërkuesi e harton enkas për kërkimin, i cili duhet t'u nënshtrohet validimit dhe besueshmërisë së tij.

Integrim i lëndëve shkollore: Nënkupton një gërshetim, përkatësisht bashkim të elementeve të dy e me tepër lëndëve mësimore (fushave programore dhe përmbajtjeve të tyre) në procesin e punës mësimore dhe të vlerësimit.

Integrim shkollor: Nënkupton përfshirjen e të gjithë nxënësve në shkollë, pa marrë parasysh dallimet gjinore, etnike etj.

Integriteti: Termi i referohet nënkupton të qenit një i tërë dhe i paprekshëm, që përbën një njësi të vetme dhe të pandarë në sensin e pranimit dhe përmbushjes së vetës.

Integriteti i mësimdhënsit: Nënkupton shkallën e investimit personal të mësimdhënsit, pranimi i detyrës si mision, ruajtja, mos lëshuarja pe gjatë krizave ekonomike, vazhdimësia, siguria e brendshme për njohurit, sjelljen dhe vlerësimin e nxënësve.

Intelegjenca artificiale: Nënkupton (sistem "trunore" kompjuterik) në funksion njohës, i krijuar nga njeriu me aftësi tipike për të dhënë përgjigje, me një kujtesë të madhe, që shkruan tekste, për t'i dhënë përgjigje në një apo më shumë pyetje, për të bashkëndërtuar të kuptuarit,etj.

Inteligjenca gjuhësore: Nënkupton aftësinë e përdorimit të gjuhës për të lexuar, për të shkruar, komunikuar, ndërvepruar etj.

Inteligjenca intrapersonale: Nënkupton aftësin e vetënjohjes, vetëreflektimit në kontakt me botën e brendshme të qenies sonë individuale me një sens të vetëdrejtimit dhe një besim të madh në vetvete "për të parë përtej vetes sonë", për të reflektuar dhe për të mësuar nga ky reflektim.

Inteligjenca logjike, matematikore: Nënkupton aftësin e përdorimit të numrave për të arsytuar në mënyrë logjike-matematikore.

Inteligjenca muzikore: Nënkupton aftësinë për të dëgjuar ” shijuar”, kuptuar muzikën, për të gjykuar, transformuar dhe shprehur atë.

Inteligjenca natyrore: Nënkupton aftësinë që lidhet me njohjen, vlerësimin dhe kuptimin e botës natyrës që na rrethon, për të dalluar dhe klasifikuar bimët, mineralet dhe kafshët, të gjitha varietetet e florës dhe faunës në mënyrë produktive (në gjueti, në bujqësi, në shkencën biologjike etj.).

Inteligjenca ndërpersonale: Nënkupton aftësinë në zhvillimin e kuptimit të vetës, me ndjenja dhe emocione që drejton sjelljen dhe aftësinë për të kuptuar dhe për t’u identifikuar me ndjenjat dhe emocionet e të tjerëve për të bashkëpunuar me të tjerët, të mësuarit nga dhe për të tjerët.

Inteligjenca pamore-hapësinore: Nënkupton aftësinë për të perceptuar botën pamore në mënyrë të saktë dhe për të rikrijuar përvojën pamore në “syrin e mendjes”.

Inteligjenca trupore-kinestetike: Nënkupton aftësi manipuluese, ndërtuese, projektuese, të shkathëtisë, komunikuese, ku individit përdor trupin ose pjesë të trupit, duart, gishtat, krahët për të shprehur idetë dhe ndjenjat, për të krijuar dhe transformuar gjëra.

Inteligjenca: Nënkupton tërësinë e funksioneve të lindura njohëse, përshtatëse dhe përfytyruese, të krijuara nga veprimtaria trunore e njeriut dhe aftësia për të zgjidhur problemin apo për t’i dhënë formë një produkti i cili vlerësohet në një apo më shumë mjedise kulturore.

Intensifikim në mësimdhënie: Nënkupton thëllim të brendshëm të përmbajtjeve dhe forcim të efektivitetit në procesin mësimor.

Interaktivitet: Nënkupton ndikimin reciprok të subjekteve në aktivitetet emocionale-njohëse, hulumtuese dhe komunikuese në mes mësimdhënësit dhe nxënësve në procesin mësimor.

Interferenca: Nënkupton ndërhyrje nga (zhurma, faktorë atmosferikë) faktorë tjerë në aktivitetete mësimdhënëse ose komunikuese mësimdhënës -nxënës.

Interpretimi në mësimdhënie: Nënkupton përshkrimin me fjalët e tyre nga mësimdhënësit për mësimdhënien, efikasitetin dhe efektivitetin në mësim.

Intervista e pastrukturuar: Nënkupton lloj intervistash ku nuk ka një rend të pararendosur pyetjesh që hulumtuesi do të drejtojë, që do të thotë se ai nuk i ka paramenduar pyetjet paraprakisht por ato bëhen natyrshëm.

Intervista në hulumtim: Nënkupton formë komunikimi, bashkëbisedimi, e përgatitur, e qëllimëshme që kërkon informacion nga ai që intervistohet tek ai që interviston, si formë ndërveprimi ndodh sy më sy apo njëllojë pyetje-përgjigjesh ndërmjet hulumtuesit dhe të intervistuarit për ato aspekte e dukuri, që nuk mund të njihen nëpërmjet dokumenteve të ndryshme dhe as të zbulohen nëpërmjet vëzhgimeve, apo metodave të tjera të vlerësimit (metodologët/ e quajn teknikë hulumtuese).

Intervistë (e strukturuar): Instrument kërkimor i përbërë nga një listë pyetjesh të parapërcaktuara të cilat synojnë të mbledhin të dhëna mbi një çështje të caktuar.

Intervistë e standardizuar: Nënkupton një pyetësor të shkruar në të cilën specifikohet lloji i informacioni që vlerësuesi ka si qëllim të mbledhë.

Intervistë gjysmë e strukturuar: Nënkupton një instrument që përbëhet nga disa pyetje të hapura, mirëpo gjatë intervistimit të subjektit mund të shtohen edhe pyetje të tjera.

Intuita: Nënkupton një zgjidhje precize për një gjykim apo veprim në jetë, që është i pashpjegueshëm saktë dhe që nuk është rezultat i përvojës jetësore apo i të mësuarit (e pa mësuar teorikisht apo praktikisht) një prirje natyrale, një burim urtësie në vetën tonë, që shumë njerëz nuk e din se e zotërojnë që nga lindja.

Intuita e nxënësit në klasë: Nënkupton një ndikim në zgjidhje precize të një detyre apo problemi mësimor, për t'ju përshtatur rrethanave me sukses dhe në mënyrë aktive pavarësisht sfidave të detyrës ose problemit mësimor në klasë.

Inventar i personalitetit: Nënkupton një instrument matës të përbërë nga një listë pohimesh, deklaratash të cilat synojnë të masin aspekte të caktuara të personalitetit dhe funksionimin e tij.

Inventari shkollor: Nënkupton bankat, karrigat, tabela, hartat shkollore, globi, kompjuteri, projektori, etj.

ISCED: Nënkuptohej klasifikimi i standardeve ndërkombëtare të arsimit të publikuara nga UNESCO e në të cilin bazohen edhe nivelet e arsimit në Kosovë.

J

Jeta profesionale e mësimeve: Nënkuptohej rruga personale, përtej modeleve të trashëguara (njohura, përjetuara, mësuara) në mënyrën e të jetuarit dhe zhvillimit profesional në karrierë.

Jodiskriminimi në mësimdhënie: Nënkuptohej trajtimi në mënyrë të barabartë nga mësimeve, pa diskriminim në baza etnike, bindjet politike ose fetare, origjinën kombëtare dhe shoqërore, përkatësinë gjinore dhe aftësitë e kufizuara të nxënësit.

K

Kakofoni: Nënkuptohej keqtingëllim, përkatësisht kur flasin disa njerëz në të njëjtën kohë.

Kampioni jo me probabilitet: Nënkuptohej mënyra arbitrare në seleksionimin e njësive të kampionit që bazohen në konsiderata subjektive, si p.sh. gjykime personale.

Kampioni mbi bazë grupi: Nënkuptohej kur një rast nga njësia primare e kampionit nuk është një element individual në popullatë, por një grup elementesh.

Kampioni me bazë rastësore sistematike: Nënkuptohej kur një pikë fillestare caktohet me anë të një procesi rastësor dhe më pas numri që vjen pas një numri të caktuar x , në listë zgjidhet në kampion.

Kampioni me probabilitet: Nënkuptohehet çdo njësi (element i popullatës) e studimit që ka një probabilitet jo zero në seleksionimin në një kampion dhe çdo anëtar i popullatës ka një probabilitet të barabartë në përzgjedhjen në një kampion.

Kampioni me zgjedhje rastësore i stratifikuar (i shtresëzuar): Nënkuptohehet një teknikë, me anë të së cilës përcaktohen nëngrupe nga grupe (shtresa) të ndryshme të paracaktuara, që kanë disa karakteristika të ngjashme.

Kampioni me zgjedhje të thjeshtë rastësore: Nënkuptohehet një teknikë që siguron se çdo element në popullatë ka një shansë të barabartë për t'u zgjedhur në kampion.

Kampioni: Definohehet si zgjedhje përfaqësuese e subjektivë, me karakteristika të përafërta nga popullacioni, e që bëhet objekt studimi (pra kur nga një varg rastesh që zgjidhen nga një grup më i madh dhe që përdoren) për të bërë përgjithësime për popullatën.

Kapaciteti memorizues i nxënësit: Nënkuptohehet aftësia për të memorizuar informacionin e transmetuar nga mësimdhënësi.

Karakter: Nënkuptohehet kombinim i cilësive thelbësore dhe të qëndrueshme psikike të personalitetit, të cilat shfaqen nëpërmjet sjelljeve, qëndrimeve komunikimit dhe veprimeve ndaj njerëzve të tjerë dhe ndaj vetës.

Karakteristikat e niveleve moshore: Nënkuptohen përshkrimet psiko-pedagogjike të natyrës dhe karaktersitikave të nxënësve të një moshe të caktuar sipas nivelit shkollor.

Karakteristikat e nxënësit: Janë mënyrat e të kuptuarit arsyetimit, krahasimit etj, vështirësive të përdorimit të gjuhës dhe të komunikimit të cilat jenë të ndryshme tek secili nxënës në klasë.

Karakteristikat emocionale të nxënësve: Nënkuptohen aspekte emocionale karakteristike të nxënësve si: optimist, pesimist, egoist, vetëbesim i tepërt i vetës.

Karakteristikat fizike të nxënësve: Nënkuptohet aspekte fizike karakteristike të nxënësve si: pesha, gjatësia, pamja e jashtme dhe aftësit atletike.

Karakteristikat intelektuale, krijuese: Nënkuptohen aspekte njohëse të të menduarit kritik dhe të karakteristike të nxënësve si: shkrimtaria ,mendësia , përqendrimi dhe durimi.

Karakteristikat sociale të nxënësve: Nënkuptohen aspekte shoqërore karakteristike të nxënësve si: të hapur, të mbrojtur, bashkëpunues, të ashpër, etj..

Karizma e mësuesit: Nënkuptohet cilësi e lindur e pazëvendësueshme e mësimit gjatë transmetimit të njohurive të nxënësit përmes komunikimit, aftësive shprehëse, analizuuese dhe bindëse.

Katalog vëzhgimi: Nënkuptohet instrumenti që matë (shënjon) përqindjen e kohës në çdo aktivitet mësimor, nga vëzhgimi i teknikave mësimore brenda një ore mësimore, procedurat në klasë, komunikimi, vlerësimi etj.

Katarsë: Nënkuptohehet “pastrim i shpirtit” çlirimi i tensionit, pas frustracionit apo shqetësimeve nga sjelljet amorale.

KEK:Nënkuptohehet shkurtesa për Kuadër Evropian të Kualifikimit.

Kënaqësi në mësimdhënie: Nënkuptohehet ndjenjë pozitive emocionale e mësimdhënsit që t’u demostrojë shpreh nëpërmjet shpjegimit, ai i nxit nxënësit e tij që të jenë më të vëmëndshëm ndaj asaj që po shpjegon, kënaqësinë për atë që po bën dhe për dijet që po u transmeton nxënësve të tij, duke fshehur kështu lodhjen, stresin, mërzitjen.

Këndvështrimet e mësimdhënësve: Nënkuptohen pikëpamjet e mësimdhënësve për karakteristikat e një metode ose teknike mësimore në klasë.

Keqëtrajtimi i fëmijëve: Nënkuptohehet sjellja jo e mirë fizike ose emocionale ndaj nxënësve nga mësimdhënësi ose prindi.

Keqmenaxhimi i shkollës: Nënkuptohehet mosplanifikim joorganizim adekuat, udhëheqje dhe kontroll pa kritere dhe pa qëllim nga drejtori i shkollës, e të cilat si pasoje kanë uljen e motivimit dhe performancës së mësimdhënësve dhe të cilat e bëjnë shkollën një vendë jo të mirë për të mësuar.

Keqtrajtim: Nënkuptohen të gjitha format e keqtrajtimit fizik ose emocional: abuzimin seksual, neglizhencën ose trajtimin neglizhues, ose çdo shfrytëzim tjetër që çon në dëmtim real ose të mundshëm të shëndetit, të fëmijës, të mbijetesës, zhvillimit ose dinjitetit të tij.

Kërcënim: Nënkuptohehet akt i shprehjes së agresivitetit, që shprehet me fjalë ose gjeste, (veprim) për t'i bërë dëm ose frikësuar dikë.

Kërkim empirik: Nënkuptohehet hetimi faktik i realitetit, i kryer në një disiplinë të caktuar pedagogjike.

Kërkim korrelacional: Nënkuptohehet lloji i kërkimit shkencor, nëpërmjet të cilit përcaktohet nëse ndërmjet dy a më shumë ndryshoreve ekziston një lidhje domethënëse, pozitive apo negative. Nëse korrelacioni është pozitiv, kjo do të thotë se rritja apo ulja e vlerave të njërës ndryshore (x) shoqërohet me rritjen apo uljen e vlerave të ndryshores tjetër (y) dhe anasjelltas.

Kërkim në literaturë shkencore: Nënkuptohehet procesi i kërkimit, analizës dhe përpunimit të informacionit nga literatura shkencore nga hulumtuesi.

Kërkime aktive (në veprim): Nënkuptohehen kërkime që zakonisht i zhvillojnë mësime për të njohur efektivitetin dhe efikasitetin e metodave dhe teknikave bashkëkohore pedagogjike me qëllim për të përmirësuar mësime dhe për të lehtësuar të mësuarit e nxënësve të tyre.

Kërkime profesionale: Nënkuptohehet punimet e specializimit, teza e masterit dhe disertacioni i doktoratës apo punimet shkencore nga profesionistët brenda instituteve të specializuara pedagogjike, të cilat disponojnë njohuri të mira nga fusha e metodologjisë së kërkimit.

Kërkimi shkencor: Nënkuptohehet një proces i aktiviteteve kërkimore intelektuale të definuara qëllimisht, të cilat realizohen

me zbatimin e një procedure të përcaktuar, sipas kritereve të definuara të zgjedhjes dhe vlerësimit në një shkencë në mënyrën e ofrimit dhe shtjellimit të të dhënave dhe fakteve, po ashtu edhe në përmbajtjen dhe vëllimin e tyre.

Kërkimi eksplorues: Nënkuptohej kërkimi i kryer për një problem i cili nuk është i përcaktuar në mënyrë të qartë apo që në fakt nuk “shihet” nuk ekziston hulumtuesi duhet të bëjë shpjegime të një marrëdhënie “shpjeguese” jo ekzistuese për të nxjerrë konkluzione përfundimtare.

Kërkimi i informacioni digjital : Nënkuptohej kur hulumtuesi i duhet të hyjë dhe të kërkojë informacion online, të artikulojë nevojat informative, të gjejë informacione të përshtatshme, të zgjedhë burimet efektive, të “lundrojë” ndërmjet burimeve online, të krijojë strategji personale informacioni për një temë.

Kërkimi diciplinar: Nënkupton kur hulumtuesi ka për qëllim të ofrojë teori të reja, apo të përmirësojë ato të mëherëshme në një diciplin, të caktuar të pedagogjisë.

Kërkimi shumëdiciplinar: Nënkupton kur hulumtuesi ka për qëllim të ofrojë teori të reja, të përmirësojë ato të mëherëshmet nga shumë disiplina për një problem apo çështje pedagogjike.

Kërkimi holistic: Kërkimi i orientuar nga hulumtuesi për zgjidhjen e problemeve, që lidhen me problemin specifik në fenomenet edukative në shkollë.

Kërkimi përshkrues: Kërkimi i orientuar nga hulumtuesi për të përcaktuar, përshkruar ose identifikuar dukuri, fenomene pedagogjike.

Kërkimi analitik: Kërkimi i orientuar nga hulumtuesi për të mësuar se "pse diçka po ndodh ose si erdhi kjo diçka" deri këtu, ku është zanafilla e problemit, rrjedha dhe procesi si dhe mundësisht edhe zgjidhja e problemit.

Kërkimet konfirmuese: Nënkuptohej kërkimet që testojn hipotezat- parashikimet dhe rezultatin që janë bërë para se të fillojë faza e matjes.

Kërkimi në web/internet: Nënkuptohej kur hulumtuesit kërkojnë nëpërmjet programeve kërkuese dhe e përpunojnë materialin pasi e kanë gjetur atë; menaxhojnë, dallojnë përmbajtjet digjitale të vlefshme dhe jo të vlefshme dhe kërkojnë në mënyrë të pavarur në internet informacione për konceptin.

Kërkimi joempirikë: Nënkuptohej i referohet një hulumtimi që është e bazuar në teorinë e krahasimit dhe përdorimin të vëzhgimit dhe eksperimenteve për të arritur rezultatin duke përdorur njohuritë ekzistuese si burimi i saj. Kërkimi jo empirik përdoret për të mbështetur një qasje kërkimore të veçantë në një shkencë.

Këshilli i shkollës: Nënkuptohej roli pjesëmarrës dhe roli përfshirës i anëtarëve (mësimdhënës, prindër, etj.) me rol këshillues në organizimin e mësimin në shkollë.

Klasa informuese: Nënkuptohej i referohet, klasave informuese, ku nxënësit mund të këmbëjnë informacion mes tyre dhe në të njëjtën kohë, nxënësit zhvillojnë aftësitë e bashkëpunimit me njëri-tjetrin, për tema specifike janë të ftuar edhe specialistë të fushës njohëse nga jashtë shkolle.

Klasa përgatitore: Nënkuptohej i referohet, edukimit për të filluar mësimdhënien.

Klasa (hapsira): Nënkuptohej mjedisi mësimor fizikë, (një klasë tipike është hapsira “territoriale ‘mbrenda objektit shkollor 12 metra e gjatë dhe 8 metra e gjerë) e projektuar që të akomodoj, mësojnë 32 nxënës.

Klasa: I referohet bashkësisë së nxënësve (identifikohet me përkatësin e ndarjës nëpër klasa, paralele) me karakter relativisht të punës së përhershme, me moshë dhe aftësi përafërsisht të njëjta, me përbërje heterogjene ku nxënësit mësojnë së bashku nën udhëheqjen e mësimdhënësit.

Klasat e mbipopulluara: Ky term i referohet shkollave ku numëri i nxënësve në klasë është mbi 36 nxënës, pra deri në 40-45 nxënës në klasë.

Klasifikimi i përshkrimeve të profesioneve: Nënkuptohej një dokument, i cili përmban përshkrime të funksioneve dhe detyrave të profesioneve të cilat i përkasin çdo grupi profesionistësh e të cilat jepen më të detajuara me një indeks të emërtimeve apo me kodet respektive.

Klasifikimi i profesioneve: Nënkuptohej grupimi i profesioneve në bazë kriteresh të caktuara të mbështetura në llojin e punës dhe në kompetencën e nevojshme, të ndarë në grupe të mëdha, nëngrupe të mëdha, grupe të vogla dhe grupe njësi profesionesh.

Klasifikimi i profesioneve të një vendi: Nënkuptohej një instrument, i cili prezanton informacion rreth strukturës aktuale të profesioneve të një vendi, i cili bazohet në llojin e punës dhe në

kompetencën e nevojshme (emërtimet përkatëse, përshkrimet e tyre).

Klasifikimi: Nënkuptohët grupimi i dukurive që hulumtohen në kategori, procedura te ndarjës së një tërësie (nocioni-koncepti) në disa nyje, sipas kriterit të definuar më parë, i cili njëkohësisht e shpreh përkatësinë e të gjithë anëtarëve, tërësisë së caktuar, por edhe specifikat e dispozitave të tyre.

Klima në shkollës: Nënkuptohët atmosfera sociale “ndjesia personale për arritjen e nxënësve dhe të mësuarit” e mjedisit, bazuar në rregullat e vendosura nga mësimdhënësit dhe administratorët e shkollës.

Klima në klasë: Nënkuptohët një veti karakteristike që dallohet ose vërehet tek mësimdhënësia dhe të mësuarit në një klasë gjatë punës mësimore, disiplinën, respektin, komunikimin etj.

Kllasteri ose grumbullimi i mendimeve: Nënkuptohet një teknikë ku mësimdhënësi kërkon që nxënësit në mënyrë jo lineare (të degëzuar) të paraqesin ide të ndryshme rreth një teme dhe ato ide të lidhen në mënyrë logjike (nxënësit mendojnë lirshëm dhe hapur rreth një çështjeje) për të krijuar lidhje midis fakteve.

Kodi i etikës: Nënkuptohet një kod i shkruar, civil, kanunor, zakonor.

Koeficienti emocional (EQ): Nënkuptohet një koncept që (përfaqëson matjen e karakterit) përkufizohet si matje e aftësisë së individit për të qenë përgjegjës, i ndershëm, i vëmendëshëm, për të respektuar kufijtë në raportë me të tjerët dhe ruajtjen e paqës me të tjerët.

Koeficienti i intelegjencës (IQ): Nënkuptohehet një koncept (përfaqëson dijen, kuptimin) që përkufizohet si matje e nivelit të të kuptuarit të nxënësve për të mësuar të zgjedhë probleme, për të kujtuar mësimet, për të zgjidhur detyra të vështira në matematike, etj.

Koeficienti social (SQ): Nënkuptohehet një koncept (përfaqëson karizmën) që përkufizohet si matje e aftësisë për të ndertuar një rrjetë miqësh dhe për të mbajtur atë për një periudhë të gjatë kohore.

Koeficient korrelacioni: Nënkuptohehet një term vlerësues që tregon fortësinë e lidhjes ndërmjet ndryshoreve/variablave midis -1.00 dhe 1.00,; masë e shkallës së bashkëlidhjes midis -1.00 tregon një lidhje të fortë negative, një vlerë 1.00 tregon një lidhje të fortë pozitive. Vlera 0 tregon se midis ndryshoreve nuk ka asnjë lidhje.

Kognicioni: Përkufizohet si term për matje 'grykim' të nivelit të arsytimit, koncepteve, memories dhe gjuhës. Çdonjëra prej tyre ka karakteristikat e veta, në edukim ky term përdoret për mënyrat me të cilat nxënësi përpunon informacionin si marrje, njohje, kodim dhe depozitim në kujtesë për periudha të ndryshme kohore dhe përdorimi i tij për një qëllim të caktuar mësimor.

Kognitivistet: Nënkuptohen përfaqësuesit e kognitivizmit të cilët theksojnë se të mësuarit në vetvete është një proces i brendshëm që nuk mundë të vëzhgohet drejtpërsëdrejti.

Kognitivizmi: Nënkupton teoria e nxënies, e bazuar në idenë se fëmija në zhvillim (në proces, ecje kronologjike e moshore) ndërton struktura kognitive (hartat mendore, skema, koncepte të rrjetëzuara etj.) për të kuptuar dhe për t'iu përgjigjur përvojave

fizike (kimike e biologjike) në botën që e rrethon, ambientin e tij të ngushtë e më vonë edhe atë të gjerë.

Koha e procesit mësimor joefikase (të personalizuar): Nënkupton kohën kur ngecim, ngatërrohemi, zhvillim i shpërfillur, apo përparojmë në mënyrë joefikase në të mësuar.

Koha e procesit mësimor të individualizuar: Nënkupton kohën shtesë që i japim nxënësit, mundësia që në menyrë të ngadalsuar të përparoj në të mësuar efikas dhe efektiv në klasë.

Koha e realizimit të kërkimit: Nënkupton dinamikën e realizimit të kërkimit sipas javëve, muajve dhe viteve.

Koha (ora) mësimore: Nënkupton ora mësimore 45' minuta.

Kohë e lirë: Koha që e ka individi në dispozicion për ta shfrytëzuar për veprimtari të lirë, jashtë obligimeve që i ka të caktuara nga puna apo profesioni.

Koherencë e projektit hulumtues: Nënkupton shkallën e lidhshmërisë logjike mes pjesëve të planit të projektit njëra me tjetrën, si dhe me situatën përkatëse të projektit.

Kohët mësimore: Nënkupton orët mësimore, java mësimore, gjysmë vjetori (semestri), viti shkollor etj.

Kohezion: Nënkupton forcën që e shtyn individin të mbetet pjesëtar i një grupi.

Komforti: Përkufizohet si “ndjenj rehati” fizike, temperatura e mjedisit etj.

Kompetenca e mësimeve: Nënkupton aftësinë e mësimeve për të demonstruar përbushjen e një detyre në një kontekst të caktuar sipas standardeve profesionale të kërkuara, dhe jo thjesht “potenciali” i tij për të kryer një detyrë.

Kompetenca e nxënësve: Përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t’i fitojë gjatë procesit të mësimit.

Kompetenca demonstron nga nxënësi (njohuri): Bazohet në performancën e tij (aftësi), si dhe bazohet në perspektivën e sjelljes (qëndrim).

Kompetenca digjitale e nxënësve: Nënkupton bazohet në performancën e tij (aftësi), dhe shkathtësive digjitale që një nxënës duhet t’i fitojë gjatë procesit të mësimit përkatësisht mund ta përdor pas përfundimit të një arsimit shkollor.

Kompetenca dixhitale e mësimeve: Nënkupton performancën e mësimeve që të përdor aftësitë metodike për identifikimin e burimit të informacionit nga mediet digjitale, interneti, burimi primar ose sekondar ta përdor në mjediset mësimore (klasë kabinet) për të komunikuar për të bashkëpunuar me mësimeve tjerë, për të modifikuar për një prezantim, për një tabelë ose grafik duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin profesional.

Kompetenca e nxënësve: Nënkupton performancën e njohurive, të shkathtësive dhe të qëndrimeve që një nxënës duhet t’i fitojë gjatë procesit të mësimit gjegjësisht përfundimit të një niveli arsimit shkollor.

Kompetenca kyçe: Nënkuptohen aftësi të zbatueshme në llojet e veprimtarisë ku përveç njohurive përfshihen edhe qendrimet e gatishmëria, shprehitë dhe efektiviteti, p.sh., aftësitë për planifikim dhe organizim të punës, për vetëkontroll e vetëvlerësim, për të mbajtur qëndrim pozitiv ndaj punës, për të punuar në grup, për të mësuar gjatë gjithë jetës, etj.

Kompetenca nga nxënësi: Nënkupton performancën që demonstron nga nxënësi (njohuri të thella, të plota e të përpikta), bazohet në performancën e tij (aftësi) në një fushë të dijes ose për një problem të caktuar, që i japin atij siguri, si dhe bazohet në perspektivën e sjelljes (qëndrimimit) për një problem të caktuar që ka nxënësi.

Kompetenca shkencore: Nënkupton aftësi të arsyetojë të përshkruajë dhe vlerësojë shpjegimin shkencor, të propozojë mënyra të të shtruarit të pyetjeve si dhe përdorimit të terminologjisë shkencore gjatë komunikimit.

Kompetencat e fushës/lëndës që synon të arrijë nxënësi: Nënkupton arritjet në përmbajtjen/et mësimore, metodologjinë e mësimdhënies, rezultatet e të nxënës të kompetencave për një vit mësimor apo nivel shkollor.

Kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse: Nënkupton arritjet për kompetenca kyçe për secilin vit mësimor rezultat-in/et e të mësuarit për kompetencat kyçe në shkallën përkatëse arsimore.

Kompetencat: Nënkuptohen aftësi të gjera si kombinim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të përshtatshme për kontekstin për t'i zbatuar njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet,

rutinat, vlerat dhe emocionet, në mënyrë të pavarur, praktike dhe domethënëse.

Kompetencë: Nënkupton aftësi (zotësi) dhe gatishmëri e një individi, për të kryer me efektivitet dhe përgjegjësi një punë të caktuar, në sajë të zotërimit të njohurive, shkathtësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave përkatëse për të përmbushur me efikasitet dhe efektivitet profesionin e tij.

Kompetencë profesional: Nënkupton zotësi, gatishmëri për të ushtruar me efektivitet dhe përgjegjësi një profesion, (p.sh. vetëm për realizimin e një detyre pune të thjeshtë ose komplekse, e përbëre nga një numër kompetencash të veçanta për realizimin e një funksioni ose për ushtrimin e një profesioni). në sajë të zotërimit të sistemit përkatës të njohurive, shkathtësive, shprehive, qëndrimeve dhe vlerave ose formimit profesional dhe përvojës në punë.

Kompetenca profesionale e mësimdhënësit: Nënkupton aftësinë e mësimdhënësit për të demonstruar përmbushjen me sukses (brenda standardeve profesionale të kërkuara) të një detyre profesionale, në një kontekst të caktuar pra në mësimdhënie.

Kompjuteri në mësim (aplikimi): Nënkupton përdorimin e kompjuterit gjatë përgatitjeve të aktiviteteve mësimore, materialeve mësimore, literaturës dhe dosjeve të përgatitjeve mësimore për nxënësit etj. që mësimdhënsi iu parashtron nxënësve, jo nivelit të vështërisë së zgjidhjes.

Komplekse (detyrë/kërkesë): Nënkupton i referohet strukturës së detyrës problematike që mësimdhënsi iu parashtron nxënësve jo nivelit të vështërisë së zgjidhjes së detyrës/kërkesës.

Kompleksiteti i materialit të lëndës: Nënkupton i referohet strukturës së materialit të lëndës që mësimdhënësi iu parashtron nxënësve.

Kompleksiteti i njohjes. Nënkupton i referohet shkallës ose thellësis së të menduarit që kerkohët për të zotëruar një objektiv të veçante abstrakt të përmbajtjes dhe numri i hapave të një algoritmi që rrit kompleksitetin e njohjes.

Kompliancë: Nënkupton i referohet ndryshimit të sjelljes sipas kërkesës së dikujt.

Komunikim interpersonal funksional: Nënkupton i referohet mesazhit brenda raportit të drejtpërdrejtë “ballë për ballë” ndërmjet njerëzve me qëllim, me plan dhe vetëdije, duke kërkuar dhe pranuar informacione kthyesë mbi pranueshmërinë dhe ndikimin e tyre, njihet si komunikim profesional.

Komunikim: Nënkupton i referohet bashkëbisedimit, ndërveprimit, marrëdhënies në të folur, me gjeeste dhe në të shkruar në mes njerëzve.

Komunikimi efektiv në klasë: Nënkupton i referohet një situatë komunikimi, një shpjegimi të arsyeshëm për të plotësuar detyrën praktike në klasë apo që rezultojn nga aktivitetet dhe që shërben që nxënësit të jenë në gjendje të kuptojnë mësimin më mirë.

Komunikimi joverbal në klasë: Nënkupton i referohet komunikimit (pa fjalë) ku përfshihen: sjellja e trupit (qëndrimi, orientimi dhe lëvizjet e trupit gjatë qëndrimit ulur, ecjes dhe të ndenjurit në këmbë), mimika (balli, faqet, mjekrra, goja), kontakti me sy (shikimi, bebzat e syve, muskujt e syve), gjestikulimi,

prekja me takt pedagogjik në supe, sjellja në hapsirë, sjellja në lidhje me kohën individuale në rrethanat e jashtme gjatë komunikimit me nxënës në klasë.

Komunikimi ndërpersonal në klasë: Nënkupton i referohet shkëmbimit të mendimeve, mesazheve apo informatave me anë të ligjërimit, shenjave, shkrimit apo sjelljes në mes të mësimdhënësit dhe nxënësit në mësim.

Komunikimi në fjalim në klasë: Nënkupton i referohet formimit të sekuencave të tingujve gjuhësore orale të cilët i përdorim në mënyrë të rrjedhshme, ndërsa flasim me nxënësit në mësim përkatësisht në klasë.

Komunikimi në mësimdhënie: Nënkupton i referohet transmetimit të njohurive tek nxënësit me emocione, vlera sociale kulturore dhe etike të të pyeturit dhe analizimi i pergjigjeve në përcaktimin e asaj që ka efekt të rezultatet e atij komunikimi në ndikimin edukativ ndaj nxënësve.

Komunikimi verbal: Nënkupton i referohet të folurit si shpejtësia, ritmi, ngjyra dhe intensiteti i zërit, artikulimi, melodia, qartësia etj.

Komunikologjia interpersonale: Nënkupton i referohet disiplinës shkencore e cila merret me problematikën e komunikimit interpersonal (ballë për ballë), komunikim i drejtpërdrejt që përoret në sferën e këshillimit, pedagogjikë.

Koncept: Nënkupton i referohet formës themelore të të menduarit, me të cilën pasqyrohen tiparet më të përgjithshme dhe më thelbësore të sendeve dhe dukurive.

Koncepti për veten: Nënkupton një imazh pozitiv optimist të vetëvlerësimit konstant në situatë të ndryshme, është reagim efektiv, një gjykim për vlerësimin e vetës, besimi në vetëvete, krenari për atë që personi ka, i pëlqen apo që “shikon” tek vetja e tyre.

Konceptualizmi: Nënkupton të specifikosh se si është përkufizuar një koncept, ngase konceptet kanë shpesh më shumë se një kuptim ose përkufizim.

Konfirmim: Nënkupton ndikimin dhe zbatimin të normave të grupit nga individit pa një arsye vetjake.

Konflikti verbal: Nënkupton dy ose më shumë reagime të papajtueshme verbale mes dy njerëzve apo njeri me tjetrin gjatë komunikimit.

Konflikti në klasë në mes nxënësve: Nënkupton, sjelljet konfliktuoze, rrahje në mes të nxënësve të ndryshëm në situata mësimore apo jashtë mësimore gjatë pushimit në klasë.

Konfuzion në mësimdhënie: Nënkupton, pasiguri të punës profesionale gjatë mësimdhënies që nuk mundë të modifikojn planifikimin e dëshiruar në mësimdhënie dhe nuk gjejnë përgjigje.

Konkludim: Nënkupton, pasim i një mendimi të ri i nxjerrë nga mendimet e tjera, përshkrim përmbledhës me arsyetim.

Konkluzioni: Nënkupton mendimi të ri i nxjerrë me procedurë metodologjike të arsyetuar nga mendimet e tjera autentike në kuptimin (aspektin) e hulumtimit.

Konkretizim: Nënkupton ‘veprim’ mendor, me anë të së cilit kalojnë mendërisht nga vetitë e abstraktuara në dukuritë konkrete.

Konkurdanc: Nënkupton bashkëmendim me dikë tjetër si “veprim” mendor, apo veprim konkret për realizimin e një synimi apo planifikimin dhe zgjidhjen e një detyre konkrete.

Konsideratë : Nënkupton mendim i shkruar apo verbal, vlerësim pozitiv për një nxënës për një ose disa arsye, të mësuarit, sjelljës, angazhimit.

Konsistente: Nënkupton e qëndrueshme në vazhdimësi.

Konstatim: Nënkupton evidentim i një fakti, dukurie së vërtetë nga ana e një individi, në bazë të veprimtarisë së proceseve psikike dhe intelektuale, duke e emërtuar atë me fjalë ose fjali.

Konstruksionizëm: Nënkupton mënyrë teori se si ndërtohen njohuritë publike në disiplina dhe profesione të ndryshme.

Konstruktivizëm: Nënkupton teori psiko-pedagogjike pikëpamje që thekson rolin aktiv të nxënësit në ndërtimin e të kuptuarit dhe informacionit prej tij, bazuar në përvojat e tyre dhe jo tjeshtë zbulohet apo transmetohet e gatshme.

Konsulent arsimor: Nënkupton këshillues arsimor, njohës të problemeve arsimore të cilët ushtrojnë ndikim pozitiv tek sistemi arsimor ose mësimeve: si zhvillimi i kurrikulës, menxhimi i shkollës, komunikimi, zhvillimi profesional dhe legjislativi shkollor etj.

Kontekstet shkollore: Situatat fizike, gjeografike, demografike shoqërore, ekonomike, politike, kulturore, brenda së cilave vepron shkolla dhe të cilat nuk mund të ndryshohen, së paku jo menjëherë.

Konteksti bio-ekologjik: Nënkupton tërësia e ndërveprimit dhe bashkëveprimit të një numëri forcash dinamike që i japin formë zhvillimit, fillojnë nga vlerat biologjike, çdo person jeton mëson dhe zhvillohet në familja, lagje, mjedisi pra në një ekosistem jetësor.

Konteksti socio-kulturor: Nënkupton tërësia e mjedisit apo situatës që e rrethon dhe hyn në ndërveprimin me individin apo ngjarjet që lidhen me ndikimet shoqërore.

Konteksti i kërkimit: Nënkupton mjedisi ose situata tërësore që e rrethon një dukuri që e hulumton kërkuesi dhe që ka ndërveprim ndikues në kërkim.

Konteksti personal i kërkuesit: Nënkupton të kaluarën pedagogjike, sociale, psikologjike, kulturore dhe gjuhësore të hulumtuesit.

Kontrata e punës së mësimdhënsit: Nënkuptohe marrveshja e shkruar brenda një kuadri ligjor, që përcakton kufirin minimal të pagesës, detyrat dhe përgjegjësitë si dhe kushtet e punës, ajo mund të jetë individuale (punëdhënësit dhe individit), por mund të jetë edhe kolektive (në mes të punëdhënësve dhe sindikatave).

Kontratat: Nënkuptohen përfshijnë (përcaktojnë) kontributin e mësimdhënësve, pagesën dhe kushtet e shërbimit dhe përgjegjësisë profesionale.

Kontrollimi verbal (me gojë): Nënkupton i referohet cilësisë së informacioneve që sjellë nxënësi, mënyra se si i parashtron argumentet, mënyra se si i interpreton dhe komenton njohuritë mësimore, sa është i kuptueshëm, elekuentë, kreativë dhe operon lirshëm gjatë komunikimit etj.

Korrelacioni pozitiv: Nënkupton tregon se të dy faktorët rriten apo zvogëlohen së bashku në kërkim.

Kornizë kualifikimesh: Nënkupton një instrument për zhvillimin dhe klasifikimin e kualifikimeve në përputhje me një tërësi kriteresh për nivelet e arritjes së të mësuarit.

Korrelacion: Nënkupton një madhësi statistikore që na ndihmon të kuptojmë relacionin mes dy variablave, lidhjen e shkakësisë që mundëson të vihën re se sa ngushtë lidhen dy ndryshore, si përshkrim statistikor numerikë apo me fjalë.

Korrelacioni negativ: Nënkupton tregon se rritja e njërit faktor shoqërohet me zvogëlimin e faktorit tjetër.

Korrigjimi nga mësimdhënësi: Nënkupton tërheqjen e vëmendjes së nxënësit te gabimi dhe mundësia që ofron mësimdhënësi për nxënësin me informacionin, sesi ta përsërisë detyrën pa gabuar me shkrim.

Krahasim: Nënkupton veprim mendor, me anë të të cilit gjejmë ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet objekteve apo dukurive që marrin në shqyrtim gjatë kryerjes së këtij veprimi mendor. Konceptet bëhen më të sakta dhe më të plota me krahasimin e tyre.

Kredit, sistem kreditesh: Nënkupton njësinë për matjen e ngarkesës mësimore, që zakonisht i referohet kohëzgjatjes së një kursi apo moduli mësimor (p.sh., një kredit mund të jetë i barabartë me 25 orë mësimore).

Kredo: Nënkupton idetë dhe bindjet e një njeriu ose të një grupi të caktuar individësh në një fushë të caktuar të veprimtarisë shoqërore.

Krijimtari: Nënkupton një produkt të mendimit krijues të njeriut në krijimin e vlerave materiale, shoqërore e shpirtërore, e rëndësishme për zhvillimin e shoqërisë.

Kriter: Nënkupton një cilësi, koncept apo veti që shqyrtohet gjatë vlerësimit të një pune, aktiviteti apo programi të aktivitetit të përcaktuar për standardin e nivelit të pranueshëm, nivelin e punës apo të cilësisë së punës.

Kriteret e vlerësimit: Nënkuptohen standardet, kriteret për të vlerësuar, të kuptuarit saktësia, korrektësia, mënyra e arsytimit, demonstrimi, shpejtësia, zbatueshmëria përkatëse etj.

Kritika shkencore: Nënkupton analiza kritike e argumentuar objektive e shkencore që u bëhet punimeve të autorëve të tjerë nga një hulumtues.

Krizë në arsim: Nënkupton, arsim i dështuar “shpërfilluar” kur kompromentohet apo cenohet integriteti i shkollës, mësimdhënsit dhe sistemit edukativ, kur ka jostabilitet në arsimim shpërfillje kaotike, që kërkon reforma gjithëpërfshirëse (jo gjithëherë krizat në arsim janë të këqija, shpeshëherë ato shërbejnë si shtyesa që të rregullohet sistemi i arsimit).

Kronologjike: Nënkupton tregimin e ngjarjës a situatës nga fillimi në mbarim, në bazë të kohës që ka ndodhur (përshkrim sipas viteve të ngjarjës).

Kuadri kombëtar i kualifikimeve kombëtare: Nënkupton gjithë gamën e kornizave të sektorëve arsimor në një vend e cila i klasifikon kualifikimet profesionale në përputhje me një tërësi kriteresh për nivelet përkatëse.

Kualifikim profesional: Nënkupton sistem njohurish, shkathtësish, shprehish, qëndrimesh dhe vlerash që mundësojnë ushtrimin me sukses të një veprimtarie profesionale të caktuar, fitimi i të cilave bëhet nëpërmjet të mësuarit, në një institucion arsimit, vërtetohet dhe dëshmohet me anë të dokumentit përkatës (dëftesës, certifikatës ose diplomës) dhe shpreh një lloj (emërtimi, titull) arsimor.

Kubimi: Nënkupton një teknikë mësimi, ku përdoret kubi me lëvizje të shpejta, për të menduarit dhe të shkruarit në secilën faqe të kubit e cila ndihmon shqyrtimin e një teme nga këndvështrime të ndryshme nga nxënësit.

Kufizimi kohor i projektit: Nënkupton një përcaktim të afatit të fillimit dhe të mbarimit të projektit, një datë konkrete, qartësimi dhe përcaktimi i qartë i mbarimit të projektit është gjithmonë një datë konkrete.

Kuiz: Nënkupton aktivitet që zhvillohet në media/emision televiziv ose në shkollë ku fëmijët ndahën në grupe dhe përgjigjen në pyetjet rreth një teme ose lënde të caktuar të cilat vlerësohen me pikë nga një juri vlersuese ku nxënësit fitues marrin një

shpërblim simbolik (mirënjohje ose çertifikatë) si motivim plotësues.

Kuiz në shkollë: Nënkupton një aktivitet mini-teste për të parë nëse koncepti është kuptuar nga e gjithë klasa, apo në nivel shkollë.

Kujdestar klase: Nënkupton mësimdhënësin që caktohet, emërohet të merret ekzklusivisht (me obligime dhe përgjegjësi) që të kujdeset për nxënësit e klasës së caktuar; të udhëheq, drejtojë/ndihmoj, kordinoj/përcjellë, dhe të menaxhoj sjelljet e nxënësve në klasë në mënyrën me të mirë të mundëshme në aspektin e disiplinës, suksesit, vijueshmërisë si dhe të bashkëpunoj dhe komunikoj me prindërit e nxënësve për sjelljet dhe suksesin e fëmijëve.

Kujtesë selektive: Nënkupton “rithirrja” në kujtesë vetëm e disa prej ngjarjeve apo aspekteve të një përvoje jetësore.

Kultura shkollore: Nënkupton vlerat, normat dhe besimet e përbashkëta që e karakterizojnë një shkollë ose një grup mësimdhënësish në shkollë (që vlejn për të gjithë shkollën). Kulturës shkollore i nevojitet një kohë e gjatë për t’u formuar, prandaj ajo ndryshohet me vështiresi për një kohë të shkurtër, pozitivisht apo negativisht.

Kuptimplotë: Nënkuptohët i referohet të mësuarit të qendrueshëm “që ka kuptim” kur nxënësit kuptojnë me të vërtetë diçka, ata mund ta transferojnë të mësuarit e përvetësuar prej tyre, të zgjerojnë njohuritë që kanë përfituar drejt një konteksti të ri mësimor dhe jetësor.

Kureshtja: Nënkupton dëshirën apo shtytjën e brendshme, pa një shtytje të jashtme të individit për të njohur apo mësuar të paditurën dhe të panjohurën.

Kurrikulum: Nocioni nënkupton rrjedhë të gjithëmbarshme të aktiviteteve edukativo-arsimore, qëllimeve, përmbajtjeve, metodave, mjeteve, teknikave, strategjive, realizimit dhe vlerësimit (evaluimit) të arritjeve.

Kurioziteti: Nënkupton (dëshirë ” etje” për të ditur) një karakteristikë e përhershme e individit e cila ka veçantinë, këmbnguljen dhe vazhdimsin gjatë vëzhgimit, komunikimit, përcjelljes së informacionit të njerëzve gjatë gjithë jetës.

Kurrikula e formimit të përgjithshëm: Nënkupton përfshin planin vjetor lëndor, aftësit dhe temat ndërkurrikulare, si dhe projektet kurrikulare të cilat mbështeten në dokumentet zyrtare për kurrikulën e formimit të përgjithshëm.

Kurrikula si kuadër konceptual për filozofin edukese: Përkufizohet një sistem dijenishë e praktikash të planifikimit dhe të programimit të të mësuarit me tërësinë e strategjive mësimore, të cilat planifikohen për tu zbatuar në një shkollë dhe mbi të cilin ngrihet procesi i arsimimit, si qëllim përfundimtar, d.m.th. rezultatet që synohet të arrihen në përfundim të një niveli shkollimi çfarë duhet të dinë dhe çfarë duhet të jenë në gjendje të bëjnë nxënësit.

Kurrikule cilësore: Nënkupton një kurrikul më efektive duke i thjeshtuar objektivat duke i realizuar përmes veprimtarive ndërvepruese, argëtuese dhe tërheqëse për nxënësit si më të

përshtatshme, shumë afër me nevojat e nxënësve, motivuese dhe lehtësisht të praktikueshme në mënyrë aktive.

Kurrikulë gjithëpërfshirëse: Nënkupton një kurrikul që i'u mundëson, apo ofron çdo nxënësi të gjejë vetveten, të përparojë sipas ritmit individual, të jetë i suksesshëm, të ndiehet pjesë aktive e shkollës.

Kushtet në shkollë: Nënkuptojn përfshijnë mësonjtorët (klasët) kabinetet, oborri, fusha e sportit (kushtet kryesore që duhen të plotësohen për punën efikase dhe efektive në shkollë) dhe ndihmëse si hapsira brenda të cilave nxënësi/ja pritët që të zhvillojn të mësuarit.

Kompetencat kyçe për një mësimdhënës: Nënkuptohen qasje profesionale mësimdhënie, njohuri për lëndën, njohuri për pedagogjinë, aftësi komunikuese dhe kompetenca të nevojshme për të drejtuar dhe mbështetur nxënësit dhe një kuptim të ri të dimensionit shoqëror dhe kulturor të arsimit bashkohorë përkatësisht duke përdorur teknologjtë në veprimtaritë profesionale në shkollë.

Kompetenca për komunikim: Një qasje profesionale mësimdhënie që përfshin njohurin dhe aftësin e mësimdhënësit për të komunikuar në mësim, duke përfshirë edhe komunikim përmes mjeteve teknologjike.

Kompetenca të punës shoqërore: Një qasje profesionale mësimdhënie që përfshihën njohuri dhe aftësi për të marrë përgjegjësi, aftësi për të kombinuar interesat personale me nevojat shoqërore si dhe gatishmëria për marrjen e vendimeve të pavarura profesionale.

Kompetenca gjuhësore: Një qasje profesionale mësimdhënie që përfshin njohurit dhe aftësitë për komunikim me gojë dhe me shkrim për të informuar nxënësit e tij në mënyrë të qartë për lëndën, duke përdorur mënyra efektive të mësimdhënies që t'i ndihmojë nxënësit të komunikojn në mënyrë të pavarur.

Kompetenca kulturore: Një qasje profesionale mësimdhënie që përfshin njohuri të thella të kulturës kombëtare, e evropiane dhe qëndrim tolerant ndaj kulturave të ndryshme etnike.

Kompetenca organizative: Një qasje profesionale mësimdhënie që përfshin aftësinë e mësimdhënësit për të organizuar nxënësit në klasë, për të menaxhuar dhe kontrolluar veprimtarit e tyre mësimore në mënyrë efektive dhe për të planifikuar dhe përmirësuar veprimtarinë e vet të mësimdhënies.

Kompetenca didaktike: Një qasje profesionale mësimdhënie që lidhet me aftësinë e mësimdhënësit për të transmetuar njohuri që tërheqin nxënësin në lëndën mësimore, në mënyrë që ata të jenë të gatshëm më tej për të vazhduar veprimtarinë e tyre në mënyrë të pavarur me lehtësi ose të krijojë materiale mësimore duke marrë parasysh dallimet mendore, shoqërore, kulturore të nxënësve të tij, duke përdorur forma dhe metoda të ndryshme të mëimit.

Kompetencë e mendimit pedagogjik: Një qasje profesionale mësimdhënie e mësimdhënësit për të reflektuar për veprimtarinë e tij mësimore edukative; për të parashikuar rezultatet e veprimtarisë së tij dhe për të planifikuar ecurinë e të mësuarit të nxënësve të tij.

Kompetenca njohëse e krijuese: Një qasje profesionale mësimdhënie që nënkupton aftësinë e mësimdhënësit për të

mësuar/kuptuar çfarë është e nevojshme për një nxënës kur formulon qëllimet e procesit mësimor, kur planifikon dhe analizon veprimtaritë mësimore dhe njohëse/krijuese në klasë.

Kompetencë psikologjike: Një qasje profesionale mësimdhënie që nënkupton aftësinë e mësimdhënësit të kuptojë personalitetin e nxënësit, të ndiejë vështirësitë e nxënësit, të ofrojë ndihmë kur është e nevojshme.

Kompetenca si vlerësues: Një qasje profesionale mësimdhënie që nënkupton aftësinë e mësimdhënësit për të shqyrtuar objektivisht rezultatet e nxënësve, arritjet, efikasitetin dhe veçorit pozitive dhe negative të vlerësimit.

Kompetenca këshilluese: Nënkupton një qasje profesionale mësimdhënie për të siguruar këshillime të ndryshme psiko-pedagogjike në procesin mësimor në klasë.

Kompetenca të zhvillimit gjatë gjithë jetës: Nënkupton një qasje profesionale mësimdhënie që të krijojë bindjen tek nxënësi për të zhvilluar aftësitë, njohuritë dhe kompetenca gjatë gjithë jetës së tij.

Kompetencat e lëndës: Konsiderohen aftësitë e mësimdhënësit për të realizuar kompetencat kyçe në procesin e mësimdhënies për lëndën mësimore.

L

Labilitet: Nënkupton paqëndrueshmërin e individit në gjendjen e caktuar mendore.

Laborator shkollor: Nënkupton mjedis shkollor të pajisur, që shërben për zhvillimin e veprimtarive të nxënësve.

Laborator edukimi: Nënkupton mjedis (zakonisht në fakultet të edukimit) i cili shërben për përgatitjen e mësimeve të rinj në drejtim të zhvillimit të kreativitetit në procesin mësimor përmes zbatimit të teknologjisë bashkohore në mësim, integrimin lëndor dhe modeleve krijuese si avancim të praktikave dhe të shkathtësive pedagogjike.

Lapsus: Nënkupton gabim të rastësishëm, gabim i paqëllimshëm gjatë të folurit.

Lavdërimi: Nënkupton lloj i shpërblimit verbal publikisht në klasë, njohje e përpjekjes, angazhimit që influencon dhe ndikon në qëndrimet e nxënësve në lidhje me aftësin për të mësuar.

Legjislacioni për arsimin: Nënkupton gamën e ligjeve udhëzimeve dhe procedurave të shkruara: vendime, rregullore etike që i referohen një sistemi arsimor në shkollë për mësimeve, planifikimin, kurrikulën, menxhimin e shkollës, vlerësimin.

Lehtësitë infrastrukturore në shkollë: Nënkupton aspekte infrastrukturore ose të ndërlidhura me infrastrukturën e të cilat ofrojnë mundësitë e përshtashem optimale të nxënësve në mjediset

brenda shkollës apo për hyrje në shkollë (pjerrina për hyrje me karrocë).

Leje për të mësuar (Andragogji): Nënkupton leja (dokument i shkruar, nënshkruar dhe i vulosur me pagesë ose pa pagesë) që u jepet punëtorëve për qëllim studimi, formimi, trajnimi brenda orarit të punës, etj.

Lënda mësimore: Nënkupton përmban një sistem didaktik faktesh, konceptesh, parimesh, përshkrimesh të proceseve natyrore dhe shoqërore.

Lëndët praktike: Nënkuptohen veprimtari profesionale, të cilat përshkruajnë veprimet që duhen kryer për të përmbushur detyrat profesionale përkatëse si p.sh.: instalimeve elektrike, riparimit dhe mirëmbajtjes së makinave, etj.

Lëndët teorike: Nënkuptohen teori në shkencat natyrore dhe shoqërore të cilat më shumë janë të fokusuara te trajtimi i fakteve, i koncepteve, i parimeve dhe i proceseve natyrore e shoqërore teorike.

Lexuesi optik; I referohet makinës së programuar për leximin e të dhënave (shenjave të vëna me laps) në mënyrë elektronike nga fletëpërgjigjet e nxënësve dhe bartjes (futjes) së tyre në rezultat përfundimtare në programin **EXEL**.

Mësimdhënia liberale: Nënkupton mënyrë të mësimdhënies e cila respekton në përgjithësi levizjen e lirë të nxënësve në klasë, komunikimin dhe mendimin kritik të tyre.

Librat shkollorë: Nënkuptohen si burimi më i përhapur i të mësuarit për studimin e një lënde studimore të strukturuar dhe një numër ushtrimesh dhe veprimtarish në format të shtypur, apo në versionin elektronik.

Ligjërata: Nënkuptohet mësimdhënie e cila përmbledh të dhëna, njohuri për një çështje të caktuar shkencore me fjalë.

Ligjërata e avancuar: Nënkupton mësimdhënie, në të cilin mbizotëron niveli i lartë i të ofruarit të njohurive e përmbajtjeve të mësimt, për përvetësimin aktiv të të kuptuarit dhe të menduarit.

Ligjërata e fragmentarizuar: Nënkupton mësimdhënie, në të cilin mësimdhënësi bën ndarjen në pjesë të caktume logjike të ligjëratës me qëllim të përqendrimit të nxënësve dhe mbajtjen e vëmendjes.

Ligjërata e modifikuar: Nënkupton mësimdhënie në të cilën mësimdhënësi komunikon gojarisht rreth përmbajtjes, informon, shpjegon, koncepte gjatë qartësimit si dhe përmbledh njohuritë e ofruara për nxënësit.

Ligjëratë e përparuar: Nënkupton mësimdhënie/veprimtari që fillon me marrjen e pyetjeve nga nxënësit për t'i inkurajuar ata që të dëgjojnë. Ligjërata e përparuar ndahet në pjesë, nga 15-20 minuta.

Limitet e kërkimit: Nënkupton aspekte të veçanta të kërkimit, për të cilat kërkuesi është i vetëdijshëm që mund të ndikojnë në rezultatet e kërkimit.

Liri: Nënkupton faktor përbërës të veprimtarisë së vullnetshme të individit në shfaqjen e mendimeve, ndjenjave, qëndrimeve dhe sjelljet të tij, të cilat nuk kufizohen nga faktorët e jashtëm.

Liria në mësimdhënie: Nënkupton autonominë didaktike të mësimdhënësve dhe të shprehjes së lirë pedagogjike e kulturore të mësimdhënësit në ushtrimin e profesionit të vet.

Listë kontrolli: Instrument që përmban një listë konceptesh, për të vrojtuar dhe për të matur përvetësimin e shkathtësive, shprehjeve dhe vlerave, për një njësi, kategori të përmbajtjes programore, nënkategori, ushtrim laboratorik, ushtrim praktik për secilin nxënës (që shënohet me ndonjë shenjë, p.sh. a, b, c, d, apo në nota p.sh., 1, 2, 3, 4, 5 apo duke i shprehur me %, për shkallën e arritshmërisë). Përdoret nga mësimdhënësi për aktivizimin e nxënësve gjatë punës së pavarur në klasë, laborator apo në punishte.

Lloji i pyetjes: Nënkupton se çfarë përgjigje të gatshme apo ide po kërkon.

Lobingu: Nënkupton grupe të individëve për raste të qeshtëjeve të diskutueshme (kurrikula, lëndët mësimore, vlerësimi) pro ose kundër.

Lodhje: Nënkupton një ndjenjë e mungesës së energjisë dhe e motivimit, të cilat si shak mund të jenë fizike, mendore ose të dyja.

Loja: Nënkupton është procesi më efektiv i të mësuarit me një qëllim të caktuar në të cilën fëmijët marrin pjesë me dëshirë entuziazëm, dhe me kënaqësi si aktivitete mësimore që u mundësojnë nxënësve të mësojnë nga njëri-tjetri dhe së bashku.

Lojëra me role: Nënkupton aktivitet mësimor qëllimi kryesor i të cilave është zhvillimi dhe zbatimi praktik i metodave të ndërveprimit tolerant nga fëmijët.

Lojërat popullore: Nënkuptohen aktivitet mësimore ndërveprues në natyrë, apo në klasë që s'kan rregulla strikte por të tilla si janë të mësuara apo njihen nga popullata.

Lojëra-mësime: Nënkuptohen aktivitete mësimore qëllimi kryesor i të cilave është zhvillimi i materialeve lojra, për të zgjidhur problemet e ndërveprimit ndërpësonal në situata të përafërta jetësore.

Lojërat muzikore: Nënkuptohen përfshijnë lojrat që fëmijët i realizojnë me instrumente muzikore ose përplasje (grushtim) duarsh ose objektesh të cilat krijojnë ose lëshojnë tinguj të cilat nxisin ndjenjën për vallëzim.

Ludus: Nënkuptohet teknikë psiko-pedagogjike që bazohet tek animacioni, praktikohet te edukimi parashkollor por jo vetem.

LL

Llogaridhënia në arsim; Nënkupton (përshkrimin me shkrim) aftësin për të shpjeguar dhe arsyetuar zgjidhjet dhe aktivitetet e veprimtarisë së kryer me parë si parim bazë për performancë, efikasitet dhe efektshmëri të veprimeve të qëllimshme të mësimdhënësve në arsim.

M

Makro-organizim: Nënkuptohehet organizimi me vëllim të madh përmbajtjesor dhe kohor i punës edukativo-arsimore në një institucion shkollor.

Mani: Nënkuptohehet shqetësimi afektiv që dallohet nga humori i lartë, euforia e përgjithshme dhe mbivlerësimi i aftësive nga vetë individi për një punë.

Marramendja: Nënkuptohehet ndjenja e lëvizjes kur nuk ka lëvizje.

Marrëdhënie shkakësore: Nënkuptohehet marrëdhënie nëpërmjet së cilës një gjendje (pasojë) është rezultat i diçkaje tjetër (shkakut).

Marrëdhënie: Nënkuptohehet raport, lidhje e dy dukurive shkak – pasojë.

Marrja e gojës: Nënkuptohehet vështirësi me ngarkesë emocionale në situatat e komunikimit (gjendja afektive të bashkëbiseduesit) si pasojë e një emocioni të menjëhershëm tepër shqetësues dhe ndikon në mënyrën e tyre të sjellurit dhe të marrëdhënieve të tyre me komunikuesin.

Marrja (përvetësimi) i të mësuarit të kuptimshëm: I referohet përfitimit të mësimit nga ana e nxënësit, përfitimit të rregullave, koncepteve baze dhe asociacioneve bazë (informacion faktik) i të mësuarit.

Marrja (përvetësimi) i të mësuarit të pakuptimshëm: I referohet mësimit nga ana e nxënësit, të rregullave, koncepteve baze dhe asociacioneve (informacion faktik) të mësuarit në një nivel të ‘zbehtë’ e sipërfaqësor të të kuptuarit.

Materiale dhe burime mësimore: Nënkuptohej njëri nga burimet e thjeshta mësimore: teksti mësimor që jep një informacion të kuptueshëm për moshën e nxënësit dhe që e ndihmojnë atë të zhvillojë aftësi, shkathtësi, njohuri dhe qëndrime të nevojshme për të mësuarin gjatë gjithë jetës: bibliotekat elektronike, broshurat informuese apo ndërjegjësuese, enciklopeditë, softëver elektronik në funksion të të mësuarit, studimet shkencore, etj.

Materializmi didaktik: Nënkuptohej mbitheksimi i qëllimeve arsimore, përkatësisht i aspekteve arsimore në mësim karshi edukimit.

Matja në të mësuar: Nënkupton mbledhjen çmuarjen dhe vlerësimin e informacionit nga nxënësit mbi atë çka din (sasinë) dhe se si e dijnë (cilësinë) për një periudhë të caktuar kohore.

Matja në procesin mësimor: I referohet caktimit të numrave vlerësues sipas rregullave specifike përkatësisht notave numerike të vendosura nga vet mësimdhënsi ose rrjedhojë nga përgjigjet e një testi të standardizuar.

Matje: Përshkrimi i një ngjarjeje ose i një karakteristike, duke përdorur numrat. Matja tregon se sa shumë, sa shpesh ose sa mirë është bërë diçka duke përdorur rezultatet, shkallët ose nivelet. Ka karakter sasior gjykimi në renditjen e vlerësimit të fëmijëve sipas karakteristikave të veçanta që kanë në njohuri dhe në të mësuar.

Matjet në shkencat sociale: Nënkuptohe procesi për të kuantifikuar pozitën shoqërore, qëndrimet, sjelljet dhe konceptet teorike pra si nocion “diçka që përcaktohet mund edhe të matet”.

Maturë shtetërore: Nënkuptohe provimi përfundimtar për vlerësimin e njohurive shkathtësive dhe aftësive të nxënësve që kanë fituar arsimin parauniversitar (përcaktim i nivelit të kompetencës) dhe lejimi (diploma) i tyre që të vazhdojn arsimimin në nivelin universitar.

Mbajtja e shënimeve: Nënkuptohen praktika e shënimit, përzgjedhjes dhe e ruajtjes së informacionit nga burime të ndryshme (p.sh. libra, video, bashkëbisedime, intervista).Nxënësit shënojnë dhe ruajnë atë që ata mendojnë se është thelbi i informacionit dhe mund ta përdorin në të ardhmën.

Mbajtja mend e të mësuarit: Nënkuptohe mbajtja mend e asaj që është mësuar me parë dhe rikujtimi i saj në një moment të mëvonshëm vlerësimi.

Mbështetja për zbatimin e kurrikulës: Nënkupton tekstet shkollore, laboratorët dhe mjetet didaktike, si dhe mjediset e praktikës, të cilat mbështesin proceset e zbatimit të kurrikulës së formimit të përgjithshëm.

Mbështetje për të mësuar: Nënkupton ndihmën, mbështetjen që jep mësimdhësi për t'i bërë (nxitë, stimuluar) nxënësit të mësojnë në të tashmën si mundesi për të mësuarit në të ardhmen.

Mbrojtje e fëmijëve: Nënkuptohe përkujdesja e rregullt ose e herëpashershme, që zhvillohet jashtë shkollës dhe jashtë mjedisit familjar nga i rrituri.

Me taksonomi: Nënkuptojmë konceptin e ligjëshmërive në mësim që kanë rrjedhë nga përshkrimi i fakteve e deri te vlerësimi/krijimi si akt më i lartë i të menduarit.

Media mësimore: Nënkuptohen një nënkategori e burimeve të të mësuarit që përfshijnë mediat dëgjimore (p.sh. këngët), vizive (p.sh. fotografite), audio-vizive (p.sh. filmat), dhe nderaktive (p.sh. Skype).

Mediatekë shkollore: Nënkuptohet vendi ku ruhen mediat e ndryshme, mjetet audiovizive, filmat etj.

Meditim: Nënkuptohet praktikimi i përqendrimit, që ndikon në bllokimin e stimuljeve shqisorë dhe përqendrimi vetëm në të menduar “të pastër”.

Mekanizëm mbrojtës: Nënkuptohet sistem alarmi (natyral ose i mësuar) për mbrojtjen e unit.

Memorizimi i fakteve: Nënkuptohen mbajtja në mend e fakteve ashtu siç janë mësuar.

Menagjimi i klasës: Nënkupton procedurat e punës së mësimdhënsit në angazhimin e nxënësve, rregullat, diciplinën dhe kohezionin e klasës.

Menaxher në shkollë: Nënkupton profesionistë që menaxhojnë me aspektin organizativ e të cilët ndikojnë në masë të madhe në suksesin e shkollës.

Menaxhim i kërkimit: Nënkuptohen mjet për zbatimin e strukturuar të detyrave me përmbajtje komplekse, të cilat janë të

kufizuara në kohë, kanë një qëllim të caktuar dhe shfaqen gjatë punës së përditshme të hulumtuesit.

Menaxhimi në shkollë: Nënkupton mënyrën e planifikimit, organizimit, udhëqjes, kontrollit dhe kordinimit të mësimdhënësve dhe stafit tjetër nga menaxhmenti i shkollës me qëllim ngritjen e efikasitetit të procesit mësimor, realizimin e sukseshëm, motivimin e mësimdhënësve dhe stafit ndihmës në shkollë.

Menaxhimi i projektit: Nënkuptohe procedura gjatë realizimit të projektit, të kufizuara në kohë, me një qëllim të caktuar vlerësues dhe ndikues.

Mendo/puno në dyshe, shkëmbe mendime: Nënkuptohen veprimtari e të mësuarit në bashkëpunim, në të cilën mësimdhënësi bën pyetje me fund të hapur për nxënësit, të cilën zakonisht e shkruan në tabelën e bardhë apo të gjelbër në klasë.

Mëngjarash: Nënkuptohe nxënësi, i cili dorë dominante e ka dorën e majtë, andaj edhe të njëjtën e përdor për përmbarimin e detyrave të caktuara.

Mentor në induksion fazën e hyrjes në mësimdhënije: Nënkuptohe mësimdhënsi që mbështet një mësimdhënës të ri me njohuri dhe aftësi praktike të bazuar në strategji të planifikimit efektiv të orës mësimore, menxhimit të klasës dhe për ti zbatuar gjatë planifikimit të vlerësimit efektiv si dhe bashkpunimit me prindër gjatë mësimdhënjes praktike.

Mentor: Eksperti, i cili e udhëheq kandidatin në arritjen e gradës së caktuar.

Menxhimi i diciplinës së klasës nga mësimdhënsi: Nënkupton komunikimin dhe bashkëveprimin e mësimdhënësit me nxënësit përmes teknikave të veçanta dhe reagimit të përshtatshëm për të mbajtur mjedis mësimor relativisht të çliruar nga problemet e sjelljes dhe kontrollin e diciplinës të nxënësve në klasë.

Mënyrat e ndryshme të përgjigjeve të nxënësve; Karakteristika individuale për t'u përgjigjur nga nxënësit: të parët, të paduruar, përgjigjen shpejt, për të vënë re detajet e veçanta etj.

Mënyrat e parapëlqyera për të mësuar: Mënyra të mësuarit në situata mësimore të parapëlqyera për të mësuar si: përdorimi i figurave në vend të tekstit, të punuarit me nxënësit tjerë kundrejt të punuarit vetëm të detyrave, etj.

Mërzi: Nënkupton monotoni, humbje e interesit, vëmendje e paqëndrueshme, humbje e shpresës etj.

Mërzitje në mësimdhënie: Nënkuptohe ndjenjë negative emocionale e mësimdhënësit që shprehet nëpërmjet lodhjes stresit, pakënaqësisë nga puna që bën, etj.

Mësim (jap mësim): Definicioni i referohet për punën, veprimtarin e vetëdëshme, të qëllimshme, të organizuar, të planifikuar, të sistematizuar dhe mbase të rregullt, që bën mësimdhënësi në shkollë, sipas një programi të caktuar, për formimin e personalitetit të nxënësve, për t'i paisur ata me arsim dhe edukatë, duke përdorur metoda, mjete, parime e strategji të përgjithshme për moshën e tyre.

Mësim i strukturuar: Nënkupton mënyrë mësimdhënie që i mundëson nxënësit të përdorin si input përvojat e tyre, dhe t'i

ndihmojë ata të përvetësojnë më shpejt kompetencën e re dhe si rrjedhim të jenë më të suksesshëm në jetë.

Mësim (themelor) didaktik: Koncept që përkufizon procesin sistematik dhe të organizuar të ofrimit të njohurive të verifikuara shkencore, nga mësimdhënësi gjatë një kohe të caktuar mësimore.

Mësim i panderprerë individual: Termi i referohet procesit aktiv mendor dhe të vazhdueshëm e të përjetshëm me anë të të cilit individi fiton njohurit, aftësit dhe qendrimet pra thekson personin tek i cili ndodh ose pritet të ndodh ndryshimi.

Mësimdhënësit aktiv: Nënkupton i referohet mësimdhënësve që parapëlqejnë t'u japin gjithmonë e më shumë energji dhe “forcë” nxënësve përmes komunikimit.

Mësimdhënësi efektiv: I referohet mësimdhënësit inkurajues, të sinqertë, të besueshëm në vlerësim, kreativ dhe me aftësi të mira komunikuese.

Mësimdhënësi fillestar: I referohet mësimdhënësit fillestar në vitet e para në mësimdhënie.

Mësimdhënësi lehtësues (fascilitor): I referohet mësimdhënësit që ndikon në lehtësimin e të mësuarit të nxënësve, nxitjës së përkushtimit të tyre ndaj nevojave të tyre, si dhe sigurimin e strategjive, metodave dhe burimeve të përshtatshme për ta bërë të mësuarit sa me efektiv për nxënësit.

Mësimdhënësi mentor: I referohet mësimdhënësit që mentoron një mësimdhënësi fillestar në mësimdhënie në klasë.

Mësimdhënësi pragmatikë: Nënkupton i referohet mësimdhënësve që janë në kërkim të “rendimentit” diçka që është pragmatike e bashkëkohore për përdorim për nxënësit.

Mësimdhënësi reflektues: I referohet mësimdhënësit që i angazhon nxënësit e tij në objektiva dhe qëllime kuptimplotë.

Mësimdhënësi si organizator dhe orientues: Nënkupton i referohet mësimdhënësit që të gjitha aktivitetet gjatë realizimit të punëve të pavarura të nxënësit, detyrat e shtëpisë apo aktivitetet jashtëshkollore i organizon dhe orienton për nxënësit.

Mësimdhënësi teoricientë: Nënkupton i referohet mësimdhënësit që është i interesuar në transmetimin e njohurive, që i konsideron njohuritë, detajet, informacionet në vazhdimësi si më të rëndësishmet për nxënësit.

Mësimdhënësit e kuptueshëm: Nënkupton mësimdhënësit që flasin thjeshtë, shkurtë dhe në mënyrë interesante, komunikues të mirë, këshillues, vlerësues të pranueshëm dhe ndikues e nxitës pozitiv për të mësuarit.

Mësimdhënësit e pakuptueshëm: Nënkupton mësimdhënësit që flasin në mënyrë të komplikuar, jointerese, jo ndikues dhe pa ndikim që nxënësit të dëgjojnë një ligjërim të tillë nga ai.

Mësimdhënësit objektivë: Nënkupton mësimdhënësit që shprehin perceptimet e tyre si perceptime, mendimet e tyre si mendime dhe ndjenjat e tyre si ndjenja objektive.

Mësimdhënësit skematik: Nënkuptohen mësimdhënësit e karakterizuar nga shpjegime, sipas një skeme të ngrirë të pa

ndryshuar (në çdo orë mësimore) dhe pa asnjë ndryshim gjatë realizimit të mësimdhënies së tyre në klasë.

Mësimdhënësit subjektivë: Nënkupton mësimdhënësit që mendimet dhe ndjenjat e tyre i transformojnë në fakte të perceptuara joreale vetëm si mendime dhe ndjenja subjektive.

Mësimdhënia: Koncepti i referohet situatave të procesit të mësimdhënies metoda, strategji dhe teknika të ndryshme të vlerësimit në të cilat mësimdhënësit përfshijnë nxënësit, gjatë veprimtarive në klasë, detyrave dhe angazhimeve që duhet ti kryejnë/plotësojnë në klasë.

Mësimdhënia si proces i orientuar: Nënkupton i referohet procesit të të mësuarit drejt një grupi të veçante: duke filluar me shpjegimin e përmbajtjes, dhënies ose përcjelljes së njohurive, organizimin e veprimtaris së nxënësve që karakterizohet nga funksioni i vazhdueshëm i procesit të vlerësimit e reflektimit që funksionon dhe jep efekt në të mësuar të nxënësve.

Mësimdhënia dhe të mësuarit: Me termin “mësimdhënie/të mësuar” nënkuptohen dy aspekte të të njëjtit proces të rëndësishëm të gërshetuar me njëra tjetrën, e të cilat mundësojnë përvetësim e programeve mësimore në shkollë.

Mësimdhënia e drejtpërdrejtë: I referohet ligjërimit dhe demonstrimit të fakteve, përkufizimit të nocioneve, mësimi të rregullave, konkretizimit të objekteve në punën mësimore si dhe gjatë ndërtimit të shkathtësive të nxënësve për të zgjidhur probleme të ndryshme jetësore.

Mësimdhënia e ndërsjelltë: I referohet çasjës bashkëkohore të mësimdhënies në funksion të motivimit të nxënësve të provojnë “rolin” e mësimdhënësit dhe përgjegjësinë për të mësuar nxënësit tjerë (shkathtësi digjitale).

Mësimdhënia e suksesshme; Nënkupton mësimdhënien që ndikon në procesin e të mësuarit, veprimtarive të të mësuarit si edhe performancës së njourive, shkathtësive e aftësive praktike të nxënësve.

Mësimdhënia hap pas hapi; I referohet procesit të të mësuarit formësimit dhe përparimit duke mësuar hapa pas hapi: aftësi, shprehi, dhe shkathtësi (të shkruarit, lëvizjet, pikturimi, gjimnastika etj).

Mësimdhënia konstruktiviste: I referohet procesit të mësimdhënies, ku nxënësi përvetëson konceptet, modelet dhe abstraktimet përmes proceseve të përgjithësimit dhe dallimit.

Mësimdhënia në grupe të vogla: I referohet procesit të mësimdhënies për ata nxënës të cilët janë vendosur në grupe me të vogla organizative, dhe jo në klasa, bazuar në nevoja të përbashkëta, në mënyre efikase dhe produktive.

Mësimdhënia nëpërmjet rrjetit (internet): Nënkupton i referohet procesit të mësimdhënies që mund të variojë nga përdorimi i burimeve multimediale, që nxirren nga arkivat digjitale, deri në kurset e plota mësimore online në internet.

Mësimdhënia për të mësuarin aktiv: Nënkupton i referohet procesit të mësimdhënies përmes një qasje të të shpjeguarit që

bazohet në katër parime bazë: të mësuarit konstruktiv, të vetë-rregulluar, kontekstual, dhe bashkëpunues.

Mësimdhënia përmes metakomunikimit: Nënkupton i referohet procesit të mësimdhënies së vetëdijshme dhe të pavetëdijshme, racionale dhe iracionale, të qëllimshme dhe të paqëllimshme, humane dhe edukative, psikologjike dhe sociale, plotësuese e informuese, konstruktive e kontaktibile, kreative e prodikative, të njëanshëme e reaktive, të mësimdhënsit me nxënësit e tij.

Mësimdhënia tradicionale: Nënkupton i referohet procesit të mësimdhënies ku kriteri kryesor është transmetimi i informacionit të përfshirë në një tekst ose në ndonjë burim dhe të mësuarit nga nxënësit është vetëm përvetësimi i njohurive dhe fakteve që duhën mbajtur mend dhe jo të procedurave që duhën zbatuar.

Mësimdhënia virtuale; Nënkupton, i referohet procesit të mësimdhënies së planifikuar, ku përshihen planifikimi, organizimi dhe dhënia e detyrave, monitorimi i nxënësit që shfrytëzon teknologjin si përcjelljës së njohurive dhe mundësive të realizimi të procesit të të mësuarit nga largësia (pa afërsi fizike mësimdhënës–nxënës).

Mësimdhënie shpjeguese: Nënkupton i referohet procesit të mësimdhënies sipas së cilës mësimdhënsi prezanton materialin mësimor me një organizues praparak (shpjegues dhe krahasues) kur materiali mësimor është krejtësisht i panjohur në formë të plotë dhe të organizuar, (të shpjegurit e qartë të fakteve dhe koncepteve) duke lëvizur nga konceptet më të gjera tek ato më specifike rreth temës që do të mësohet.

Mësimdhënia e profesionalizuar: Nënkupton i referohet procesit të mësimdhënies (shpjegim, sqarim, udhëzim, përshkrim, lehtësim, udhëheqje, instruktim) si një ndërmjetësues në përzgjedhjen dhe transmetimin e njohurive, aftësive, shkathtësive e të shprehive) me rregulla të arsyeshme.

Mësimdhënsit që përqendrohen në suksesin e përgjithshëm të klasës: Mësimdhënsit që përqendrohen tek metoda e teknika të ndryshme për suksesin e përgjithshëm të nxënësve në klasë.

Mësimdhënësit në rolin mbështetës emocional: Nënkupton i referohet procesit të mësimdhënësit që i ndihmojnë nxënësit për t'u zhvilluar individualisht për të arritur nivele të larta vetëveprimi, arsyetimi dhe miratimi.

Mësimdhënsit në rolin qendror të mësimdhënies: Nënkupton i referohet procesit të mësimdhënies me misionin e zbatuesit të kurrikulës, duke përdorur planifikime të sakta, shprehi të mira, koncepte për drejtimin e klasës dhe vlerësimin e nxënësve.

Mësimi reflektiv: Nënkupton i referohet procesit të të mësuarit të mëhershëm i cili ndikon të krijojë një kuptim të ri nga informacionet e reja.

Mësimi për të mësuarit: Nënkupton i referohet një procesi të përjetshëm i cili vazhdimisht përmirsohet (mësimi është produkti aktiv mendor ndërsa të mësuarit përfshin procesin e të mësuarit) në aspekte kritike si: motivimi, mbajtja mend dhe transferimi i të mësuarit për gjatë gjithë jetës.

Mësimi në distancë: Nënkupton i referohet procesit të të mësuarit me ndihmën e komunikimit elektronik, përmes mjeteve të

ndryshme, si video-konferenca, forumet apo forma të tjera mësimi në largësi.

Mësimi vëzhgues: Nënkupton i referohet procesit të të mësuarit përmes vëzhgimit dhe imitimit të të tjerëve.

Mesore: Numri që ndodhet në mes të një game numrash, mënyrë e llogaritjes së tendencës qendrore, që ndonjëherë është më e përdorshme se llogaritja e së mesmës.

Metakognicioni: Si term nënkupton dija e asaj se si ne mendojm mbi funksionin e të menduarit përkatësisht përfshin çdo gjë që një individ mendon dhe që lidhet me mënyrën se si përpunohet informacioni i mësuar.

Metakonjektivizëm: Koncepti i referohet njohurive rreth procesit të të menduarit të njerëzit.

Meta-njohja: Termi do të thotë “të mendojm mbi të menduarin” në veprimtari të të mësuarit, që të mësohet më shumë dhe më mirë nga tre komponente: dijet personale, dijet mbi detyrat dhe dijet e strategjive.

Metoda “extra kohe”: Koncepti i referohet metodës, ku nxënësi njihet me një stimul (p.sh. një numër apo fjalë në letër) dhe atij i kërkohet të përgjigjet (p.sh. ta thotë numrin apo fjalën) që nxënësi të mendojë dhe të përgjigjet, para se të bëjë ndërhyrjen apo korrigjimin mësimdhënësi.

Metoda e demonstrimit; Nënkupton i referohet metodës së mësimit, të vrojtuarit si dhe përmbajtjet së përvojës të shfaqur në

forma të ndryshme të operacioneve tona për dukuritë dhe fenomenet e shoqërisë dhe natyrës.

Metoda e dialogut ose e bisedimit: Nënkupton i referohet metodës erotematike bashkëbisedimit të mësimdhënsit me nxënës si dhe bisedës-dialogut në mes nxënësve si formë e veçantë e komunikimit në mësim.

Metoda e individualizimit: Nënkupton i referohet trajtimit të diferencuar deri në individualizim, ushtrime, problema, detyra, materiale të diferencuara, materiale të përshtatura nevojave të nxënësit për të mësuar.

Metoda e ndërthurjes I, apo teknika ‘Xhingsav’: Nënkupton i referohet njëres nga teknikat e të lexuarit në bashkëpunim, ku leximi i njësisë mësimore nuk bëhet në tërësi nga ana e të gjithë nxënësve, por nxënës të caktuar janë përgjegjës ta interpretojnë atë sa më mirë, për kuptimin e tërësisë nga të gjithë.

Metoda e ndërthurjes II, apo fletët e ekspertit: Nënkupton i referohet njëres nga teknikat e të lexuarit në bashkëpunim, e cila është e suksesshme kur teksti duhet të lexohet, i orientuar në bazë të pyetjeve nga të gjithë nxënësit, mirëpo nxënës të caktuar janë përgjegjës për të ndihmuar të tjerët në grupet e tyre që të mësojnë më në detaje rreth “pikpamjeve” të leximit nga fleta e tyre e ekspertit.

Metoda e projekteve: Nënkupton i referohet mësimdhënies e cila finalizohet me zotërimin praktik të nxënies përmes projektit mësimor.

Metoda e punës me tekst: Nënkupton i referohet mësimdhënies kur përdorimi i tekstit, librit nga mësimdhënësi dhe nxënësit përbën rolin kryesor në punën mësimore dhe në punën e vetarsimit.

Metoda e trekëndëshit: Nënkupton i referohet përdorimit të disa metodave kërkimore njëkohësisht, në mënyrë që të sigurojë vlefshmërinë e të dhënave të hulumtuesit.

Metoda historike në kërkimet në edukim: Metoda e përzgjedhjes së burimeve parësore, regjistra, ditar dhe plane dhe të dhëna të tjera, si psh: të dhëna, për të bërë studime dhe shkruar historitë e së kaluarës, njihet si histografi.

Metoda individuale: Nënkupton i referohet mësimdhënies si formë pune me fëmijët dhe njihet si një praktikë e mirë si një ndihmë e veçantë ndaj nxënësve që ju paraqiten vështirësi në të mësuar.

Metoda krahasuese në hulumtim: Nënkupton konstatimin e ngjashmërisë dhe ndryshimeve mes dukurive të ndryshme, p.sh. të faktorëve dhe akterëve të ndryshëm, apo edhe ndërmjet të ndryshmeve për një dukuri në aspektin kohor diakron- pra në kohë të ndryshme, apo sinkron- në kohë të njëjtë.

Metoda majeutike: Nënkupton i referohet mësimdhënies që ka karakter disjunktiv të pyetjeve me përgjigje alternative, afirmative ose negative.

Metoda mikse në kërkim: Nënkupton i referohet qasjes sasiore dhe cilësore, duke përdorur të dhënat si primare ashtu dhe

sekondare, kjo metodë po bëhet gjithnjë e më e zakonshme në hulumtimet në edukim.

Metoda S-K-A: Akronim i përdorur për të përpiluar objektivat e të mësuarit. Ai përbehet nga fjalët skills (aftësitë), knowledge (njohuritë), dhe attitudes (qëndrimet), dhe përdoret për të përpiluar objektivat e lëndës dhe të kapitullit mësimor.

Metoda SMART: Një metodë për kujtesën që përdoret kur përcaktohen objektivat e mësimit. Ajo përbehet nga akronimet e specific (specifike), measurable (i matshëm), action-oriented (i orientuar drejt veprimit), reasonable (i arsyeshëm), dhe time-bound (me afat të përcaktuar).

Metoda të mësimdhënies: Nënkuptohen përfshijnë rrugët, mënyrat, rregullat, procedurat, hapat për realizimin e qëllimit të mësimdhënies për të arritur rezultatet në procesin mësimor.

Metoda verbale: Nënkuptohen përfshijnë (metodën e monologut dhe dialogut).

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies: Procedura standarde që përdorin mësuesit në bashkëveprim me nxënësit për paraqitjen dhe për zhvillimin e materialeve dhe të veprimtarive mësimore për të arritur qëllimet dhe objektivat mësimore.

Metodat e edukimit: Rrugët, mënyrat ecurit e bazuara mbi rezultate shkencore për të arritur qëllimin e edukimit.

Metodat e kërkimit në edukim: Rrugët mënyrat ecurit për të arritur rezultatet e duhura në hulumtimet empirike në fushën e edukimit.

Metodat e mësimdhënësit në funksion pedagogjik:

Nënkuptohen përdorimi i metodave të mësimdhënies për aftësitë komunikuese, shkathtësitë pedagogjike, diskutimet e planifikuara, formulim pyetjesh, analizë teksti, përdorim i mjeteve mësimore dhe teknikave të vlerësimit.

Metodat në shkencat shoqërore: Janë mënyra të domosdoshme të kërkimit, të cilat na mundësojnë që të arrijmë rezultate dhe njohuri të reja, apo t'i korrigjohet ato ekzistuese për të kuptuarit mbi realitetin shoqëror.

Metodat vizuale: I referohen shqyrtimit dhe diskutimit të pikturave, ilustrimeve, shiritave filmikë, të cilët tregojnë sjelljen e njerëzve në botën përreth tyre dhe shembullin personal.

Metodë e inkurajimit të nxënësit: I referohen sjelljes pozitive të mësimdhënësit ndaj një nxënësi që abuzohet nga bashkëmoshatarët, në mënyrë që të rrisë vetëvlerësimin e tij.

Metodikat: Disiplina shkencore pedagogjike që studiojnë ligjësitë e mësimin të suksesshëm në lëndët përkatëse mësimore që i aftësojnë mësimdhënësit se si me planifikuar dhe me organizuar mësimdhënien nëpër lëndët e veçanta mësimore.

Metodologji vlerësimi: Nënkuptohet të gjitha tipet (llojet) e vlerësimit (në të gjitha nivelet) për një numër të madh kategorish vlerësimesh.

Metodologjia e mësimdhënies: Nënkuptohet tërësia e mësimdhënies dhe realizimit të një ore mësimore të sukseshme (metodat, teknikat dhe strategjitë mësimore, përkatësisht mënyrat, hapat, procedurat) që mësimdhënësi përdor gjatë gjithë orës

mësimore në klasë, që mundësojnë punë individuale, punë në grupe dhe dyshe, përfshirje aktive apo bashkëpunim mësimdhënës-nxënës, me qëllim që nxënësit të përvetësojnë njohurit dhe aftësitë e synuara apo rezultatet e pritshme të mësimdhënies.

Mikro-organizim: I referohen organizimit në vëllim me të vogël të veprimtarisë edukativo-arsimore dhe mësimore me karakter operativ (njësi mësimore).

Miratimi: Nënkupton përkrahjen e mësimdhënësit në ndjenjën e lirisë së veprimit, rritjen e interesit ndaj mësimin, angazhimin dhe performancën e nxënësve.

Mirënjohje: Nënkuptohe vlerësim (fletë e shtypur tërheqëse ku shënohet emri mbiemri dhe motivacioni ose arsyeja) inkurajues e cila i ipet nxënësit si shenjë mirnjohje për një arritje ose pjesëmarrje në një ngjarje të caktuar.

Mirëqenie: Nënkuptohe gjendje pozitive emocionale që shoqërohet me kënaqësi nga ana e individit.

Mjedisi i sigurt për të mësuar : I referohet situatës ”klimës” emocionale që ekziston në klase; si mjedisi i qetë ku nxënësit ndjehen mirë, i shprehin lirshëm idetë, pikëpamjet, nëse ka probleme dhe kur ka raste të konflikteve, ato menaxhohen mirë dhe drejtë nga mësimdhënësi.

Mjedisi fizik për të mësuar: Nënkupton përshtatshmërin e mjedisit për mbajtjen e mësimin. Krijimi i kushteve fizike në një klasë dhe në mjediset e mësimdhënies dhe të mësuarit.

Mjedisi hapsinor: I referohet faktorëve fizikë në mësimdhënie dhe në të mësuar përkatësisht përshtatshmëris si: madhësia e klasës, hapësira për aktivitete për secilin nxënës në klasë.

Mjedisi i punës mësimore në klasë : I referohet faktorëve fizikë në mësimdhënie dhe në të mësuar si: akustika, cilësia e ajrit dhe ajrosja (dritare me hapje), ndriqimi, temperatura, ngrohja e domosdoshme e klasës, inventari i klasës për mundësi të përdorimit të përshtatshmëris si një mjedis pune/mësimi.

Mjedisi i të mësuarit : Nënkuptohehet ambienti (ose ambientet) ku synohet të organizohet procesi i të mësuarit, organizimi i mënyrës sesi do të ulën, ndërveprimi ndërpësonal i pritur ose i toleruar nga mësimdhënsi për nxënësit.

Mjedisi mësimor (i klasës): I referohet përdorimit të hapësirës dhe kushteve fizike (temperaturës dhe ndriqimit) në klasë nga mësimdhënsi dhe nxënësit si pamja e tabelës, ndriqimi i klasës, mundësi për të parë dhe dëgjuar çdo demonstrim nga mësimdhënësi dhe secili nxënës në klasë.

Mjetet e mësimdhënies: I referohen një grupi materialesh dhe pajisjesh që përdoren rregullisht nga mësimdhënësit gjatë procesit të mësimdhënies.

Mjete mësimore: I referohen atyre mjeteve që do t'i përdorni gjatë procesit mësimor duke përfshirë: tekstet, lapsin, shkumësin, tabelën, grafikët e ndryshëm, fjalor, vepra letrare, artistike, llaptop e projektor në mësim.

Mjetet auditive: I referohen pajisjeve për xhirime tonike të nxënësve.

Mjetet audiovizuale: I referohen paisjeve për xhirime audiovizuale.

Mjetet organizative grafike: I referohen paisjeve vizive që ndihmojnë nxënësit të përvetësojnë dhe ta rikujtojnë informacionin (shohin marrëdhëniet përmes shembujve me konkret) p.sh. diagramat ndihmojnë nxënësit që ta organizojnë punën në një mënyrë më të lehtë sistematike.

Milëfi i nxënësit: Përjetim i një ndjenje negative të dhimbshme ose reagim sjellje verbale si pasojë e një fyerje verbale ose sjellje fyese të mësimit ndaj nxënësit.

Moda: Tregues statistikor që paraqet tendencën qendrore. Vlera që përsëritet më së shpeshti, nuk ndikohet nga vlerat ekstreme, përdoret për të dhëna numerike dhe kategorike në hulumtime.

Modelet kurrikulare: Nënkuptojn konceptualizime të këndvështrimeve për kurrikulumin si përmbajtje.

Modelet e mësimit: Janë rrugët afirmative të të mësuarit që mësohen nga literaturë (përshkruar kohore dhe përfshirës si njohuri aftësi dhe qëndrime të veçanta për ti ndihmuar nxënësit në procesin e të mësuarit si një rrugë e cila kërkon njohje, përvetësim nga praktika e mësimit apo eksperimentimit pedagogjik. (modele ideale në mësimit nuk ka, ato kërkojnë qëndrim reflektiv të mësimit).

Modeli holistik në sferën e epistemologjisë: Mënyrë organizimi njerëzore spontanisht aktive kur njerëzit njihen si organizëm aktiv dhe jo si një organizëm reaktiv, si një burim veprimesh dhe jo si një grumbullim i akteve të nisura (nxitura) nga forcat e jashtme.

Modeli i mësimdhënsit si edukator: Nënkupton mësimdhënësin si çlirues të mendjes njerëzore duke e venë theksin tek përmbajtja dhe procesi dhe si një edukator i qenieve në formim, që kanë dije dhe moral njerëzor.

Modeli i të kuptuarit me projektim në kurrikulë: Përfshin një varg procesesh dhe standardesh projektimi në kurrikulë, ku mësimdhënësit janë projektues dhe një nga detyrat e tyre kryesore është që të projektojnë kurrikulën dhe përvojat e të mësuarit për të përmbushur qëllimet e specifikuar.

Modeli pedagogjik i edukimit: Një përpjekje sistematike për përshkrimin e kuptimit të mësimdhënies dhe të mësimit për të formuluar një teori që merr në konsiderat atë që dimë nga përvoja dhe kërkimet pedagogjike.

Modeli sinëktik: Nënkupton parimin sipas të cilit të mësuarit është së pari produkt kognitiv e pastaj përjetohet emocionalisht dhe kultivohet përmes mësimit të drejtuar nga mësimdhënësi dhe të vetëmësimit nga nxënësi.

Modelimi: Teknike mësimore në të cilën mësimdhënia fillon duke tërhequr së pari vëmendjen e nxënësit (p.sh., është radha ime, më shiko sesi po e bëj) kryen vetë pjesën e parë të detyrës/ushtrimit, ndërsa nxënësi e vëzhgon, ushtron, mëson dhe e më pas e zgjidh “bën” detyrën/ushtrimit në klasë.

Modernizimi i arsimit: Përshtatje e vullnetshme me frymën e kohës si kapërcim i së vjetrës, konservatores dhe të tejkaluarës si sinonim i ndryshimit pozitiv të arsimit.

Modifikim i mësimdhënies: Nënkupton ri-mendim, riorganizim ose një trajtim i modifikuar i mësimdhënies nga vet mësimdhënësi pas reflektimit.

Modifikimi i sjelljës: Nënkupton formësimin e sjelljës së nxënësit duke injoruar sjelljet e padëshiruar dhe duke përforcuar sjelljet e dëshiruara.

Modul (i hapur): Nënkupton nënprogram- tërësia më e vogël programore e përmyllur, përkatësisht një temë nga tematika mësimore.

Moduli mësimor: Nënkupton njësi mësimore “autonome”, me kohëzgjatje relativisht të shkurtër, në të cilën integrohet teoria me praktikën dhe nëpërmjet së cilës synohet arritja e një kompetence të caktuar pune.

Momente të mësimdhënies: Nënkupton ndjenja të çastit të cilat bazohen te mësimi i nxënësve duke krijuar orientime në të mësuar apo supozime të mësimdhënies.

Monitorim: Nocioni në kuptimin më të përgjithshëm të fjalës, do të thotë: “monitoroj, kryej vëzhgime të vazhdueshme për diçka, regjistroj ose testoj, ndjek me vëmendje e me kujdes një punë, një veprimtari, shikoj sesi kryhet diçka”.

Monitoruesi i testit të maturës: Nënkupton personi i angazhuar nga Masht i cili regjistron aktivitetin e testimit, rrjedhën e gjithë procesit të testimit dhe e raporton atë.

Monografia: Nënkupton punim që trajton një temë të veçantë në tërësinë e saj, që ka titullin e vet dhe që zakonisht botohet si libër.

Monotoni: Nënkupton gjendje emocionale që shkaktohet nga përsëritja e vazhdueshme e një veprimtarie në mënyrë të pandryshueshme.

Moralitet hoeteronomous: Nënkupton morali i detyrimit të rregullave të jashtme ose ligjeve, rregulla të vendosura nga autoriteti i jashtëm ose programet e edukimit.

Morfologjia: Nënkupton sistemin që udhëheq strukturën e fjalës, njëjësën dhe shumësin e emrave, me kohët e foljeve, me prapashtesat, me fjalët e bashkuara etj.

Morfologjike (vështirësi): Nënkupton strukturë morfosintaksore të parregullt, kur fëmija ka një fjalor të varfër, atëherë kemi të bëjmë me vështirësi të karakterit morfologjik.

Mosbesim: Nënkupton dyshim të plotë rreth asaj që dëgjon një individ nga një individ tjetër.

Moshë parashkollore: Nënkupton vitet 4 deri në 5 përkatësisht vitet e fundit para futjes së fëmijës në shkollë.

Motiv: Nënkupton faktor që ndikon në aktivizimin dhe drejtimin e sjelljes e lidhur me synimin e arritjes së qëllimit për uljen e tensionit (shqetësimin) për të plotësuar nevojën.

Motivim i brendshëm: Nënkupton motivim që lidhet me veprimtari që janë shpërblim në vetvete, gjendje e brendshme që gjallëron “diçka që një person kërkon të arrij për veten” që drejton përpjekjen për rritjen vetjake në jetë dhe mbështet përpjekjen që duhet të bëjë individi për të arritur vetërealizimin.

Motivimi : Proces i aktivizimit të organizmit, nga një faktor ose bashkësi faktorësh që nxisin aktivitetin e orientuar në realizimin e një qëllimi që duhet të arrijë individi në të mësuar ose në jetë.

Motivim për të mësuar: Nënkupton prirja për t'i parë veprimtarit mësimore të kuptimshme dhe të vlefshme si dhe përpjekja për të përfutur prej tyre.

Motivimi në procesin mësimor: Nënkupton kur nxënësit motivohen të mësojnë nga motivues të jashtëm (notat, miratimi i mësimdhënësit, shpërblimet si dhe presionin e prindërve).

Motivimi i nxënësit: Nënkupton nxitja e brendshme e nxënësit për njohuri të reja.

Multidisiplinarteti: Nënkupton ndërlidhje, bashkim, kualitet i ri nga dy ose më tepër diciplina ose nga disa përmbajtje me cilësi të ndryshme në një.

Multimedia mësimore: Nënkupton integrim të medias mësimore (tekste, video, audio dhe ndëraktive) për të ofruar një situatë/përvojë mësimore me gjithëpërfshirëse.

Mundësia për të mësuar: Nënkupton nivelin sipas së cilit nxënësit ju është shpjeguar përmbajtja dhe aftësitë që janë të përfshira në kurrikulen e shkruar dhe/ose ato që atyre u nevojiten të kishin mësuar për të pasur rezultate të mira në testet e jashtme.

Mungesë e arsyeshme: Nënkuptohej mungesa e justifikuar me dëshmi në një orë mësimi apo ditë mësimi për nxënësin.

Mutizmi i pjesëshëm: Nënkupton një vështirësi ose paaftësi të fëmijës për të folur që shfaqet, para moshës shkollore apo në

momentin e fillimit të shkollës (fëmija nuk e fillon komunikimin i pari ose nuk e kthen pergjigjjen, nuk flet as me shokët, as me mësimdhënësit e tij një lloj” izolim” i fëmijës, ngase nuk ndihet rehat dhe i sigurt, kjo mund ta bëjë shkollën sfiduese për të, megjithëse fëmija ka inteligjencë të mirë dhe dëshirë për të komunikuar.

Mutizmi i plotë: Nënkupton fazë kalimtar gjatë së cilës fëmija flet me zë të ulët dhe duke belbëzuar për shkak të aspekteve traumatizuese dhe pamundësis që të shprehë ndjenjat e tij.

Mutizmi: Nënkupton përkufizohet si “zhdukje” e pavullnetshme (dhe i nënshtrohet disa mekanizmave të inkoshiencës) e të folurit tek një fëmijë, i cili e ka pasur të zhvilluar më pare aftësinë për të folur.

N

Nativizëm: Nënkupton pikëpamje se ligjet e zhvillimit të shoqërisë konsiderohen si shkaqe natyrore.

Ndarje kronologjike e nxënësve: Nënkupton ndarje sipas (kohës së lindjes) moshës, datës, muajit dhe vitit të lindjes.

Ndërdije: Forma më e lartë e vetëdijes.

Ndërgjegje: Ndjenjë e përgjegjësisë morale për sjelljen dhe veprimet e një individi brenda shoqërisë.

Ndërhyrje: Nënkupton mbështetje të qëllimshme të mësimdhënësit (veprimi, procesi i reagimit) për nxënësit për t'u

përmirsuar për ti orientuar/ riorientuar sjelljen e një nxënësi ose të gjithë nxënësve që tëpërqendrohën në mësim.

Ndërlikim në mësimdhënie: I referohet veprimit të zbatueshmërisë në praktiken mësimdhënëse kur planifikimi dhe pritshmërit nuk zbatohen (shkojnë) ashtu siç planifikohen gjatë performances së mësimdhënësit në klasë.

Ndërveprim social: Ndikim i ndërsjellë ndërmjet komunikimit, gjeesteve ose mimikës ndërmjet individëve në një shoqëri.

Ndërveprimet asimetrike në mësimdhënie: Ndërveprimet në të cilat mësimdhënësi jep mësim apo komunikon vetëm me nxënësit të përgatitur që kanë njohuri duke lënë anash nxënësit tjerë më pak të përgatitur,apo më më pak njohuri.

Ndërveprimi në të mësuar: Një përvojë (situatë mësimore) kur të dy faktorët mësimor ndikojnë në funksion apo qëllim edukativ në procesin mësimor.

Ndëshkimi: Akt dënimi, sanksioni formal, verbal, për individin për gabime/ sjellje jo të mira në jetë.

Ndëshkimi i nxënësit: Një nga teknikat e modifikimit të sjelljes së nxënësit në klasë që mësimdhënësi e përdor që të përmirsoj ose eliminoj sjelljen e padëshiruar të nxënësit në klasë.

Ndëshkimi fizik: Një nga teknikat e modifikimit të sjelljes së nxënësit në klasë izolim, qëndrim jashtë klase, e deri te ndalim me duar, jo-goditje por modifikim të sjelljes nga mësimdhënësi mosaprovim me marr pjesë në aktivitete jashtëmësimore si: ekskursione me nxënësit tjerë, etj.

Ndëshkimi verbal: Një nga teknikat e modifikimit të sjelljes së nxënësit në klasë nga mësimdhënësi, një poshtërim verbal që krijon të nxënësi ndjenjën e turpër, të ankthit, të fajit, agresivitetit, mungesës së kujdesit.

Ndijim: Procesi psikik i ndërgjegjësimit për njohjen e botës që na rrethon.

Ndjenja e inferioritetit. Përjetim ndjenjë vetmie si një "dele e zezë" brenda një grupi.

Ndjenjë e fajit: Akt i sjelljes së ndaluar, që shfaqet si shqetësim "vetëfajësim" i individit kur cenon, shkel normat sociale dhe të sjelljes.

Ndjenjë estetike: Përceptim dhe përjetim, përkatësisht kënaqësi, që shkaktohet kur shikojmë diçka të bukur nga arti, jeta ose bukuria natyrore dhe njerëzore.

Ndjenjë intelektuale: Përjetim i individit ndaj rezultateve të punës mendore.

Ndjenjë morale: Përjetim ose vlerësim pozitiv për njeriun dhe veprimin e njeriut.

Ndjenjë: Përjetim ndaj njerëzve, ngjarjeve ose sjelljeve, që shfaqet si kënaqësi ose pakënaqësi.

Ndjeshmëri: Veçori e njerëzve për të reaguar ndaj ngacmuesve të jashtëm.

Ndjesi: Mbresë dhe përjetim i një cilësie të objektit a të dukurisë së caktuar.

Ndjësia e mirëqenies së nxënësve: Gjendja pozitive mendore që i mundëson një nxënësi të punojë me efikasitet brenda shkollës dhe klasës, lidhet me sigurin, mospasjen e frikës dhe ankthit gjatë procesit mësimor.

Ndjësia e përkatësisë: Ndjesitë që të bëjnë të pranueshëm dhe të vlerësuar nga bashkëmoshataret, mësimdhënësit dhe fëmijet e tjerë në shkollë.

Ndrojtja e nxënësve në dhënien e përgjigjeve: Nënkupton frikën e nxënësve se përgjigja e tyre nuk është e saktë andaj ata kanë ndrojtje se dalin qesharak për atë që përgjigjen para nxënësve tjerë dhe mësimdhënësit.

Ndryshimi: Është term i përgjithshëm që përfshin risin, zhvillimin dhe përshtatjen e planifikuar nga një njëri ose një grup njerëzish.

Ndryshueshmëri: Aftësia e njerëzve për të ndryshuar vazhdimisht, për të mbijetuar dhe për t'u përsosur.

Negocim shoqëror: Aspekt i procesit mësimor që mbështetet në bashkëpunimin me të tjerët dhe në respektin për këndvështrime të ndryshme nga të tjerët.

Nepotizëm: Favorizim i anëtarëve të familjes pa merita për dhënie të titujve ose të emërimit në pozita të caktuara.

Nervozizëm: Reagim emocional i njeriut që shfaqet përmes ngritjes së zërit, të bërtiturave dhe lëvizjeve të pakontrolluara të duarve.

Neuron: Qeliza kryesore e sistemit nervor, që përçon mesazhe në çdo pjesë të trupit.

Neurozë: Çrregullim i lehtë psikik, që shfaqet si frikë e paarsyeshme dhe tension emocional.

Nevoja për të mësuar :Përkufizohet si mospërputhje ose hendek midis kompetencave të specifikuara (kërkuara për një nivel arsimor) dhe nivelit aktual të kompetencave të nxënësit pra (zhvillimit të të mësuarit të nxënësit).

Nevojë: Impuls, mungesë nxitje e brendshme, që krijon tension dhe shqetësim deri në realizim/arritje përmbushëse si vetëvlersim.

Ngacim: Ndryshimi fiziologjik dhe neurofiziologjik, që shkaktohet nga një ngacmues i jashtëm.

Ngacmimi ndërmjet bashkëmoshatarëve: Sjellje agresive e padëshirueshme, në mesin e fëmijëve të moshës shkollore.

Nivele vështirësie: Niveli sipas së cilit një test, ose forma të tjera të vlerësimit detyra/kërkesa, përfaqësojnë nivelin ose llojin e kompleksitetit njohës të detyrave/ kërkesave të përfshira në vlerësim për nxënësin.

Normë: Kriter që e vendosim kur vlerësojmë apo gjykojmë për nxënësin.

Nota: Është masa numerike ose cilësore, e bazuar në kritere të definuara mirë, e cila përdoret për të përshkruar rezultatet e vlerësimit të nxënësit për një lëndë.

Nxënës me simptoma stresuese: Përshkruhen nxënësit që zakonisht kanë vështirsi me përqendrimin dhe probleme në të mësuar apo koncept të varfër për vetën.

Nxënës të cilët kanë vështirësi në të shprehur: Përshkruhen nxënësit që janë të mbyllur në vetëvete, emotivë, pa kurajo në një orë mësimi, pavarësisht se e kanë kuptuar mësimin, nuk kanë guximin t'i drejtojnë pyetje mësimdhënsit për t'u sqaruar sepse ndjehen të paaftë, nuk gjejnë guximin për ta ngritur dorën, pasi i mundon mosbesimi, frika, pasiguria se mund ta thonë gabim e në këtë mënyrë ndjehen të pasigurtë të shprehen.

Nxënës impulsiv: Nxënësit të cilët reagojnë shumë shpejt në dhënien e përgjigjeve, që përgjigjen të parët dhe janë të padurueshëm për tu përgjigjur më vonë.

Nxënësit pjesëmarrës aktiv në procesin e të mësuarit: Përshkruhen nxënësit që bëjnë pyetje dhe japin përgjigje në pyetjet e mësimdhënsit, dhe përgjithësisht interesimi i nxënësve rreth mësimin si dhe gatishmëria për të mësuarit investigativ (hetues).

Nxënësit reflektiv: Përshkruhen nxënësit të cilët kanë tendencë për të menduar, të matur dhe të kujdeseshëm kur përgjigjen në pyetje.

Nxënësit aktivistë: Përshkruhen nxënësit që e perceptojnë informacionin në mënyrë konkrete (duke bërë prova, eksperimente, mësojnë nga gabimet dhe e përpunojnë në mënyrë aktive vetë për njohjen e gjërave të reja me aplikimin/zbatimin e tyre në realitet.

Nxënësit analitik: Përshkruhen nxënësit të cilët reagojn shumë shpejt ndaj detajeve ngase ata kanë preferencave të veçanta ndaj edhe përgjigjet e tyre janë me të ndryshme nga nxënësit tjerë.

Nxënësit globalë: Përshkruhen nxënësit të cilët parapëlqejnë t'i mësojnë informacionet me "kërcime" të gjata, pra t'i absorbojnë ato pothuajse rastësisht, duke mos e parë ndonjë lidhje dhe befasisht ata e kuptojnë mësimin.

Nxënësit kronologjikë: Përshkruhen nxënësit të cilët parapëlqejnë që ta kuptojnë informacionin e dhënë me anë të hapave linear, ku secili hap përcillet në mënyrë logjike nga ai i mëparshmi.

Nxënësit intuitivë: Përshkruhen nxënësit të cilët preferojnë zbulimin e mundësive dhe marrëdhënieve, u pëlqejnë risitë, janë të mirë në kuptimin e koncepteve të reja etj.

Nxënësit jo të interesuar për të mësuar: Përshkruhen nxënësit të cilët kanë mungesë interesimi, gatishmërie dhe motivimi për të mësuar dhe jo që kanë çrregullime intelektuale.

Nxënësit pragmatistë: Përshkruhen nxënësit të cilët parapëlqejnë të bëjnë ushtrime praktike dhe me kuptim (hartojnë pyetje për të tjerët, bëjnë ushtrime që kërkojnë aftësinë e të menduarit kritik, krahasojnë, gjykojnë, përgjithësojnë, diskutojnë, dhe argumentojnë, shkruajnë, redaktojnë, korrigjojnë, bëjnë ushtrime me alternative, diskutojnë) dhe e përpunojnë informacionin në mënyrë aktive.

Nxënësit praktikë: Përshkruhen nxënësit të cilët parapëlqejnë të përfshihen fizikisht ose marrin pjesë aktivisht në ato që u kërkohet

të mësojnë, parapëlqejnë më shumë aktivitetet në klasë që e ndërlihdin teorinë me praktikën.

Nxënësit që mësojnë duke dëgjuar: Përshkruhen nxënësit të cilët parapëlqejnë të mësojnë më mirë kur e dëgjojnë atë që u thuhet, p.sh. ligjërimin, udhëzimet me gojë dhe u pëlqen të marrin pjesë në diskutime.

Nxënësit që ndiejnë: Përshkruhen nxënësit të cilët parapëlqejnë studimin e faktorëve, në zgjidhjen e problemeve, nuk preferojnë befasishtë dhe komplimentet, janë të durueshëm, dhe praktikë.

Nxënësit reflektues: Përshkruhen nxënësit të cilët parapëlqejnë të marrin/përceptojnë informacionin në mënyrë konkrete dhe reflektojnë mbi to, duke dëgjuar, diskutuar dhe shkëmbyer ide të përvojave personale, për çështje të ndryshme, të figurave apo pikturave. etj.

Nxënësit teoricientë: Përshkruhen nxënësit të cilët parapëlqejnë të përftojnë informacionin në mënyrë abstrakte dhe reflektojnë për detajet, hollësitë, marrin shënime në klasë, kur zgjidhin ushtrime dhe studiojnë teori në heshtje.

Nxënësit verbalë: Përshkruhen nxënësit të cilët parapëlqejnë të kuptojnë më shumë nga fjalët e shkruara ose të folura nga mësimdhënësi.

Nxënësit vizualë: Përshkruhen nxënësit të cilët parapëlqejnë të mësojnë më mirë nëpërmjet mjeteve të ndryshme vizuale, pamore (skica, vizatime, piktura, foto, filma etj., mbajnë mend më mirë udhëzimet nëse i shohin ato në formë vizuale) nëse i shohin më parë figurat, para se të lexojnë një tekst.

Nxitja e vetëvlerësimit të nxënësit: Përshkruhen aktivitete të mësimdhënsit kur përdorin materiale mësimore për nxënësit që ndikojnë në rritjen e vetëvlerësimit të çdo nxënësi në klasë si: inkurajimi për nivelin personal të arritjeve, shmangia e krahasimeve mes nxënësve të klasës, dhe nxjerrja në pah e talenteve, përtej atyre akademik.

Nxitja: Përshkruhet është një stimul që qon në veprimin e dëshiruar nga mësimdhënësit për nxënësit.

Nxitja në mësimdhënie: Përshkruhet si procesi i dirigjuar nga mësimdhënësi ose prindi, që nxënësi/fëmija të mësojë, të marrë iniciativë, të angazhohet dhe të interesohet për zhvillimin e aftësive të tij në mësim.

Nxitja në të mësuar: Përshkruhet është çdo element, që mësimdhënsit i shtojnë detyrës për të ndihmuar nxënësin në kryerjen e saj (me fjalë, vizuale, fizike, me shenja).

Nxitje e mbështetjes për të ndryshmen: Të gjitha format e mbështetjes që zhvillojnë mësimdhënësit sipas nevojave të mbështetjes që janë pjesë e zhvillimit të kurrikulës në shkollë.

Nj

Njohje: Procesi i të menduarit njerëzor, që përfshinë perceptimin, arsyetimin dhe kujtesën.

Njohuri aftësuese: Procese të njohjeve që përfshijnë (fakte, koncepte dhe parime) mbi skemat, mbi metodologjinë dhe përgjithësimet.

Njohurit deklarative: Procese të njohjeve që përfshijnë (informacion gojor, përkatësisht që deklarohet me fjalë).

Njohurit faktike: Njohurit faktike janë njohja e elementeve të përmbajtjes diskrete të elementeve të izoluarra “copë informacioni” që përfshijnë terminologji dhe njohuri për detaje dhe elemente specifike të faktit.

Njohurit konceptuale: Janë njohurit e “formave me komplekse” të organizuara të njohurive. Ato përfshijnë, njohuri për klasifikimet dhe kategoritë, parimet dhe përgjithësimet si dhe teoritë, modelet dhe strukturat.

Njohurit metakognitive: Janë “njohuri për njohjen në përgjithësi si dhe njohuri për njohjen e dikujtë” ku përfshihen njohurit strategjike, kontekstuale dhe të kushtëzuara si dhe njohja e vetës.

Njohurit procedurale: Janë “njohurit se si bëhet diçka“ përfshin njohurit e aftësive dhe algoritmeve teknikave dhe metodave si dhe njohurit për kriteret e përdorura për të përcaktuar ose justifikuar “kur duhet bërë çfarë” brenda fushave dhe diciplinave specifike.

Njohurit pedagogjike (reflektuese): Nënkupton njohurit dhe aftësit reflektuese për mësimdhënien pedagogjike si: njohje e lëndës mësimore në kontekstin e mësidhënies (si oragnizohen, paraqiten, shpjegohen dhe demonstrohen /ofrohen për nxënës, për të nxitur të kuptuarit) dhe njohuri rreth proceseve mësimore (çfarë vështirsish mund të priten gjatë mësimdhënjes së një lënde), si i ndëlidhin këto njohuri me strategjit metodat e teknikat e mësimdhënies që i përdorin në klasë me nxënësit.

Njohurit pedagogjike të menagjimit të klasës: Njohurit që ndërlidhen/ndihmojn praktiken për të menagjuar aktivitetet dhe veprimtarit e nxënësve në klasë organizimin e përgjithshëm në klasë dhe diciplinën.

Njohurit e nxënësve: Janë tërësia e koncepteve dhe përgjithësimeve, që janë të dobishme në shumë kërkesa/detyra që zotërohen nga nxënësit.

Njohurit pedagogjike (konceptet dhe terminologjia): Njohurit për konceptet e rëndësishme pedagogjike (filozofin, parimet, metodat, çasjet dhe strategjit, materialet, programet dhe vlerësimin) për prezentimin e terminologjisë dhe përmbajtjes pedagogjike për mësimdhënie.

O

Objektiv edukativ: Theksimi “përshkrimi”i diçkaje që duhet të arrihet (rezultati) përfundimtar pjesërisht apo plotësisht për një aktivitet dhe kohë mësimore.

Objektivi arsimor: Qartësimi i rezultateve të synuara që nxënësit duhet të mësojnë ose zotërojnë në një nivel arsimor të shkollës.

Objektiv didaktik (si rezultat): Rezultati përfundimtar i dëshiruar i procesit të shpjegimit të të mësuarit, të arritur nga nxënësi, falë proceseve të mësimdhënies dhe të mësuarit në shkollë.

Objektiv mësimor: Aktivitet “diçka” që duhet të arrihët pjesërisht apo plotësisht, i matshëm në sasi dhe i kufizuar në kohë gjatë procesit mësimor.

Objektiva të të mësuarit: Deklarim i qartë i materialit, për të cilin synohet që nxënësit ta mësojnë nëpërmjet mësimdhënies.

Objektivat global (të përgjithshëm): Përfshijnë rezultate tëdëshiruara në tema të gjera (p.sh. sensi i numërit) ose tema të shumëta p.sh (thyesat, numërat e përzier, numrat dhjetorë) etj.

Objektiva ekspresiv \ shprehës: Përkufizohen si përshkrime se ç’ farë do të bëjë nxënësi në sjelljet përfundimtare të performancës (të flas, të përshkruaj, të gjykoj, të performoj me fjalë apo sjellje) si rezultat i mësimdhënies.

Objektiva emocionale: Përkufizohen si përshkrime se ç’ farë do të bëjë nxënësi në sjelljet përfundimtare të performancës (të ndjej, të përshkruaj ndjenjën, të performoj emocionalisht një sjellje) si rezultat i mësimdhënies.

Objektiva kognitiv: Objektiva mësimore të deklaruar në kuadrin e operacioneve mendore të një niveli më të lartë.

Objektiva në mësimdhënie: Deklaratat përshkruese që shprehin se si ne duam të mësojnë (përvetësojnë) nxënësit tanë, si rezultat i mësimdhënies **globale** (përmbajtja e gjerë te programit), arsimore (të orës mësimore ose të kapitullit), dhe mësimor si rezultat i mësimdhënies.

Objektiva të sjelljes: Janë sjelljet përfundimtare të matshme dhe të vëzhgueshme apo kërkesa që përqendrohen te ndryshimet e

vëzhgueshme dhe të matshme që plotsojnë tri kritere: të provuarit për arritje, kushtet e performancës dhe niveli i pranueshëm i performancës së nxënësit.

Objektivat e nivelit të lart të mësimdhënies; Përkufizohen si përshkrime se çfarë do të bëj nxënësi në arritjet përfundimtare të performancës (të dallojn, të krahasojn, të arsyetojnë, të argumentojne, të analizojne, të gjykojnë), si rezultat i mësimdhënies.

Objektivat e nivelit të ulët: Përkufizohen si përshkrime se çfarë do të bëj nxënësi në arritjet përfundimtare të performancës (të njohin, të përdorin, të ndërtojnë) si rezultat i mësimdhënies.

Objektivat e përgjithshëm të kërkimit: Janë pohime më të gjëra, të cilat zbërthejnë realizimin e qëllimit të kërkimit.

Objektivat mësimorë: Synime afatshkurtra dhe konkrete që shpresohet të demonstrojë nxënësi në fund të orës mësimore si rezultat i të mësuarit në kuadrin e kontekstit të qëllimeve arsimore, që lidhen me përmbajtjen mësimore, me metodat e mësimdhënies, me përdorimin e mjeteve mësimore dhe me vlerësimin.

Objektivat specifike të kërkimit: Janë pohime, që u referohen aktiviteteve specifike, apo të arriturave specifike të pritura të kërkimit, si rrjedhim i rezultateve empirike.

Objektiviteti i kërkimit: Paraqet paanshmëri, neutralitet dhe raport të drejtë ndaj dukurisë së hulumtuar, që do të thotë se dukuria pasqyrohet siç është.

Obligim ligjor: Një formulim i shkruar kontratë ose marrëveshje ligjore në mes personit fizik dhe juridik.

Oborri i shkollës: Mjedisi jashtë mureve të shkollës për të organizuar, aktivitete kurrikulare dhe jashtë kurrikulare që i mbështesin aktivitetet brenda klasës.

Operacionalizimi i kërkimit: Zhvillimi i mënyrave për matjen e koncepteve dhe variablave, krijimi i një mënyre për të matur një koncept ose disa dimensione të tij.

Orari i mësimave: Renditja e orëve të mësimit gjatë një dite ose gjatë një jave.

Orë mësimi: Njësi kryesore metodike e organizimit të procesit mësimor në bazë klase, që zgjat 45 minuta.

Organ: Pjesë e trupit të njeriut, që e kryen një funksion të caktuar.

Organizim: Proces i sistemimit të vazhduar të informacionit dhe përvojës në kategori mendore. Rrjet i rregullt dhe logjik lidhjesh njohurish që përdoren për të lidhur vizualisht copëza dhe pjesë të informacionit dhe të përvojës.

Organizimi dhe drejtimi i klasës: Procesi i administrimit të veprimtarisë së klasës në lidhje me aspekte të tilla si: planifikimi i mësimit, shfrytëzimi i burimeve mësimore, shfrytëzimi i hapësirës dhe i kohës, krijimi i klimës, kontrolli, diciplina, zgjidhja e konflikteve dhe vlerësimi i realizuar në klasë.

Organizimi i mësimdhënies në klasë “Orkestrimi”: Përkufizohet si përshkrim i mësimdhënies që planifikohet me

saktësi kohore organizative duke pasur në mendje të kuptuarit, nxitjen e ndryshimit dhe vlerësimin.

Organizuesit paraprak: Përkufizohet si deklaram i koncepteve përfshirëse për të prezantuar dhe përmbledhur materialin mësimor që realizohet në klasë.

Organizuesit grafik: Pajisjet pamore që ndihmojnë për të organizuar idetë, si tabelat shkak-pasojë, tabelat kronologjike, grupimet, diagramet në formë peme, diagramet Ven, tabelat T, tabelat M, për të ndihmuar nxënësit të ndjekin paraqitjen e informacionit dhe shpjegimet në procesin mësimor në klasë.

Orientim për të mësuar: Procesi i përqendruar në mësim për përvetësimin e përmbajtjes mësimore të specifikuara nga mësimdhënësi (leximet e caktuara).

Orientimi drejt qëllimit: Përcaktimi dhe puna drejtë përmbushjes së synimeve të deklaruara që lidhen me arritjet në institucionin arsimor. Ato iu komunikohen të gjitha palëve të përfshira në shkollë.

Orientimi humanist i kurikulimit: Konceptimi i kurikulimit sipas dallimeve individuale ndërmjet fëmijëve/nxënësve në funksion të autonomisë, pavarësisë dhe kreativitetit të çdo fëmije/nxënësi.

Orientimi në karrierë: I referohet një radhë procesësh, për të informuar nxënësit për profesionet, orientimin dhe aftësimin profesional për të përzgjedhur rrugët e jetës individuale në mësim, punë dhe karrierë.

Origami: Lojë me letra të prera në madhësi dhe forma të ndryshme me bashkimin e të cilave krijohet forma e caktuar gjatë ushtrimeve në klasë.

P

Paaftësi mësimore: Problem perceptual, tek nxënësit me aftësi të mira për të kuptuar, por me aftësi të dobëta në gjetjen e fjalëve që ndikojn negativisht në nxënësin si ndërtues aktiv i njohurive të tij gjatë rrjedhës së procesit mësimor në shkollë.

Padurim: Paqëndrueshmëri e individit për të kapërcyer vështirësitë gjatë punës së tij.

Pakujdesia në edukim: Nënkupton kujdesin e pamjaftueshëm, të pavëmendshëm, të paqëndrueshëm të mësimdhënësit ose edukatorit ndaj fëmijës.

Pantonima në edukim: Nënkupton komunikimin me shenja ose lëvizje, në mes të mësimdhënësit dhe nxënësve.

Paradigma (arsimore): Shembull i ri që mund të shërbejë në procesin e arsimimit të nxënësve në shkollë përgjatë një kohe të caktuar.

Paradigmë: Pranim i të gjitha arritjeve shkencore, të cilat përgjatë një kohe të caktuar, që i japin botës së shkencës modelin e shtrimit të problemeve dhe zgjidhjen e tyre.

Paragjykim: Opinion ose qëndrim i gabuar për një individ ose grup që zakonisht është negativ dhe i pabazuar në fakte/dëshmi.

Paralali: Çrregullim në të folur, si pasojë e shqetësimit ose problemit me organet e të folurit, p.sh. gjuhën, qiellzën, dhëmbët.

Parathënia: Pjesa që shpjegon se për kë është shkruar libri dhe arsyetimi sipas autorit të librit.

Parim pedagogjik: Pikënisje, rregull themelor mbi të cilin bazohet e udhëhiqet, ndërtohet e funksionon procesi i zhvillimit dhe të mësuarit të nxënësve.

Parime mësimore: Pikënisje të punës mësimore të planifikimit, drejtimit, organizimit, menagjimit, vlerësimit etj.

Parimi i drejtimit edukativ: Pikënisje e organizimit të punës mësimore, sipas moshës dhe aftësive psiko-fizike të nxënësit dhe organizimit të klasës që zbatohet pavarsisht nga lënda mësimore.

Parimi i konkretizimit: Pikënisje për shpjegimin, sqarimin dhe konkretizimin e pjesëve apo temave mësimore që janë më të rëndësishme, konkretizime mësimore në pika kyçe dhe të rëndësishme për mësimdhënien.

Pasiguri: Humbje e natyrshme ose shformim i strukturës individuale të personalitetit që shfaqet në paraqitje, në të folur, gjestikulacione dhe në mimikë.

Pasojë: Ngjarje që pason një veprim.

Pasqyrim mendor: Tërësi e pasqyrimeve mendore (informacion i perceptuar, i përpunuar mendërisht dhe i ruajtur në kujtesë) që mund të riprodhohet me gojë, me shkrim, në mënyrë grafike ose praktikisht për një pjesë të realitetit objektiv në trajtë faktesh, konceptesh, parimesh, ligjësisht, procesesh dhe procedurash etj.

Pastrimi i të dhënave në kërkim: Pastrimi i të dhënave që si interesojnë hulumtuesit ose që nuk kanë lidhje me kërkimin e tij/saj.

Patenta: Certifikim ligjor i një shpikësi, e drejta ekskluzive e përdorimit për ta shitur apo përdorur shpikjen e tij për një afat ose gjatë gjithë jetës së tij/saj.

Pavetëdiije: Humbja e aftësisë për të përceptuar dhe reaguuar me vetëdiije.

Pedagog: Njohësi i shkencës së pedagogjisë (me diplomë universitare apo pasuniversitare) i cili konsiderohet si këshillëdhënës i aspektit pedagogjik të mësimdhënies në shkollë.

Pedagogji familjare: Disiplinë e pedagogjisë e cila studion edukimin e fëmijës në familje.

Pedagogji mësimdhënëse: I referohet proceseve mësimdhënëse në qasje, aftësi dhe shkathtësi pedagogjike, veprimtari, praktika, vlerësime dhe ndikime ndaj nxënësve (përfshin atë jep mësim, si jepet mësim, dhe atë që përfiton mësim dhe se si mësohet) dhe çështje të tjera që janë me rëndësi për mësimdhënien në shkollë.

Pedagogji parashkollore: Disiplinë e pedagogjisë, e cila studion specifikat e edukimit të fëmijëve të moshës parashkollore (para shkuarjes në shkollë).

Pedagogji speciale: Disiplinë e pedagogjisë, e cila studion specifikat e edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Pedagogjia e kohës së lirë: Disiplinë e pedagogjisë, e cila studion çështjet specifike të arsimit dhe edukimit në kohën e lirë të njeriut.

Pedagogjia e përgjithshme: Shkenca e cila studion çështjet fundamentale-pedagogjike siç janë: lënda kërkimore e pedagogjisë, ligjshmëritë pedagogjike, metodologjinë pedagogjike, detyrat e pedagogjisë, mundësitë dhe kufijtë e edukatës etj.

Pedagogjia futurologjike: Diciplinë e pedagogjisë, e cila trajton çështjet e zhvillimit të edukatës dhe arsimimit në të ardhmen. Merret me projektimin dhe parashikimin në fushën e edukatës dhe arsimit.

Pedagogjia implicite: Pedagogjia e fshehtë e lidhur me personalitetin e edukatorit.

Pedagogjia konviktore: Diciplinë e pedagogjisë që studion specifikat e edukimit të të rinjve me qëndrim në konvikte.

Pedagogjia pedeutologjike: Diciplinë e pedagogjisë e cila studion specifikat e profesionit të mësimdhënsit, zhvillimit ,trajnitimit dhe të përsosjes profesionale të tij.

Pedagogjia shkollore: Disiplinë e pedagogjisë që studion specifikat në edukimin e fëmijëve të moshës shkollore në mësimet e rregullta dhe në aktivitetet e lira të nxënësve në shkollë.

Pedagogjia: Shkencë, e cila studion edukatën, ligjësitë e zhvillimit, formimit, vetëformimit dhe vetedukimit të personalitetit të lirë e të gjithanshëm të njeriut, nga aspekti fizik-shëdetësor, intelektual, moral, estetik, punës, kombëtar,etj.

Përcaktimi: Puna drejtë përmbushjes së një synimi të deklaruar për arritje.

Perceptimi: Pasqyrim në vetëdijen tonë i tërësive të jashtme të sendit ose dukurisë nga përdorimi i organeve shqisore (regjistrat shqisor) për të siguruar një informacion të nevojshëm për të udhëhequr apo kryer një aktivitet.

Perceptimi i nxënësit në të mësuar: Përdorimi i organeve shqisore për të siguruar një informacion të nevojshëm për të kryer një aktivitet mësimor (i referohet perceptimeve për ndikimin në nxitjen në të mësuar përmes praktikave vlerësuese).

Përcjellja sistematike e nxënësit në mësim: Vëzhgimi, kontrollimi i arritjës së nxënësit në mësim, evidenca e nxënësve që vlerëson mësimdhënsi si: detyra, organizime, puna me grupe, puna e pavarur, testi, aktivitete të lira dhe të punës praktike në shkollë.

Përdorimi i kompjuterit nga mësimdhënsi: Nënkupton përdorimin si burim leximi për të mësuar (librat, revistat, për të gjetur dhe siguruar informacione, shembuj, për të shkruar, vizatuar, llogaritur e dizajnuar) për të prezantuar përmbajtjen nëpërmjet përpunimit të tekstit si dhe për të vlerësuar (regjistruar/mbajtur shënime për detyrat, punën e pavarur të nxënësve, etj.).

Përdorimi i materialeve nga kërkuesi: I referohet bibliotekave elektronike/e-librarisë për të prezantuar përmbajtjen, për të gjetur dhe siguruar informacione për kërkime.

Përdorimit i TIK-ut në mësimdhënie: I referohet përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit nga mësimdhënësi për realizimin e mësimdhënies dhe të mësuarit në klasë.

Përforcimi i sjelljës: I referohet faktorëve të motivimit apo arritjës kur mësimdhënësi influencion nxënësin që sjellja e tij të marrë formë ose drejtim nga përforcimi vlerorë në mësimdhënie.

Përforcimi pozitiv në të mësuar: Një shpërblim (veprim) për sjelljen e dëshiruar që ipet menjëherë nga mësimdhënësi, sapo nxënësi të shfaqë sjelljen me qëllim përseritjen (lavdërimet verbale, dhënia e stimujve etj), në mënyrë që ai të bëjë lidhjen e menjëherëshme mes veprimit dhe përforcimit në të mësuar.

Përformanca e nxënësve: Mënyra e paraqitjes së nxënësve me njohuritë qëndrimet dhe aftësit e reja, e të cilat përmes teknikave dhe instrumenteve që përdorin mësimdhënësit vlerësohen dhe bëhet gjykimi numerik (1.2.3.4.5) apo përshkrues me fjalë.

Performancë e mësimdhënësve: Nënkupton tërësinë e punës së mësimdhënësve të demonstruar përmes aktiviteteve efektive gjithëpërfshirëse si: funksionet, detyrat, obligimet, përgjegjësitë e rezultateve të punës si dhe të plotësimit të dokumenteve përkatëse në mësimdhënie.

Përfytyrim: Pasqyrim në vetëdijen tonë i figurave “mendore” të sendeve ose dukurive, të cilat në çastin e caktuar nuk i shohim me sy.

Përgatitja psiko-pedagogjike e mësimdhënësit: Nënkupton zotërimin e njohurive shkencore psiko-pedagogjike të komunikimit, dhe një spektri të gjerë të metodave dhe teknikave psiko-pedagogjike në funksion të mësimdhënies dhe të mësuarit.

Përgatitja paraprake e mësimdhënësve: Nënkupton arsimin universitar dhe pasuniversitar (bachelor dhe master) për mësimdhënie për lëndën e caktuar apo grup lëndësh mësimore.

Përgaditja shkencore e mësimdhënësit: Nënkupton formimin shkencor të mësimdhënësit, përkatësisht ku ai zotëron konceptet kryesore, terminologjin shkencore, është i aftë të shpjegoj dhe të zgjidhë ushtrimet, detyrat për nivelin njohës të nxënësit në klasën e caktuar për mësimdhënie.

Përgënjeshtrimi: Verifikimi i pasaktësisë së njohurisë (me fakte, dëshmi, fotografi, dokumentar, dokumente etj).

Përgjegjësia e përbashkët: Përgjegjësia e prindërve, mësimdhënësve, drejtoreve të shkollave, inspektoreve, anëtareve të bordit të shkollës, dhe vetë nxënësve për dështimet apo përparimet e siguruara për një proces mësimor në shkollë.

Përkrahja e nxënësit: Nënkupton ofrimin e kujdesit në mësim ose gjatë aktiviteteve mësimore përmes punës individuale të mësimdhënësit për nxënësin.

Përkrahja në të mësuar: Nënkupton nxitje për të bërë atë që u kërkohet nxënësve, për të mësuar me material shtesë, demonstrime, udhëzime praktike të mësimdhënësit me nxënësin në nxitjen e interesit të tij në të mësuar .

Përkufizimet specifike: Nënkuptohen përshkrimet për koncepte apo terminologji pedagogjike profesionale që bën mësimdhënësi.

Përkufizimi: Nënkupton përshkrim të një termi ose koncepti duke përmendur elementet kryesore me fjalët e tyre nga mësimdhënësit.

Përkushtimi i nxënësit; Nënkupton përshkrim të vazhdimësisë së interesit dhe dëshirës së nxënësit për të mësuar dhe njohur.

Përhumbje e vëmendjës së nxënësve në shkollë; Nënkupton mungesë vëmendje të nxënësit në shkollë (mësimdhënsit i përshkruajnë si nxënës të hamendur ose ëndërrimtar në mësim).

Përmbajtja e mësimi: Nënkupton pjesën me qenësore të përmbajtjeve në tematiken mësimore e cila trajton konceptin, përgjithësimin, procesin e të mësuarit dhe vlerësimin.

Përmbledhjet e punimeve: Vepra (libra), në të cilat publikohen punime, të shkruara nga disa autorë, të cilët trajtojnë tematika që kanë aktualitetin për kohën e vet dhe si të tilla prezantohen nëpër konferenca dhe simpoziume.

Përmirësim në të mësuar: Nënkupton pjesën e krahasimit me vlerësimin e fundit të nxënësit (përmirësimet në aspektin pozitiv) në njohuri, aftësi të nxënësit dhe sjellje nga vlerësimet paraprake.

Përpjekje në të mësuar: Nënkupton pjesën e angazhimit për të mësuar dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë nga nxënësi.

Përpunimi digjital i imazheve nga nxënësit: Nënkupton pjesën kur nxënësit i përpunojnë fotografitë: t'i presin, t'i rrotullojnë, ti ndryshojnë ngjyrat dhe madhësitë, ti transferojnë, ti ruajnë në një dosje në formatin e dëshiruar.

Përpunimi digjital i tekstit nga nxënësit: Nënkupton pjesën kur nxënësit i përzgjedhin opsionet rregullojnë menaxhojnë, të përdorin dokumente të rëndësishme të shtojnë “header and

footer” në një tekst të shkruar, përdorin ikonën “clip art” për të integruar imazhe sipas fjalëve nëpërmjet ikonës “research word “ paraqesin (të dhënat bazë) nëpërmjet grafikëve, tabelave etj.

Përputhshmëria e përmbajtjes: Niveli sipas të cilit përmbajtja në objektiva, përmbajtja e shpjeguar dhe përmbajtja e vlerësuar realizohen në një kohë si veprime brenda një orë mësimore.

Përqendrim: Qëndrim i diciplinar i vëmendjës mbi proceset që kushtëzohen nga faktorët fiziologjik dhe faktorët psikikë (fokusim me regjistrin shqisor) si një bashkëveprim që mundëson për të pasur përqendrim në të mësuar.

Përsëritja e përpunuar (version i të mësuarit përmendësh): Mënyrë e të mësuarit të një informacioni domethënës që konsiston në përsëritjen e vazhdueshme deri në të mësuarit përmendësh të një njësie të caktuar mësimore.

Përsëritje (të mësuarit përmendësh): Mënyrë e të mësuarit që konsiston në përsëritjen, ripërsëritjen e “diçkaje” të vazhdueshme deri në të mësuarit përmendësh të një njësie të caktuar mësimore me qëllim aktivizimin dhe sforcimin e kujtesës së nxënësve për të kuptuar mësimin e ri.

Përshkrim i praktikës në klasë: Nënkupton i referohet përshkrimit të planifikimit metodave, mënyrave specifike, teknikave dhe gjithë veprimtarin e sjelljës së mësimdhënsit brenda një ore mësimore duke përfshirë edhe problemet e identifikueshme që ndeshen mbrenda orës mësimore dhe që e ç’orientojnë mësimdhënien (të gjitha elementet që mund të vështrihen nga përpunimi i informatave që merren nga shqisat).

Përshkrimi i punës: Nënkupton detyrat e punës përgjegjësitë (funksionet) që kryen një individ në kuadrin e një profesioni të caktuar.

Përshkrimi: Paraqitje e dukurisë ose detyrës në një listë të caktuar të asaj çka dëshirohet të vëzhgohet.

Përshtatja e metodës nga mësimdhënsi: Nënkupton pjesën kur mësimdhënsit do përshtasin metodën që t'i lehtësonin të kuptuarit në prezantimin e asaj që ata u mësojnë nxënësve sipas specifikave të nxënësve ose sipas moshës.

Përshtatje: Nënkupton ndryshimin e kushteve të të mësuarit për të plotësuar nevojat e nxënësve, për më tepër adaptimi i individit në ambientin e ri, ose adaptimi i formës, metodës apo instrumentit të mësimdhënies për nxënësit në kontekstin e caktuar mësimor në klasë apo jashtë objektit shkollorë.

Përshtatja strukturale: Nënkupton pjesën e një procesi të të mësuarit konceptimit të realitetit nga nxënësit duke i përshtatur për përfitimin e një vlere a të një dobie njohëse ose duke e krijuar një strukturë të re me ndryshimet.

Përsonaliteti i mësimdhënësit: Nënkupton disa aspekte si: askciologjik (i cili zbulon kulturën etiko-profesionale të mësimdhënsit si tërësia e vlerave pedagogjike) “teknologjikë” (si subjekt “mjet” për veprimtarinë social-pedagogjike) krijues (si manifestim dhe drejtim i krijimtarisë pedagogjike) dhe përsonal (kultura etiko-profesionale si mënyra specifike e realizimit të brendshëm të individit).

Përsonalizimi i edukimit: Nënkupton pjesën e përputhjes së një mjedisi të veçantë mësimor dhe/ose qasjes mësimore me interesat, aftësitë dhe nevojat e vet individëve.

Përvoja në të mësuar: Nënkupton pjesën e përvetësimit të njohurive të mësuara me problemet që kanë hasur gjatë viteve, reagimet njohëse, emocionale me vlerë ndaj situatave konkrete në të mësuar si një mbështetje për të mësuar mësimet e reja në të ardhmen e tyre.

Përzgjedhje në kërkim: Zgjedhje e një përqindje individësh ose rastesh nga popullsia si përfaqësuese të asaj popullsie në tërësi për pjesëmarrje në hulumtim.

Pesëvargëshi: Një lloj i veçantë i poemës me pesë rreshta, që përdoret në mësimdhënie e cila kërkon sintetizimin e informacionit dhe të materialeve në shprehje, të cilat përshkruajnë apo reflektojnë rreth idesë kryesore të temës (vjershë me pesë rreshta, që e shkruajmë si pesëvargësh).

Pikëllimi: Nënkupton një ndjenjë dhimbje pas vdekjes së një personi në familje ose të njohur për nxënësin/fëmijën.

Pikëpamje kognitive mbi të nxënit: Teori psiko-pedagogjike që e trajton nxënësin si qenie që ka një proces mendor aktiv, që merr, mban mend dhe përdor njohuri.

Pilotim i testit të kërkimit: Paratestim vlerësues për pyetjet në test dhe vlefshmërinë e testit.

PISA: Test ndërkombëtar për vlerësimin e njohurive dhe aftësive të nxënësve parauniversitarë (15-vjeçar që mbahet/realizohet në

mënyrë periodike (çdo tre vjet), e i cili është hartuar, administruar, vlerësuar dhe raportuar nën mbikëqyerjen e (OECD) Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

Pjekuri shkollore: Nënkupton nivelin e zhvillimit të fëmijës, në aspektin fiziko-shëndetsor, intelektual, social, emocional, të paraditurive dhe të zhvillimit të fjalorit, pjekurisë apo gatishmërisë për nisje në shkollë apo për fillimin e shkollimit.

Pjesmarrësit në hulumtim: Nënkupton i referohet subjekteve, të përfshira në hulumtim apo që i nënshtrohen studimit.

Plan ditor: Nënkupton plan i shkruar për një proces mësimor të përditshëm të mësimdhënësit për çdo orë mësimore, ku ai përshkruan mënyrën se si do ta realizoj mësimdhënien në klasë.

Plan (në arsim): Nënkupton një dokument zyrtar të mësimdhënësit të cilit i kërkohet ti përmbahet për ta realizuar me sukses veprimtarine e tijë edukativo-arsimore në klasë.

Planet mësimore: Janë përshkrime të detajuara të një ose disa orëve mësimore që orientojnë mësimdhënien gjatë kësaj periudhe kohore ku përfshihen: objektiva specifike, një përmbledhje e shkurtër e aktiviteteve, veprimtarive, materialet e nevojshme dhe teknikave për të vlerësuar mësimdhënien dhe të mësuarit në klasë/shkollë.

Plani i hapësirave për të mësuar në klasë: Planifikimi i sistemimit fizik të orendive të klasës, sistemimi i nxënësve në grupe apo në forme rrethi, për ndërveprim, për detyra dhe prezentime, të mjeteve mësimore dhe materialeve mësimore në klasë.

Plani i monitorimit të dokumentacionit institucional:

Nënkupton vëzhgimin e plotësimit të dokumentacionit zyrtar (plan lëndor/ modul/ projekt kurrikular, regjistra, libri amzë, dëftesa, çertifikata, numërat serik për inventarin shkollor etj.).

Plani i zhvillimit të shkollës: Nënkupton planin e zhvillimit afatgjatë të shkollës (5-8 vite).

Plani mësimor tabelar: Pasqyrimi tabelar i lëndëve mësimore dhe fondit të orëve mësimore të parapare për secilën lëndë mësimore dhe për secilën klasë që i referohet tërësive mësimore, dhe njësisive, mësimore të vitit shkollor.

Plani në kërkimin në pedagogji: Skica, skema plan i menduar dhe i shkruar, që ndihmon kërkuesin për ndjekjen e hapave gjatë realizimit të kërkimit.

Plani për një orë mësimore (plankonspekti): Përgatitja e mësimdhënsit për çdo orë mësimore në të cilën shkruhen metodat, aktivitetet, veprimtaritë, demonstrimet e duhura me nxënësit si dhe teknikat e përdorura përkatëse të vlerësimit sipas programit të mësimdhënies në klasë.

Plani strategjik i arsimit: Dokumenti që “prezanton” synimin e dëshiruar që shkruhet si rezultat i planifikimit afatgjatë dhe që bazohet në prioritetet zhvillimore të vendit.

Planifikimi: Nënkupton përshkrimin e strategjisë së analizimit, përcaktimit, specifikimit dhe parashikimit të qasjes që zgjedhim për arritjen e një qëllimi.

Planifikim i arsimit: Përcaktim i misionit dhe vizionit për zhvillimin e arsimit të një vendi në raport me kërkesat ekonomike dhe sociale të atij vendi.

Planifikim i mësimdhënies: Nënkupton përcaktimin e synimeve dhe specifikimin e të gjithë veprimtarive në mësimdhënie, përkatësisht në një orë mësimore nga mësimdhënsi si dokument i shkruar (plankonspekt) ose jo.

Planifikimi i kërkimit: Nënkupton ide fillestar të shkruar të kërkimit që e përcakton qëllimin, e orienton përzgjedhjen e qasjes dhe metodën e kërkimit.

Planifikimi i mësimdhënësit për një orë mësimore: Procesi i parashikimeve të një njsije mësimore dhe pritëshmërive të mësimdhënësit si: shkathtësive dhe aftësive të shpjegimit argumentimit, debatit, të pyeturit, detyrave dhe diturive të nevojshme, të nxënësve si dhe reflektimit të vlerësimit të të mësuarit.

Planifikimi i njësive tematike në klasë; Procesi i parashikimeve të përmbajtjes së veprimtarive dhe metodave didaktike për integrimin e dy temave në një temë, përmes bashkëbisedimit me nxënësit dhe mënyrës së vlerësimit në ndërtimin dhe kuptimin e informacionit.

Planifikimi kohor: Paraqitje e shkruar e dinamikës së kërkimit që mbulon një periudhë disamujore, që përbëhet nga punë, veprime praktike dhe teorike, të cilat duhet të kryhen nga kërkuesi.

Plotënia e njohurive: Nënkupton vlerësimin maksimal të përgjigjeve nga pyetjet me gojë dhe me shkrim nga nxënësi

(plotënia e njohurive në qartësi dhe në të kuptuar të të mësuarit në nivelin e dukshëm të zotërimit).

Popullata e studimit në kërkim: Grup komplet, në një hulumtim karakteristikat e të cilit do të përcaktohen përmes kampionit.

Popullata në kërkim: Numri total teorik i elementëve specifike, që përcaktohet për një studim të konkretizuar në kohë dhe hapësirë.

Portofoli (dosja): Përzgjedhja e punimeve individuale të nxënësit modele të cilat dëshmojnë përparimin e tyre. Portofoli përdoret si një mjet vrojtimi për të treguar përparimin nga vetë nxënësi, por edhe nga mësuesi.

Postformal: Nënkupton të menduar për gjetjen e lidhjeve që në dukje janë të ndryshme, vendosja e lidhjeve midis logjikës dhe ndjenjave, që shkojnë përtej nocioneve të thjeshtëzuara të shkakut dhe pasojës.

Pragmatizëm: Rrymë filozofike dhe edukative, që ka për qëllim përgatitjen e fëmijëve për të tashmen, përkatësisht për atë që është e rëndësishme për ta në këtë kohë, dhe që është praktike në jetë.

Praksis pedagogjik: Nënkupton njohurit vetijake, njohja e vetëvetes, njohja e vlerës ajo që ne zotërojm (ndonse mund të mos jemi të vetëdijshëm për këtë) të menduarit tonë mbi bazën e përvojës dhe përdorimin e këtyre njohurive në mësuesi.

Praksis-in biografik: Përshkruan njohurit praktike vetijake të jetës së mësuesit në një kohë dhe vendë ku kanë jetuar dhe zhvilluar mësuesin.

Praktika e udhëzuar në mësimdhënie: Praktikë gjatë procesit të mësimdhënies, që u krijon nxënësve mundësi që të vënë në praktikë aftësitë e tyre shqyrtuese dhe komunikuese, ndërkohë që vëzhgojnë nga afër kryerjen e detyrave dhe i korrigjojnë ato.

Praktika refleksive: Nënkupton praktika mendore, gjykuese, vlerësuese nga aspekti i nxënësit pas mbarimit të praktikës (në laborator apo vend punishte).

Praktikat mësimore në mësimdhënie: Nënkupton term që i referohet (dekleratave nga mentori për të mësuarit joformal) përvojës së mësimdhënsit gjatë praktikës në klasë (të identifikuar) përkatësisht njohuri akademike të lëndës (ve) që duhen përvetësuar, aftësi mësimdhënëse dhe mbështetjen për mësuarit e mësimdhënësve ndaj procesit dhe problemeve komplekse në mësimdhënie dhe vlerësim.

Praktikë mësimore e gjerë, e strukturuar: Praktika e të mësuarit me mundësi përmirësimi të ndryshme për t'iu përgjigjur zhvillimit.

Prapambetja mendore në fëmijërinë e hershme: Nënkupton ndërthurje të shkaqeve të ndryshme që veprojnë mbi sistemin nervor të fëmijës në periudha të hershme të jetës, përfshirë këtu faktorët gjenetikë, të trashëgimisë, keqtrajtimet, neglizhimet apo mungesa e mbështetjes dhe nxitjeve social-edukative.

Preciziteti: Përcaktimi i saktë në të gjitha fazat e punës shkencore kërkimore, që d.m.th. me precizitet të citohen dhe të shfrytëzohen burimet e të tjerëve.

Preferenca në të mësuar: I referohet të mësuarit sipas karakteristikave vetiake, stileve të të mësuarit të individualizuar të fëmijëve/nxënësve.

Preferencat për aktivitete mësimore të mësimdhënësve: I referohet aktiviteteve mësimore të preferuara nga mësimdhënësi për sa i përket aplikimit në mësimdhënie.

Premisat: Mendimet apo qëndrimet, nga të cilat nxirret përfundimi (mendimi - qëndrimi i ri).

Prezantimi digjital PowerPoint në mësimdhënie: Nënkupton prezantimin e fjalës, figurave fotove në formate të ndryshme ose përmasa specifike dhe shfaqjen e tyre me anën e projektorit si prezantime në mësimdhënie.

Prezantimi digjital: Nënkupton prezantimin e fjalës, fakteve nocioneve figurave fotove përmes mjeteve digjitale gjatë zhvillimit të orës mësimore ku synohet arritja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që i duhen nxënësit për gjatë gjithë jetës nga mësimdhënsi.

Prezantimi dramatik: Nënkupton i referohet mësimdhënjes ku përfshihet, loja me role, një parodi apo skeç, një video e krijuar vetë, apo një program multimedial ku mësimdhënësi përmes një prove imituese kërkon të krijoj shprehje të ngjashme me ato që kërkohen në situata reale, si kërkesa që rrjedhin nga programi i edukimit.

Prezanton detyrat: Nënkupton detyrat/ kërkesat e mësimdhënësve ndaj nxënësve si kërkesa për prezantime/

paraqitje në klasë që duhen arrirë nga ana e tyre në klasë sipas kërkesës së planprogramit mësimor.

Prezentizmi pedagogjik: Nënkupton qëndrim pozitiv dhe jokritik ndaj çdo gjëje të tanishme, prirja për ti shpjeguar ngjarjet e së kaluarës sipas këndvështrimit të vlerave dhe koncepteve të kohërave të sotme.

Prindërimi: Nënkupton të dy prindërit biologjike të fëmijës/nxënësit, mënyrës së të sjelljes të tyre ndaj fëmijës/nxënësit (racional, emocional) përkujdesjes dhe diciplinimit, rregullave dhe normave që vendosin (autoritar, neglizhues, privilegjues, refuzues, tolerues) me ndikim në mirëqenien dhe edukimin e fëmijës.

Prirja: I referohet “dellit “inciatives së nxënësit për të vizatuar, kënduar organizuar lojra, koduar si dhe veprimtari të ndryshme si funksion mendor apo psiko-fizik i fëmijës/nxënësit.

Prirje për mësimdhënie (mësues i vërtet): I referohet atij/asaj që ndihmon fëmijët/nxënësit se si mësohet në situata të vërteta mësimore dhe që kanë ndikim në atë që arrihet nga fëmijët/nxënësit në jetë, përtej arsimit formal.

Pritshmërit në mësimdhënie: Besimet lidhur me atë çfarë ju mendoni se mund të ndodhë ose do të ndodhë në të ardhmen, me atë çfarë do të mësojnë ose nuk do të mësojnë nxënësit. Pritshmëritë janë qëllime që synohen nga mësimdhënësi.

Problem: Situatë, në të cilën njeriu përpiket të arrijë një qëllim dhe duhet të gjejë një mjet për ta zgjidhur atë.

Probleme me kërkesa kognitive:Nënkupton i referohet kërkesave që lidhen me “thellësinë e dijeve“, të lidhura me procesin mendor ku i kërkohet nxënësit që të gjëjë zgjidhje me sukses pas një analizë komplekse të të dhënave që i paraqiten, të sintetizojë ose vlerësojë të dhënat, justifikojë pretendimet dhe arsyetimet, në mënyrë që të mund të zhvillojë një plan i cili do ta ndihmojë që të zgjidhë problemin e shtruar kognitiv.

Probleme psikosomatike në të mësuar: Nënkupton probleme gjatë të cilave një shqetësim fizik shkaktohet apo theksohet nga faktorët emocional të nxënësit.

Problemet familjare, të shëndetit dhe financat: Nënkupton tre faktorë të jashtëm që ndikojnë negativisht në performancën e nxënësve në të mësuar.

Procedura pedagogjike: Përshkrimi i një serie veprimesh të planifikuara që bëjnë mësimdhënësit dhe nxënësit për të mundësuar përmbushjen e një detyre profesionale nga mësimdhënësit dhe aktivitetin e nxënësve gjatë të mësuarit.

Procedurat e zgjedhjes së konflikteve në klasë: Nënkupton sygjerime ose shpjegime të përzgjedhura më shumë kujdes të lidhura me ndodhit e konflikteve në mes nxënësve në klasë si praktika të përditëshme në klasë.

Procedurat e mësimdhënies në klasë: Nënkupton veprimtari efektive zbatuese dhe praktike në klasë nga mësimdhënësi (fillestar apo edhe atyre me përvojë) për një sërë aspektesh të ndryshme nga planifikimi deri te zbatimet/aplikimet praktike në klasë.

Proces i bashkëndërtuar: Proces në të cilin dy njerëz ideojnë, negociojnë dhe ndërveprojnë për të krijuar dhe ndërtuar bashkë një produkt përfundimtar si shkrim, formulim, synim etj.

Proces i të mësuarit në shkollë: I referohet kohës së përfshirjës aktive të nxënësve nën udhëheqjen e mësimit në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore në shkollë.

Proceset njohëse: Nënkuptohen mënyrat e ndryshme përmes të cilave njerëzit njohin, kuptojnë, zbatojnë dhe në përgjithësi “mendojnë” për përvojat e tyre.

Procesi i mësimit: I referohet procesit të mësimit nga planifikimi, ofrimi i njohurive, përcaktimi i strategjive, metodave dhe teknikave mësimore, përdorimi i burimeve dhe procesit të vlerësimit të nxënësve.

Procesi i mësimit në klasë: Përshkrimi i mënyrës se si funksionojnë si qasje e personalizuar (mendojnë, përjetojnë, zbulojnë, adaptojnë dhe reflektojnë) për mësimit dhe të mësuarit në klasë deri te vetëvlerësimi i mësimit.

Procesi i të mësuarit: Nënkupton mësimi që ndodh gjatë procesit të ndryshimit, përvetësimit të njohurive aftësive qendrike dhe zakoneve për qëllime personale ose sociale, që sjell ndryshimin te individit dhe i cili e bën atë më të aftë si një refleksim në sjellje si rezultat i procesit të të mësuarit.

Procesi komunikues në mësimit: Nënkupton komponentën e tij shprehëse (kuptimin e asaj që tanimë ekziston) dhe komponentën ndikuese (realizimin a asaj që s’ekziston akoma) në mënyrë që procesi komunikues të shërbejë arrijtes së qëllimit, pra

komunikimi me nxënësin i përmban të dy komponentat (a) Procesi për të kuptuar atë që po shpjegohet dhe mësohet përmes përfshirjes në veprimtari kuptimplota (përfshirë komunikimin me të tjerët) dhe (b) njohurive për krijimin e personalitetit.

Profesionist i mësimdhënies: Profesor (jo vetëm titull) njohuritë e tij mbi procesin e mësimdhënies të organizuara mirë një kompleks kompetencash (njohurish, shkathtësish, shprehish, qëndrimesh dhe vlerash), për punë të kualifikuar në një institucion arsimit ose gjatë veprimtarisë mësimore dhe i cili përsoset nëpërmjet përvojës së efektshme që ka shëtuar zgjidhje për problemet të mësimdhënies në klasë.

Programe kompjuterike grafike: Nëkuptohen programe kompjuterike të cilat bëjnë të mundur që përveq ushtrimeve nxënësit të përjetojnë botën nëpërmjet krijimit, imazheve, pikturave, teksteve dhe materialeve zanore.

Programi individual i edukimit, PIE: I referohet një plani, materiali dhe testeve (sistemimi) që përdoret nga mësimdhënësit për fëmijët e talentuar, me dhunti dhe gjenialitet (kujtesës, arsytimit si dhe të përceptimit vizual) si dhe për nxënësit me nevoja të veçanta (në të dëgjuar, në të folur, të leximit, etj).

Programi mësimor: Një dokumenti pedagogjik që përmban përmbajtja e lëndës mësimore, mënyra si realizohet ajo ku përcaktohen qëllimet dhe detyrat mësimore, vëllimi i njohurive, i aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që duhet të përvetësojë nxënësi gjatë një viti mësimor; anët teorike dhe praktike dhe çdo gjë tjetër që ka të bëjë me arritjen e pikësnyimeve të lëndës si: listën e temave dhe të nëntemave të lëndës, kohëzgjatjet për çdo temë,

rekomandime për vlerësimin e nxënësve, orët dhe fondin e orëve mësimore, etj.

Programimi në mësimdhënie: I referohet aftësive të mësimdhënësit të aplikojë, modifikime programi, aplikime programi, software, pajisje, të kuptojë parimet e programimit, të kuptojë çfarë është një program në mësimdhënie, etj.

Projekt i kërkimit: Tërësi funksionale organizative-operative, e hulumtuesit e cila parasheh procedurën e realizimit të procesit të hulumtimit, nga ideja fillestare deri te formimi i njohurisë shkencore dhe zbatimi i saj eventual në praktikë.

Projekt pedagogjik: Nënkuptohehet projekti i shkruar që u jep përgjigje pyetjeve: pse?, kush?, çfarë?, kur?, si? dhe në çfarë? rrethanash? si dhe çfarë efektesh priten pasi të realizohet ai.

Projekti akcional: Nënkuptohen projekti i shkruar me kohëzgjatje më të gjatë, në funksion të ndërrimit pozitiv të praktikës dhe veprimtarive të ndryshme për të ardhmën, në funksion të edukimit efektiv.

Projektimi pedagogjik; Projekti i shkruar iniciativa qeveritare ose e njohësve të pedagogjisë së një vendi për të ndryshuar qasjen në arsim nëpërmjet projektimit në funksion të edukimit efektiv për të ardhmen.

Provimet: Testimi i njohurive që organizohen, realizohen për të rriturit, që vijojnë programet e arsimit, ose që kërkojnë certifikim formal, të cilat janë në pajtim me kërkesat standarde ekzistuese të lëndës ose lëmis profesionale.

Psikologji edukimi: Disiplinë shkencore, e cila merret me studimin e aspektit psikologjik të edukimit.

Puna e pavarur në klasë: Puna që kryejnë nxënësit në mënyrë të pavarur, pa ndikimin e mësimitdhënësit.

Puna ekipore: Puna që kryejnë dy ose me tepër subjekte (fëmijë/nxënës apo dy ose me tepër të rritur) që punojnë për një qëllim të caktuar.

Puna me modele: Nënkupton një projekt “të mësuarit me bazë problemin “për përvetësim e njohurve, shkathësive e shprehive dhe vlerave e qëndrimeve të reja nga zgjidhja e problemit.

Puna profesionale shkencore: Nënkupton një interpretim të veçantë të zbulimeve shkencore ose modelim nga vlerat shkencore, (profesionalisht e vijimisht e implementuar, ka attribute të përbashkëta me punën shkencore) për t’i zbatuar rezultatet në praktikë nëpër fushë veprimtarive të caktuara dhe me një diapazon të caktuar kërkimor.

Puna shkencore: Nënkupton karakterizohet me faktin se duhet të përmbajë diçka të re, origjinale, autentike, të zbuluar nga kërkimet e nevojshme, me angazhime procesore dhe me organizime të denja dhe shumë serioze të një hulumtuesi.

Punë në grupe e mësimitdhënies: Nënkupton organizimin e mësimitdhënies mbi bazën e grupit, ku nxënësit brenda grupit ndërveprojnë në mes vete për të realizuar qëllimin brenda orës mësimore.

Punë profesionale në mësimdhënie: Nënkupton është sinonim për një detyrë të veçantë gjatë procesit të mësimdhënies (p.sh. hartimin e një pyetsori, hartimin e një testi njohurish, aftësish etj.).

Punim i diplomës: Vepër profesionale e pavarur, që trajton një temë të caktuar, me të cilën dëshmohet aftësia e një niveli më të lartë studimor, apo si kurorëzim i studimeve.

Punim seminari: Përpunim i një teme në mënyrë të pavarur, me të cilën studenti i fillon përvojat e para të punës kërkimore.

Punime shkencore (kërkime pedagogjike): Studime me qëllime shkencore, që shtrojnë a zgjidhin çështje të reja shkencore, që zgjerojnë çështjet e mëparshme ose që i trajtojnë ato në mënyrë të re, nga aspekte të tjera, sipas kërkesave të metodologjisë shkencore, me aparaturë të verifikuar shkencore, me gjuhë dhe stil shkencor, me analiza, kritika, dëshmi e polemika nga burimet dhe autorët vendor dhe ndërkombëtar, me të dhëna të shumëta, referime për burimet e shfrytëzuara, me fusnota e bibliografi.

Pyetja: Formulim me gojë ose me shkrimi i një thënie që nxit të menduarit dhe kërkon përgjigje.

Pyetja në mësimdhënie: Pikënisje për njohje në drejtimin mësimor, pyetja që bën mësimdhënësi si orientim mendor për të parë çfarë dhe sa di nxënësi (të kuptuarit e nxënësve për nivelin dhe cilësinë e përgjigjës) duke respektuar kufijtë kohorë të reagimit të mundshëm të nxënësit që do të përgjigjet.

Pyetje specifike për nxënësin: Pyetje që bën mësimdhënësi dhe i drejtohet specifikisht vetëm një nxënësi.

Pyetje të nivelit të lartë për nxënësin: Pyetjet që bën mësimdhënsi dhe ju drejtohet nxënësve për të nxitur të menduarit dhe imagjinatën për dhënien e ideve kreative, në trajtimin e një teme mësimore.

Pyetje të nivelit të ulët për nxënësin: Pyetjet që ju drejtohen nxënësve për të nxitur një përgjigje për mbamendjen e informacioneve nga tema dhe në trajtimin e një teme mësimore.

Pyetjet që synojnë tërheqjen e vëmendjes: Pyetja që bën mësimdhënësi për të tërhequr vëmendjen e nxënësve apo për të paralajmëruar diçka.

Pyetjet divergjente: Pyetjet që bën mësimdhënësi që nuk kërkojnë vetëm një përgjigje të saktë nga përgjigjdhënësi.

Pyetjet e tërthorta: Kur kërkuesi i bën dy ose tri pyetje për të marrë një përgjigje që me një pyetje nuk do të mund ta merrte.

Pyetjet për(situatën): Pyetjet të organizuara në grup të bazuara në fragmentin e shkëputur nga situata të jetës së përditshme të nxënësit.

Pyetjet konvergjente: Pyetjet që bën mësimdhënësi dhe që kërkojnë vetëm një përgjigje të saktë nga përgjigjdhënësi.

Pyetjet për ngritur apo ndërtuar hipoteza: Pyetjet që bën mësimdhënësi për të nxitur mendimin kritik e krijues gjykime dhe vlerësime që qëllim kanë të nxisin hamendësime hipotetike.

Pyetjet përqendruese: Pyetjet që bën mësimdhënsi që bëjnë lidhjen midis asaj që nxënësi di që më përpara dhe asaj që do të mësojë gjatë procesit mësimor në klasë.

Pyetjet qe synojnë kontrollin e kujtesës: Pyetjet që bën mësimdhënësi ndaj nxënësve për grupime të dhënash, klasifikime, krahasime, analiza, sinteza, interpretime dhe vlerësime (të hapura, divergjente dhe të mbyllura, konvergjente).

Q

Qartësia në mësimdhënie: Nënkupton sjellje komplekse të mësimdhënësit në aspektin kognitiv dhe të paraqitjes verbale ose me shkrim gjatë të shpjeguarit të përmbajtjeve mësimore për nxënësit në klasë.

Qasja didaktiko-metodike: Nënkupton planifikimin organizimin (procedurat dhe veprimtarin) si dhe artikulimin e punës edukativo-arsimore dhe mësimore në shkollë.

Qasja e mësimdhënies: Nënkupton qasjen e përzgjedhur se si do ta parqes para nxënësve përmbajtjen, si përdor variacione të ndryshme specifike si dhe teknikat e vlerësimit të nxënësve.

Qasjet sasiore për përpunimin e të dhënave në kërkim: I referohen të dhënave në të cilat mbështetemi te mënyra se si bëhet studimi, që janë të prezantuara në trajtën e statistikave për tu përmbledhur, krahasuar dhe përgjithësuar, të shoqëruara me hipoteza që rrjedhin nga teoria/për të vlerësuar hipotezat e një fenomeni të caktuar shoqëror në mënyrë që të kontrollojë statistikisht ndikimin e tyre, ose rezultatin e ndryshueshëm ose jo.

Qëllim: Nënkupton objektiv që një individ përpiqët të arrijë ose ia vë vetës se do të arrijë apo se çfarë do të bëjë për të arritur atë në jetë.

Qëllimet afatgjata: Nënkuptohen janë objektiva të largëta në kohë që në mënyrë efikase të mobilizojnë përpjekjen apo të drejtojnë atë që duhet të bëjë nxënësi për të arritur qëllimin afatgjatë.

Qëllimet afatshkurtëra: Nënkuptohen objektiva, një drejtim për performancë më të mirë për të marrë rezultate afatshkurtëra (janë hapa të njëpasnjëshëm për të arritur tek qëllimi final) dhe arritja e tyre motivon për qëllim final.

Qëllimet arsimore: Synimet e përgjithshme, afatgjata, që duam të arrijmë në të ardhmen, diçka drejt së cilës duhet të ecim për ta arritur. Qëllimet arsimore lidhen me procesin e përgjithshëm të edukimit. Ato përcaktohen për veprimtarinë tërësore të shkollës, për planet dhe programet mësimore.

Qëllimet e mësimdhënies: Formulime të përgjithshme, të mësimdhënies, por që janë të pamatshme, të deklaruara ose të nënkuptuara për natyrën e një mësimdhënie më të mirë, e cila siguron më pas rezultate më të mira të të mësuarit të nxënësve.

Qëllimet edukative: Nënkuptohen përcaktohen “si diçka që një person kërkon të arrij” në mënyrë të ndërgjegjëshme, që synon të arrijë, arritja e e të cilave varet nga faktorë të brendëshëm ose të jashtëm që ndikojnë mbi personat.

Qëllimi i edukimit: Nënkupton përkthim me arsyetim në mënyrë kritike, shpjeguese, etike me një limit kohor për arritje të përmbushjes së potencialit të fëmijës/nxënësit, nëpërmjet realizimit të një programi mësimor, jo detyrim i pakuptimtë shoqëror.

Qëllimi i përformancës: Nënkupton synim vetijak për t,u dukur i zoti (nota dhe vlerësime të mira në teste) ose që përformon mirë në sytë e të tjerëve (të dukurit i pëlqyeshëm) në gjykimin e mësimeve.

Qëllimi i zotërimit: Synimi vetijak për të përmirsuar aftësitë dhe për të mësuar për jetën personale dhe për jetën si synim profesional.

Qendrat e përkujdesjes dhe qëndrimit ditor: Janë institucione të përkujdesjes (jo gjithnjë profesionale) ku fëmijët/nxënësit qëndrojnë para ose pas shkollës sidomos në sistemet arsimore ku fëmijët/nxënësit vetëm gjysmën e ditës e kalojnë në shkollë.

Qëndrim: Vlerësim i përgjithshëm për njerëzit, objektet ose dukuritë.

Qëndrimet në edukim: Vlerësime të përgjithshme që shprehin reagim e kundër reagim ndaj sjelljeve të individëve në situata të ndryshme (jetësore) si: përkujdesja ndaj të tjerëve, durimi, qetësia, respekti, komunikimi, etj.

Qëndrimet ndaj mësimeve: Vlerësime të përgjithshme për të mësuarit nga nxënësit/fëmijët si: gatishmëria, durimi dhe motivimi për të mësuar.

R

Rang në kërkime: Nënkupton diferencën në mes të vlerës më të madhe dhe vlerës më të vogël në vargun e të dhënave në hulumtim.

Raporti i kërkimit: Nënkupton paraqitjen me shkrim të rezultateve të hulumtuara në të cilën definohen informatat e caktuara, një dokument i shkruar, që komunikon fakte të rëndësishme për t'u përdorur në të ardhmen dhe jo thjeshtë për t'u arkivuar.

Rast studimi: Nënkupton një “raport i publikuar për një person, grup apo situatë” e cila ka qenë e studiuar gjatë kohës. Në çoftë se studimi është bërë për një grup, ai shpjegon sjelljen e grupit si një i tërë, dhe jo sjelljen e secilit individ në atë grup.

Rast studimor: Studim i gjithanshëm i një personi ose situatë të caktuar si rast studimi.

Rastësor: Lotarik, pa zbatuar ndonjë rregull ose model të paracaktuar.

Reagim: Sjellje e individit ndaj mjedisit ose situatave mjedisore si rrjedhojë e ngacmimit.

Reagimi i mësimdhënsit: Nënkupton qëndrimin pozitiv ose negativ të mësimdhënësit nëpërmjet, vërejtjeve në motivimin e nxënësve për arsye të identifikojë, të përmirësoj apo ta këshillojë në mënyrë konstruktive në lidhje me ndonjë dobësi të nxënësit, si udhëzime se si mund të përmirësohet duke ruajtur etiken profesionale të nxënësit.

Realitet: Botë e pavarur nga njohja.

Recension: Mendim profesional dhe metodologjik i një shkencëtari për punën (shkrimin, punimin) e një shkencëtari tjetër. Sipas rregullit, recensionin shkruhet para se të botohet punimi.

Receptorët: Nënkuptohen ndjesorët auditiv-vizuel, kinestetik dhe të shijës.

Referat: Kumtesë që zakonisht paraqitet në sesione shkencore profesionale, si opinione të autorit për probleme të ndryshme, pa u marrë me çështje konkrete ose pa qenë rezultat i kërkimeve. Mund të jepet me shkrim ose të lexohët si kumtesë gojore.

Referencat dhe citimete APA-s: I referohet një stili të veçantë të perdorimit të referencave dhe bibliografise (American Psychological Association) ku saktësohet burimi referencial aty për aty: p.sh. Jones (1998) ka argumentuar se ... ka thënë se..... që shënohet në tekst.

Refleks: Përgjigje automatike ndaj ndikimeve të jashtme, shpeshherë e pavullnetshme e njeriut.

Reflektimi: Nënkuptohet procesi mendor vetë analitik i strukturimit dhe ristrukturimit të një përvoje, problemi ose njohurie ekzistuese.

Reflektimi i mësimdhënësit: Nënkuptohen përqendrimi i reflektimit vetanalitik të mësimdhënësit bazuar në dëshmi apo si rezultat i përvojës së arritur përmes praktikimit.

Reflektimi i punës nga mësimdhënësi: Procesi i analizës kritike që përfshin si elementin njohës edhe atë afektiv. Procesi i reflektimit ndaj mësimdhënies përfshin: të menduarit kritik, vetëdrejtimin, zgjidhjen e problemit, të menduarit krijues etj.

Reflektimi autobiografik i mësimdhënësit: Nënkupton reflektimin e kuptimit të drejtëpërdrejt të përvojave të

mësimdhënies profesionale autobiografike të shkruar apo për një aspekt të caktuar mësimdhënie (p.sh. online).

Reflektimi pas një ore mësimore nga mësimdhënsi: Nënkupton kur mësimdhënsi reflekton për përmbajtjen mësimore (rëndësin dhe përshmtshmerin) sa mirë është aplikuar mësimdhënia (korniza teorike dhe modeli) diskutimi (çfarë shkoi mirë dhe si mund të përmirsohet) versioni zhvillimor (për të arritur avantazhe) si dhe në fund versioni rindërtues duke reflektuar praktikën në klasë.

Reflektivët: Prirja për t'i menduar gjërat që bëjnë, për të qenë të matur dhe të kujdesshëm kur përgjigjen.

Reflektues: I referohet mësimdhënësit që mendonë në retrospektivë mbi situatat mësimore në klasësi reflektim për të analizuar se çfarë kanë bërë, si dhe për të parë mundësinë e përmirësimit të procesit të të mësuarit të nxënësve në klasë.

Reformimi në arsim: Procesi i ndryshimit për të mirë i sistemit arsimor mbi bazën e hulumtimeve në praktik. Ai ka të bëjë si me vlerësimin e nivelit në arsim po ashtu edhe me direktivat dhe instrumentet që duhet përdorur për ndryshim.

Regjistri digjital në kërkim: Instrument kërkimor (google formë) i mbledhjes së të dhënave në lidhje me arsimimin e mësimdhënësve, trajnimet, aftësit digjitale (kompetencat digjitale).

Regjistrimi audio/video: Një metodë e sigurimit të informacionit gjatë procesit të vlerësimit që mund të “kapë” çdo detaj të asaj që thuhet. Madje në regjistrimin video, mund të “kapen“ edhe ato që nuk thuhet, pra nëntekstet, reagimet refleksive, gjestikulacionet, komunikimi simbolik, etj.

Rëndësia e përzgjedhjes së metodave: Nënkuptonë mjeshterin dhe mënyrën me të cilën mësimdhënësit do të përzgjedh dhe ti përdor metodat për t'i angazhuar dhe mbajtur interesimin e nxënësve gjatë punës mësimore në mësimdhëniës efektive.

Rendimenti: Shkalla e suksesit, rezultati në kryerjen e një detyre, në përputhje me pritjet.

Respekti ndërmjet nxënësve: Marrëdhënie pozitive, regulla të pashkruara në klasë që karakterizohen me respekt reciprok dhe disa sjellje ndaluese, sjellje të pahijshme nga vetë nxënësit.

Reflektimi profesional: Vetëkorrigjimi i ndërgjegjshëm profesional ndaj dështimit ose shqyrtimit, nxjerrjes së kuptimit të drejtëpërdrejtë të përvojave personale për një situatë të caktuar mësimore, nga përvoja e mirë apo jo e mirë profesionale.

Revista pedagogjike: Revistë profesionale, e cila boton artikuj shkencorë të fushës së pedagogjisë.

Rezultatet e të demonstruarit: Përmbajtjet mësimore që nxënësit duhet t'i demonstrojnë përkatësisht bashkësia e integruar e njohurive dhe e aftësive që nxënësit duhet t'i demonstrojnë në përfundimin e nivelit arsimor apo formimit të tyre të përgjithshëm.

Rezultatet e pritshme të të mësuarit: Kompetencat që duhet të përvetësohen gjatë procesit mësimor nga nxënësit në një nivel shkollor.

Rezultatet e të mësuarit: Nënkuptohen formulime, (si përshkrime të gjëra) të kompetencave të nxënësve që reflektojnë

të mësuarit e nxënësve dhe që kanë një rëndësi përtej shkollës dhe përqendrohen tek produkti përfundimtar i mësimdhënies.

Rezultatet mësimore: Mënyra e paraqitjes së rezultateve, të përzgjedhura, të zhvilluara, bashkëpunimi dhe përmbledhja e arritjeve në fund të orës mësimore.

Riedukim: Edukim i sërishëm, me qëllim të rivendosjes së sjelljes normale të individit, sidomos në aspektin e socializimit dhe përmirësimit e sjelljes asociale në institucione risocializuese.

Rikonstruksion: Riprodhimi i informacionit, duke përdorur kujtimet, pritjet, logjikën dhe njohuritë ekzistuese.

Rishikim me rigrupim: Një teknikë e të mësuarit në bashkëpunim, e cila kërkon lëvizje në klasë gjatë realizimit të kësaj teknike nxënësit kanë mundësi që të analizojnë mendime, ide dhe fakte të ndryshme, duke sofistikuar të menduarit e tyre.

RR

Rregullat e nxënësve: Rregullat që zbatohen, në klasë në mënyrë konseguente në përvijimin e mjedisit të sigurt dhe të cilat pakësojnë mundësitë për sjellje të pahijshme në mënyrë që nxënësit të jenë të prirur për ti respektuar ato, për sjellje të hijshme që zbatohen dhe kanë efekt pozitiv për një mjedisit të sigurt dhe miqësor në klasë.

Rregullat e sjelljes në klasë: Rregullat e shkruara udhëzimet procedurat që specifikojnë veprime të pritshme dhe të ndaluara (që

lejohen dhe nuk lejohen ne klasë) që shkruhen, afishohen e vendosen në murin e klasës për lexim.

Rregullat vepruese të sjelljes në klasë: Veprimet e të sjellurit të nxënësve për të ruajtur rendin dhe qetësin në klasë, jo thjesht një bindje ndaj autoritetit të mësimdhënësit por një marrveshje dypaleshe e nënkuptuar.

Rrethanat e kërkimit: Përfshijnë situatat, kontekstin, faktorët dhe kushtet në të cilat është kryer kërkimi.

Rrethi shoqëror: Nënkupton mjedisin mikro dhe makrosocial, në të cilin zhvillohet individi (familja, institucioni parashkollore dhe shkollor, institucionet kulturor, mediet, lagjësja, rregullimi shtetëror dhe shoqëror në një vend të caktuar e të cilat bashkërisht kan ndikim pozitiv në fëmijën/nxënësin.

Rrjeti i diskutimit: Një teknikë e mësimdhënies, gjatë së cilës bëhet organizimi grafik i informacionit që mund të “orkestrohet” një mësim i ndërlikuar për të kuptuar përmbajtjen dhe idenë kryesore të tij.

Ruaje fjalën e fundit për mua: Një aktivitet, i cili synon të nxisë të nxënësit (komente, ndjenja dhe qëndrime) të mendojnë gjatë leximit, të mbajnë shënime për ose kundër një citati, një thënie, një rrjedhimi apo një produkti.

Rubrikë vlersimi: Mjet vlerësimi për të gjykuar/vlerësuar nivelin e të mësuarit të nxënësit nga një grup kriteresh, një shkallë vlerësimi për secilin kriter dhe një përshkrim verbal të secilës pikë në shkallën e vlerësimit, që përfshijnë mënyrën dalluese se si ndryshon secila pikë prej pikës tjetër.

S

Sekuencë: Një rend i veçantë në të cilin ngjarjet, lëvizjet ose gjërat e lidhura pasojnë njëra-tjetrën.

Sekuencë e të mësuarit të personalizuar: Nënkuptohen studime vëzhguese në klasë, një anizotë të të mësuarit për një sekunco aktiviteti në mësimin e personalizuar të nxënësit në klasë.

Semantika: Shkenca e cila studion kuptimin dhe domethënëien e sistemit të shenjave që shprehen në gjuhë, kuptimi tërësor i fjalës a fjalisë ose në ndonjë lloj tjetër paraqitjeje që ka një shenjë me një objekt real ose raporti që ka një shenjë me një shenjë tjetër, veçanërisht me konceptet mendore.

Seminaret në arsim: Veprimtari joformale takime nga një grup mësimsdhënësisht të cilët diskutojn për një temë të caktuar mes vete apo me moderimin nga një profesionist i lëmisë për temën për të cilën diskutohet.

Semiologjia: Displine shkencore që merret me studimin e sistemeve të shenjave, qëllimi i të cilave është të përcjell lloje të ndryshme informacioni dhe komunikimi përmes shenjave.

Sfondi teorik i kërkimit: Kërkuesi bën një përshkrim, ku do të paraqiten, krahasohen dhe vlerësohen teoritë më të rëndësishme, përmendet literatura dhe studimet që lidhen me temën (libra, artikuj, raporte hulumtuese) të autorëve të tjerë (vëndorë dhe ndërkombehtarë).

SH

Shembull: Një pikë referimi që i referohemi për të shpjeguar, demonstruar ose ilustruar një përmbajtje të caktuar mësimore.

Shënimet e mësimdhënsit: Nënkuptohenn përshkrimet e procesit të punës mësimore pa ndonjë koment ose vërejtje personale e të cilat mund të lexohën përsëri nga mësimdhënësi dhe të ndihmojnë reflektimin krahasimtar si dhe për të rikujtuar elemente të veçanta të mësimdhënies që ka ndodhur para një kohe të gjatë.

Shënimi i sjelljeve të pahijshme të nxënësit nga mësimdhënësi: Nënkuptohen shënime të regjistruara: emrin e mbiemrin e nxënësit, veprimin, datën, orën, vendin dhe reagimin e mësimdhënësit për sjelljen dhe masat e përdorura ndëshkuese (të cilat përdoren për statistika arsimore).

Shenjat paralajmruese patologjike të nxënësit: Nënkuptohen njohja e shenjave të nxënësve që kanë predizpozita të jenë të dhunshëm (të zemruar, të zhgënjyer, nervozizëm i përhershëm, sherre fizike të përditshme, kërcnime, probleme me kontrollin e ndjenjave) për siguri dhe parandalim të krimit si, përdorimi i drogës, therrjet dhe vrasjet në shkolla etj.

Shkalla e reagimit: Mënyra, prirja dhe niveli i reagimit të nxënësit ndaj situatave dhe njerëzve të caktuar.

Shkalla e vetëvlerësimit: Instrument matës, i përbërë nga një listë pohimesh apo deklaratash, të cilat synojnë të tregojnë nivelin e vlerësimit që individi e ka për veten.

Shkalla e vlerësimit: Një vlerësim që kërkon gjykim të nivelit sipas të cilit prezantohet ose përpilohet secili kriter (shkallët e vlerësimit përbehen nga shkallë me pesë pikë dhe dhjetë-pikë).

Shkalla numerike: Instrument matës me një grup kriteresh tipike ku përdoren numrat për shkallë të ndryshme të tiparit (meqenëse ne kemi vlerësimin nga 1 deri në 5, atëherë shkalla numerike është 1-5 më e përshtatshme për të aplikuar këtë instrument, në shkollat tona).

Shkalla përshkruese: Instrument matës (i nderlikuar/vështirë për t'u ndërtuar, por me vlera të larta komunikuese) me ose pa një grup kriteresh tipike që përshkruajn sjelljet e nxënësve në detyra/kërkesa dhe gjatë të mësuarit në klasë.

Shkalla vlerësuese: Instrument vrojtimi, që ndihmon mësimmshënësin të masë qëndrimet dhe aftësitë që mund të vlerësohen në mënyrë të kufizuar. Përdoren dy shkallë vlerësuese: përshkruese dhe numerike.

Shkathtësi: Zotërim i komponentës së veçantë për të kryer veprime në saj të aftësive lëvizore (motorike), mendore (intelektuale) dhe ndijore (sensoriale) për të kryer drejtë dhe saktë një veprim, mbështetur në njohuri paraprake për të, si dhe duke iu nënshtruar kontrollit të vetëdijes në çdo element të tij.

Shprehi: Zotësi aftësi për të kryer saktë, shpejt, në mënyrë të sigurt dhe automatike një veprim, në mënyrë të vetëkontrolluar mendore ose lëvizore.

Shkathtësi e shprehi pune: Shkathtësi e shprehi për kryerjen e veprimeve të punës së përgjithshme d.m.th. përdoret së bashku

me veçoritë përkatëse, në të gjitha llojet e punëve kurse pjesa tjetër janë shkathtësi të veçanta (speciale) dhe kanë një sferë të ngushtë përdorimi, në një profil të caktuar pune.

Shkathtësi personale të mësimdhënësit: Të gjitha ato shkathtësi që përbëjnë personalitetin unik dhe me më ndikim mësimdhënien efektive.

Shkathtësi profesionale të mësimdhënies: Shkathtësit që lidhen specifikisht me mësimdhënien dhe përmbajtjen që janë të lidhura ngushtësisht me komunikimin, durimin, gatishmerin dhe përshtatshmërinë e mësimdhënjës.

Shkathtësi teknike: Të gjitha ato shkathtësi që kërkohen në vendin e punës apo profesionit dhe që trajneri, apo profesori, përqendrohet gjatë mësimi apo instruktimit.

Shkolla: Nënkupton institucion profesional të edukimit (arsimit), veprimtaria themelore e të cilit është mësimi, përkatësisht puna e përbashkët e mësimdhënies dhe nxënësve me qëllim që ata ketë të fundit të përvetësojnë dije, vlera, shkathtësi dhe shprehje të përcaktuara me plan-program përkatës dhe t'i zhvillojnë potencialet dhe personalitetin e tyre në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme.

Shoqëri dijesh: Term që thekson se në një shoqëri dija, dhe jo kapitali, puna ose çdo gjë tjetër përben burimin parësor të zhvillimit ekonomik-shoqëror të një vendi.

Shpërblim: Përforcim motivues për rritjen e efektshmërisë në të mësuar që është e rëndësishme për të vlerësuar dhe mund t'i stimulojë nxënësit për mësim.

Shpërndarja e informacionit dhe përmbajtjes pedagogjike:

Nënkupton aftësi të mësimdhënsit që të ndajë me të tjerët përmbajtjen e informacionit të gjetur, të jetë i gatshëm për të ndarë njohuritë, përmbajtjen dhe shpërndarjen e të reja, përmbajtjeve dhe burimeve, të dijë rreth praktikave dhe të integrojë informacion të ri mbi bazë e njohurive ekzistuese pedagogjike.

Shpjegimi i nxënësit: Nënkupton kur një nxënës integron njohuritë e mësuara nga mësimdhënësi (përsëritë njohuritë) i integron (përsëritje e përpunuar) në mënyra tjera nga përmbajtja e shkencës ose probleme të jetës së përditshme.

Shpjegimi i paqartë i mësimdhënësit: Nënkupton paaftësinë e mësimdhënsit për ta bërë me të lehtë, kuptueshëm përmbajtjen e një mësimi për nxënësin (e vështirsojnë përmbajtjen e një mësimi për nxënësin).

Shprehitë: Mënyra të kryerjes së operacioneve të caktuara, të cilat me përsëritje dhe ushtrime të shpeshta përforcohen, që me rastin e kryerjes së tyre nuk ka nevojë të mendohet aq shumë se e si realizohen, p.sh, kur lexojmë, shkruajmë, flasim etj.

Shpresë: Pritja e suksesit të dëshiruar.

Shpresë në mësimdhënie: Pritja e suksesit të dëshiruar të mësimdhënsit për nxënësin.

Shqetësimi në mësimdhënie: Situata kur mësimdhënësi nuk din se çka pritët nga ai gjatë procesit mësimor (jo efektiviteti i shfaqur i mos planifikimit) ose planifikimit jo të mirë për udhëheqjen dhe drejtimin e procesit mësimor.

Shqyrtimi: Punim me karakter polemizues, zakonisht nuk përmban vëllim të madh, megjithatë përmban elementet e studimit shkencor.

Shtangie: Mungesë gatishmërie për të reaguuar ndaj një situatë të caktuar që manifestohet si: ndjenjë e frikës, ankth e deri tek epilepsia.

Shtysë: Nxitje e brendshme ose e jashtme që shton vullnetin, dëshirën dhe guximin për të kryer ose përfunduar një aktivitet të caktuar.

Simulimi: Nënkupton një imitim të një modeli (profesional) në një lojë mësimore që paraprakisht kërkon aftësi dhe shkathhtësi të ngjashme me ato që kërkojnë në situata reale jetësore gjatë realizimit nëpërmjet metodave edukative në klasë me nxënësit.

Stërvitja: Metodë e mësimin, e cila përfshin planifikimin dhe pajisjet që nevojiten në situatat kur duhet të imitohet diçka nga jeta reale. Përdoret kur mësimdhënësi planifikon që nëpërmjet një simulimi të një ngjarje të vërtetë jetësore të aftësojë nxënësit të praktikojnë ushtrim apo sjellje të caktuara.

Sindrom: Kompleks shenjash ose simptomash jo normale të dukurive patologjike të individit.

Sinergjia: Veprimi i ndërsjelltë pozitiv (i harmonizuar) i pjesëve në tërësi, për shembull i anëtareve në çift, grup, ekip etj.

Sinjal: Stimul, i cili nuk përmban informacion, por që përmban shenjë pamore, me anë të së cilës i transmetohet tjetrit diçka.

Sinjali i mësimdhënësit: Shenjë verbale (lënia e fjalës për gjysmë dhe vëzhgimi) ose me gjeste (tundje koke) që nxënësi të ndalojë, ndërpresë ose ndryshoj sjelljen e tij në klasë.

Sinopsis: Përmbledhje e shkrimeve dhe e përmbajtjeve të shkruara të disa autorëve për të njëjtën temë, të renditura sipas kronologjisë.

Sinteza: Proces i ndërthurjes së pjesëve përbërëse në mënyrë që të krijohet një model ose strukturë që ka ekzistuar më parë.

Sistemi i krediteve (ECTS): Sistemi standard i krahasimit të krediteve akademike (shkallë vëllimi të të mësuarit bazuar në rezultatet e përcaktuara dhe ngarkesen e punës, 1 vit studime është e barabart me 60 kredite apo 1500-1800 orë ngarkesë) e cili u lejon individëve që të fitojnë kualifikime në institucione të ndryshme universitare, përkatësisht lehtësi në transferimin e krediteve të fituara në një skemë kualifikimi kombëtare dhe njohje të vlerësimit në kuadrin e një skeme tjetër kombëtare ose ndërkombëtare.

Sistemi klasë-orë-lëndë: Sistem mësimor në shkolla që veçanti ka disa kategori didaktike: viti shkollor, orari i mësimimit me 6 orë në ditë, mësimi lëndor, artikulumimi i lëndës në tema mësimore, ku njësia mësimore ofrohët e ndarë në tre etapa dhe udhëheqja dhe puna e përbashkët me nxënësit e mësimdhënësimit.

Sistemimi: Do të thotë se të gjitha elementet, të cilat i shqyrton kërkuesi, duhet të jenë të lidhura në mes veti, në mënyrë funksionale, me qëllime të caktuara dhe me lidhjet e sërishme prapavajtëse, si kusht i ekzistimit dhe i funksionimit të tërësisë së sistemes.

Sjellja e nxënësit: Ndryshim i jashtëm i vëzhgueshëm që vlerësohet nga mësimdhënësi.

Sjellja e nxënësve në klasë: Të gjitha llojet e sjelljeve në rrjedhën e aktiviteteve të të mësuarit, mungesa e vëmendjes, reagimi, entuziazmi, interesimi, fokusimi, qetësia, përqendrimi, etj. (pra jo gjithmonë lidhën me sjellje të këqija dhe të padëshirushme të nxënësve në klasë).

Sjellja përçarëse: Sjellja e pahijshme në procesin e mësimdhënies, përçmimi, bullizmi diskriminimi pozitiv/negativ që përçan nxënësit e një klase.

Sjellje devijante: Sjellje me anë të të cilës individi vepron në kundërshtim me rregullat dhe normat sociale.

Sjellje e keqe e nxënësit në klasë: Nxënësi që me sjelljen e tij vazhdon të shqetësoi pëngoj klasën (nxënësit) të përfshirë në mësim e cila mund të jetë zhurmë, përplasje gjërash etj, duke e bërë të vështirë apo të pamundur zhvillimin e mësimimit nga mësimdhënësi në klasë.

Sjellje jo etike: Sjellje jo e mirë e papërshtashme ose agresive e nxënësit sipas rregullave etike në klasë, që sjell probleme gjatë mësimimit dhe që duhet ndryshuar me ndalim ose ndëshkime kufizuese për të mos përsëritur atë sjellje.

Sjellje josociale: Sjellje e papërshtatshme, në kundërshtim me rregullat shoqërore dhe të papranueshme për shoqërinë.

Sjellja impulsive: Sjellje të çrregullta që pengojnë zhvillimin normal të mësimimit në klasë.

S-K-A: Akronim i përdorur për të përpiluar objektivat e të mësuarit. Ai përbehet nga fjalët Skills (Aftësitë), Knowledge (Njohuritë), dhe Attitudes (Qëndrimet).

Skeda e ecurisë së nxënësit: Skeda që përmbajnë një numër të objektivave me afatgjatë, të cilave mësimdhënësit mund t’iu referohen herë pas here për të përcaktuar ecurinë e tyre në procesin mësimor.

Skema: Një formë e organizuar e të dhënit kuptim të një eksperience që ndryshon me moshën. Do të thotë “skema” përfaqëson një mendim, nocion ose sjellje që është mësuar dhe internalizuar në mendjen e fëmijës.

Skenarët në mësimdhënie: Nënkupton një “përshtatje” një strukture jo të njëjtë të realizimit të detyrave funksionit dhe veprimtarive të mësimdhënies në klasë. Kur planifikohen dhe zbatohen skenarët, mësimdhënësit marrin rolin e regjisorit dhe nxënësit marrin rolin e aktorëve.

Skenari: Fjalë e cila është huazuar nga teatri, përkatësisht një “kolazh” veprimesh dhe ngjarjesh që organizohen në një ambient të veçantë, ku i kushtohet vëmendje e veçantë skenave, personazheve dhe situatave si edhe marrëdhënieve ndermjet tyre.

Skica e punës: Instrument formal, që krijon përgjegjësi dhe shërben për përshkrimin e shkurtër të projektit.

Skica: Parashikim preliminar i punës hulumtuese (nuk do të thotë se ajo nuk mund të ndryshohet) një lloj udhërrëfyese gjatë punës suaj hulumtuese, një mendim (i shkruar) që ka të bëjë me atë që ke ndërmend të bësh dhe mënyrën se si do ta bësh.

SMART: Një metodë për kujtesën që mund të përdoret kur përcaktohen objektivat e mësimit. Ajo përbehet nga akronimet e Specific (Specifike), Measurable (I matshëm), Action-oriented (I orientuar drejtë veprimit), Reasonable (I arsyeshëm), dhe Time-bound (Me afat të përcaktuar).

Socio-konstruktivizmi: Teoria e cila e konsideron të mësuarit si proces aktiv për ndërtimin e njohurive nga nxënësi, që bazohet në njohuritë e ndërtuara më parë dhe ndërveprimin e subjektit me mësimdhënsin (mësimdhënsi nuk mund t'ua mësojë nxënësve dijet, por merr rolin e fasicilituesit që ndihmon nxënësit të ndërtojnë vetë njohuri dhe të zhvillojnë kompetenca, duke vepruar në situata të kuptueshme ose afërsisht reale).

Sociologjia: Shkenca që studion fenomenet shoqërore, ndërveprimin social (stratifikimi social, rregullat dhe proceset shoqërore) dhe zhvillimin e jetës sociale dhe të shoqërisë në tërësin e saj.

Sondazhet statistikore: Janë anketat rreth arsimit që japin informacion të rëndësishëm për të gjitha llojet e arsimit publik dhe jopublik ku regjistrimet përfshijnë një "mostër", me kritere të metodologjisë së anketave si: pyetësorët, intervistuesit dhe teknikat që duhen ndjekur pas mospërgjigjës.

SPSS: Program kompjuterik, i dedikuar për shkencat sociale, që lehtëson futjen e të dhënave hulumtuese në program, ruajtjen e tyre dhe përpunimin statistikor të të dhënave hulumtuese në mënyrë automatike.

Stadet e zhvillimit konjitiv: Sipas Piazhës janë katër stade të zhvillimit konjitiv paraoperacional, operacional, operacional-konkret dhe operacional-formal.

Stadet e zhvillimit sipas Kohlebergut: Janë parakonvencionale, konvencionale, dhe past-konvencionale.

Stadi konjitiv i zhvillimit: Shoqërohet me mendimin formal si dhe me rritjen e aftësive për t'u marrë me manipulime mendore, të kuptuarit e abstragimit, hipotezat e testeve, etj.

Stadi moral i zhvillimit: Shoqërohet me moralin e bashkëpunimit, konvencional me qëndrim të palëkundur për të menduar se rregullat janë të pandryshueshme pa marrë parasysh qëllimet dhe rrethanat lehtësuese.

Standard arsimor: Një kriter i arsimit i shprehur numerikisht si një mesatare statistikore, ose në mënyrë filozofike, si një ideal i përsosmërisë, sipas të cilit gjykohen dhe vlerësohen gjërat dhe vlerësohen komponentët përbërës të edukimit.

Standarde profesionale: Një tërësi treguesish që e karakterizojnë profesionin nga pikëpamja sasiore dhe cilësore dhe shërbejnë si matës të përgatitjes dhe gatishmërisë së një individi për përmbushjen e kërkesave në ushtrimin e një profesioni.

Standardet e arritjeve të nxënësit: Përcaktojnë nivelin e përmbushjes së standardeve të përmbajtjes nga nxënësit.

Standardet e përmbajtjes: Përcaktojnë se ç' duhet të dijë dhe të jetë i aftë të bëjë nxënësi në një lëndë mësimore.

Standardet e programeve dhe teksteve shkollore: Përfshijnë kriteret filozofike, pedagogjike, psikologjike dhe shkencore mbi bazën e të cilave hartohen programet dhe tekstet shkollore.

Standardet e një programi: Përcaktojnë njohurit shprehite dhe aftësitë që nxënësit duhet t'i zotërojnë në një nivel të caktuar pas përfundimit të një programi arsimor.

Standardet e përmbajtjes: Theksojnë se dijet duhen fituar, pavarësisht nëse janë procese apo përmbajtje.

Standardet e performancës: Theksojnë se dijet janë detyra që duhen kryer nga nxënësi, pra dija është pjesë përbërëse e detyrës/kërkesës dhe ai duhet t'i përdorë dijet dhe aftësitë në një mënyrë të caktuar në zgjidhjen e detyrës/kërkesës.

Statistika pedagogjike: Shkencë e metodave për kërkimin e dukurive masive pedagogjike me ndihmën e kërkimeve numerike.

Statusi social: Rangimi i pozicionit të një personi në një komunitet, nga më i ulëti të më i larti (kuptimi i përgjithshëm).

Statuti socio-ekonomik: Pozita relative në shoqëri, e bazuar në shkollim, të ardhura, ekonomi, vendbanim, etj.

Stilet e të mësuarit: Përkufizohen si sjellje karakteristike njohëse/konjuktive, të cilat shërbejnë si indikatorë/tregues se si fëmijët mësojnë, si perceptojnë, si ndërveprojnë dhe si reagojnë ndaj mjedisit ku mësojnë. Stilet konsiderohen edhe si predispozita për rrugët dhe mënyrat e të mësuarit dhe janë të lidhura ngushtësisht me llojin/tipin e personalitetit që ka fëmija. (çasje karakteristike ndaj mësimi) për përpunimin e informacion në mënyrë specifike.

Stilet njohëse: Përkufizohen si pasqyrim i karakteristikave në përpunimin e informacionit që zhvillohet në menyrë të përshtatshme me të cilat nxënësit përpunojnë informacionin njohës.

Stili aktivist i të nxënit: Qëndrim mendjehapur dhe entuziast për idetë e reja, dëshirë për përfshirje në përvoja të reja, punë me të tjerët në grupe, në lojë me role, takime dhe diskutime.

Stili i të mësuarit analitik: Nxënësit e pavarur, që zgjidhin probleme, dhe zhvillojnë e zbulojnë parime e ide (të vetat) logjike të mësimit të ri, me mundësi për të tjerët që t'i ndjekin ato dhe “zor” se e pranojnë dështimin.

Stili i të mësuarit komunikativ/komunikues: Nxënësit që preferojnë një mënyrë sociale/shoqërore mësimit si ndërveprim personal nga diskutimet apo aktivitetet në grup.

Stili i të mësuarit konkret: Nxënësit e interesuar për informacionin që ka vlera imediate që janë kureshtarë, spontanë dhe të gatshëm për variacionin dhe ndryshimet konstante, që nuk pëlqejnë rutinën dhe punët me shkrim, por parapëlqejnë përvojat vizuale dhe argëtimin kur përfshihen fizikisht gjatë mësimit.

Stili i të mësuarit nën autoritetin e të tjerëve: Nxënësit që janë të përgjegjshëm, por të varur për struktura të gatshme, të cilat jepen në progres udhëzime të qarta dhe ndihen më rehat me diskutime të ndryshme, apo në zgjidhjen e problemeve me konsensus.

Stili i të mësuarit vetëselektues: Stil i të mësuarit individual me përjashtim të hapit të parë në vend të dhënjes së një teme nga mësuesi, nxënësit zgjedhin vetë temën e të mësuarit.

Stili reflektiv i të mësuarit të nxënësit: Prirje për t'i parë situatat nga këndvështrime të ndryshme, për të dëgjuar pikëpamjet e të tjerëve, mendon me kujdes përpara se të nxirren përfundimet.

Stili teoricien i të mësuarit të nxënësit: Mënyrë analitike në të menduarit e gjërave në një radhë logjike, u pëlqen t'i provojnë gjërat, mësojnë më shumë kur përdorin teknika dhe marrin informata kthyesë, lidhin atë që janë duke mësuar më atë që e kanë detyrë ta bëjnë, kanë një prirje për të qenë perfeksionist.

Stimujt e jashtëm verbal për nxënësin: Fjalët e mësimdhënësit si, p.sh: një lavdërim, një mirënjohje ose pjesëmarrje në grupe pune, vlerësim para të gjithë nxënësve në klasë.

Strategjia:Termi nënkuptohet si mjeshtri e udhëheqjes së mësimdhënësit për trajtimin e qëllimeve e detyrave mësimore përmbajtjeve, formave, metodave, mjeteve, dhe vlerësimeve.

Strategjia e të mësuarit: Një plan i përgjithshëm (orientim a drejtim i veprimit, specifik dhe proaktiv) drejtë procesit dhe realizimit të rezultateve, që në fokus kanë mësimdhënien për arritjen e qëllimeve të përgjithëshme, para se të merremi me detyrën e të mësuarit specifikisht.

Stresi në shkollë: Termi i atribuohet dështimit ose mungesës së aftësive për të mësuar, nga nxënësi përkatësisht humbjes së përqendrimit e deri te koncepti negativ për vetën nga nxënësi.

Struktura dhe organizimi i mësim: Struktura e mësimit hyrja, përmbledhja e mësim, pjesa kryesore, organizimi i mësim, sekuenca mësimore, ngarkesa e përmbajtjes dhe vlerësimi i mësim, si dhe pjesa përfundimtare.

Struktura e kurikulës: Elementet që përdoren për ndërtimin e saj (kurikula me bazë lëndët mësimore, modulet mësimore, projektet mësimore apo me strukturë të kombinuar) të lidhura me njëra-tjetrën të cilat kanë të bëjnë me kompetencat, njohuritë, shprehitë, qëndrimet, metodologjitë, instrumentet e vlerësimit, kushtet e nevojshme të realizimit.

Struktura e një dukurie: Tërësi e elementeve të rëndësishme, të lidhura në mënyrë funksionale midis tyre.

Strukturalizmi pedagogjik: Teoria që i referohet stadave, të integruara të mbështetura në veprim (enaktive) të mbështetura në pamje (ikonike) dhe të mbështetura tek gjuha (simbolike).

Strukturë e qëllimit të përbashkët: Mënyrë se si nxënësit krijojnë marrëdhënie me të tjerët, që gjithashtu punojnë për një qëllim të caktuar.

Strukturimi i një ore mësimore: Organizimi i përmbajtjes së orës mësimore apo përmbledhja e asaj që është mësuar, që mësohet në fillim, në mes dhe fund të orës mësimore.

Strukturimi: Përmbajtja e ofruar që i ndihmon nxënësit për të lidhur objektivat me njohurit dhe mundësitë e tyre për të arritur dhe lejuar nxënësin të ecë përpara drejtë objektivit të radhës.

Student: Individu që është i regjistruar në arsimin e lartë dhe ende nuk e ka përfunduar këtë nivel të shkollimit.

Studim i dokumentacionit: Punë kërkimore e mbështetur në dëshmitë e marra nga analiza e dokumentacionit në arkiva ose statistika të tjera administrative.

Studim longitudinal: Lloj i kërkimit shkencor, i cili kryhet me intervale kohore, por për një kohë të gjatë, duke synuar të masë ndryshimin e një dukurie me kalimin e kohës.

Studimi: Punim shkencor që ka trajtimin e plotë të një çështje të caktuar shkencore, zakonisht dallon nga monografia, sepse vë theksin më shumë te paraqitja e rezultateve hulumtuese dhe të dhënia e përgjigjes së hipotezës së ngritur për trajtim (botohet si libër ose si punim në një revistë shkencore).

Supozimi: Është një ‘fakt’ që presupozohet të jetë i vërtetë, por nuk është verifikuar ende si i tillë.

Syçeltësi e mësimdhënësit: Nënkupton që mësimdhënsi me vështrimin e tij (pa folur) ka në dijeni gjithëka që po ndodh në klasë dhe nuk i shpëton asgjë pa vërejtur.

Synimi i edukimit: Nënkupton i referohet të ndihmuarit e nxënësve për të zhvilluar njohuritë (sasinë e parashikuar të njohurive që është përcaktuar në kurrikul) shprehitë dhe aftësitë kyçe që i nevojiten fëmijës/nxënësit për jetën në botën moderne, për tu përgatitur për mësimin gjatë gjithë jetës.

T

Tabela e koncepteve: Teknikë, e cila shërben për të organizuar informacionin përpara ose të shkruhet për të veçanërisht e rëndësishme kur punohet me tri ose me më shumë koncepte njëkohësisht, të cilat duhet të krahasohen.

Tabela për afishe: Kornizë për të afishuar punime të nxënësve, grafikë të radhës të pastrimit të klasës, postera, rregulla etike dhe orarët e klasës, etj.

Tabelat e bardha: Ekran i madh kompjuterik i ndjeshëm ndaj prekjës, mjet mësimor shumë funksional, ku nxënësit mund të shtojnë skedar, video, fotografi, e cila e ka zëvendësuar tabelën e zezë tradicionale në klasë.

Taksë: Nënkupton çdo pagesë e detyrueshme me ligj e cila paguhet për ofrimin apo pranimin e një dokumenti (certifikatë, diplomë për kryerjen e një shërbim profesional publik të ligjshëm nga autoritetet shtetërore apo noteriale, avokatet, gjykatat) për qytetarët e atij vendi.

Taksonomi e objektivave: Renditje (taxis-renditje, nomos-ligj) hierarki e objektivave të njohjës, afektiv dhe psikomotor.

Taksonomi: Sistem, skemë klasifikuese me kategori të renditura në mënyrë hierarkike të nivelit të të mësuarit.

Taksonomia emocionale (afektive): Skemë klasifikuese me kategori të renditura në mënyrë hierarkike të nivelit të të mësuarit që përqendrohet tek vlerat dhe qendrimet marrja (vëmendja), përgjigjja, vlerësimi, organizimi, sistemi kompleks i vlerave, etj).

Taksonomia e Blumit: Sistemi i klasifikimit të nivelit të të mësuarit sipas Bloomit që përqendrohet tek njohuritë dhe aftësitë intelektuale me kategori të renditura: njohja, të kuptuarit, zbatimi, analiza, sinteza dhe gjykimi.

Taksonomia e rishikuar e Blumit sipas nxënësit të tij Andersen: Sistem, skemë klasifikuese me kategori të renditura në mënyrë hirearkike të nivelit të të mësuarit që përqendrohet tek njohuritë dhe aftësitë intelektuale si: njohja, të kuptuarit, zbatimi, analiza, sinteza, dhe krijimtaria.

Taksonomia njohëse (kognitive): Sistem, skemë klasifikuese me kategori të renditura në mënyrë hirearkike të nivelit të të mësuarit që përqendrohet te njohuritë dhe aftësitë intelektuale (njohja, të kuptuarit, zbatimi, analiza, sinteza dhe gjykimi apo krijimtaria).

Taksonomia psikomotore: Skemë klasifikuese me kategori të renditura në mënyrë hirearkike të nivelit të të mësuarit që përqendrohet tek zotësitë dhe aftësitë fizike (përceptimi, marrja e pozicionit, reagimi i drejtuar, mekanizmi i reagimit kompleks, adaptimi, organizim) të cilat mësohen duke filluar me imitim të veprimeve, vazhdojnë me kontrollin (që tregon fitimin e shkathtësive) dhe përfundojnë me automatizimin (që tregon fitimin e shprehisë) e tyre.

Takti pedagogjik: "Prekje e lehtë " ndaj nxënësit duke kombinuar, ndjeshmërinë, drejtësinë, këmbënguljen, dhe qëndrueshmërinë të flasë me nxënësit dhe t'i dëgjojë atë për një bisedë qortimi apo vërejtje, e cila përceptohet nga nxënësi si një akt drejtësie kur komunikohet me ndjeshmëri gjithnjë në respektimin e palëkundur të të drejtave dhe lirive të fëmijës.

Taktika në të mësuar: Taktika specifike e përdorur nga nxënësi në shërbim të strategjisë për zgjidhjen e një detyre/kërkese mësimore "strategji" konsistente me qëllim të mësuarit.

Talent: Vetë natyrore e individit për të përvetësuar diçka lehtë e shpejtë, zotësi e veçantë që e shquan një njeri në një fushë të caktuar.

Tantangrami: Termi i referohet lojës me letra të prera në madhësi dhe forma të sakëta me bashkimin e të cilave krijohet forma e caktuar gjatë ushtrimeve në klasë.

Të dhënat e gatshme në kërkim: I referohen raporteve, dokumentacionit, udhëzimeve, ligjeve etj., që në i mbledhim dhe përdorim për të ekzaminuar një pyetje hulumtuese apo për të vërtetuar ose rrëzuar një hipotezë të ngritur.

Të dhënat: Gjithë informacioni që mblidhet gjatë një studimi por që ende nuk është analizuar dhe përpunuar e të cilat duhet të nënshtrohen analizës së përpunimit metodologjik për të kuptuar problemin ose fenomenin që ka në shqyrtim studiuesi.

Të dhënat indikator për studimin: Përgjigjjet e përgjigjdhënësve ndaj pyetjeve për secilin indikator, për të përcaktuar nivelin e marrëdhënies mes indikatorëve në një hulumtim.

Të dhënat për studimin: Përgjigjjet e përgjigjdhënësve ndaj pyetjeve për secilin indikator, për të përcaktuar nivelin e marrëdhënies mes indikatorëve.

Të dhënat primare në kërkim: Të dhënat e mbledhura posaçërisht për kërkime, si intervistat apo pyetësorët, të cilat mund të ri-përdoren për kërkime tjera longidutinale.

Të dish diqka: Të mbash mend, rikujtosh me saktësi përgjatë viteve dhe të jesh në gjendje ta nxjerrësh nga kujtesa në qastin kur të nevojitet (psh. alfabeti, tabela e shumëzimit).

Të drejtat e fëmijëve; Përkufizohen të drejtat si: mirëqenia psikofizike dhe emocionale, mosdiskriminimi, siguria, respekti, trajtimi i drejtë, mbrojtja nga abuzimi, liria e shprehjes, arsimimit, mendimit, komunikimit dhe lojës.

Të drejtat universale të fëmijës: Përkufizohen të drejtat njerëzore si: të drejtat për jetë, liri, barazi, arsimim, rritje, zhvillim.

Të jeni të gatshëm për mësimdhënie: Ky parim/rregull nxjerr në pah rëndësinë e të qenit i gatshëm ku përfshin fillimin e mësimdhënies dhe kalimin nga një veprimtari në tjetrën, pa krijuar boshllëk apo humbje kohe.

Të komunikosh në mësimdhënie: Të përcjellësh informacionin që keni në mendje, atë që mendoni që e shprehni me fjalë për qëllime të ndryshme në mësimdhënie gjatë procesit mësimor dhe të vlerësuarit të nxënësve (komunikimi midis mësimdhënësit dhe nxënësve) që praktikohet/realizohet në klasë.

Të kuptuarit në pedagogji: Nënkupton sasi dhe cilësi të njohurive (jo statike), por një veprimtari në të cilën nxënësi nxjerr kuptimin e diçkaje si p.sh. formimin e opinioneve të tyre vetjake, krijimin e kuptimit nga përvojat dhe reflektimi, strukturimin e argumenteve në mënyrë logjike dhe të shprehurit qartë dhe bindshëm.

Të menduar inovativ të nxënësve: Nënkupton kreativitet në të mësuarit e pa varur, vetë drejtim, të menduarit e rendit të lartë dhe bindjet e tyre për implikimet në jetë.

Të menduarit krijues të nxënësve: Aftësia për të menduar për diçka në mënyrë/mënyra të reja, ose të pazakonta për të gjetur zgjidhje të veçanta për problemet.

Të menduarit kritik të nxënësve: Aftësia për të konceptuar, analizuar, përmbledhur, dhe vlerësuar informacionin, idetë, produktet ose performancën në mënyrë aktive dhe në mënyrën e duhur, duke i shqyrtuar problemet, të dhënat dhe zgjidhjen logjikisht dhe sistematikisht.

Të mësuarit natyror të fëmijëve/nxënësve: Procesi natyral me anë të të cilave individë fiton njohurit, aftësit dhe qëndrimet pra mëson vetë nga natyrshmëria e tij si qenie dhe ndërveprimi me të tjetret gjatë gjithë jetës.

Të mësuarit aktiv të fëmijëve/nxënësve: I referohet procesit të të kuptuarit të gjerave (ose me teknikisht një dije, njohuri që ndërtohet përsosht) me pavarësi dhe duke u angazhuar në veprimtari kuptimplote si dhe duke komunikuar me të tjerët.

Të mësuarit e bazuar në kompetencat e punës: Të mësuarit e projektuar për t'i pajisur nxënësit me kompetencat që kërkohen në botën e punës.

Të mësuarit e vallëzimit: Aktivitetet i mësimdhënësit i cili shpjegon vallëzimin, demonstroi hapat e vallëzimit, numëron taktet gjatë vallëzimit dhe bënë korigjimin e lëvizjeve gjithnjë duke iu përshtatur moshës dhe aftësive të nxënësve.

Të mësuarit e vetë normuar: Si koncept përkufizohet në të mësuarit që ka karakteristika të veçanta në menaxhimin e kohës vetmonitorimin dhe përparimin e të mësuarit, korrektimin këmbënguljen pavarësisht pengesave.

Të mësuarit emocional të fëmijëve/nxënësve: Nënkupton përgjigje neurokimike dhe hormonale që ngjallin ndjesi, kënaqësi, kreativitet, sfidë dhe gëzim të përcaktuara si paraqitje mendore, të vazhdueshme tek secili prej nesh.

Të mësuarit formal: Mësimi në të cilën përmbajtja zgjidhet nga të tjerët dhe i prezantohet nxënësit, udhëzimet, detyrat e caktuara mësimore, aftësitë bazë të të mësuarit përgjithësisht një aktivitet mësimor në klasë.

Të mësuarit gjatë gjithë jetës: Të mësuarit në të gjitha etapat e jetës, që mund të realizohet me mënyra nga më të ndryshmet me rrugë formale, joformale dhe informale, me anë të përpunimit mendor të përvojës së fituar nëpërmjet shërbimit të informimit dhe atij bibliotekar, mjeteve të komunikimit.

Të mësuarit imitues të fëmijëve/nxënësve: Nënkupton të mësuarit e një sjelljeje ose roli duke imituar sjelljen ose rolin e vëzhguar dhe demonstrimin e menjëhershëm pas imitimit se si e kanë përvetësuar.

Të mësuarit kuptimplotë të fëmijëve/nxënësve: I referohet të mësuarit të qendrueshëm “që ka kuptim me të vërtetë” mund të transferohet nga lënda e përvetësuar prej tyre, të zgjerojnë njohuritë që kanë përfituar drejtë një konteksti të ri dhe ta përdorin atë në jetë.

Të mësuarit ndërveprues të mësimitdhënësve: Konceptohen aktivitetet këshilluese si një proces ndërveprimi dhe bashkëkomunikimi me të tjerët (koleget).

Të mësuarit në situatë: Momente të mësimitdhënies ndjenja të çastit të cilat bazohen të mësimit i nxënësve duke krijuar orientime në të mësuar apo supozime të mësimitdhënies.

Të mësuarit në vendin e punës: Nëkuptohen konceptohen aktivitetet mësimore të vet-inicuar në vendin e punës të cilat e lejojnë mësimitdhënien të ndërtoj kuptimin e mësimitdhënies si proces, duke bërë, eksperimentuar, reflektuar, vlerësuar mësimitdhënien pa ndërveprim me të tjerët.

Të mësuarit për emocionet e fëmijëve/nxënësve: I referohen të mësuarit për të zotëruar (vetëdijësuar, identifikuar dhe reflektuar) emocionet e pranishme për sukses në situata sfiduese në jetën mësimore.

Të mësuarit përmes imitimit: Mësimi që ndodh kur individit përmes imitimit zgjedh detyra mësimore që kanë me pak struktura njohëse (mësimi i koncepteve verbale që kërkojnë imitim).

Të mësuarit përmes mësimitdhënies: Përkufizohet si “mësimi për të dhënë mësim apo si të bësh mësimitdhënie” përmes përvojës së mësimitdhënies si dhe duke kërkuar praktika të reja për të konceptuar mësimitdhënien gjatë reflektimit në praktikë.

Të mësuarit personal të fëmijëve/nxënësve: Është procesi kur individit vetë mëson, pra të gjitha veprimtarit e të mësuarit të vetëdrejtuar dhe të qëllimshëm për të vendosur se çfarë të mësoj,

si të mësoj dhe me cilat aktivitete mësimore, si të menaxhoj procesin e të mësuarit, etj.

Të mësuarit rutinë të fëmijëve/nxënësve: Të mësuarit përmendësh përmes përsëritjes, shpeshherë pa e kuptuar domethënien, arsyetimin, ose marrëdhëniet e përfshira mbi temën që po trajtohet.

Të mësuarit se si të mësosh: Përfshin zotërimin ose marrjen e njohurive dhe aftësive për të mësuar në mënyrë efektive në çfardo situatë të të mësuarit që has, (të thjeshtë e të ndërlikuar) dhe që zgjeron efektivitetin e të mësuarit për shumë qëllime pavarësisht nga metoda dhe përmbajtja mësimore.

Të mësuarit si funksion: Nënkupton aspekte kritike si motivimi, mbajtja mend dhe transferimi i të mësuarit i cili ndikon në bërjen e ndyshimit të sjelljes, pra thekson funksionin e të mësuarit.

Të mësuarit si proces i përfitimit të kompetencave: Nënkupton aspekte e përgjegjësi për planifikim, përkushtim dhe angazhim për të përfituar kompetenca.

Të mësuarit si proces i përfitimit të njohurive të planifikuara: Nënkupton aspekte të planifikimit përgjegjësi për planifikim të të mësuarit, dhe vetëdrejtim.

Të mësuarit si proces: Nënkupton rezultatin atë që ndodhë gjatë rrjedhës së procesit të të mësuarit pra thekson procesin e të mësuarit.

Të mësuarit si produkt: Nënkupton rezultatin përfundimtar, rezultatin e të mësuarit pra thekson produktin përfundimtar të të mësuarit.

Të mësuarit të të rriturit: Procesi i të mësuarit me interes drejtë qëllimit që shoqërohet me planifikimin dhe ndryshimin e dëshiruar në modalitete arsimimit formal, joformal dhe informal.

Të mësuarit tradicional të fëmijëve/nxënësve: Një qasje mësimdhënie “ku mësimdhënsi është aktori kryesor”, e cila është kryesisht përgjegjëse për shpërndarjen e informacionit që duhet mbajtur mend nga nxënësit (të cilat shihen si marrësit pasivë të informacionit) dhe bazohet në mendimin se të mësuarit ka të bëjë me përfitimin, mbledhjen dhe grumbullimin e informacionit.

Të mësuarit vetëselektues të fëmijëve/nxënësve: Nënkupton përcaktimin e secilit që mëson, në përzgjedhjen se cilat aspekte do ti mësoj dhe cilat do ti anashkaloj.

Të mësuarit nga vëzhgimi: Nënkupton të mësuarit duke vëzhguar sjelljet e të tjerëve nëpërmjet disa proceseve si: vëmendjes, ruajtjes, dhe motivimit.

Të mësuarit zbulues të fëmijëve/nxënësve: Nënkupton të mësuarit personal gjatë të mësuarit “nxënësi/fëmija mëson si të mësojë” kur zgjidhin një problem në mënyrë të pavarur.

Të mësuarit bashkëpunues të fëmijëve/nxënësve: Situatë (gjatë veprimtarisë mësimore në klasë) në të cilën përpunimi, interpretimi, shpjegimi dhe argumentimi janë pjesë integrale e veprimtarisë së grupit dhe në të cilat të nxënësi mbështetet nga nxënësit të tjerë të klasës.

Të mësuarit duke shërbyer: Ndërthurje e të nxëniet akademik me zhvillimin vetjak e shoqëror të vijuesve dhe kolegeve të tyre.

Të mësuarit e mbështetur në problem të fëmijëve/nxënësve: Metoda që i pajisin nxënësit me probleme reale, të cilat gjatë zgjidhjes jo domosdoshmërisht marrin përgjigje të sakta.

Të mësuarit e pjesë-pjesshëm të fëmijëve/nxënësve: Ndarje e një liste çështjesh në lista (pjesë) më të vogla për tu mësuar.

Të mësuarit e vetërregulluar të fëmijëve/nxënësve: Pikëpamje që e shoh të mësuarit si aftësi që përdoret në analizën e detyrave mësimore, në përcaktimin e qëllimeve, në planifikimin e mënyrës se si duhet të kryhet detyra, në përdorimin e aftësive dhe veçanërisht në bërjen e modifikimeve në mënyrën e të mësuarit.

Të mësuarit nga “përvoja” e fëmijëve/nxënësve: Të mësuarit si rezultat i përvojës, ky mësim mundë të jetë i saktë ose i pasaktë varësisht nga mënyra se si e kupton nxënësi atë nga përvoja.

Të mësuarit hulumtues: Mënyrë e të mësuarit në të cilën mësimitdhënësi paraqet një situatë të ngatërruar dhe nxënësit e zgjidhin problemin duke mbledhur të dhëna dhe duke testuar përfundimet e tyre.

Të mësuarit metakognitiv: Fushë e re e shkencës kognitive që na ndihmon të kuptojmë rolin e mësimitdhënësit si model i të menduarit dhe i të mësuarit, dhe rolin e fëmijëve/nxënësve që marrin nga këto demonstrime një shembull procesesh dhe strategjish që mund t'i përdorin në ndërtimin e njohurive të tyre.

Të mësuarit në bashkpunim: Është një mënyrë mësimdhënie në grupe të vogla ku kërkohet përgjigjja nga nxënësi për një qështje të parashtruar nga mësimdhënësi, eksplorimi i përgjigjes dhe zgjedhjet alternative.

Të mësuarit situacional: Ide sipas së cilës aftësitë dhe njohuritë lidhen me situatën ku janë mësuar dhe janë të vështira për t'u zbatuar në mjedise të reja.

Të mësuarit vëzhgues: Të mësosh duke vëzhguar dhe imituar të tjerët.

Të mësuarit: Përkufizohet procesi i pavarur, i fëmijës/nxënësit, intelektual e psikomotorik me anën e të cilit përvetësohen dituri, shkathtësi e shprehje, që ndikojnë të ndryshojnë sjelljet e përgjithshme, faktori i ndryshimit të individit, që vjen si rezultat i përvojës dhe nga mënyra se si e kupton.

Të shpjeguarit-të mësuarit: Dy procese të lidhura ngushtë mes tyre, dy aspekte të të njëjtit proces të ndërthurur, ku njeri aspekt ndikon, por edhe ndikohet nga tjetri. Ndonjëherë nxënësit shpjegojnë (janë të përfshirë në shpjegim si në rastin e ndihmës që bashkëmoshataret i ofrojnë njëri-tjetrit, ose kur bëhen prezantime grupi përpara klasës) dhe herë të tjera ata mësojnë.

Teknika evidencë aktivitetesh: Përdoret për të siguruar një evidencë shënjestër për anët e forta dhe të dobëta të fëmijëve/nxënësve për aktivitetet në kapitujt dhe tema të veçanta.

Teknika vlerësuese: Përdoret për të siguruar një evidencë informacion për qëllime raportimi, përmirësimi dhe vlerësimi në procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit.

Teknika “Brainstorming”: Cilësohet edhe si teknikë e “thyerjes së akullit”, e cila u krijon mundësi nxënësve që të mësojnë ta kapërcejnë vijën e “zonës së frikës” dhe të çlirohen në shfaqjen e mendimeve dhe në komunikimin mësimdhënës-nxënës dhe nxënës-nxënës.

Teknika e parashikimit me terma paraprakë: Teknikë evokuese, e cila përdoret për të nxitur kureshtjen për të lëxuarit aktiv, për të zhvilluar imagjinatën dhe për një kuptim më të mirë të informacionit të ndërtuar gjatë leximit për të bërë të mundur një parashikim paanshmërisht të saktë, por pa nxjerrë jashtë sekretin e tregimit apo mësimin deri në fundë të orës së mësimin.

Teknika efektive të mësimin: Janë të gjitha teknikat me synim përkrahjen e të mësuarit efektiv të nxënësve dhe që aftësojnë nxënësit të mësojnë në forma të ndryshme, për t’i nxitur dhe për t’i motivuar ata gjatë të mësuarit.

Teknika PRQ: Prano, reflekto, qartso, është teknikë që e përdorin mësimdhënësit në komunikim me prindërit.

Teknika motivuese: Teknikat me synim përkrahjen e të mësuarit efektiv të nxënësve për arritje, si: modeli, përforcimi, përcaktimi i synimit.

Teknikat e kujtesës: Nënkuptohen teknikat me synim përkrahjen e të mësuarit efektiv të nxënësve për rimat, akronimet, fjalët lidhëse, fjalët kyçe dhe teknika e vendodhjes.

Teknikat e mësimdhënies efektive: Nënkuptohen teknikat me synim përkrahjen e të mësuarit efektiv të nxënësve që përzgjedh

mësimdhënësi gjatë veprimtarive me nxënësit në klasë në nxitjen për të mësuar pavarësisht përmbajtjes mësimore.

Teknikat e mësimi: Nënkuptohen teknikat me synim përkrahjen e të mësuarit që rrjedhin nga metodat mësimore (pjesa konkrete në realizimin e orës mësimore nga mësimdhënësi) një seri veprimesh të planifikuara nga mësimdhënësi për përmbushjen e një detyre profesionale gjatë aktiviteteve të nxënësve gjatë të mësuarit në klasë.

Teknikat sociometrike: Nënkuptohen teknikat që masin aftësin apo paaftësin e një nxënësi për tu shoqëruar me nxënësit tjerë (gjatë aktiviteteve në lojrat edukative në klasë) cilët janë shokë lojë me një nxënës tjetër, si dhe kur një nxënës është vetmitar dhe kur një nxënës është lider i grupit në lojë.

Teknikë pedagogjike: Nënkuptohet instrumenti për ecurin (rrjedhëshmërinë) e aktiviteteve edukative brenda një ore mësimore në klasë gjatë mësimdhënies.

Teknologjia e komunikimit dhe informacionit në mësimdhënie: Çdo produkt që ruan, transmeton informacione elektronike në formë dixhitale (kompjuterat personale, e-mail dhe media sociale) që kontribuojnë në procesin e shpjegimit dhe përvetësimit të mësimi nga nxënësit në klasë.

Tekstet e shumëfishta: Nënkuptohen burime interpretative të ndryshme si fotografi, tabela, të dhëna qeveritare, pjesë të shkurtëra nga teksti bazë i lëndës për të mësuar.

Tekstet shkollore: Nënkuptohen burime informacioni, material për të mësuarit bazë të një lënde mësimore në shkollë.

Teksti mësimor: Nocioni tekst nënkupton material pune kushtuar nxënësve i hartuar, mbi bazën e planit dhe programit mësimor në përputhje me qëllimin dhe kërkesat/detyrat e caktuara, që siguron një bashkëveprim pedagogjik jo vetëm ndërmjet nxënësit e tekstit mësimor, por lehtëson edhe komunikimin ndërmjet mësimdhënësit e nxënësit.

Tematika: Biseda rreth temave për tematika të ndryshme për të bashkëbiseduar pyetur e përgjigjur njësoj lidhur me tematiken, duke u përpjekur që biseda mos të jetë asnjëherë jashtë temës së mësimimit.

Temperamenti i fëmijës: I referohet mënyrës së përgjithshme të reagimit të fëmijës ndaj objekteve, dukurive e situatave të ndryshme jetësore.

Temperamenti i mësimdhënësit: I referohet mënyrës së përgjithshme të reagimit e cila shprehet në dinamikën e veprimit të tij në mjedisin ku zhvillohet mësimdhënia, në klasë.

Temperamenti: Paraqet cilësinë psikike të personalitetit me bazë gjenetike, e cila shprehet në dinamikën e veprimit të individit në jetë.

Teori e Mësimimit: Disiplinë pedagogjike e cila studion mësimin me karakter pedagogjik, andrologjik, gnosologjik, ontologjik etj.

Teoria e ndikimit social (Vigotski): Teoria e cila thekson se të gjitha funksionet e një stadi më të lartë ndërveprimi rrjedhin nga marrëdhëniet mes individëve, andaj bashkëpunimi shoqëror luan një rol vendimtar në zhvillimin e plotë të aftësisë njohëse të fëmijës si në formimin e vëmendjes, kujtesës logjike, ashtu edhe

në formësimin e koncepteve. Sipas kësaj teorie çdo funksion i zhvillimit të fëmijës shfaqet dy herë: herën e parë, midis bashkëveprimit ndërmjet qenieve shoqërore dhe herën e dytë, si zhvillim i brendshëm i aftësive njohëse të tij.

Teoria enaktive: Teoria që vë theksin se të mësuarit nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të ri-interpretimit jolinear, njohja situacionele (e mbështetur në situatën) dhe jo e shkaktuar nga të mësuarit e cili merret kudo dhe kurdo, ndikon më se shumëti për të zgjëruar njohjën e mbivendosur të nxënësit.

Teoria e zhvillimit të identitetit (Marcia): Teoria që vë theksin në të mësuarit nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të zhvillimit të identitetit si: përhapja e identitetit, pezullimi, plotësimi i identitetit dhe përjashtimi.

Teoria e zhvillimit të përsonalitetit (Eriksenit): Teoria që vë theksin se të mësuarit dhe zhvillimit i identitetit janë piknisje kanë epigjenetiken biologjike ku fetusi zhvillohet në kohë të caktuar dhe mbi eksperiencën përsonale për tu formuar si përsonalitet (teoria ka disa stade zhvillimi) si nismëtar–fajtorë (4-5 vjeçar), të zellshëm-inferiorë (6-11 vjeçar), të identifikueshëm–konfuz (12-18 vjeçar).

Teoria bihejvioriste: Teoria që vë theksin se të mësuarit dhe zhvillimi duhet të fokusohen në ngjarjet e jashtme, si shkak (ndikim) i ndryshimeve në sjelljet e vëzhguara.

Teoria e edukimit humanist: Teoria që vë theksin se të mësuarit dhe zhvillimit duhet të fokusohet te aspekti psikologjik, përkatësisht ndjeshmëria e mësimdhënsit ndaj ndjenjave të nxënësit dhe vlerësimi i vlerave dhe qendrimeve pozitive për

veten nga nxënësi (si dashuria dhe vetëvlersim për të arritur aktualizimin, si vetëdije dhe vetëbesim se ai mund të (arrij) ti plotësoj nevojat bazike si: ushqim, strehë, veshje, etj.

Teoria e mendjës: Teoria që vë theksin se të mësuarit dhe zhvillimit duhet të fokusohen te mendimet, ndjenjat, besimet, dëshirat dhe përceptimet e fëmijëve/ nxënësve.

Teoria e Mësimit : Diciplinë pedagogjike që studion mësimin me karakter pedagogjik, androgogjik, interpretimet teorike të mësimit organizimin mbi bazën e fakteve nga hulumtimet në mësimsdhënie dhe në të mësuar.

Teoria e të mësuarit social (Bandura); Teori që vë theksin në të mësuarit nëpërmjet procesit të zhvillimit të plotë të potencialit të nxënësve sipas së cilës fëmijët vëzhgojnë dhe imitojnë një model sjellje duke kaluar në një proces në katër hapa: vëmendja, mbajtja, produkti, motivimi.

Teoria konstruktiviste e të mësuarit: Teori që vë theksin në të mësuarit që fokusohet në faktin që fëmija/nxënësi ndërton të mësuarit përmes një procesi konstruktiv.

Teoria rindërtuese e të mësuarit: Teori që vë theksin se të mësuarit nëpërmjet procesit të zhvillimit dhe rishikimit të teorive didaktiko-metodike në procesin e aktiviteteve hulumtuese integrative në procesin e të mësuarit.

Teoria shkencore: Një sistem gjithëpërfshirës koherent dhe konsistent i koncepteve ideve për të shpjeguar fenomene, orientime ose udhëzime për të shpjeguar fakte, si një ndërthurje e asaj që është e ditur me ato që hamendesohën, pra nga

parashikimet rreth botës, realitetit në të cilin ne operojmë dhe rezistencës në kohë, por që padyshim i hap rrugë qindra studimeve shkencore të mapasëshme.

Teoria shoqërore konjitive: Teoria që vë theksin të bindjet, përceptimet për veten dhe pritshmërit shoqërore të të mësuarit në mënyrë aktive nëpërmjet përvojave jetësore.

Teoria socialkulturore: Teoria që vë theksin në të mësuarit si proces social dhe kulturor ku interaktiviteti shoqëror luan rol thelbësorë në zhvillimin e fëmijës/nxënësit.

Teoria sociokonstruktiviste: Teori që vë theksin në të mësuarit e mëparshëm dhe ndikimit që ai ka nëpërmjet procesit të strukturimit të mendimit nga nxënësi ku mësimdhënësi e mbështetë nxënësin derisa ai/ajo të jetë në gjendje të arrijë të bëjë vetë atë.

Teoritë e mësimdhënies: Nënkuptohen teoritë që trajtojnë/përshkruajnë mësimdhënien procesin nëpërmjet metodave teknikave aktiviteve veprimtarive të propozuara për ti përdorura nga mësimdhënësit për të ndikuar në të mësuarit e nxënësve në situatë mësimore në klasë dhe jashtë saj gjatë mësimdhënjes.

Teoritë e të mësuarit: Teoritë e të mësuarit trajtojnë përshkruajnë qasjet, mënyrat, stilet afinitetet e të mësuarit nga situatat mësimore nga përvoja mësimore e fëmijë në shkollë duke u bazuar mbështetur te hulumtimi aktiv.

Teoritë e zhvillimit në edukim: Teoritë që trajtojnë, përshkruajnë zhvillimin, vazhdimësinë, vijueshmërinë dhe ndërlihdjen e aspekteve të zhvillimit të fëmijëve/nxënësve në edukim.

Teoritë “personale” reflektuese: Teori personale e praktikimit të mësimdhënies reflektuese me argumentet, interpretimet, mbarështrimet e rezultateve nga vet mësimdhënsit.

Tërheqja e vëmendjes së nxënësit: Ngjallja e interesit dhe kureshtjës së nxënësve për përfshirjen në procesin e të nxënit përmes diagrameve, vizatimeve, ilustrimeve apo materialeve të tjera mësimore.

Termi “kapitali human/ njerëzor” :Njërin nga dimensionet e brendshme të kapitalit intelektual e cila konsiston në: edukim, kompetencë, vlera, përvojë dhe pozitë shoqërore.

Testë i arritjës (kryerjës me sukses); Nënkuptohe mënyra e shfaqjës së demonstrimit apo kryerjës së domonstrimit në atletikë, not, gjimnastikë, sipas pikëve të kërkuara olimpike.

Testet e aftësive: Përmbajnë kërkesa/detyra, pyetje që masin aftësin e një nxënësi se sa është i aftë të bëj (dëshmoj, përformoj, të faktoj) një projekt, shkrim, vizatim, ushtrim, kodim) të vëzhgueshëm nga mësimdhënsi.

Testet e arritjeve: Teste të standardizuara (kur janë vlerësim i jashtëm) që realizohen në kushte dhe kritere të barabarta për të gjithë nxënësit që përfundojnë shkollën e mesme të ulët, ku specifikohen arritjet e të gjithë nxënësve sipas kërkesave/detyrave specifike në lëndë të ndryshëme apo për gjithë programin mësimor.

Testet e kalueshmerisë: Teste të standardizuara (vlerësim i jashtëm) që realizohet në kushte dhe kritere të barabarta për të gjithë nxënësit që përfundojnë arsimin parauniversitar

përkatësisht kandidatët për arsimin e lartë ku vlersohët përgaditja e tyre (kalimi apo jo i pragut të njohurive që është pesëdhjetë përqindëshi i njohurive të programit mësimor).

Testet joverbale: Teste të përpiluara me shembuj numerikë dhe vizatimorë, të shkrimit.

Testet me kombinime: Teste, një sistem detyrash, pyetjesh me kombinime në bazë të informacionit nga dy kolona: kolona në të majtë përmban listën e përshkrimeve, ndërsa kolona në të djathtë përmban listën e alternativave.

Testet moshore: Testet e organizuara me terma të niveleve moshore, zotërimin e njohurive dhe shkathtësive nga nxënësit në një fazë moshore të zhvillimit të fëmijës/nxënësit.

Testet verbale: Testet që bazohen në gjuhën e folur, për të matur lëximin, të folurit, intonacionin, diksionin etj.

Testi me përgjigje nga vetë nxënësi: Nënkuptohej një specifikë e veçantë, e përgjigjeve me ndërtim (që pritët të shtjellohet) që kërkojnë të shkruar ose vizatuar, demonstruar, si dhe ku kërkohet një problem me dy deri në katër fjali.

Testi me zgjedhje të shumëfishtë të thjeshtë: Nënkuptohen pyetjet kur nxënësit duhet të përzgjedhin mundësin e saktë ndërmjet katër mundësive të dhëna ose gjetje e një pikë kryesore që ka të bëjë me përgjigje nëpërmjet një grafiku ose teksti mësimor.

Testi me zgjedhje të shumëfishtë të përbërë: Nënkuptohen pyetjet kur nxënësve ju kërkohët përgjigje të shkurtra dhe që

vlerësohen si një e vetme e një ose më shumë përgjigjeve nga lista e dhënë, (plotësimi i një fjalie duke përzgjedhur ato fjalë që duhen) si dhe përgjigje që i lejojnë nxënësit që të lëvizin elemente për të plotësuar një detyrë që kërkon: për të çiftuar elemente të ndryshme të dy bashkësive, për të radhitur ose për të kategorizuar elementë të ndryshëm.

Testi i maturës: Testi standardizues i organizuar nga Masht për të gjithë nxënësit që kanë përfunduar arsimin parauniversitar (si dhe kandidatet nga arsimi për të rritur) në kushte të barabarta sipas rregullave dhe kritereve të vlerësimit.

Testi i standardizuar: Një test i standardizuar, administruar, i pikëzuar dhe i interpretuar në të njëjtën mënyrë, pavarësisht kur dhe ku është përdorur.

Testi me të vërteta - jo të vërteta të shumëfishta: Nënkuptohen pyetjet ku nxënësit duhet të zgjedhin ndërmjetë alternativave të shumta, (çdo alternativë si një deklaratë e veçantë) e cila mund të jetë përgjigje e vërtetë ose jo e vërtetë.

Testi vlerësues: Instrument për të matur dhe vlerësuar përparimin e nxënësve në lidhje me objektivat specifike të lëndës.

Testi: Një instrument sistem detyrash, pyetjesh, çështjesh, të lidhura logjikisht ndërmjet tyre, për matjen e njohurive, aftësive të cilat kanë të bëjnë me një fushë të caktuar dhe që duhen zgjidhur.

Testimi ese: Përdoret për të matur disa objektiva mësimorë me përgjigje të dhëna nga vetë nxënësit. Përveq përgjigjeve në këto

teste ka rëndësi shkrimi, mbarështimi i përgjigjeve dhe vlerësimi i tyre nga aspekti gjuhësorë.

Testimi në bazë kriteri: Zhvillohet atëherë kur rezultatet e testeve krahasohen jo vetëm me ato të nxënësve të tjerëve, por edhe me një kriter të dhënë paraprakisht si kriter gjykes/matës.

Testimi objektiv: Përmban pyetjet me alternativa, me ushtrime të korrespondimit pyetje-përgjigje, pohimet e saktë/e pasaktë dhe çështjet me përgjigje të shkurtra ose çështjet me plotësime.

Testimi: Nënkupton procedurën e vlerësimit gjatë së cilës përdoren testet me anë të cilave maten njohuritë, aftësitë, suksesi për përcaktimin e shkallës sasiore dhe cilësore të zhvillimit të një nxënësi në mësim.

Teza e masterit: Punim shkencor i cili realizohet nën mbikëqyrjen e profesorit të lëndës përkatëse (mentorit) me mbrojtjen e së cilës studenti arrin titullin master i shkencës (master shkencor apo master profesional).

Tradita kulturore: Nënkupton traditën në marrëdhënie familjare, kulturore ambientale, si dhe marrëdhëniet ndërnjerëzore në procesin e zhvillimit dhe formimit të individit.

Trajneri në mësimdhënie: Mësimdhënësi që ka njohuri të metodologjive bashkohore i cili trajnon mësimdhënësit tjerë sipas instuksioneve me qëllim bashkohësimi të strategjive dhe teknikave mësimore për një aspekt të mësimdhënies.

Trajnimet arsimore: Veprimtari relativisht joformale së paku krahasuar me sistemin ligjerues akademik në universitete me

instruksione praktike më qëllim bashkohësimi të strategjive dhe teknikave mësimore për një aspekt të mësimdhënies në klasë.

Trajnimet në mësimdhënie: Definoohen si përvetësim sistematik i shkathtësive rregullave, koncepteve apo qëndrimeve si dhe instruksioneve praktike me qëllim që të arrihet një performancë më e avancuar në mësimdhënie.

Trajnimi i integruar: Konceptohet si evoluim progresiv i praktikave të trajnimit, që ndikojnë në përforcimin e rëndësisë që i jepet trajnimit të mësimdhënësve në shërbim (një bashkëdyzim i përvojave kërkimore kritike të hulumtuara dhe praktikave mësimdhënëse të vëzhguara në klasë).

Transferimi anësor i të mësuarit: Nënkupton kur një aftësi e mësuar më parë përdoret për të zgjidhur një problem të ngjashëm me atë të hasur në një kontekst të ndryshëm jetësor.

Transferimi pozitiv i të mësuarit: Nënkupton kur një aftësi e mësuar më parë e bën më të lehtë të mësuarit e mëvonshëm.

Transferimi vertikal i të mësuarit: Nënkupton kur një aftësi e mësuar më parë përdoret në mënyrë të drejtëpërdrejtë në përvetësimin e një aftësie komplekse.

Transferimi i të mësuarit: Transmetimi i asaj që është mësuar në një kontekst, për t'u përdorur në kontekste të ardhshme (situatat dhe problemet).

Trashëgimi: Tërësia e predispozitave gjenetike të prindërve që barten përmes gjeneve dhe ndikojnë në zhvillimin e individit.

Tregu i kualifikimeve profesionale: Lloj i “veçantë ‘tregu që ka të bëjë vetëm me ofertat dhe kërkesat për kualifikime profesionale.

Treguesi arsimor: Statistikë e lidhur me politikën që synon të sigurojë informacion rreth kushtit, funksionimit ose veprimtarisë së një sistemi arsimor ose të një pjese të tij, por ato nuk janë dukuri në vetvete. Statistikat kualifikohen si tregues vetëm nëse ato përmbushin funksionin e pikës së referimit, trendet e të krahasimit.

Treguesit cilësorë: Shënojnë ndryshore që nuk është e lehtë të paraqiten numerikisht; për to përdoret shkalla vlerësuese-përshkruese.

Treguesit e variacionit: Japin informata për shtrirjen (gjërsinë) ose variabilitetin (llojllojshmërinë) e vlerave të të dhënave.

Treguesit sasiorë: Përmbajnë ndryshore që mund të paraqiten lehtësisht në mënyrë numerike.

Trysnia në të mësuar: Nënkuptohe shtyesa për të mësuar me ide dhe praktika të kuptimshme dhe mbështetëse të ndikuara nga mësimdhënësi për të pasur sukses fëmija/nxënësi, pa cenuar integritetin e tij personal.

Tolerancë në klasë: Sjelljeje tolerante të një mësimdhënësi ndaj nxënësve në mësim përkatësisht zhurmës gjatë lëvizshmërisë në klasë.

TH

Thellësia e përshtatjes së testit: Niveli sipas së cilit një test, ose forma të tjera të vlerësimit përfaqësojnë nivelin ose llojin e kompleksitetit njohës të përfshirë në objektiva dhe të shpjeguara në klasë nga mësimmshënësi.

Thellim i dijeve: Nënkupton drejtimin nëpërmjet pyetjeve nga mësimmshënësi për interesim të nxënësit dhe mundësive nga literatura për të mësuar më shumë, më specifikisht apo gjerësisht rreth çështjeve njohëse.

U

Udhëzime metodologjike: Nënkuptohen këshilla të shkruara ose të rishkruara orientuese që ndikojnë në mbarëvajtjen e orës së mësimit, me të cilat synohet të arrihet sukses gjatë gërshetimit të këtyre komponentëve: njohurive, aftësive dhe qëndrimeve mësimmshënëse. Udhëzimet i referohen njohurive specifike në aktivitetet mësimore, në vështirësi, në shembuj të zgjidhur, dhe vlerësime për ndikim pozitiv për mësimmshënësit në mësimmshënënie.

Udhëzon nxënësit: I referohet mësimmshënësit dhe praktikës kur ai kërkon që nxënësit të mbajnë një fletore të vogël apo ditar në të cilin të shkruan qëllime që vetë i ka vendosur dhe si do ti realizojë ato gjatë veprimtarive mësimore.

Udhëzues metodikë: Manualet shkollore, udhërrëfyesit pedagogjikë, programet kompjuterike, etj.

UNESKO: Organizata e Kombeve të Bashkuara për Shkencë, Arsim dhe Kulturë.

Universitet: Institucion shkencor- mësimor, i cili në përbërje të vetë ka më shumë fakultete (bashkësi fakultetesh) qëllimi i të cilave është përgatitja dhe aftësimi profesional shkencor e kërkimor i studenteve për profile të caktuara.

Ushtrime në mësim: Nënkuptohen aktivitete të rëndësishme (detyra, ushtrimore algoritma, plotësime nga teksti) sa i përket lëndës së caktuar, që lehtësojnë të kuptuarit dhe rrisin njohuritë e fituara nga nxënësi si në mësim dhe nën drejtimin e mësimdhënsit.

Utopi: Diçka e padukshme e imagjinuar apo që mendohet por që nuk bazë reale.

V

Validiteti bashkëveprues i pyetjës në kërkim: Kur një pyetje është e krahasueshme me një tjetër dhe matë në mënyrë valide të njëjtën përmbajtje.

Validiteti dallues i pyetjes në kërkim: Kur pyetja përdoret për të dalluar një grup nga tjetri.

Validiteti ndërtues i pyetjeve në kërkim: Kur disa pyetje, të cilat lidhen me një çështje, na japin rezultatin e kërkuar.

Validiteti parashikues i pyetjës në kërkim: Kur një pyetje përdoret për të parashikuar një sjellje.

Validiteti përmbajtësor në kërkim: Kur ekziston relevanca e pjesëve përbërëse të hulumtimit si tërësi.

Vallëzimi: Zhvillimi i ndjenjës për ritëm dhe koordinim të lëvizjes nga fëmijët/nxënësit sipas një korografie të përgaditur dhe të udhëhequr nga mësimdhënësi.

Varfëri rudimentale në fjalor: Nënkuptohe kur nxënësi ka vështirësi në vendosjen e fjalëve në fjali apo fjalit e formuara janë thjeshtë fjalë pa pasur asnjë lidhje në mes vete.

Variabël cilësor në kërkim: Kur vlerat e tij shprehen me fjalë.

Variabël i pavarur në kërkim: Faktori që matët, manipulohet ose seleksionohet nga studiuesi, me qëllim që të përcaktohet marrëdhënia e tij me një fenomen që vëzhgohet në hulumtim.

Variabël i varur në kërkim: Faktori që vëzhgohet dhe matet për të përcaktuar efektin e variablit të pavarur.

Variabël në kërkim: Dimension me të cilin mund të grupohen individë ose grupe.

Variabël sasior në kërkim: Kur vlerat e tij, të vërteta dhe jo ato të koduara, shprehen me numra.

Variabla të pavarura: Janë variabla që mendohet se influencojnë fenomenin që kemi objekt studimi, janë të kontrollueshme dhe të manipuleshme nga studiuesi.

Variabla të varura: Janë ndryshorët të cilët studiuesi përpiqet t'i parashikoj, pikërisht reagimin e variablave të varura duam të shohim dhe të masim në një studim kërkimor. Variabli i varur në

një studim, mund të shërbej si variabël i pavarur në një studim tjetër.

Variablat: Një koncept i matshëm siç mund të jetë moshë, peshë, pasuria, për klasifikimin e njerëzve, në kategori të ndryshme diskrete, dhe të vazhdueshme (në kuptimin e variacionit të tyre).

Veçim: Ndarja e individëve nga të tjerët në bazë të karakteristikave veçuese të tyre.

Vëmendja selektive: Fokusimi i veçantë ose selektiv në një pjesë të informacionit që regjistrohet në regjistrin tonë sensorë.

Vendëndodhja e të mësuarit: Përcakton ambientin e të mësuarit pra nënkupton vendin ku nxënësit pritet të realizojnë veprimtarin e të mësuarit brenda apo jashtë shkollës: në klasë, laborator, jashtë shkollës, në oborr, fushë futbollit etj.

Veprimi kognitiv: Nënkupton të menduarit rreth problemit që kërkon zgjidhje, analizë, vlerësim jo thjesht një rikujtim i atij koncepti.

Veprimi personal: Ndjesia e veprimit personal si përcaktuesi i motivimit për të mësuar.

Veprimtari mësimorë: Veprimtari e përbashkët e mësimdhënësit dhe nxënësve në një institucion arsimit gjatë së cilit nxënësit, nën drejtimin e mësimdhënësit, fitojnë njohuri, shkathtësi e shprehje, edukohen, zhvillohen nga ana mendore e fizike dhe aftësohen për të mësuar gjatë gjithë jetës.

Veprimtari plotësues kurrikulare: Veprimtari të strukturuar mësimorë, të qëllimshme që ndodhin jashtë kontekstit të lëndëve

ku përfshijnë projektet, sportet, punën vullnetare, fotografimin, dramën, muzikën etj.

Veprimtaria e të mënduarit dhe të lëxuarit të drejtuar (DRTA): Veprimtari e drejtuar leximi, e cila parashikon të përfshijë nxënësit në mënyrë vepruese në procesin e lëximit në klasë.

Veprimtaritë teatrore: Nënkuptohen aktivitete të mësimdhënësit me nxënësit sipas skenarëve të bazuar në vepra teatrale që praktikohen në klasë.

Verbositi: Nënkuptohet fjalëkuptimi, përkatësisht përdorimi i më shumë fjalëve, të gjata dhe pa kutim që nuk i shërben asnjë funksioni pedagogjik në komunikimin mësimdhënës nxënës të cilat nuk janë të nevojshme për të përcjellë një mesazh.

Vështirësi e gjuhës shprehëse: Vështirësi për t'i përdorur fjalët së bashku, fjalor të kufizuar ose paaftësi për ta përdorur gjuhën në mënyrë shoqërisht të përshtatshme.

Vështirësi e gjuhës perceptuese: Vështirësi për të kuptuar se çfarë thonë të tjerët.

Vështirësi në mësim: Një term “ombrellë” për një shumëllojshmëri vështirësishë me origjinë fiziologjike që burojnë nga mënyra se si truri e merr, e përpunon dhe e interpreton apo e përdor informacionin të cilat sjellin vështirësi në aktivitetet mësimore si: leximi, shkrimi, dëgjimi, të folurit, arsyetimi dhe kryerja e veprimeve matematikore në klasë.

Vështirësi që lidhen me zërin: Nënkuptohet një zë jo i zakonshëm, probleme që lidhen me intesitetin e zërit p.sh. zë

shumë i lartë, zë shumë i ulët, probleme të cilësisë së zërit: zë i çjerrur, zë i ngjirur, zë i zhurmshëm, zë hundor që shoqërohet me fërshëllimë, etj.

Vështirësi të artikulimit: Vështirësi që ka fëmija për t'i formuar apo lidhur tingujt, shkronjat ose rrokjet, pra kur fëmija zëvendëson një shkronjë me një tjetër, i lë jashtë ose nuk i përfshin shkronjat ose rrokjet, duke çuar kështu në deformimin e fjalëve ose në keqshqiptimin e tyre në artikulum.

Vështirësi të përziera gjuhësore: Vështirësi që ka fëmija për të kuptuar, për të përdorur ose për të shkruar fjalët dhe simbolet (p.sh. gjestet, gjuhën e shenjave) fonologjinë (rregullimi dhe kombinimi i duhur i tingujve), morfologjinë (strukturën e fjalëve), sintaksën (rendin dhe kombinimin e fjalëve në fjali); përmbajtjen e gjuhës (semantika, kuptimet e fjalëve dhe fjalive) dhe funksionin e gjuhës në komunikim (pragmatika, kombinimi i komponentëve të gjuhës (fonologjia, morfologjia, sintaksa dhe semantika) në mënyra funksionale dhe shoqërore të përshtatshme), ose çdo kombinim jo i drejtë i tyre që sjell vështirësi në të mësuar.

Vështirësitë gjuhësore: Vështirësi që kanë të bëjnë me dëmtime gjuhësore, për të shprehur nevojat, idetë ose mendimet e tij, ose për të kuptuar se çfarë thonë të tjerët.

Vështrim pedagogjik: Analizë profesionale nga konteksti real për të nxjerr kuptimin mbi pedagogjinë mësimdhënien dhe të mësuarit apo për një aspekt të veçantë mësimor.

Veta-aktualizimi: Nënkupton të qenit i vetëdijshëm dhe me vetëbesim se mund të arrijë dhe mund të mësojë, dëshira për

njohuri dhe aftësi që nuk ka lidhje me programin arsimor në shkollë.

Vetarsimimi: Nënkupton të mësuarit spontan (natyrshëm) ose sipas dëshirës personale nga vullneti dhe motivi i individit për zhvillim, vetëzhvillim, vetëformim dhe vetëngritje, jo si imponim nga jashtë, por si obligim dhe dëshirë individuale e njeriut.

Vetedukimi: Nënkuptohe funksioni subjektiv për të kultivuar dhe përsosur vetveten si aktivitet personal gjatë zhvillimit të personalitetit.

Vetëefikasiteti: Nënkupton bindjet e njeriut rreth zotësisë vetiake për të kontrolluar jetën e tij në situata të caktuara jetësore.

Vetëefikasiteti në të mësuar: Nënkupton energji dhe përpjekje personale, një ndjesi efikasiteti personal që rrit këmbëgjuljen dhe motivimin për të mësuar dhe kontribuar në arritje vazhduese jetësore.

Vetëmësimi: Nënkupton ngritje intelektuale personale, me dituri të reja nga përmbajtje heterogjene të mësimin, si libri, filmi, televizioni, radio, interneti etj.

Vetëmotivimi: Nënkupton motivimin që mbështetet nga qëllimet e arritëshme që e drejtojnë njeriun drejt qëllimeve më të mëdha jetësore.

Vetëpërforsimi: Nënkupton angazhimin e nxënësit për të zhvilluar një aftësi të caktuar nga vetëbesimi pa mbështetjen e mësimit duke bërë përshtatjet e nevojshme për të siguruar sukses në të mësuar.

Vetëstudim: Nënkupton studim pa mbikqyerje (i padetyruar dhe pa mbeshtetëjen e të tjerëve) me përzgjedhje të librave ose materialeve mësimore që duhen mësuar, në interes personal të vetë të rriturit për të përmbushur njohuri, arritur aftësi, qendrime vlera dhe gjykime vetanake.

Vetëvlerësimi i mësimdhënësit: Procesi gjatë të cilit mësimdhënësi mbledh informacione për veten dhe bën gjykimin e njohurive aftësive qëndrimeve dhe vlerave të tij në mësimdhënie.

Vlerësimi diagnostikues: Aktivitet vlerësimi që identifikon nivelet e arritjeve të nxënësve, për të orientuar mësimin drejtë plotësimin të nevojave të tyre për të mësuar.

Vetëvlerësimi i nxënësit: Vetëgjykim i nxënësit për arritjet e tij, ndërgjegjësimi që nxënësit i jepen kritere të sakta mbi të cilat ai/ajo bën vetëvlerësimin e punës së tij/saj p.sh.: për të korigjuar me shkrim gabimet më të shpeshta dhe më pas, ai/ajo ta integrojë korigjimin në veprimtarinë e kërkuar mësimore.

Vetëvlerësimi: Koncept që përkufizohet si të paturit e një opinionin (mendim të mirë për vetën) pozitiv për vetën që ndikon në sjelljen tonë, përvoja në situata sociale jetësore etj.

Vetëkoncepti: Të qenit në dijeni përcaktues i bindjes, se cili dëshiron të jetë apo është gjykim i vetës, si rezultat i arritjës ndjenjë kompetencë e veprimit personal (shpeshherë i shoqëruar me miratim social).

Vëzhgim i strukturuar: Lloj i kërkimit shkencor përmes të cilit të dhënat mbledhen duke vëzhguar dukurinë në mënyrë sistematike.

Vëzhgimet në klasë (orë mësimore): Janë mënyra të drejtpërdrejta për të përcaktuar se si realizohet procesi mësimor në klasë, se çfarë ndodh gjatë veprimtarive me nxënës në klasë p.sh. gjatë procesit të komunikimit.

Vëzhgimi në natyrë: Procesi shqisor me qëllim vëzhgimin e një fakti, një dukurie, të një procesi, të një ngjarje, të një realiteti në natyrë, për qëllime vlerësimi, për plotësimin dhe verifikimin e njohurive të mësuara në shkollë.

Vijues: Çdo person i regjistruar në çfarëdo programi për arsimin dhe aftësimin e të rriturve.

Vizioni i nxënësve: Ka të bëjë me atë që nxënësit duan të bëhen si do t'ia arrijë, me kalimin e kohës, ndërsa ata rriten e zhvillohen, e kanë një ide të qartë për veten se çfarë duanë të arrijnë në jetë.

Vlefshmëria e testit: Zakonisht përcakton se sa mirë një test mat atë që duhet të masë.

Vlefshmëria e përmbajtjes: Niveli sipas të cilit një test ose instrumente të tjera të vlerësimit, përfaqësojnë përmbajtjen e lëndës të përfshirë në kurrikul. Vlefshmëria e përmbajtjes mund të lëvizë (nga i lartë e deri te i ulët) vlerën e përmbajtjes.

Vlefshmëria: Cilësia që ka studimi kur ka qenë në gjendje të masë atë që ka synuar të masë.

Vlerat universale njerëzore: Nënkuptohen cilësitë e pranuar morale, sociale, estetike njerëzore, pa marrë parasysh hapësirën dhe kohën.

Vlerë: Bindje që ruhet thellë lidhur me çfarë është e rëndësishme ose e dëshirueshme që shprehet nëpërmjet qëndrimeve dhe veprimeve praktike të personave.

Vlerësim diagnostikues: Vlerësim që synon të zbulojë shkaqet njohëse, fizike, emocionale, shoqërore të problemeve që kanë nxënësit, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese.

Vlerësim i institucionit: Procesi i studimit dhe i analizës së anëve të forta dhe të dobëta të një institucioni arsimor, me qëllim inspektimi ose akreditimi.

Vlerësim i jashtëm: Një proces testimi i standardizuar që e zhvillon dhe e përdor një agjenci apo organ vlerësues që nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me institucionin shkollor por që shërben për të klasifikuar nxënësit sipas një ose disa kriterëve për njohuri aftësi, kompetenca, etj.

Vlerësim i koleksionit të detyrave të nxënësit: Detyra/kërkesa për punë me shkrim, drafte, punë artistike, prezantime të cilat pasqyrojnë njohuritë e reja dhe kompetencat e nxënësit në të mësuar.

Vlerësim i orientuar në qëllime: Vlerësimi që përdor qëllimet dhe objektivat si kriterë për të përcaktuar suksesin e nxënësit në të mësuar..

Vlerësim i orientuar në vendime: Procesi që prodhon një informacion për të marrë vendime, duke përzgjedhur ndërmjet dy (vendimeve) gjërave.

Vlerësim i progresit: Vlerësim i arritjeve të nxënësve për të siguruar informacion në lidhje me progresin e tyre (arritjet e tyre në fusha të ndryshme të kurrikulës/lëndëve mësimore dhe zotërimin e kompetencave kryesore.

Vlerësim sipas kritereve: Nënkuptohe kur diçka vlerësohet nga dikush në një mënyrë të caktuar dhe sipas kritereve të caktuara më parë.

Vlerësimi i brendshëm: Vlersimi i vazhdueshëm nga mësimdhënësi i pikëve të forta dhe të dobëta të nxënësve, duke iu dhënë atyre informata që synon të njohë gjendjen dhe nivelin që mund t'a arrijnë nxënësit si bazë për të përcaktuar ecurin e të mësuarit në të ardhmën dhe të shërbejnë si bazë për të përzgjedhur shkollimin e mëtutjeshëm si dhe aftësimin për punësim.

Vlerësimi në proces mësimor: Veprimtari e planifikuar e vazhdueshme dhe pjesë integrale e praktikave të procesit të mësimdhënies dhe të mësuarit (si vlerësim me test ose me anë të vlerësimit me portofolin lëndor të nxënësit, nëpërmjet vlerësimit periodik).

Vlerësimi autentik nga mësimdhënësi: Përfshin shumë më tepër sesa çka mësojnë nxënësit, që janë të matshme nëpërmjet testeve të standardizuara ose testeve të zakonshme të përgatitura nga profesori. Autenticiteti vjen nga vlerësimi i asaj që është më e rëndësishme dhe jo nga vlerësimi i asaj që është e standardizuar.

Vlerësimi diagnostifikues: Nënkupton vlerësim lidhur me shkaqet ose arsyet që krijojnë probleme ose dështime në të mësuar, përdoret si bazament për të përcaktuar se çfarë pjese ka zënë procesi i të mësuarit gjatë orëve mësimore.

Vlerësimi i mirëfilltë: Procedurë për vlerësimin e zbatimit të aftësive dhe shprehive të fituara nga nxënësit, siç do të bënin në jetën reale.

Vlerësimi formues: Nënkupton tërësinë e metodave, praktikave dhe teknikave për të testuar, për të kontrolluar, analizuar dhe për të matur nivelin e njohurive, aftësive dhe të arritjeve të nxënësit.

Vlerësimi i burimeve: Synon të sigurojë një informacion për të përcaktuar se si do të përdoren burimet për të arritur objektivat e projektit, programit.

Vlerësimi i kontekstit: Ka si qëllim të përcaktojë kontekstin veprues, të përshkruajë kushtet aktuale, të identifikojë dhe të vlerësojë nevojat dhe mundësitë në kontekstin e dhënë, të diagnostikojë problemet.

Vlerësimi i kurrikulumit: I referohet procesit të përcaktimit të vlerës së një aspekti ose të tërë kurrikulumit. Objekti i vlerësimit mund të jenë nevojat për kurrikulumin, politika e kurrikulumit, përmbajtja e tij, procesi i mësimdhënies, mjetet mësimore, objektivat mësimore, përvetësimi i kurrikulumit mësimor nga nxënësit, efektshmëria e mësimdhënies, mjedisi, etj.

Vlerësimi i mësimdhënësit: Vlerësimi është procesi i verifikimit, i gjykimit të mësimdhënësit, duke përdorur një standard vlerësimi që përfshin gjykimet sipas evidencës së njohurive, aftësive,

sjelljeve dhe nevojave të tyre e të cilat krahasohen me standarde dhe kompetenca të paracaktuara si përshkrim vlerorë standard për mësimdhënësin.

Vlerësimi i nxënësit: Gjykimi i mësimdhënësit mbi arritjet e nxënësit për përmbajtjen e përvetësuar i bazuar në kritere dhe në plan program mësimor.

Vlerësimi i nxënësve me notë: Pjesë perfundimtare e gjykimit të mësimdhënësit, të praktikës vlerësuese kur ai vendos (shënjon me numër ose përshkrim me fjalë në ditarë) gjykimin për nxënësin në një lëndë mësimi.

Vlerësimi i përformancës: Çdo formë vlerësimi të nxënësve kur kryejnë një veprimtari, demonstrojnë të mësuarit e tyre, një realizim detyre i vëzhgueshëm, i vlefshëm e i besueshëm dhe i saktë nga nxënësi në klasë.

Vlerësimi i personelit mësimor: Vlerësimi që i bëhet personelit mësimor (përmes testeve të përformancës) në procesin e mësimdhënies.

Vlerësimi i procesit mësimor: Vlerësimi i procesit përshkrues për arritjet dhe për interpretimin e rezultateve në mënyrë që siguron një informacion për kapërcimin e vështirësive dhe për marrjen e vendimeve të mëtejshme si: të parashikojë vështirësit në procedurat ose gjatë zbatimit: të regjistrojë procedurat siç kanë ndodhur: të sigurojë informacion për marrjen e vendimeve, etj.

Vlerësimi i produktit: Synon të masë vlerësojë dhe të interpretojë produktin.

Vlerësimi informal: Vlerësim (formues), me anën e të cilit mësime dhënësi grumbullon informacione nga burime të shumta siç janë: vëzhgimet e nxënësve, listat e verifikimit, pyetjet, ditarët dhe vetëvlerësimet e tyre gjatë procesit të zhvillimit dhe pjesëmarrjes aktive si bazë për të përcaktuar gjykimin përfundimtar të nxënësit.

Vlerësim rezultati në arsim: Procesi gjatë të cilit gjykohet mbi bazën e një kriteri për vlerën e një rezultati arsimor, mbi bazën e informacioneve të grumbuluara më parë.

Vlerësimi nëpërmjet portofolit: Vlerësimi, për nxënësin se si ai avancohet hap pas hapi, nga një koleksion punimesh të organizuara prej tij gjatë vitit shkollor (detyra shtëpie me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e dëshmi të veprimtarive kurrikulare).

Vlerësimi përmbledhës nga mësime dhënësi: Një gjykim që matë arritjet e njohurive dhe të aftësive të përfutuara nga nxënësi në shkollë që përdoret për vendosjen e notave nga mësime dhënësi (rezultatete përfundimtare).

Vlerësimi përmbledhës për programet: Përcakton arritjet në përfundim të programit, projektit, kursit, për të gjykuar efektshmërinë e programeve, projekteve, kurseve, etj

Vlerësimi i përgjithshëm: Termi përdoret për të përshkruar veprimtaritë e mësime dhënësit për të mbledhur informacion për njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet për të vendosur mbi to një vlerë gjykimi.

Vlerësues amator: Personi që kualifikimin kryesor profesional nuk e ka në fushën e vlerësimit, ndërkohë që angazhimin në këtë fushë e ka vetëm si pjesë të biografisë së tij profesionale.

Vlerësues profesionist: Person që dallohet nga kualifikimi i gjerë në fushën e vlerësimit dhe ka detyrë e përgjegjësi kryesore hartimin, drejtimin e administrimin e vlerësimeve.

Vlerësuesi (hulumtues) në mësimdhënie: Përsoni i kualifikuar për vlerësime kuptimplota, me attribute të veçanta aftësi e profesionalizëm në procesin e vëzhgimit të fakteve, aspekteve dhe proceseve që lidhen me mësimdhënien në klasë, në qartësimin e çështjeve për të cilat ai/ajo interesohet të vlerësoj mësimdhënësin.

Vlerësimi i drejtë dhe korrekt i nxënësve: Procesi i vlerësimit të nxënësve kur dihet vëllimi (sa duhet të dijë nxënësi) cilësia (si duhet ti paraqes njohurit dhe cilat njohuri) dhe përgjegjësia (vlerësimi i drejtë/korrekt për nxënësin).

Vlerësimi i fokusuar: Gjykimi për njohurit dhe aftësitë e nxënësit specifik për një aftësi që është në fokus të vlerësimit (p.sh nga të shkruarit vetëm shenjat e pikësimit, bukurshkrimi, etj).

Vlerësimi i programit: Procesi i mbledhjes se fakteve dhe provave që të gjykohet vlere (numerike ose përshkruese) e një programi të caktuar arsimor/shkollor që vlerësohet.

Vlerësimi i informacionit në të mësuar: Nënkupton dhënien e gjykimit rreth shkallës së rëndësisë së asaj çka nxënësit kanë informacion dhe vlefshmërisë së informacionit në të mësuar.

Vlerësuesi i brendshëm: Profesionisti që harton pyetjet, administron testimin dhe vlerëson të mësuarit, mësimdhënësi.

Vlerësuesi i jashtëm:Personi i specializuar nga një institucion ose agjencion i jashtëm që harton pyetjet, administron testimin dhe vlerëson të mësuarit.

Vrojtimi i drejtpërdrejtë: Teknikë për të vlerësuar aktivizimin e nxënësit në aktivitete mësimore, ndihmesën e punës në projekte grupore.

Vullnet: Sjellje dhe veprim individual i qëndrueshëm për arritjen e një aspekti të caktuar.

Z

Zakonet: Nënkuptohen karakteristika shprehëse specifike të komunikimit që posedojnë njerzit e një vendbanimi të caktuar si përshëndetje, debate (toni i zërit) mikëpritje, falënderime, etj.

Zbatimi i kurrikulës: Termi “zbatim” ka të bëjë me “përdorimin në praktikë” të një kurrikulumi/programi mësimor ose me “çfarë përbëhet ai në praktikë”. Zbatimi është një fazë kritike në ciklin e planifikimit të një kurrikulumi.

Zbehja: Mësimdhënësi që heq apo zbeh gradualisht dhe në mënyrë sistematike ndihmën ndaj nxënësit. p.sh. i heq nxitjen dhe shpërblimin e dhënë fillimisht për detyrën, duke e bërë nxënësin të punojë më i pavarur.

Zemërimi në të mësuar :Ndjenja e dështimit të zgjidhjes së një detyre pas shumë përpjekjeve tona që ia atribuojmë vetës apo faktorëve të pakontrollueshëm.

Zënkat: Janë kundërshti me kohëzgjatje të shkurtër, si mosmarrëveshjet verbale me ton të lartë në mes fëmijëve dhe të cilat shpeshëherë përfundojnë me shtyrje, bërtitje, përdorimi i gjuhës nënçmuese, fyerje, kërcënim, frikësim, poshtërim, e deri në grushtim në mes të nxënësve në klasë.

Zëri i nxënësve: Opinionet, mendimet, këndvështrimet origjinale të nxënësve për të mësuarit mësimdhënien, vlerësimin, shkollën siç i përjetojnë ata vet pra në procesin e zhvillimit të tyre në shkollë.

Zgjidhja e konflikteve në klasë nga mësimdhënësi: Zgjidhja në klasë e konflikteve në mes të nxënësve në situata mësimore apo jashtë mësimore (këshillimi si të kuptoj problemin, të menaxhoj, të ndihmoj, dhe të gjëj zgjidhje përmes komunikimit në shuarjen e konflikteve në klasë).

Zgjidhja e problemeve në klasë: Përfshin strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në klasë nga mësimdhënësi.

Zgjim i interesit për të mësuar: Ndikim nxitës i mësimdhënësit duke ftuar, përfshir dhe gjallëruar klimën e të mësuarit tek nxënësit përmes mësimin aktiv, hulumtues etj.

Zotërimi i informacionit nga nxënësi: Parametri për të gjykuar informacionin mbi ndërtimin e fjalëve, të cilat mund të qendrojnë në një fjalë dhe fjalit me njera tjetrën e deri te diskursi.

Zotim: Fjalë e dhënë nga një person verbalisht apo me shkrim, marrje e vullnetshme e obligimit për të kryer një punë ose për të bërë diçka mbi bazën e një marrëveshje verbale, apo të shkruar me një person apo një institucion.

Zona e zhvillimit proksimal apo zona e zhvillimit të përfaqësues (Lev Vygotsky): Një koncept i zhvilluar që përfaqëson distancën optimale ndërmjet asaj që një fëmijë/nxënës e ka mësuar tashmë dhe asaj që një fëmijë/nxënës mund të mësojë përmes udhëzimeve ose ndihmës së të rriturve, ose të bashkëmoshatarëve me të përgatitur.

ZH

Zhënjimi: Termi i referohet ndjenjës (të ndjerit) së papritur brenda vetes për mosarritjen e një synimi për vetën, paknaqësisë në arritjen e pritshmërive për të marrë arritur “diçka” për shumë arsye.

ZhKBSH: Akronim për të gjitha vendimet që merren në nivelin e shkollës, ku përfshihen krijimi i programit, zgjedhja e tij, zgjidhjen e materialeve që janë në dispozicion, dhe bërjen e përshtatjeve të nevojshme sipas interesave dhe nevojave të bashkësive shkollore.

Zhurma: Një përbërës fizik që ndikon negativisht (në vesh dhe në strukturat e larta të trurit) tinguj të padëshiruar që vlerësohet nga mësimdhënësi si penguese në mësim/komunikim gjatë procesit mësimor.

Zhvatje në edukim: Formë e përfitimit pa bazë ligjore nga personi apo personat si kushtëzim për dhënien e vlerësimit pozitiv ose çertifikimit.

Zhvillim i gjithanshëm: Zhvillimi i individit në të gjitha aspektet: intelektuale, morale, fizike, estetike, punuese të personalitetit.

Zhvillim i qëndrueshëm në edukim: Nocioni nënkupton qëndrueshmëri orientimi dhe efikasiteti të proceseve dhe praktikave që janë në themel të vijave orientuese në sistemin edukativ të një vendi si garancë për të ardhmën.

Zhvillim i shkollës: Përparimi apo ngritja graduale nëpërmjet një vargu ndryshimesh progresive në aspektin e ofrimit të një ambienti dhe procesi edukimi cilësor.

Zhvillim: Termi i referohet ndryshimeve (jo të gjitha ndryshimeve vetëm atyre sistematike) që ndodhin të qeniet njerëzore nga çasti i ngjizjes deri te çasti i vdekjes.

Zhvillim vetiak: Termi i referohet ndryshimeve në personalitetin e individit.

Zhvillimi fizik: Termi i referohet ndryshimeve në strukturën trupore si dhe për funksionet jetësore të zhvillimit gjatë gjithë jetës.

Zhvillimi i mësimdhënësve në fazën e hyrjës në profesion/ induksionit: Faza që përfshin vazhdimin e kompetencave për mësimdhënie mbi bazën e eksperiencës dhe praktikës që ndodh në klasë, pas përfundimit të sukseshëm “merret” fitohet edhe licencimi si parakusht i njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që duhet ti zotërojë një mësimdhënës i ri.

Zhvillimi i mësimdhënësve para shërbimit: Nënkupton përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, faza e parë në aspektin teorik si parakusht i njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që duhet ti zotëroj “merret” fitohet në universitetet që përgadisnin mësimdhënës.

Zhvillimi kognitiv: Nënkupton përsosmërinë e funksioneve të intelektit, të cilat mund të shihen si ndryshime (graduale pozitive) duke përfshirë vëmendjen, memorien, zgjidhjen e problemeve, kreativitetin dhe gjuhën akademike.

Zhvillimi konjitiv: Termi i referohet ndryshimeve në mendime (ndryshime të shkallëshkallëshme dhe sistematike përmes të cilave proceset mendore bëhen me komplekse dhe me të sofistikuara).

Zhvillimi i proceseve kognitive të fëmijëve/nxënësve: Nënkupton karakteristika të arritjes graduale të kognicionit (njohjes) si: organizimi, adaptimi, asimilimi.

Zhvillimi social: Termi i referohet ndryshimeve përgjatë viteve në mënyrë se si lidhemi dhe komunikojmë me të tjerët në shoqëri.

Zhvillueshmëria spirale e programit mësimor: Zgjërimi i vëllimit dhe i përmbajtjeve të nocioneve për nivele të ndryshme të programit mësimor.

Literatura

1. P. Bejtja, P. (1999). Profesionit – si dukuri social pedagogjike, Buletini ‘Politika sociale’.
2. Biehler, F. Robert, Jack Snoëman, (2004), Psikologjia e zbatuar në mësimdhënie, ISP, “Nënë Tereza”, Tiranë.
3. Bruner, Jerome (2003), Kultura e edukimit, ISP, Tiranë.
4. Brussel: Directorate-General for Education and Culture. November 2003.
5. Common European Principles for Teacher Competencies and Qualifications. – Brussels European Commission. Education and Training 2010: Progress Report.
6. Çela, Vita (2003), Cilësia ë procesit të mësimdhënies dhe metodat e punës së mësuesit ruajnë e përmirësojnë cilësinë e shkollës, “Vlerësimi i Arsimit, nr. 3, ISP, Tiranë.
7. Fjalor për Arsimin dhe Formimin Profesional, Observatori Kombëtar i Shqipërisë, 2001.
8. Freitag, K. W. (2007). Permeability in education, vocational training and further education – the key to lifelong learning.
9. Green Paper on Teacher Education in Europe (2000). High Quality Teacher Education for High Quality Education and Training by Bucherberg F., Campos B.P., Kallos D., Stepherson J. (eds). Umea: TNTEE.
10. Grillo, Prof. Dr. Kozma (2002), Fjalor Edukimi (Psikologji – Sociologji- Pedagogji), ISP, Tiranë.
11. Heckman, J. 2008. “Schools, skills, and synapses.” Economic Inquiry.

12. Hutmacher, W.: Key competencies for Europe Report of the Symposium. Berne, Switzerland 27-3- March, 1996. Council for Cultural Cooperation (CDCC)
13. Karaj, Th. Psikologjia e zhvillimit të fëmijës. Progres, 2005
14. Key competences for Lifelong Learning - European reference framework, 2007
15. Kraja, Prof. Dr. Musa (2006) dhe (2002), Pedagogjia, Tiranë.
16. Mailaret, Gaston (1997), Pedagogjia e përgjithshme, “Koha”, Prishtinë.
17. Marsh, J. Colin. (2009). *Koncepte themelore për ta kuptuar kurrikulumin*. Botimi i katërt në shqip, Tiranë, Qendra për Arsim Demokratik.
18. Matthews, B./ Ross, L (2010): Metodatat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. Qendra për Arsim Demokratik (CDE). Tiranë.
19. Mita, Nikoleta (redaktore), (1999), Metodatat e mësimdhënies, Tiranë.
20. Murati, Prof. Dr. Xheladin (2004), Pedagogjia e përgjithshme, “Logos”, Shkup.
21. Musai, Bardhyl, (2014), Metodologjia e mësimdhënies, “Pegi”, Tiranë.
22. Osmani, Shefik (1983), Fjalor i pedagogjisë, “8 Nëntori”, Tiranë.
23. Papa.J.Michel;Daniels.D.Tom Spiker.D.Bony.’Komunikimi organizativ –qasjet dhe pritjet’UET Press .2009.
24. Peffers, J., Reid, E., Stylianidou, dr.F., Walsh, dr.P., & Young, prof. Michael (2005). Planprogramet kombëtare në Kosovë – Vlerësim i hapave të parë. Instituti i Edukimit, Universiteti i Londrës.

25. Rexhepagiq, Jashar (2002), Tema të zgjedhura dhe bashkëkohore pedagogjike, ASHAK, Botime të veçanta XXXIX (Seksioni i shkencave shoqërore, libri 11), “Libri shkollor”, Prishtinë.
26. The shift to learning outcomes – Conceptual, political and practical developments in Europe, CEDEFOP, 2008
27. Vladimir (1985), Sistemet mësimore, ETMM, Prishtinë.
28. Walton Dominique “Te shpetojm Komunikimin “UET Press .2009. 2009
29. Wilson, C. (2001), Defining and Teaching Learning Outcomes
30. Zajazi, Tahir (2003), Metodologjia të mësimdhënies dhe mësimnxënies (Strategji & Teknika për Rivendosjen e Shkollës), EJT, Shkup.

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja "Blendi", Prishtinë

Tirazhi: 200 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37(038)=18

811.18'374.2'373.46:37

Azemi, Bashkim Ali

Fjalor i pedagogjisë / Bashkim Ali Azemi. -
Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2024. -
256 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-591-70-6

ISBN 978-9951-591-70-6



9 789951 591706